



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I SË DREJTËS CIVILE



Rruga "MILTO TUTULANI", Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax. + 355 4 222 537, <http://www.fdut.edu.al>

DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

"I. Kuptimi i përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile. II. Dallimet e institutit të përfaqësimit nga kontratat e porosisë, komisionit dhe agjencisë. III. Aspekte të praktikës gjyqësore lidhur me institutin e përfaqësimit".

Kandidati

Neritan CENA

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Ardian NUNI

TIRANË 2021

E drejta e autorit :

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorim dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjete apo forme pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin nr. 20, datë 13.11.2008.

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie	v
Hyrje	vi
Metodologjia	vii
Çështje të etikës	ix

Kreu I :

KUPTIMI I PËRFAQËSIMIT SI INSTITUT I VEÇANTË I TË DREJTËS CIVILE SI DHE TRAJTIMI HISTORIK I ZHVILLIMIT TË KËTIJ TË FUNDIT

Kuptimi i përfaqësimit si institut i të drejtës civile	1
Zhvillimi historik i përfaqësimit në sistemin Civil Law, si dhe ndarjet që i bëhen përfaqësimit	2
Kalimi nga koncepti i mandatit tek instituti i përfaqësimit	2
Përfaqësimi i drejtpërdrejtë (direkt) dhe jo i drejtpërdrejtë (indirekt)	3
Përfaqësimi aktiv dhe përfaqësimi pasiv	4
Zhvillimi historik i përfaqësimit në sistemin tonë të brendshëm të së drejtës	4
Trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1929.....	4
Trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas parashikimeve të Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.....	7
Trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1981.....	10
Kuptimi i përfaqësimit si institut i të drejtës civile, si dhe karakteristikat e këtij të fundit sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1994 (Kodi Civil aktual).....	12
Kuptimi i përfaqësimit sipas Kodit Civil të vitit 1994.....	12
Veprimet që nuk mund të kryhen me përfaqësim	13
Karakteristikat e përfaqësimit si institut i të drejtës civile.....	14

KREU II

LLOJET E PËRFAQËSIMIT SI DHE TRAJTIMI I TYRE NË RAPORT ME INSTITUTE TË TJERA TË SË DREJTËS CIVILE

Llojet e përfaqësimit.....	20
Përfaqësimi ligjor ose i detyrueshëm	20
Përfaqësimi vullnetar.....	21
Prokura	23
Forma e prokurës	23
Llojet e prokurave	24
Mbarimi i prokurës.....	25
Delegimi i pushteteve të përfaqësimit (nënprokura)	30
Dallimet e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile nga institute të tjera të së së drejtës civile.....	32
Dallimet e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile nga gjerimi i punëve	

të tjetrit	33
Dallimet e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile nga kontrata në dobi të personit të tretë.....	38

KREU III

TRAJTIMI I PËRFAQËSIMIT PA TAGRA DHE PASOJAT QË SJELL KY I FUNDIT NË RAPORT ME TË TRETËT.TRAJTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT LIDHUR ME INSTITUTIN E PËRFAQËSIMIT DHE I PASOJAVE TË TIJ NË RAPORT ME TË PËRFAQËSUARIN. FORMAT E NDRYSHME TË SHFAQJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE.

Trajtimi i përfaqësimit pa tagra dhe pasojat që sjell ky i fundit në raport me të tretët	39
Trajtimi i kuptimit të përfaqësimit pa tagra dhe format e shfaqjes së këtij të fundit	39
Natyra e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra	51
Koha e nevojshme për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra, si dhe forma e miratimit	55
Koha e nevojshme për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra	55
Format e miratimit të veprimeve të përfaqësuesit pa tagra nga ana e të përfaqësuarit	61
Ekzistenca e veprimeve juridike që nuk kanë nevojë për miratim	69
Shtrirja e përfaqësimit pa tagra	71
Përgjegjësia e përfaqësuesit pa tagra	72
Trajtimi i Konfliktit të interesit lidhur me institutin e përfaqësimit dhe i pasojave të tij në raport me të përfaqësuarin.....	81
Format e ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesave	95
Konflikti i interesave ndërmjet prindërve dhe fëmijëve	95
Konflikti i interesave ndërmjet kujdestarit dhe fëmijëve të mitur që ndodhen në kujdestari.	97
Konflikti i interesave ndërmjet kujdestarit dhe personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar	97
Konflikti i interesave ndërmjet bashkëshortëve	98
Konflikti i interesave në shoqëritë tregtare	100
Konflikti i interesave avokat – klient.....	100

KREU IV

DALLIMET E INSTITUTIT TË PËRFAQËSIMIT NGA KONTRATA E POROSISË, KOMISIONIT DHE AGJENCISË

Dallimet dhe ngjashmëritë e institutit të përfaqësimit nga kontrata e porosisë.....	102
Dallimet	103
Ngjashmëritë	110

Dallimet dhe ngjashmëritë e institutit të përfaqësimit nga kontrata e komisionit	116
Dallimet	116
Ngjashmëritë	118
Dallimet dhe ngjashmëritë e institutit të përfaqësimit nga kontrata e agjencisë	119
Dallimet	119
Ngjashmëritë	120

KREU V

PËRFAQËSIMI NË GJYQ (AD LITEM), SI DHE ASPEKTE TË PRAKTIKËS GJYQËSORE LIDHUR ME INSTITUTIN E PËRFAQËSIMIT

Kuptimi, llojet dhe karakteristikat e përfaqësimit gjyqësor.....	122
Trajtimi i përfaqësimit gjyqësor vullnetar ose kontraktual.....	124
Trajtimi i përfaqësimit gjyqësor ligjor ose të detyrueshëm	129
Dallimet ndërmjet përfaqësimit vullnetar nga ai ligjor, rrethi i personave që mund të caktohen si përfaqësues, si dhe mbarimi i përfaqësimit gjyqësor.....	133
Dallimet ndërmjet përfaqësimit vullnetar nga ai ligjor.....	133
Rrethi i personave që mund të caktohen përfaqësues.....	133
Rastet e mbarimit të përfaqësimit gjyqësor.....	139
Përfaqësimi gjyqësor i shtetit dhe i personave juridikë publikë.....	140
Fenomeni i kufizimit të autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit.....	142

KREU VI

KONKLUZIONE, REKOMANDIME DHE BIBLIOGRAFIA

Konkluzione dhe Rekomandime	146
Bibliografia	159
Abstrakt (shqip – anglisht).....	164

PARATHËNIE

Ky punim ka për qëllim të tij një trajtim të zgjeruar të përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile, meqenëse ky i fundit po merr një rëndësi të veçantë në vendin tonë në kuadër kjo të intensifikimit të marrëdhënieve juridiko – civile. Si rrjedhojë e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave nevoja e të vepruarit me përfaqësues rezulton që të jetë shndërruar në një domosdoshmëri si për personat fizikë ashtu edhe për ato juridikë, kjo për shkak të mungesës së kohës së nevojshme nga ana e këtyre të fundit për të kryer të vetëm të gjitha veprimet juridike apo veprime të tjera të ligjshme.

Në trajtimin e dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë institutin e përfaqësimit për efekt krahasimor do i referohemi si dispozitave të Kodit Civil Gjerman nga dhe e ka burimin edhe trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas të drejtës sonë të brendshme, ashtu edhe dispozitave të Kodit Civil Italian, si dhe në kuadër të intergrimit të vendit tonë në Bashkimin European ju referuam në mënyrë të veçantë edhe parimeve europiane të të drejtës kontraktore (PECL), si dhe parimeve të të drejtës ndërkombëtare tregtare (UNIDROIT).

Në trajtimin e mjaft koncepteve që lidhen me institutin e përfaqësimit, si dhe dhënien e vlerësimit personal dhe rekomandimet përkatëse për efekt krahasimor do i referohemi edhe qëndrimit doktrinal të mbajtur nga profesorë të njohur të të drejtës civile vendas dhe të huaj, në trajtimin që këta të fundit i kanë bërë institutit të përfaqësimit, si dhe qëndrimit që ata kanë mbajtur lidhur me problematika të caktuara të ndeshura këto në marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, ndërmjet përfaqësuesit dhe personave të tretë me të cilët ai ka kryer veprimet juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, si dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe personave të tretë.

Në morinë e trajtimeve të shumta që i janë bërë institutit të përfaqësimit nga profesorë të njohur të së drejtës civile qofshin këta të huaj apo vendas shpresoj që ky punim të kontribuojë sadopak në pasurimin e literaturës juridike shqiptare në fushën e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile, për efekte studimore si nga ana e studentëve të së drejtës ashtu edhe nga prakticienët e kësaj të fundit meqenëse punimi krahas trajtimeve teorike është ilustruar edhe me raste të praktikës gjyqësore, si dhe me situata të cilat në kuadër të intensifikimit të marrëdhënieve juridiko - civile do të ndeshen në jetën e përditshme, duke u bërë në këtë mënyrë pjesë e konflikteve gjyqësore që do paraqiten për zgjidhje para gjykatës në të ardhmen e afërt.

HYRJE

Origjina e përfaqësimit si institut i të drejtës civile është e vjetër dhe e lidhur me vetë fillimet e kësaj të drejte. Kalimi nga shoqëria agrare në shoqërinë industriale është periudha kur nevoja e përfaqësimit në kryerjen e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ndryshme paraqitej e domosdoshme. Marrëdhëniet civile dhe veçanërisht ato tregtare nuk mund të kuptoheshin pa këtë institut dhe institute të tjera të ngjashme.

Nocioni i përfaqësimit të drejtpërdrejtë rezulton që t'i ketë fillimet e tij që në fillim të shekullit të trembëdhjetë, i cili përbën edhe shekullin e ndryshimeve të dukshme tregtare dhe diplomatike.

Prej asaj kohe dhe në vijim institutit të përfaqësimit i janë kushtuar mjaft trajtime doktrinare, të cilat fillojnë me kanonistët e shekullit të trembëdhjetë, Domat dhe Pothier dhe vijnë më pas me juristë të shumtë, kryesisht gjermanë dhe francezë ndërmjet të cilëve vlen të veçohet juristi i famshëm gjerman Proff. Laband, i cili në studimin e tij "*Die Stellvertretung bei dem abschluss von Rechtsgeschäften*" (Përfaqësimi në kryerjen e veprimeve juridike) botim i vitit 1881, ishte i pari që bëri dallimin e institutit të përfaqësimit nga kontrata e porosisë, duke vënë theksin në trajtimin e përfaqësimit dhe konkretisht atij vullnetar si një marrëdhënie juridike që lind mbi bazën e një veprimi juridik të njëanshëm sikurse është prokura. Ky trajtim gjeti pasqyrimin e tij edhe në Kodin Civil gjerman të vitit 1896 (BGB) dhe prej aty u përhap në të gjitha kodet civile të vendeve që ndoqën traditën gjermanike të së drejtës, ndër të cilët është edhe vendi ynë.

Në kohët më moderne trajtime të shumta të përfaqësimit janë bërë nga profesorë dhe studiues të njohur të së drejtës civile anembanë kontinentit europian dhe në gjithë vendet e tjera që ndjekin traditën e të drejtës civile, ndër të cilët do të veçoja trajtimet e juristëve francezë Jacques Flour, Luc Jeam dhe Jacques Chestin, trajtimet e profesorëve italianë të së drejtës Andrea Torrente, Alberto Trabuchi dhe Francesco Galgano, trajtimin e profesorit rus të së drejtës civile D.M.Genkin, trajtimet e profesorëve gjermanë të së drejtës Karl Larenz dhe Manfred Eolf, Franz Jurgen Sacker dhe Hans Schramm, si dhe në mënyrë të veçantë edhe trajtimin e autorëve Ole Lando dhe Hugh Beale në librin e tyre të titulluar : "The Principles of European Contract Law", (Parimet europiane të të drejtës kontraktore), si dhe trajtimet e profesorëve shqiptarë të të drejtës civile dhe të procedurës civile si Prof.Andrea Nathanaili, Dr.Alqiviadh Lamani, Prof.Stavri Çeço dhe Prof.Dr.Ardian Nuni.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Motivimi për zgjedhjen e kësaj teme ka një lidhje të ngushtë me vetë rëndësinë që paraqet studimi i përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile. Në qoftë se do t'i referohemi prespektivës dhe analizës juridike do të arrijmë në përfundimin se përfaqësimi ka fituar një rëndësi të veçantë në fushën e marrëdhënieve juridiko – civile që lindin apo krijohen ndërmjet personave fizikë, ndërmjet tyre dhe personave juridikë, si dhe ndërmjet vetë këtyre të fundit.

Në vendin tonë përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile i janë kushtuar trajtime shumë të pakta teorike, duke e lënë në këtë mënyrë në harresë në aspektin doktrinar këtë institut kaq të rëndësishëm të të drejtës civile. Mungesa e vëmendjes së duhur që duhet t'i kushtohet këtij instituti kaq të rëndësishëm të së drejtës civile, i cili në kuadër të itensifikimit të marrëdhënieve juridiko – civile po merr një rëndësi mjaft të veçantë ka qenë një tjetër motiv, i cili më ka shërbyer si shtysë për tu thelluar në studimin tim lidhur me këtë institut të së drejtës civile.

Për realizimin e këtij punimi kam kryer fillimisht një studim të detajuar ndër vite të doktrinës dhe legjislacionit shqiptar, si dhe doktrinës dhe legjislacionit të huaj lidhur me përfaqësimin, ndër të cilët do të veçoja doktrinën gjermane dhe atë italiane lidhur me përfaqësimin, si dhe legjislacionin e bashkimit europian dhe konkretisht parimet europiane të të drejtës kontraktore (PECL), si dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare tregtare (UNIDROIT).

Në një fazë të dytë kam konstatuar të gjitha mangësitë në dispozitat e Kodit Civil dhe të Kodit të Proçedurës Civile lidhur me përfaqësimin. Gjithashtu kam treguar kujdes që të realizoj edhe një analizë krahasimore me legjislacionin gjerman dhe atë italian, si edhe në kuadër të parimeve europiane të të drejtës kontraktore (PECL), duke analizuar qasjen e këtyre legjislacioneve lidhur me përfaqësimin.

Fillimisht përsa i përket studimit tim, u përgatit struktura e tij dhe më vonë u krijua një plan i detajuar kërkimesh, identifikimesh dhe gjetjesh kryesore. E gjithë literatura e studiuar është mjaft e pasur dhe kryesisht bazohet në atë të huaj, meqenëse edhe trajtimet lidhur me institutin e përfaqësimit janë të shumta.

Metoda e kërkimit që kam ndjekur bazohet kryesisht në interpretim, dhe në parashtrimin e shumë situatave apo rasteve të cilat mund të ndeshen në jetën e përditshme. Në funksion të arritjes së përfundimeve lidhur me pyetjet, situatat apo rastet e parashtruara kam përdorur interpretimin gramatikor,

ekzaminimin e gjenezës historike, qëllimin e ligjvënësit ...etj. Rëndësi të veçantë i kam kushtuar edhe analizës së krahasimit ndërmjet legjislacionit tonë dhe atij gjerman dhe italian në fushën e përfaqësimit, duke iu referuar për këtë qëllim edhe qëndrimin doktrinar që mbahet nga autorë të ndryshëm të së drejtës civile lidhur me problematikat e konstatuara.

Si përfundim vlerësoj se punimi në fjalë përbën një risi në fushën e të drejtës civile në përgjithësi dhe për institutin e përfaqësimit në veçanti. Ky disertacion rikualifikon konceptin e përfaqësimit duke paraqitur mendimin përkatës lidhur me shumë problematika dhe mangësi ligjore që konstatohen nga trajtimi në mënyrë të imtësishme të institutit të përfaqësimit. Uroj që ky kontribut shkencor të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë ata që dëshirojnë të thellojnë njohuritë e tyre rreth përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile.

Çështje të etikës.

Gjatë realizimit të këtij punimi jam treguar korrekt me literaturën dhe citimet e përdorura, duke respektuar në këtë mënyrë në të gjitha rastet të drejtat e autorit.

KREU I

I. Kuptimi i përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile, si dhe trajtimi historik i zhvillimit të këtij të fundit.

Kuptimi i përfaqësimit si institut i të drejtës civile.

Një nga ëndërrat më të mëdha të njerëzimit ka qenë që të bëhej e mundur që një person të ndodhej njëkohësisht në dy vende të ndryshme. Është e qartë që fizikisht një gjë e tillë nuk është e mundur, megjithatë fatmirësisht ligji ka gjetur një mënyrë për ta bërë të mundur juridikisht atë që nuk është e mundur të bëhet fizikisht. Me anë të caktimit të një personi tjetër si përfaqësues, një person mund të ndodhet juridikisht në të njëjtën kohë në më shumë se një vend.

Në këtë këndvështrim, përfaqësuesi është një person të cilit i jepet fuqia për të qenë: **“Ju vetë”**, brenda kufijve të punëve që i janë ngarkuar, çdo gjë që përfaqësuesi dëgjon, e keni dëgjuar ju, çdo gjë që përfaqësuesi thotë e keni thënë ju. Me fjalë të tjera ju jeni përgjegjës ligjërisht për veprimet e përfaqësuesit, kur këto janë kryer brenda kuadrit të punëve që i janë ngarkuar atij.

Pothuajse askush nuk mund t’ a evitojë përfaqësimin. Kjo është e vërtetë jo vetëm për situatat e biznesit, por edhe për situata krejt normale të jetës së përditshme, qoftë edhe në veprimet më të vogla duke kthyer me anë të një shoku apo miku një send që ja keni marrë dikujt tjetër.

Një numër tepër i madh marrëdhëniesh janë të ndikuara nga përfaqësimi, duke filluar nga marrëdhëniet në të cilat përfshihet një avokat i talentuar deri tek marrëdhëniet e një shitësi ambulant, nga marrëdhëniet në një shoqëri të vogël tregtare me një apo dy ortakë dhe deri te marrëdhëniet në kompanitë apo shoqëritë e mëdha të biznesit. Në fakt personat juridikë çdo veprim që bëjnë, e bëjnë nëpërmjet përfaqësuesit.

Duke iu referuar teorisë së veprimeve juridike, në parim pasojat juridike të veprimeve të njeriut nuk dalin jashtë sferës juridike të këtij të fundit, çfarë nënkupton se nga veprimet juridike lindin të drejta dhe detyrime juridiko civile vetëm për personin apo personat që janë pjesmarrës në këto veprime juridike dhe për llogari të të cilit kryhen këto veprime juridike¹.

Nëse veprimet juridike dhe veprimet e tjera të ligjshme do të duheshin të kryheshin vetëm personalisht, pra vetëm nga subjekti i interesuar, pengesat që

¹ Referoju për këtë qëllim Prof.Dr. Ardian Nuni, në librin “E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme”, botim i vitit 2012.

do të lindnin për krijimin, ndryshimin ose shuarjen e marrëdhënieve juridiko - civile do të ishin tepër të mëdha, duke kufizuar dhe vështirësuar në këtë mënyrë së tepërmi si jetën e përditshme ashtu edhe veprimtarinë e shumë personave qofshin këta fizikë apo juridikë. Kështu drejtuesi apo titullari i një personi juridik do të ishte në pamundësi reale për të kontraktuar fizikisht me të gjithë klientët e shoqërisë së tij, një person i sëmurë ose i dënuar me burgim nuk do të mund të kryente një sërë veprimesh të cilat mund të ishin jetike për këtë të fundit, një person që nuk zotëron njohuri në fushën juridike nuk do të mund të merrte pjesë personalisht në kryerjen e disa veprimeve juridike ...etj. Gjithashtu situata do të paraqitej mjaft e vështirë për subjektet e pazotë për të vepruar për shkak moshe ose heqje apo kufizimi të zotësisë juridike për të vepruar, interesat e këtyre të fundit do të mbeteshin të pambrojtura juridikisht, për shkak se këto të fundit në kuptim të ligjit nuk do të mund t'i ushtronin të drejtat e tyre personalisht, referuar faktit se ligji i konsideron të pavlefshme veprimet që kryhen prej këtyre të fundit.

Situatat e mësipërme thjeshtohen nëse një subjekt tjetër mund të zëvendësojë personin e interesuar në kryerjen e veprimeve juridike apo veprimeve të ndryshme. Pikërisht në funksion të evitimit të situatave të sipërcituar ligji ka mundësuar që një person kur për arsye nga më të ndryshmet nuk mund të jetë në gjendje të kryejë një apo disa veprime të caktuara, të mund t'i kryejë këto veprime me anë të një personi tjetër të quajtur përfaqësues. Kjo mundësi e njohur nga ligji përbën edhe bazën e institutit të përfaqësimit.

Zhvillimi historik i përfaqësimit në sistemin civil Law, si dhe ndarjet që i bëhen përfaqësimit.

i) Kalimi nga koncepti i mandatit tek instituti i përfaqësimit.

Të drejtat moderne të të gjitha vendeve njohin të drejtën për kryerjen e veprimeve juridike nëpërmjet përfaqësuesve. Ndonëse në thelb synohet drejt rregullimit të të njëjtave fenomene juridike, konceptet janë të ndryshme në Common Law dhe në Civil Law. Në sistemin Common Law në kuptim të ligjit është e mundur që një person të autorizojë një person tjetër për të kontraktuar në emër dhe për llogari të personit që ka dhënë autorizimin, por marrëveshja duhet detyrimisht të ketë formën e kontratës dhe pëlqimi i dyanshëm është esencial për vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje. Në sistemin Civil Law situata paraqitet e ndryshme. Fillimisht rregullimi ligjor i përfaqësimit u zhvillua nën influencën e konceptit romak të mandatit (mandatum), koncept ky i përdorur të të drejtën romake për të treguar një urdhër ose një komandë. Si rezultat i këtij ndikimi, e drejta franceze edhe sot e kësaj dite përdor termin “mandat” për përfaqësimin. E drejta gjermane megjithëse nuk përdor terminologjinë latine, përsëri i qëndron strikt, madje në një mënyrë dukshëm më të qartë, e trajton përfaqësimin si veprim juridik të njëanshëm.

Sipas teorisë së vjetër latine, personi të cilit i ishte drejtuar mandati (figurë e ngjashme me përfaqësuesin e sotëm) nuk mund të merrte asnjë shpërblim apo kompensim për punën e kryer, pasi mandati ishte zakonisht i shoqëruar nga një marrëdhënie varësie dhe veprimet ishin të prezumuara se kryheshin për shkak të kësaj marrëdhënieje.

Deri në hartimin e Kodit Civil Gjerman të vitit 1896 trajtimi i përfaqësimit si institut më vete nuk ishte i konsoliduar, ndonëse pikërisht tradita e mungesës së shpërblimit shërbeu si bazë për trajtimin e tij, si një marrëdhënie juridike e njëanshme. Edhe Kodi Civil Francez i vitit 1804 i njohur ndryshe edhe si Kodi i Napoleonit, i cili ishte më i vjetër se Kodi Civil Gjerman e trajtonte mandatin apo përfaqësimin në mënyrë jo shumë të qartë. Konfuzion krijohej gjithashtu edhe në Kodin Civil Italian, atë Spanjoll, si dhe atë Zvicëran. Pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil Gjerman praktika franceze e qartësoi dukshëm situatën duke iu përshtatur teorisë gjermane lidhur me institutin e përfaqësimit. Është pikërisht Kodi Civil Gjerman ai që bëri dallimin e qartë ndërmjet përfaqësimit dhe mandatit, duke e konsideruar të dytin kontratë dhe duke e rregulluar për këtë qëllim më vete nga përfaqësimi dhe konkretisht duke e përfshirë në dispozitat e pjesës së posaçme. Pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil Gjerman shumica e vendeve të traditës së të drejtës civile duke përfshirë Italinë, Finlandën, Danimarkën, Norvegjinë, Suedinë, Zvicrën dhe Greqinë adoptuan mënyrën e rregullimit të institutit të përfaqësimit sipas modelit gjerman të së drejtës. Edhe Kodi Civil aktual që është në fuqi rezulton që ta ketë trajtuar institutin e përfaqësimit sipas modelit gjerman të së drejtës.

ii) Përfaqësimi i drejtpërdrejtë (direkt) dhe jo i drejtpërdrejtë (indirekt).

Që të kemi figurën e përfaqësimit të drejtpërdrejtë ose të mirëfilltë, nuk mjafton që një person të veprojë për llogari të një personi tjetër. Ai duhet gjithashtu të veprojë në emër të këtij personi, si dhe të deklarojë se nuk po e kryen veprimin juridik për vete por në emër dhe për llogari të një personi tjetër. Nëse një person vepron në interes të një tjetri p.sh duke qenë specialist makinash, blen një makinë të mirë për një shokun e tij që nuk ka makinë, por nuk e deklaron se po vepron në emër të këtij të fundit nuk kemi përfaqësim të drejtpërdrejtë, por në një rast të tillë kemi të bëjmë me të ashtuquajturin përfaqësim të tërthortë ose jo të drejtpërdrejtë².

Ky lloj përfaqësimi sikurse e cituam edhe më lart ka qenë i vetmi i njohur nga e drejta romake, e cila ndiqte parimin se me anën e të huajve nuk mund të vehtësohet asgjë (*extreueam personam nihil adquiri potest*)³. Përfaqësuesi i të drejtës romake mund të vepronte në interes të një të treti, por gjithmonë në emër të tij. Në këtë mënyrë marrëdhënia juridike krijohej ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë, ndërsa i përfaqësuarit mbetej në fakt i huaj për këtë marrëdhënie. Një përfaqësim të ndërmjetëm të

² Alberto Trabucchi, *Instituzioni di Diritto Civile*, fq. 248, botim i vitit 1986.

³ Alberto Trabucchi, *Instituzioni di Diritto Civile*, fq. 248, botim i vitit 1986.

këtij lloji në të drejtën tone civile, si shembull mund të japim atë të kontratës së komisionit që rregullohet nga nenet 935 – 944 të Kodit Civil aktual. Edhe Kodi Civil aktual në nenet 64 – 78, kur flet për përfaqësimin ka parasysh vetëm përfaqësimin e drejtpërdrejtë dhe jo atë të tërthortë ose jo të drejtpërdrejtë.

Ndërsa në përfaqësimin direkt pasojat e veprimit vijnë menjëherë dhe drejtpërdrejt për të përfaqësuarin (në këtë rast përfaqësuesi quhet alter ego i të përfaqësuarit), në përfaqësimin indirekt ai që kryen veprimin fiton të drejtat dhe bëhet njëkohësisht subjekt i detyrimeve që lindin nga veprimi juridik. Në një rast të tillë do të duhet një veprim juridik tjetër për të transferuar pasojat e veprimit juridik tek personi, në interes të të cilit është kryer veprimi juridik. Në teorinë e të drejtës civile përfaqësimi i drejtpërdrejtë quhet dhe ndërvendosje reale.

Gjatë trajtimit të përfaqësimit në këtë punim do të merremi vetëm me përfaqësimin e drejtpërdrejtë dhe termi : **“përfaqësim”** do të nënkuptojë ashtu sikurse dhe në dispozitat përkatëse të kodit tonë civil, përfaqësimin e drejtpërdrejtë.

iii) Përfaqësimi aktiv dhe përfaqësimi pasiv.

Nëse përfaqësuesi bën një deklaram vullneti i cili sjell pasoja për një person tjetër të ndryshëm nga deklaruesi, themi se kemi të bëjmë me përfaqësim aktiv. Nëse ndaj përfaqësuesit vepron një person tjetër, i ndryshëm nga deklaruesi i vullnetit (i përfaqësuarit) por me pasoja për të përfaqësuarin themi se kemi të bëjmë me përfaqësim pasiv. Zakonisht të dyja këto përfaqësime bashkëekzistojnë me njëri – tjetrin. Megjithatë ka raste kur një person të jetë i autorizuar vetëm për të marrë deklaramet e tjetrit dhe jo për të bërë vetë deklarime⁴.

Zhvillimi historik i përfaqësimit në sistemin tonë të brendshëm të së drejtës.

i) Trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1929

Përfaqësimi në Kodin Civil të vitit 1929, i njohur ndryshe edhe si Kodi Civil i Zogut parashikohej në nenet 1105 – 1112. Kështu në nenin 1105 të Kodit Civil të vitit 1929 parashikohej shprehimisht se : *“Veprimet e kryeme prej përfaqësuesit në emnin e të përfaqësuarit, brenda kufijve të pushteteve të tij, kanë efekt drejtpërsëdrejti në favor të përfaqësuarit dhe kundra tij”*⁵.

Referuar përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezulton se edhe në Kodin Civil të vitit 1929 rezulton se si formë përfaqësimi njihej vetëm përfaqësimi direkt. Në këtë dispozitë parashikohej ai përfaqësim në të cilin veprimet e përfaqësuesit i prodhonin efektet e tyre drejtpërsëdrejti në sferën juridike të të përfaqësuarit pa prekur atë të përfaqësuesit.

⁴ Alberto Trabucchi, *Instituzioni di Diritto Civile*, botim i vitit 1986.

⁵ Referoju për këtë qëllim nenin 1105 të Kodit Civil të vitit 1929.

Sipas përcaktimeve të Kodit Civil të vitit 1929 kushtet që kërkoheshin për vlefshmërinë e përfaqësimit ishin :

a) duhet që të ekzistonte një pushtet përfaqësimi domethënë një raport juridik i cili të autorizonte përfaqësuesin që me veprimin e tij të prodhonte efekte juridike për të përfaqësuarin. Pushteti me përfaqësue e kishte burimin ose në vullnetin e të përfaqësuarit ose në një shkak tjetër (*pushteti ligjor i përfaqësuesit*).

b) duhet që përfaqësuesi të vepronte në emrin e të përfaqësuarit⁶.

Përfaqësuesi duhet të lajmëronte atë me të cilin po kontraktonte se veprimi i tij do të kishte efekte jo për veten e tij, por për një tjetër person. Ajo që ishte deçizive për ekzistencën e përfaqësimit ishte fakti i veprimit në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit e jo raporti i brendshëm me të përfaqësuarin⁷.

Në nenin 1106 paragrafi i dytë të Kodit Civil të vitit 1929 parashikohej se : “*Në qoftë se vullneti i përfaqësuesit asht i vesuem veprimi asht i anulueshëm në dobi të të përfaqësuesit*”⁸.

Nga përmbajtja e paragrafit të mësipërm rezulton se në kuptim të ligjit veprimet e kryera nga përfaqësuesi, kur vullneti i tij ishte i vesuar konsideroheshin të pavlefshme, kjo për arsye se kontrata konsiderohej e lidhur si rezultat i kryqëzimit të vullnetit të përfaqësuesit dhe personit të tretë që ishte palë në veprimin e kryer me përfaqësuesin.

Dispozitat e neneve 1105 e vijues të Kodit Civil të vitit 1929 kishin parasysh përfaqësimin në fushën kontraktuale, megjithatë këto dispozita vlenin për të gjithë të drejtën civile. Mund të kryheshin me përfaqësim edhe të gjitha veprimet juridike të njëanshme veçanërisht si premtimi i njëanshëm dhe të gjitha veprimet procedimore etj. Edhe në Kodin Civil të vitit 1929 përjashtimisht përfaqësimi nuk lejohej për kryerjen e atyre veprimeve juridike të cilat ose për shkak të natyrës së tyre ose për shkak të parashikimit ligjor kërkonin deklarinimin personal të të interesuarit. Kështu përgjithësisht përfaqësimi nuk lejohej në të gjitha të drejtat familjare.

Në Kodin Civil të vitit 1929 nuk ekzistonte një dispozitë e posaçme lidhur me prokurën, por në nenin 1107 të tij në mënyrë indirekte flitej për të. Kështu në këtë nen parashikohej se : “*I treti që kontrakton me një përfaqësues ka të drejtë me kërkue që ky të justifikojë pushtetet e veta dhe kur këto pushtete rezultojnë nga një shkresë, t’i japë një kopje të kësaj të nënshkrueme prej tij*”⁹.

Shkresa e cituar në dispozitën e sipërcituar nuk ishte gjë tjetër vetëm se prokura

⁶ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

⁷ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 1106 paragrafi i dytë i Kodit Civil të vitit 1929.

⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 1107 të Kodit Civil të vitit 1929.

që i përfaqësuarit i kishte dhënë përfaqësuesit për të kryer veprimin juridik për të cilin ishte autorizuar për ta kryer. Megjithatë në doktrinën e asaj kohe flitet gjerësisht për prokurën. Përkufizimi që doktrina e asaj kohe i bënte prokurës ishte: *“Prokura është pushteti i përfaqësimit që buron nga një akt juridik i bërë prej të përfaqësuarit”*¹⁰.

Edhe sipas Kodit Civil të vitit 1929 prokura ishte një veprim juridik i njëanshëm që i adresohet një personi (përfaqësuesit). Ky akt që i përfaqësuarit i jepte përfaqësuesit sillte efekte që nga momenti që përfaqësuesi merrte dijëni. Sipas doktrinës juridike të asaj kohë mjaftonte dijënia e përfaqësuesit dhe nuk ishte nevoja që dhe i treti të kontraktonte me përfaqësuesin të kishte dijëni për prokurën e këtij të fundit¹¹.

Lidhur me formën e prokurës në doktrinën ekzistonte mendimi se kjo e fundit krahas formës shkresore mund të jepej edhe në mënyrë verbale, me heshtje, si dhe dhënia e prokurës mund të rezultonte edhe nga një sjellje e palëve, nga e cila të rezultonte duke pasur parasysh rrethanat dhe zakonet se i përfaqësuarit kishte pasur vullnetin për t'i dhënë prokurë përfaqësuesit.

Në doktrinën e asaj kohe prokura që i njoftohej të tretëve prej vetë të përfaqësuarit quhej si prokurë e jashtme dhe prokura që i njoftohej të tretëve jo prej të përfaqësuarit por prej përfaqësuesit quhej prokurë e brendshme. Prokura konsiderohej si e jashtme edhe kur pushtetet e përfaqësuesit i njoftoheshin të tretit prej vetë përfaqësuesit me tregimin e prokurës së dhënë prej të përfaqësuarit. Si çdo akt tjetër juridik edhe dhënia e prokurës supozonte që i përfaqësuarit duhet të kishte zotësi të plotë për të vepruar. Prokura e dhënë në një moment në të cilin vullneti i të përfaqësuarit ishte i vesuar mund të anullohej me padinë e aullimit sipas rregullave të caktuara në nenet 1301 e vijues të këtij kodi, ashtu si çdo akt tjetër që ishte rrjedhojë e një vullneti të vesuar. Prokura mund të jepej në bazë të një kushti pezullues ose në një mënyrë që të mos prodhonte pasoja veçse në një datë të caktuar. Në këtë rast veprimet e kryera prej përfaqësuesit para realizimit të kushtit ose para kësaj date nuk ishin të detyrueshme për të përfaqësuarin edhe sikur më pas kushti të vërtetohej ose pas ardhjes së datës së caktuar në prokurë, kjo për faktin se prokura nuk kishte fuqi prapavepruese, përndryshe konsiderohej e pavlefshme.

Përsa i përket objektit prokura mund të jepej për veprime të caktuara (prokurë e posaçme), ose për një kategori të caktuar veprimesh, ose për të gjitha punët e përfaqësimit, në të dy rastet e fundit prokura konsiderohej e përgjithshme. Prokura e përgjithshme autorizonte përfaqësuesin që të kryente vetëm punët e një administrimi të thjeshtë.

¹⁰ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

¹¹ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

Edhe në Kodin Civil të vitit 1929 konkretisht në nenin 1108 të tij ¹², sikurse në Kodin Civil aktual për veprimet juridike të cilat duhet të bëheshin me akt noterial edhe prokura me të cilën duhet të ishte i pajisur përfaqësuesi duhet të kishte të njëjtën formë përndryshe konsiderohej e pavlefshme.

Shkaqet të cilat sillnin mbarimin e prokurës edhe në Kodin Civil të vitit 1929 ishin të njëjta me Kodin Civil aktual. Interesant konsiderohej qëndrimi që mbante doktrina lidhur me veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi pas vdekjes së të përfaqësuarit. Në një rast të tillë të tretët nuk konsideroheshin se kishin vepruar në mirëbesim sepse një fakt i tillë konsiderohej si i ditur botërisht. Por kur përfaqësuesi konsiderohej se kishte vepruar me mirëbesim për shkak se nuk i dinte shkaqet e shuarjes së pushteteve të tij, i tretë përfitonte nga mirëbesimi i përfaqësuesit. Këtë qëndrim doktrina e lidhte me parashikimin ligjor të nenit 1710 të Kodit Civil të vitit 1929 në të cilin parashikohej se : *“Në qoftëse i porosituri nuk e di shkakun e shuëmjes së porosisë, gjithcka ka ba para se të ketë marrë vesh atë shkak konsiderohet e vleftësisht e bame për ekzekutimin e porosisë”*¹³. Ky parashikim ligjor vlente edhe për veprimet e kryera nga përfaqësuesi për shkak të padijenisë së tij për shuarjen e pushteteve të tij si rezultat i vdekjes së të përfaqësuarit.

Në Kodin Civil të vitit 1929 kontraktimi i përfaqësuesit me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij nuk ishte absolutisht i ndaluar. Këto kontraktime bëheshin kur prokura e autorizonte shprehimisht përfaqësuesin që të kryente veprime juridike me veten ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij. Por dhe kur mungonte një autorizim i shprehur i të përfaqësuarit, veprimi nuk konsiderohej absolutisht i pavlefshëm (nul), por vetëm i anulueshëm me kërkesën e të përfaqësuarit. Por i përfaqësuari pavarësisht se nuk e kishte autorizuar shprehimisht përfaqësuesin për të kryer veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, në rast se përfaqësuesi i kryente veprime të tilla i përfaqësuari kishte të drejtë të ratifikonte këto veprime¹⁴.

Në Kodin Civil të vitit 1929 krahas përfaqësimit vullnetar ku pushtetet e përfaqësuesit buronin nga vullneti i të përfaqësuarit njihej edhe përfaqësimi ligjor, i quajtur ndryshe dhe si pushteti ligjor. Si raste të përfaqësimit ligjor njiheshin përfaqësimi i personave që u ishte hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar, përfaqësimi i të miturve. Në të tilla raste përfaqësimi rregullohej nga vetë ligji. Shpesh herë pushteti i përfaqësimit ligjor ndryshonte sipas rasteve. Tutoria kishte për qëllim mbrojtjen e interesave të të miturve ose personave që u ishte hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Pushteti ligjor i përfaqësimit mund të shtrihej në të gjithë sferën juridike të të përfaqësuarit, por mund të ishte edhe i kufizuar vetëm në një pjesë punësh ose për një punë të posaçme siç mund të ishte rasti i caktimit të një përfaqësuesi të posaçëm në rastet kur ndërmjet të miturit dhe kujdestarit ose prindërve të tij kishte konflikt interesash. Po ashtu si te rasti i përfaqësimit

¹² Referoju për këtë qëllim nenit 1108 të Kodit Civil të vitit 1929.

¹³ Referoju për këtë qëllim nenit 1710 të Kodit Civil të vitit 1929.

¹⁴ Referoju për këtë qëllim nenit 1112 të Kodit Civil të vitit 1929.

vullnetar edhe te përfaqësimi ligjor, përfaqësuesi nuk lejohej të kryente veprime juridike me veten ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

ii) Trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas parashikimeve të Ligjit për pjesën e përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

Instituti i përfaqësimit në Ligjin për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 parashikohej në nenet 61 – 75 të tij. Në referim të nenit 61 të këtij ligji : *“Një person mund të kryente veprime juridike dhe me anë të një personi tjetër që kishte zotësi për të vepruar (përfaqësuesi), përveç kur përfaqësimi nuk lejohej sipas ligjit¹⁵”*.

Edhe në kuptim të dispozitave të këtij ligji e drejta për të përfaqësuar mund të bazohej në ligj (përfaqësimi ligjor) ose në vullnetin e të përfaqësuarit me anë të lëshimit nga ana e këtij të fundit të prokurës (përfaqësimi vullnetar).

Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi sillnin pasoja drejtpërdrejt për të përfaqësuarin¹⁶, duke krijuar për këtë të fundit të drejta dhe detyrime juridiko – civile vetëm kur veprimet ishin kryer brenda kufijve të tagrave që i ishin dhënë përfaqësuesit. Kufijtë e tagrave të përfaqësuesit përcaktoheshin nga ligji ose nga prokura, por ato mund të nxirreshin edhe nga rrethanat në të cilat kryheshin veprimet juridike të njohura ndryshe si rrethana konkludente.

Nga rregulli i përgjithshëm se veprimet juridike të cilat kryheshin nga përfaqësuesi brenda tagreve të dhëna ishin të detyrueshme për të përfaqësuarin, ligji bënte përjashtim vetëm në rastin kur veprimi juridik ishte rezultat i një marrëveshjeje me keqbesim ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë në dëm të të përfaqësuarit, i cili kishte të drejtë që të kërkonte që veprimi juridik të shpallej i pavlefshëm¹⁷. Në të tilla raste bëhej fjalë për veprime juridike që kryente përfaqësuesi duke shkelur me dashje besimin që i ishte dhënë nga i përfaqësuarin duke shtrembëruar vullnetin e këtij të fundit me qëllim nxjerrjen e përfitimeve për vete ose për personin e tretë me të cilin kryente veprimin juridik. Një parashikim i tillë ligjor gjendet edhe në Kodin Civil aktual dhe konkretisht në nenin 102 të tij.

Nga përfaqësimi i ushtruar brenda kufijve të tagrave që i ishin dhënë përfaqësuesit lindnin për të përfaqësuarin jo vetëm të drejta dhe detyrime por edhe pasoja të tjera të dëmshme që rridhnin nga zotimet që bënte përfaqësuesi në rastin e kryerjes së veprimit juridik në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Si shembull mund të referojmë që nëse përfaqësuesi premtonte që sendi i shitur nuk kishte të meta të fshehta dhe nëse më pas në një moment të mëvonshëm këto të meta shfaqeshin atëherë përgjegjësia do të rëndonte mbi të përfaqësuarin¹⁸. Ishte ky i fundit që do konsiderohej përgjegjës ndaj personit të tretë me të cilin përfaqësuesi kishte kryer veprimin juridik.

Në doktrinën e asaj kohe mbahej qëndrimi se vërtet përfaqësimi nuk mund të kishte për objekt të tij kryerjen e veprimeve të paligjshme, por në rast se përfaqësuesi do të kryente

¹⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 61 të Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

¹⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 62 të Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

¹⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 66 të Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

¹⁸ Referoju për këtë qëllim librit : “E drejta Civile e RPSH – së”, fq. 88 – 112 me autor Andrea Nathanailin.

veprime të tilla përgjegjës për kryerjen e këtyre veprimeve do të ishte i përfaqësuari. Kështu në rast se përfaqësuesi duke lidhur dhe ekzekutuar një veprim juridik në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit brenda kufijve të tagrave që i ishin dhënë kryente edhe ndonjë veprim të paligjshëm në dëm të personit të tretë, i cili ishte palë në lidhjen dhe ekzekutimin e detyrimeve që rridhnin nga ky veprim juridik. Në këtë rast për këtë veprim të paligjshëm të përfaqësuesit do të përgjigjej vetë i përfaqësuari kundrejt personit të tretë për shpërblimin e dëmit që mund t'i ishte shkaktuar. Për të ilustruar përfundimin e sipërcituar nga ana e doktrinës së asaj kohe paraqitej si shembull se në rast se personi i tretë kishte lënë si garanci në formën e pengut për shlyerjen e një detyrimi të caktuar një send të luajtshëm, të cilin ia kishte dorëzuar përfaqësuesit atëherë përgjegjës në rast dëmtimi apo humbjeje të këtij sendi përkundrejt personit të tretë do të ishte i përfaqësuari¹⁹.

Edhe në ligjin për pjesën e përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 ashtu sikurse edhe në Kodin Civil aktual parashikohet në një dispozitë të posaçme konflikti i interesit ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, duke parashikuar në të njëjtën mënyrë se përfaqësuesi nuk mund të kryente veprime juridike me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij²⁰. Referuar qëndrimit që mbahej në doktrinë lidhur me këtë parashikim ligjor përcaktohet se në këtë rast ndalimi ishte i diktuar nga fakti se përfaqësimi nga i njëjti person i interesave të kryqëzuara dhe të kundërta përbënte rrezik për të përfaqësuarin sepse jepte shkak që përfaqësuesi të abuzonte me pozitën e tij. Në dallim nga parashikimet e Kodit Civil të vitit 1929 dhe atij aktual sipas të cilëve këto veprime nuk konsiderohen të pavlefshme kur i përfaqësuari e ka autorizuar shprehimisht përfaqësuesin për të kryer veprime të tilla juridike, në nenin 65 të Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil nuk parashikohet një gjë e tillë dhe kur ndalimi i sipërcituar shkelet veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi konsideroheshin absolutisht të pavlefshme. Në doktrinën e asaj kohe ekzistonte mendimi se në rast se i përfaqësuari e kishte dhënë pëlqimin e tij nuk kishte arsye që të ndalohej kryerja e këtyre veprimeve juridike nga përfaqësuesi. Për të argumentuar një qëndrim të tillë paraqitej si shembull se në rast se do të respektohej rigorozisht një ndalim i tillë atëherë shitësi i një dyqani, i cili vepronte si përfaqësues i dyqanit nuk do të kishte mundësi të blinte për veten e tij nga sendet që shiste dhe si rrjedhojë diçka e tillë nuk do të ishte aspak e justifikueshme për interesat e qarkullimit civil²¹.

Edhe në Ligjin për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 referuar për këtë qëllim burimit nga rridhnin tagrat e përfaqësuesit, përfaqësimi ndahej në dy lloje kryesore dhe konkretisht në përfaqësim ligjor dhe në përfaqësim vullnetar. Si përfaqësimi ligjor ashtu dhe përfaqësimi vullnetar që të dy bazoheshin në ligj, në kuptimin se këto lloje përfaqësimesh njiheshin dhe ushtroheshin në referim të një norme juridike. Dallimi ndërmjet tyre qëndronte në ndryshimin e fakteve apo shkaqeve juridike nga cilat buronin njëri dhe tjetri. Në përfaqësimin ligjor tagrat e përfaqësuesit përsa i përkiste volumit të tyre ishin të përcaktuara në normën juridike (ligj, statut, rregullore etj). Karakteristikë e përbashkët për të gjitha shkaqet e lindjes së përfaqësimit ligjor ishte se përfaqësimi në këto raste vendosej detyrimisht për të përfaqësuarin dhe përfaqësuesin. Kjo ishte edhe

¹⁹ Referoju për këtë qëllim librit : “E drejta Civile e RPSH – së”, fq. 88 – 112 me autor Andrea Nathanailin.

²⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 65 të Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

²¹ Referoju për këtë qëllim librit : “E drejta Civile e RPSH – së”, fq. 88 – 112 me autor Andrea Nathanailin

arsyeja se përse përfaqësimi ligjor quhej ndryshe edhe si përfaqësim i detyrueshëm. Në përfaqësimin vullnetar ndryshe nga përfaqësimi ligjor volumi i tagrave, si dhe vetë përfaqësuesi caktohej në përputhje me ligjin nga një shfaqje vullneti të të përfaqësuarit nëpërmjet një veprimi juridik të njëanshëm të tij dhe konkretisht nëpërmjet lëshimit të prokurës²². Rastet e përfaqësimit ligjor edhe në atë periudhë rezultojnë që të jenë pak a shumë të njëjta me rastet e tanishme.

Në periudhën në të cilën Instituti i përfaqësimit rregullohej nga Ligji për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955, një rëndësi të veçantë zinte përfaqësimi i shtetit dhe i organizatave shtetërore dhe shoqërore. Në atë periudhë përfaqësimi i shtetit dhe i organizatave shtetërore dhe shoqërore krahas përcaktimeve në ligjin e sipërcituar kishte edhe rregullim të veçantë dhe konkretisht rregullohej në referim të Dekretit nr. 1857, datë 26.04.1954 të emërtuar : **“Mbi Përfaqësimin e shtetit dhe të organizatave shtetërore dhe shoqërore”**.

Në funksion të trajtimit të Institutit të Përfaqësimit sipas Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 po paraqesim një shembull nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë që i përket periudhës në të cilin Instituti i Përfaqësimit rregullohej sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara.

Mbi padinë e H.I, J.I dhe S.I kundër B.I e përfaqësuar nga djali i saj H.I është kërkuar : *“Njohja e tyre si bashkëpronarë në një shtëpi pasi transkriptimi i saj ishte bërë në mashtrim të ligjës në emrin e të paditurës”*. Gjykata e Rrethit Shkodër me vendimin nr. 913, datë 08.11.1968 ka vendosur pranimin e kërkesës – padisë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim e paditura B.I. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 154, datë 13.12.1968 ka vendosur rrëzimin e kërkesës – padisë si të pabazuar në ligj me këtë arsytim : *“Paditësat pretendojnë se nëna ka vepruar edhe në dobi të tyre dhe se ajo ka vepruar si përfaqësuese e tyre. Por në këtë rast ata nuk gëzojnë të drejtë pronësie në këtë shtëpi pasi nëna nuk ka pasur një përfaqësim të tillë. Edhe sikur të pranohet se nëna ka vepruar si përfaqësuese e tyre dhe pa të drejtë e ka regjistruar pronën në emrin e saj, përsëri ky përfaqësim duhet të kishte formën e kërkuar nga ligji për kalimin e pronësisë siç kërkohet nga neni 69 i Ligjit për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955. Gjersa një përfaqësim i tillë mungon dhe nuk ka asnjë veprim juridik për kalimin e pronësisë edhe në dobi të tyre, ata nuk kanë asnjë të drejtë pronësie mbi këtë shtëpi prandaj gjykata ka vepruar në kundërshtim me ligjin duke i njohur ata si bashkëpronarë në shtëpinë objekt gjykimi”*²³.

iii) Trajtimi i institutit të përfaqësimit sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1981.

Përfaqësimi si Institut i veçantë i të drejtës civile në dispozitat e Kodit Civil të vitit 1981 parashikohej në nenet 54 – 58 të këtij Kodi. Trajtimi i Institutit të përfaqësimit sipas dispozitave të këtij kodi pati regres në krahasim, si me dispozitat e Kodit Civil të vitit 1929 ashtu edhe me ato të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955. Shumë parashikime ligjore lidhur me institutin e përfaqësimit që gjendeshin në dispozitat e

²² Referoju për këtë qëllim librit : “E drejta Civile e RPSH – së”, fq. 88 – 112 me autor Andrea Nathanailin.

²³ Referoju për këtë qëllim revistës Drejtësia Popullore nr.1/1969

mëparshme në dispozitat e Kodit Civil të vitit 1981 nuk gjenin më trajtim. Gjithsesi qëndrimi doktrinar vijoi të mbetet i njëjtë duke i bërë institutit të përfaqësimit një trajtim të njëjtë sikurse në Ligjin për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

Në nenin 54 të tij jepej kuptimi i përfaqësimit duke përcaktuar se : *“Përfaqësimi ishte një marrëdhënie juridiko – civile me anë të së cilës siç citohej në këtë nen shtetasit dhe personat juridikë mund të kryenin veprime juridike edhe me anë të një shtetasi ose të një personi juridik tjetër, përveç rasteve kur veprimi juridik për shkak të natyrës së tij ose sipas ligjit duhet të kryhej nga vetë personi”*²⁴

Në nenin 54 të Kodit të sipërcituar si dhe në dispozitat vijuese ishte përcaktuar jo vetëm kuptimi i përfaqësimit por dhe kufijtë dhe pasojat e tij. Megjithatë në ndryshim nga Ligji për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 në Kodin Civil të vitit 1981 dispozitat mbi përfaqësimin ishin të kufizuara. Kështu do të veçonim faktin se në Kodin Civil të vitit 1981 nuk gjendej i sanksionuar rregulli në bazë të të cilit përfaqësuesi nuk mund të kryente veprime juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, por në doktrinën e asaj kohe parashikohej si një nga veçoritë e përfaqësimit dhe ndalimi i përmendur më lart, i cili nënkuptohej nga vetë natyra e veprimeve juridike dhe veprimeve të tjera që mund të kryheshin me anë të përfaqësimit. Arsyetimi që përdorej për të justifikuar një ndalim të tillë nga doktrina e asaj kohe ishte se : *“Meqenëse në veprimet që kryhen me anë të përfaqësimit kemi marrëdhënie që zhvillohen ndërmjet dy palëve, kuptohet që kemi shfaqje vullneti nga dy palë, pra nga dy persona. Derisa kemi dy vullnete me drejtimeve të kundërta është e vetëkuptueshme që ato nuk mund të bashkohen në të njëjtin person, secili person mund të shfaqë vetëm vullnetin e tij dhe jo vullnetin e një personi tjetër me drejtim të kundërt. Ndaj një person që vepron si përfaqësues i një personi tjetër nuk mund të kryejë në emër të këtij personi veprime juridike me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij. Si shembull në doktrinën e asaj kohe merrej rasti i prindit, i cili si përfaqësues ligjor i fëmijëve të tij nuk mund të kryente veprime juridike në emër të fëmijëve të tij me veten e tij dhe as në emër të dy fëmijëve ndërmjet tyre, kjo sepse ai duke vepruar si përfaqësues ligjor i fëmijëve në kryerjen e veprimeve në emër të tyre do të shfaqte vullnetin e tij. Por vullnetet e palëve janë në drejtime të kundërta ndaj nuk kanë si të shfaqen nga i njëjti person”*²⁵.

Gjithashtu në Kodin Civil të vitit 1981 në ndryshim nga Ligji për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955, në dispozitat që kishin të bënin me institutin e përfaqësimit nuk parashikohej në ndonjë dispozitë e drejta e të përfaqësuarit që të kërkonte deklarinimin si të pavlefshëm të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi kur vullneti i këtij të fundit ishte me ves. Në trajtimin që i bëhej institutit të përfaqësimit në doktrinën e asaj kohe njiheshin e drejta e të përfaqësuarit që të kërkonte të deklarohet i pavlefshëm veprimi juridik kur përfaqësuesi e kishte kryer atë nën ndikimin e mashtrimit, kanosjes ose lajthimit, pavarësisht se i përfaqësuarit nuk kishte qenë nën ndikimin e këtyre rrethanave. Gjithashtu pranohej në doktrinën e asaj kohe edhe rregulli që i përfaqësuarit nuk mund të përfitonte

²⁴ Referoju për këtë qëllim nenin 54 të Kodit Civil të vitit 1981.

²⁵ Referoju për këtë qëllim botimit me autor Andrea Nathanailli dhe Nazmi Biçoku të emërtuar : “E drejta civile e RPSSH – së, fq 77 - 102.

nga mirëbesimi i përfaqësuesit²⁶.

Gjithashtu në dispozitat e Kodit Civil të vitit 1981 që bënin fjalë për përfaqësimin nuk parashikohej as e drejta e të përfaqësuarit për të kërkuar deklarinimin si të pavlefshëm të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi si rezultat i marrëveshjes me keqbesim që kishte bërë me personin e tretë me të cilin kishte kryer veprimin juridik. Referuar trajtimit doktrinar që i bëhej institutit të përfaqësimit në atë periudhë në një rast të tillë i njihej e drejta të përfaqësuarit të kërkonte pavlefshmërinë e veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi në rrethanat e sipërcituara²⁷.

Edhe në dispozitat e Kodit Civil të vitit 1981 që trajtonin institutin e përfaqësimit, si dhe në doktrinën e asaj periudhe ruhej ndarja e përfaqësimit në dy lloje dhe konkretisht :

- a) përfaqësimi ligjor ;
- b) përfaqësim vullnetar.

Në nenin 57 të Kodit Civil të vitit 1981 jepej edhe kuptimi i prokurës ku përcaktohej se : *“Prokura është akti që pasqyron vullnetin e të përfaqësuarit dhe bëhet gjithmonë me shkresë”*²⁸.

Lidhur me prokurën në doktrinën juridike të asaj periudhe termi prokurë përdorej në dy kuptime:

Së pari : Me prokurë kuptohej veprimi juridik i njëanshëm i përfaqësimit dhe anë të të cilit një person i cili quhej i përfaqësuarit ngarkonte një person tjetër, përfaqësuesin që të kryente një ose disa veprime juridike dhe veprime të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të tij. Pra në këtë kuptim fjala prokurë shprehte nocionin e veprimit juridik të njëanshëm të përfaqësimit.

Së dyti : Me fjalën prokurë kuptohej shkresa në të cilën ishte materializuar, fiksuar shfaqja e vullnetit të të përfaqësuarit dhe kufijtë e të drejtave të përfaqësuesit. Domethënë kuptohej dokumenti ku ishte pasqyruar veprimi juridik i njëanshëm i përfaqësimit²⁹.

Në nenin 58 të Kodit Civil të vitit 1981 ishin parashikuar edhe rastet kur prokura merrte fund. Këto raste ishin të njëjta me ato të parashikuara në Ligjin për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955, me përjashtim të rastit kur i përfaqësuarit ose përfaqësuesi kishin humbur zotësinë për të vepruar. Ky shkak nuk parashikohej shprehimisht në këtë Kod, si shkak që sillte mbarimin e prokurës.

I.IV) Kuptimi i përfaqësimit si institut i së drejtës civile, si dhe karakteristikat e këtij të fundit sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1994 (Kodit Civil aktual).

i) Kuptimi i përfaqësimit sipas Kodit Civil të vitit 1994

Duke iu referuar parashikimeve të Kodit Civil aktual dhe konkretisht parashikimeve të

²⁶ Referoju për këtë qëllim botimit me autor Andrea Nathanailli dhe Nazmi Biçoku të emërtuar : “E drejta civile e RPSSH – së, fq 77 - 102.

²⁷ Referoju për këtë qëllim botimit me autor Andrea Nathanailli dhe Nazmi Biçoku të emërtuar : “E drejta civile e RPSSH – së, fq 77 - 102.

²⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 57 të Kodit Civil të vitit 1981.

²⁹ Referoju për këtë qëllim botimit me autor Andrea Nathanailli dhe Nazmi Biçoku të emërtuar : “E drejta civile e RPSSH – së, fq 77 - 102.

nenit 64 parag 1, përfaqësimi është ai institut i të drejtës civile me anën e të cilit : *“Një person (përfaqësuesi) kryen brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar)”*³⁰.

Referuar përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezulton që kuptimi i përfaqësimit si institut i të drejtës civile të jetë dhënë në mënyrë të ngushtuar për shkak se me anë të përfaqësimit mund të kryhen jo vetëm veprime juridike, por edhe veprime të tjera të ligjshme.

Një përkufizim më i qartë që mund t’i jepet përfaqësimit si institut i të drejtës civile do të ishte që ky i fundit *është një marrëdhënie juridike civile e krijuar ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Kjo marrëdhënie që krijohet është një marrëdhënie e pavarur që qëndron e ndarë nga marrëdhënia juridike që krijohet nga veprimi i përfaqësuesit me personin e tretë. Kjo ndarje lidhet me kohën në të cilin lindin, në llojin dhe qëllimin e veprimit juridik mbi bazën e të cilit lindin, si dhe edhe në pasojat që sjellin. Megjithatë mund të themi se ndërmjet marrëdhënies që krijohen ekziston një lidhje e ngushtë referuar faktit se marrëdhënia juridiko – civile e përfaqësimit lind si nevojë e krijimit, ndryshimit ose shuarjes së marrëdhënies tjetër.*

Për të ilustruar atë që cituam më lart po paraqesim një shembull :

Personi A cakton si përfaqësues të tij personin B të cilin e autorizon që në emër dhe për llogari të tij si i përfaqësuar të lidhte një kontratë për blerjen e një autoveture nga personi C. Akti apo dokumenti me të cilin personi A pajis personin B që në kuptim të ligjit quhet prokurë përbën një veprim juridik të njëanshëm, i cili shërben për të krijuar marrëdhënien e përfaqësimit ndërmjet personit A si i përfaqësuar dhe personit B si përfaqësues. Kjo marrëdhënie që krijohet ndërmjet të përfaqësuarit A me përfaqësuesin B qëndron e ndarë nga marrëdhënie juridike që krijohet më vonë ndërmjet personit A si blerës dhe personit C si shitës, ndonëse marrëdhënia e dytë krijohet referuar aktit të përfaqësimit me anë të të cilit i përfaqësuarit A ka pajisur përfaqësuesin B.

ii) Veprimet që nuk mund të kryhen me përfaqësim.

Sikurse del e përcaktuar si në rregullimet e mëparshme që i janë bërë përfaqësimit si institut i të drejtës jo të gjitha llojet e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme mund të kryhen me anë të përfaqësimit. Si rregull përfaqësimi si institut i të drejtës ka gjetur zbatim në marrëdhëniet kontraktore ndërsa për një kategori të tjera veprimesh përgjithësisht të karakterit personal, përfaqësimi si institut i të drejtës nuk mund të zbatohet për shkak kjo të vetë natyrës së këtyre veprimeve të cilat kërkojnë detyrimisht praninë personalisht të personit që shfaq vullnetin. Si shembull mund të përmendim rastin e testamentit si veprim juridik i njëanshëm, i cili në referim të parashikimeve ligjore që rregullojnë institutin e trashëgimisë nuk mund të kryhet me përfaqësim. Ky ndalim ka gjetur parashikimin e tij ligjor edhe në Kodin Civil aktual dhe konkretisht në nenin 64 parag 2 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit të kryhet nga vetë*

³⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 64 parag 1 i Kodit Civil aktual në të cilin jepet edhe kuptimi i përfaqësimit

personi”³¹.

Gjithashtu në referim të ndalimit të sipërcituar si shembull mund të paraqesim rastin e lidhjes së martesës, e cila në kuptim të parashikimeve ligjore të dispozitave të Kodit të Familjes që rregullojnë lidhjen e martesës rezulton që kjo e fundit lidhet vetëm me praninë personalisht të personave që kërkojnë të lidhin martesë ndërmjet tyre.

Ajo që vlen për tu theksuar është fakti se parashikimet e nenit 64 parag 2 të Kodit Civil duhet të bëhen gjithmonë në mënyrë të zgjeruar referuar faktit se me anë të përfaqësimit nuk mund të kryhen jo vetëm ato veprime për të cilat ligji ka përcaktuar si detyrim praninë e vetë personit, por edhe të gjitha ato veprime të tjera të cilat për vetë natyrën e tyre janë të lidhura ngushtë me praninë e vetë personit, si dhe pa praninë e këtij të fundit ato nuk mund të kryhen. Si shembull mund të përmendim kryerjen e një pune të caktuar e cila lidhet pazgjdhshmërisht me cilësitë personale të personit pa të cilat ajo nuk mund të kryhet. Gjithashtu si shembull mund të citojmë edhe rastin e një futbollisti i cili pjesmarrjen në një ndeshje të caktuar nuk mund ta realizojë me anë të një përfaqësuesi.

Pavarësisht se disa legjislacione të huaja mund të lejojnë kryerjen e disa veprimeve të karakterit ngushtësisht personal, si shembull mund të përmendim rastin e martesës me prokurë përsëri edhe në këto raste personi i autorizuar për të kryer këtë veprim paraqitet më tepër si mbajtës i një vullneti preçiz të të interesuarit se sa si një përfaqësues i mirëfilltë në kushtet kur akti i përfaqësimit që i jepet në një rast të tillë paraqet qartë personin me të cilin do të lidhet martesë dhe personi i autorizuar në një rast të tillë nuk bën gjë tjetër vetëm se transmetimin e vullnetit të të përfaqësuarit që është një : **“po”** e kërkuar nga autoriteti i caktuar në ligj për të kryer procedurat e lidhjes së martesës.

iii) Karakteristikat e përfaqësimit si institut i të drejtës civile.

Referuar parashikimeve të nenit 64 të Kodit Civil, si dhe referuar edhe dispozitave të tjera të Kodit Civil që rregullojnë institutin e përfaqësimit përcaktohen edhe karakteristikat e këtij të fundit si institut i të drejtës, të cilat janë :

a) Përfaqësuesi duhet të ketë zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Kjo karakteristikë përcaktohet shprehimisht në nenin 64 parag 3 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar”*³².

Në dallim nga Kodi Civil aktual sipas të cilit është parashikuar shprehimisht që përfaqësuesi duhet të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1929 dhe konkretisht nenit 1106 të tij nuk ishte e nevojshme që përfaqësuesi të kishte zotësi të plotë juridike për të vepruar³³. Të njëjtin parashikim ligjor sikurse edhe Kodi Civil i vitit 1929 gjejmë

³¹ Referoju për këtë qëllim nenit 64 parag 2 të Kodit Civil të vitit 1994

³² Referoju për këtë qëllim nenit 64 parag 3 të Kodit Civil aktual.

³³ Referoju për këtë qëllim nenit 1106 të Kodit Civil të vitit 1929

edhe në Kodin Civil Italian dhe konkretisht në nenin 1389 të tij, sipas të cilit nuk konsiderohet e domosdoshme që përfaqësuesi të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Doktrina e asaj kohe lidhur me parashikimin ligjor sipas të cilit nuk ishte e nevojshme që përfaqësuesi të kishte zotësi të plotë për të vepruar jepte këtë arsyetim. Kufizimi i të drejtës për të qenë palë në një veprim juridik që i bëhet të miturve ose personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar bëhet me qëllim mbrojtjen e interesave të të miturve ose të personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar me qëllim që të tjerët të mos abuzojnë me pozitën juridike të tyre, për shkak se ata nuk konsiderohen të aftë që nëpërmjet veprimeve juridike që ata kryejnë të fitojnë të drejta dhe të marrin përsipër detyrime juridiko – civile. Prandaj ky kufizim nuk duhet të ekzistojë kur këta persona veprojnë si përfaqësues dhe për këtë shkak nuk mund të cënohen efektet e veprimeve të tyre, sepse efektet e këtyre veprimeve nuk shtrihen ndaj tyre por ndaj personave të përfaqësuar prej tyre³⁴. Në të njëjtin arsyetim rezulton që të bazohet edhe doktrina italiane e së drejtës civile³⁵.

Parashikimi si kusht i domosdoshëm për lindjen e marrëdhënies së përfaqësimit sipas parashikimeve të Kodit Civil aktual që përfaqësuesi të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar jo vetëm në vlerësimin tim personal por referuar për këtë qëllim edhe qëndrimin doktrinal të mbajtur aktualisht nga profesorët e të drejtës civile shqiptare nga të cilët do veçoja edhe udhëheqësin e këtij punimi Prof.Dr. Ardian Nuni³⁶ paraqitet i domosdoshëm në kushtet kur përfaqësuesi gjatë kryerjes së veprimeve juridike dhe veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit shfaq vullnetin e tij brenda tagrave që i janë dhënë nga ana e këtij të fundit. Sikurse e cituam edhe më lart përfaqësuesi në rastin e kryerjes së veprimeve juridike nuk paraqitet thjesht në pozitën e një transmetuesi vullneti të të përfaqësuarit, por në shumë raste ai si përfaqësues shfaq vullnetin e tij nga i cili lindin të drejta dhe detyrime juridiko – civile për të përfaqësuarin.

Për të ilustruar atë që cituam më lart po paraqesim një shembull.

Personi A cakton si përfaqësues të tij personin B të cilin e autorizon që në emër dhe për llogari të tij si i përfaqësuar të lidhte një kontratë për blerjen e një apartamenti të ndodhur në Tiranë pa përcaktuar zonën, sipërfaqen dhe çmimin e blerjes së këtij apartamenti. Në referim të aktit të përfaqësimit përfaqësuesi B hyn në marrëdhënie kontraktore me personin C duke kryer për këtë qëllim me këtë të fundit edhe veprimin juridik përkatës të blerjes së apartamentit që personi C kishte në pronësi të tij në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit A. Me anë të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi B rezulton që ky i fundit ka përcaktuar : **i)** si zonën përkatëse në të cilën ndodhej apartamenti ; **ii)** sipërfaqen e këtij të fundit ; **iii)** si dhe çmimin e blerjes.

³⁴ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

³⁵ Alberto Trabucchi, *Instituzioni di Diritto Civile*, botim i vitit 1986.

³⁶ Referoju për këtë qëllim Prof.Dr. Ardian Nuni, në librin “E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme”, botim i vitit 2012.

Në rastin konkret rezulton që të jemi para një shfaqje vullneti nga ana e përfaqësuesit B me pasoja juridike për të përfaqësuarin A. Me vullnetin e tij përfaqësuesi B rezulton që të ketë përcaktuar : **i)** si vendndodhjen e apartamentit ; **ii)** sipërfaqen e këtij të fundit ashtu edhe ; **iii)** çmimin e blerjes së apartamentit. Në një rast të tillë përfaqësuesi B nuk rezulton që të ketë vepruar vetëm si transmetues i vullnetit të të përfaqësuarit A, por rezulton që të ketë shfaqur vullnetin e tij lidhur me përcaktimin e disa elementëve thelbësorë të veprimit juridik që ai ka kryer me personin e tretë C. Në kuptim të ligjit dhe konkretisht në referim të përcaktimeve të nenit 6 paragraf 1 të Kodit Civil vullnet me pasoja juridike mund të shfaqë vetëm një person që ka fituar zotësinë e plotë juridike për të vepruar.

Gjithashtu si argument mund të citojmë edhe faktin se si rrjedhë e shfaqjes së vullnetit nga ana e përfaqësuesit për kryerjen e një veprimi juridik në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, këtij të fundit i lind e drejta për ti kundërshtuar këto veprime juridike për pavlefshmëri nëse përfaqësuesi i ka kryer këto veprime juridike nën ndikimin e mashtrimit, lajthimit ose kanosjes pavarësisht se i përfaqësuari vetë nuk ka qenë nën ndikimin e rrethanave të sipërcituara.

Gjithashtu në kuptim të ligjit dhe konkretisht në referim të përcaktimeve të nenit 102 të Kodit Civil të përfaqësuarit i lind e drejta për të kërkuar pavlefshmërinë e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi, nëse këto veprime juridike janë rrjedhë e një marrëveshjeje me keqbesim ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë. Që të mund të kemi marrëveshje ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë duhet që përfaqësuesi të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar, si dhe kjo marrëveshje nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se shfaqje vullneti nga ana e përfaqësuesit në dëm të interesave të të përfaqësuarit.

b) Përfaqësuesi duhet të veprojë personalisht në kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Një karakteristikë e tillë del nga vetë përkufizimi që ligji dhe konkretisht neni 64 i Kodit Civil i ka bërë institutit të përfaqësimit. Një karakteristikë e tillë gjendej e përcaktuar shprehimisht edhe nën 69 të Kodit Civil, dispozitë kjo tashmë e shfuqizuar sipas së cilës përjashtimisht përfaqësuesi mund të caktonte një zëvendës për kryerjen e veprimit juridik me kushtin që për kryerjen e një veprimi të tillë të ishte lejuar nga ana e të përfaqësuarit, si dhe në praninë e disa rrethanave që përcaktoheshin shprehimisht në neni 69 të Kodit Civil, dispozitë kjo tashmë e shfuqizuar.

c) Përfaqësuesi e kryen veprimin juridik apo çdo veprim tjetër të ligjshëm në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit

Sikurse përshkruam edhe më lart pavarësisht se përfaqësuesi në kryerjen e veprimit juridik shfaq vullnetin e tij, ai gjithmonë këtë veprim juridik e kryen në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, si dhe të gjitha këto veprime juridike të kryera nga përfaqësuesi krijojnë pasoja drejtpërdrejt për të përfaqësuarin sikurse

përcaktohet edhe në nenin 66 të Kodit Civil aktual³⁷.

ç) Përfaqësuesi i kryen veprimet në bazë dhe brenda kufijve të tagrave që i janë dhënë.

Sikurse është parashikuar edhe në nenet 64 dhe 65 të Kodit Civil tagrat e përfaqësimit në varësi të llojit të përfaqësimit përcaktohen nga ligji, nga prokura ose nga gjykata. Megjithatë jo në çdo rast tagrat duhet të dalin patjetër nga një akt i shprehur referuar faktit se sikurse gjendet e përcaktuar edhe në nenin 65 parag 2 i Kodit Civil tagret e përfaqësimit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse³⁸.

d) veprimet e kryera nga përfaqësuesi brenda kufijve të përfaqësimit janë të detyrueshme për të përfaqësuarin.

Karakteristika e sipërcituar përcaktohet shprehimisht në nenin 66 të Kodit Civil në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, brenda tagreve që i janë dhënë, krijojnë pasoja drejtpërdrejt për të përfaqësuarin”*³⁹.

Në rast se përfaqësuesi i kapërcen tagret e përfaqësimit, veprimet juridike të kryera prej këtij të fundit nuk janë të detyrueshme për të përfaqësuarin, si dhe përgjegjës për pasojat e ardhura në një rast të tillë është vetë përfaqësuesi që ka vepruar në kapërcim të tagreve të dhëna nga i përfaqësuarin. Megjithatë kjo nuk nënkupton faktin që kur veprimi juridik kryhet në kushte më të favorshme nga ato të caktuara nga i përfaqësuarin në prokurën e lëshuar prej tij, këto përfitime nuk i kalojnë të përfaqësuarit. Në një rast të tillë përfitues do të jetë përsëri i përfaqësuarin për shkak se në një rast të tillë nuk konsiderohet se përfaqësuesi ka vepruar në kapërcim të tagreve të dhëna në prokurë nga i përfaqësuarin.

dh) Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij, si dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Karakteristika e sipërcituar përcaktohet shprehimisht në nenin 67 të Kodit Civil ⁴⁰. Kjo karakteristikë do të gjejë trajtim të hollësishëm në kreun III të këtij punimi.

e) Përfaqësuesi mund të kryejë vetëm veprime juridike apo veprime të tjera, të cilat janë të lejueshme nga ligji.

Karakteristikë tjetër e përfaqësimit është edhe fakti se ky i fundit ka për objekt të saj vetëm kryerjen nga ana e përfaqësuesit të veprimeve juridike apo veprimeve të

³⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 66 të Kodit Civil aktual.

³⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 65 parag 2 të Kodit Civil aktual.

³⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 66 të Kodit Civil.

⁴⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 67 të Kodit Civil aktual.

tjera të cilat janë të ligjshme. Në asnjë rast përfaqësimi si institut i të drejtës civile nuk mund të ketë për objekt të tij kryerjen e veprimeve të paligjshme nga ana e përfaqësuesit në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Referuar karakteristikave të sipërcituara përfundimisht mund të japim këtë përkufizim për përfaqësimin si institut i veçantë i të drejtës civile : *“Përfaqësimi është një marrëdhënie juridiko - civile në të cilën një person fizik ose juridik (përfaqësuesi) duke vepruar brenda kufijve të të drejtave apo tagreve që i janë dhënë nga ligji, prokura ose gjykata kryen veprime juridike dhe veprime të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër të quajtur i përfaqësuarit, veprime të cilat krijojnë pasoja drejtpërdrejt për këtë të fundit”*.

Më lart evidentuam karakteristikat thelbësore të përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile në referim të të cilave më pas definuam edhe përkufizimin përkatës lidhur me kuptimin që në referim të ligjit duhet t’i jepet përfaqësimit. Por në kuadër të evidentimit të karakteristikave të përfaqësimit vlerësoj se paraqet një rëndësi të veçantë për trajtim si për efekt studimor, ashtu edhe në funksion të dhënies së një mendimi paraprak për raste që mund të ndeshen në jetën e përditshme dhe që mund të shndërrohen edhe në konflikte gjyqësore ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit është marrja në analizë dhe dhënia më pas edhe opinionit përkatës nëse përfaqësimi ka si karakteristikë të tij përfitimin e shpërblimit nga përfaqësuesi për veprimet juridike apo veprimet e tjera të ligjshme të kryera në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil që rregullojnë institutin e përfaqësimit, në asnjë prej tyre nuk përcaktohet nëse përfaqësimi është me shpërblim apo jo, pra nëse përfaqësuesi si rrjedhojë e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme që ka kryer në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit duhet të përfitojë apo jo shpërblim nga ky i fundit.

Arsyeja e mungesës së një parashikimi të tillë ligjor lidhet dhe shpjegohet edhe me faktin se marrëdhënia e përfaqësimit mund të lindë për shkaqe nga më të ndryshme nga të cilat mund të veçonim : **a)** lidhjet e ngushta familjare apo shoqërore të përfaqësuesit me të përfaqësuarin ; **b)** ekzistencën e marrëdhënies të varësisë apo marrëdhënies të punës ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit...*etj*. Në të tilla raste për shkak të marrëdhënies së posaçme që ekziston ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit nuk mund të flitet për përfitimin e ndonjë shpërblimi nga ana e përfaqësuesit. Kjo është edhe arsyeja që shumë autorë të së drejtës përcaktojnë se përfaqësimi ka si karakteristikë të tij faktin se është pa shpërblim⁴¹.

Por një gjë e tillë nuk mund të thuhet në rastin e marrëdhënies së përfaqësimit avokat – klient, marrëdhënie përfaqësimi e cila si rregull është me shpërblim, apo kur palët kanë parashikuar përfitimin nga ana e përfaqësuesit të një shpërblimi për veprimet juridike apo veprimet e tjera të ligjshme që ky i fundit do të kryejë në emër dhe për llogari të të

⁴¹ Referoju për këtë qëllim Prof.Dr. Ardian Nuni, në librin “E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme”, botim i vitit 2012.

përfaqësuarit.

Vlerësimi im personal është se në raste të tilla do të jenë të zbatueshme dispozitat që rregullojnë kontratën e porosisë në të cilat ndër të tjera është parashikuar se i porosituri mund të veprojë në emër dhe për llogari të porositësit duke u zbatuar për këtë qëllim dispozitat mbi përfaqësimin⁴².

Si përfundim mund të themi se përfaqësimi ka si karakteristikë të tij faktin se është pa shpërblim. Në të gjitha ato raste kur palët kanë parashikuar që përfaqësuesi për veprimet juridike apo veprimet e tjera të ligjshme që do të kryejë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit do të përfitojë një shpërblim nuk do të jemi para marrëdhënies së përfaqësimit, por para një kontrate porosie të lidhur ndërmjet palëve e cila ka në thelb të saj kryerjen e veprimeve përfaqësuese nga ana e të porositurit në emër dhe për llogari të porositësit, përkundrejt përfitimit të një shpërblimi nga ana e të porositurit.

⁴² Referoju për këtë qëllim nenit 914 të Kodit Civil.

KREU II

II. Llojet e përfaqësimit, si dhe trajtimi i tyre në raport me institute të tjera të së drejtës civile.

Llojet e përfaqësimit.

Sikurse kemi parashtruar edhe më lart që një person të mund të veprojë në emër dhe për llogari të një personi tjetër duhet t'i jetë dhënë pushtet për të bërë një gjë të tillë. Ky pushtet mund ta ketë burimin e tij nga ligji ose nga vullneti i të interesuarit.

Përcaktimin e sipërcituar e gjejmë të sanksionuar edhe në nenin 65 parag 1 të Kodit Civil në të cilin përcaktohet shprehimisht se : *“Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen me prokurë”*⁴³.

Në rastin e parë pra kur pushteti i përfaqësimit buron nga ligji kemi përfaqësim ligjor, ndërsa në rastin e dytë kur pushteti i përfaqësimit buron nga vullneti i të përfaqësuarit kemi përfaqësim vullnetar.

Në referim të përcaktimit të mësipërm të sanksionuar edhe në ligj arrihet në përfundimin se përfaqësimi si institut i veçantë i të drejtës civile të shfaqet në dy forma apo në dy trajta të ndryshme të cilat përbëjnë edhe llojet e përfaqësimit dhe konkretisht ai shfaqet si:

- i)** përfaqësim ligjor ose i detyrueshëm ;
- ii)** përfaqësim vullnetar.

i) Përfaqësimi ligjor ose i detyrueshëm.

Në të gjitha rastet kur pushteti i përfaqësimit buron nga ligji kemi të bëjmë me përfaqësim ligjor. Edhe në ato raste kur këto tagre caktohen nga gjykata sikurse referohet në nenin 64 të Kodit Civil përsëri kjo e fundit në caktimin e tagreve të përfaqësuesit i referohet dispozitave ligjore që parashikojnë caktimin e përfaqësuesit.

Në rastin e përfaqësimit ligjor i njohur ndryshe edhe si përfaqësim i detyrueshëm është ligji ai që përcakton lindjen e marrëdhënies së përfaqësimit, caktimin e përfaqësuesit, si dhe kufijtë e të drejtave të këtij të fundit të njohura ndryshe si tagre përfaqësimi. Ky lloj përfaqësimi ka karakter të detyrueshëm si për të përfaqësuarin ashtu edhe për përfaqësuesin.

Përfaqësimi ligjor, si një ndër llojet e përfaqësimit gjithmonë krijohet ose lind si rrjedhojë e ndodhjes së fakteve të ndryshme juridike që ndodhin në jetën e përditshme. Si shembuj mund të referojmë :

- a)** Lindjen e një fëmije, e cila është një ngjarje e caktuar që sjell si pasojë lindjen e

⁴³ Referoju për këtë qëllim nenit 65 parag 1 të Kodit Civil.

marrëdhënies së përfaqësimit të fëmijës nga prindërit e tij⁴⁴ ;

b) vdekjen e një personi, e cila mund të përbëjë një ngjarje që në raste të caktuara mund të paraqesë nevojën e caktimit të një kujdestari të pasurisë trashëgimore⁴⁵ ;

c) heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar të një personi është një ngjarje që sjell si pasojë edhe caktimin e një personi si kujdestar të interesave të personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar për ta përfaqësuar këtë të fundit në marrëdhëniet me të tretët⁴⁶ ;

ç) caktimi i kujdestarit për fëmijën e mitur nëse prindërit e këtij të fundit kanë vdekur ose gjenden në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore⁴⁷ ;

d) çelja e procedurës së falimentimit për një debitor, sjell si pasojë edhe caktimin e administratorit të falimentimit, i cili vepron si përfaqësues ligjor i debitorit në raport me të tretët⁴⁸.

Më lart referuam disa shembuj të lindjes apo krijimit të marrëdhënies së përfaqësimit ligjor, duke u përpjekur të evidentojmë disa prej situatave më të zakonshme që ndodhin në jetën e përditshme. Shembujt e referuar më sipër janë mëse të mjaftueshëm për të evidentuar karakterin detyrues të këtij lloj përfaqësimi. Për efekt të këtij punimi vlerësoj se paraqitet e panevojshme evidentimi i të gjitha rasteve të përfaqësimit ligjor. Shembujt e referuar më lart u dhanë edhe në funksion të përkufizimit të mësipërm se në rastin e përfaqësimit ligjor është pikërisht ligji ai që përcakton lindjen e marrëdhënies së përfaqësimit dhe se shkaqet e lindjes së këtij lloj përfaqësimi mund të jenë nga më të ndryshmet.

Ajo që vlen për tu theksuar në rastin e përfaqësimit ligjor është se ky i fundit nuk duhet të ngatërrohet me përfaqësimin organik, i cili përbën një koncept më të gjerë dhe gjen shtrirjen e tij si në fushën e të drejtën civile ashtu edhe në atë të drejtës publike. Përfaqësimi organik lind si rezultat i emërimit apo caktimit të një personi në një pozicion të caktuar. Është pikërisht emërimi ose caktimi i një personi në një pozicion të caktuar që sjell si pasojë që në kuptim të parashikimeve ligjore ky person të ushtrojë edhe pushtet përfaqësues në marrëdhënie me të tretët. Si shembull mund të referonim rastin e caktimit apo emërimit të një personi të caktuar si administrator të një shoqërie tregtare. Ky i fundit si rrjedhojë e funksionit pra si administrator i kësaj shoqërie në kuptim të ligji ushtron edhe pushtetin e përfaqësimit të shoqërisë në raport me të tretët. Edhe në rastin e përfaqësimit organik është ligji ai që ka parashikuar se si rrjedhojë e emërimit apo caktimit të një personi në një funksion të caktuar, ky i fundit ushtron edhe pushtetin përfaqësues të një personi apo grupi personash në marrëdhënie me të tretët. Si përfaqësimi ligjor ashtu edhe përfaqësimi organik kanë si karakteristikë të përbashkët faktin se të dy këto lloj përfaqësimesh janë rrjedhojë e parashikimeve ligjore.

⁴⁴ Referoju për këtë qëllim nenit 220 të Kodit të Familjes, si dhe nenit 8 të Kodit Civil.

⁴⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 344 të Kodit Civil

⁴⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 307 të Kodit të Familjes.

⁴⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 224 të Kodit të Familjes.

⁴⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 29 pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 110/2016 “Për Falimentimin”.

ii) Përfaqësimi vullnetar.

Në të gjitha rastet kur pushteti i përfaqësimit buron nga vullneti i të përfaqësuarit kemi të bëjmë me përfaqësim vullnetar. Ky vullnet i të përfaqësuarit përgjithësisht shfaqet duke u pasqyruar në një akt apo dokument që në kuptim të parashikimeve ligjore quhet : *“Prokurë”*.

Përfaqësimi vullnetar krahas formës shkresore si një nga format e shfaqjes së vullnetit mund të shfaqet edhe në format e tjera të parashikuara nga ligji për kryerjen e një veprimi juridik dhe që përcaktohen në nenin 80 të Kodit Civil sikurse janë në mënyrë verbale, me heshtje dhe me veprime konkludente.

Por nëse në rastin e shfaqjes së vullnetit në formë të shkruar nga ana e të përfaqësuarit situata paraqitet e thjeshtë për shkak se si caktimi i përfaqësuesit ashtu edhe tagrat që i janë dhënë këtij të fundit janë lehtësisht të konstatueshme, në rastin e shfaqjes së vullnetit në format e tjera të përcaktuara më lart situata mund të paraqitet mjaft e komplikuar, si përsa i përket caktimit të përfaqësuesit ashtu edhe në funksion të evidentimit të pushteve apo tagreve që i janë dhënë këtij të fundit.

Ligji dhe konkretisht neni 65 parag 2 i Kodit Civil ka përcaktuar shprehimisht se : *“Tagret e përfaqësimit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse”*⁴⁹.

Përcaktimi ligjor i sipërcituar nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për caktimin e përfaqësuesit në përfaqësimin vullnetar, si dhe përcaktimi i tagreve të këtij të fundit mund të bëhet edhe në forma të tjera krahas asaj shkresore. Gjithsesi kjo mënyrë përfaqësimi përgjithësisht është tepër e kufizuar. Ekzistenca e një akti të shkruar në të cilin të pasqyrohet vullneti i të përfaqësuarit ose i titullarit në rastin e personit juridik të përfaqësuar nuk është e nevojshme në ato raste kur marrëdhënia juridike e përfaqësimit rezulton nga vetë rrethanat konkrete të kryerjes së veprimit. Një mënyrë e tillë përfaqësimi gjendet e përhapur kryesisht në larmishmërinë e veprimeve të kryera nga personat juridikë, për të cilat nga ana e administratorit të shoqërisë jo gjithmonë lëshohet me shkrim një akt përfaqësimi.

Karakteristikë në përfaqësimin vullnetar është edhe fakti se ai mund të shfaqet si përfaqësim individual ose si përfaqësim kolektiv. Një karakteristikë e tillë rezulton nga përmbajtja e nenit 68 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe”*⁵⁰.

Kemi përfaqësim individual në ato raste kur i përfaqësuarit përfaqësohet nga një përfaqësues ose nga disa përfaqësues të cilët mund të veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri, ndërsa kemi përfaqësim kolektiv në ato raste kur e drejta e përfaqësimit i

⁴⁹ Referoju për këtë qëllim neni 65 parag 2 të Kodit Civil.

⁵⁰ Referoju për këtë qëllim neni 68 të Kodit Civil.

është dhënë dy ose më shumë personave të cilët nuk mund ta ushtrojnë pushtetin e përfaqësimit në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri, por vetëm së bashku.

Prokura

Përkufizimi i prokurës rezulton që të jetë dhënë në nenin 70 të Kodit Civil në të cilin rezulton që të jetë përcaktuar shprehimisht se : *“Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuarit, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit”*⁵¹.

Referuar përkufizimit të dhënë nga ligji për prokurën rezulton që kjo e fundit nuk përbën gjë tjetër vetëm se një shkresë apo dokument në të cilin fiksohet dhe materializohet shfaqja e vullnetit të të përfaqësuarit, si dhe kufijtë e pushteteve apo tagreve që i jepen përfaqësuesit. Në këtë kuptim prokura nuk është gjë tjetër vetëm se dokumenti në të cilin gjen pasqyrim veprimi juridik i njëanshëm i lëshuar nga ana e të përfaqësuarit në referim të të cilit krijohet edhe marrëdhënia juridike e përfaqësimit. Pra prokura nuk përbën gjë tjetër vetëm se një veprim juridik të njëanshëm, si dhe përbën faktin juridik mbi bazën e të cilit lind marrëdhënia juridiko – civile e përfaqësimit ndërmjet të përfaqësuarit i cili shfaq vullnetin e vet për caktimin e një ose disa personave të tjerë, të cilët do të veprojnë në emër dhe për llogari të tij si i përfaqësuar dhe personit apo personave që caktohen si përfaqësues. Në referim të asaj që parashtruar më lart rezulton që prokura nuk përbën gjë tjetër vetëm se një veprim juridik të njëanshëm me anën e të cilit një person i jep një personi tjetër pushtetin për ta përfaqësuar në kryerjen e një apo disa veprimeve juridike. Kjo është edhe arsyeja për cilën përfaqësuesi vullnetar quhet ndryshe edhe si mbajtësi i prokurës. Në këtë aspekt duhet të mbahet mirë parasysh se në dhënien përfaqësuesit të pushtetit për të përfaqësuar një person tjetër në kryerjen e një apo disa veprimeve juridike gjenden të pranishme dy aspekte të ndryshme të cilat nuk duhen ngatërruar me njëri – tjetrin dhe që janë :

Aspekti i parë : Personi i cili kryen veprimet në emër dhe për llogari të një personi tjetër, mund ta bëjë këtë për motive nga më të ndryshme ku si shembuj mund të referojmë lidhjet gjinore apo miqësore ose edhe ato të varësisë. Ky aspekt ka të bëjë me anën e brendshme ose me marrëdhënien e brendshme ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Ky aspekt nuk ka rëndësi për të drejtën civile.

Aspekti i dytë : Lidhet me anën e jashtme dhe konkretisht prokura shërben për t’ia treguar të tretëve me të cilët përfaqësuesi do të kontaktojë për efekt të kryerjes së veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Kjo është edhe arsyeja për të cilën prokura përbën një veprim juridik të njëanshëm, i cili duhet dalluar nga marrëdhënia e brendshme ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit, marrëdhënie e cila mund të jetë rrjedhojë e fakteve të ndryshme.

Forma e prokurës

Forma që duhet të ketë prokura si veprim juridik i njëanshëm rezulton që të jetë përcaktuar shprehimisht në nenin 72 të Kodit Civil ku parashikohet se : *“Prokura bëhet*

⁵¹ Referoju për këtë qëllim nenit 70 të Kodit Civil.

*gjithmonë me shkresë*⁵².

Në referim të përcaktimit ligjor të sipërcituar arrihet në përfundimin se prokura është një veprim juridik formal, madje vetë dispozita e sipërcituar ka përcaktuar shprehimisht se prokura krahas formës shkresore duhet të jetë e shoqëruar edhe me formë noteriale në ato raste kur ligji parashikon se veprimi juridik që do të kryejë përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit bëhet me akt noterial. Si shembull mund të referojmë kontratën e shitjes së një sendi të paluajtshmë ose të të drejtave reale mbi të, të cilat në referim të përcaktimeve të nenit 83 të Kodit Civil duhet të bëhen me akt noterial. Në një rast të tillë edhe prokura që i përfaqësuarit i jep përfaqësuesit për të kryer veprime juridike të natyrës së sipërcituar duhet që detyrimisht të ketë formë noteriale, në të kundërt konsiderohet e pavlefshme në referim të përcaktimeve të nenit 72 të Kodit Civil⁵³.

Gjithashtu në referim të përcaktimeve të dispozitës së sipërcituar edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatës dhe insitucioneve të tjera shtetërore duhet të bëhet me akt noterial, në të kundërt konsiderohet e pavlefshme po në referim të dispozitës së sipërcituar. Lidhur me përfaqësimin e personave juridikë në nenin 72 të Kodit Civil rezulton të jetë parashikuar se : *“Prokura për të kryer veprime në emër dhe për llogari të këtyre personave mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse të personit juridik”*. Megjithatë në rastet kur përfaqësuesi i personit juridik do të kryejë veprime juridike për të cilat ligji ka parashikuar që duhet të kenë formë noteriale edhe në një rast të tillë prokura e lëshuar nga personi juridik duhet të ketë të njëjtën formë, në të kundërt konsiderohet e pavlefshme. Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim vetë përmbajtjes së nenit 72 të Kodit Civil në të cilin parashikohet ndër të tjera se : *“...përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial”*⁵⁴.

Në nenin 73 të Kodit Civil rezulton që të jenë përcaktuar edhe rastet kur prokura mund të vërtetohet në forma të tjera dhe konkretisht vetëm për kryerjen e disa veprimeve të caktuara të përcaktuara këto shprehimisht në dispozitën e sipërcituar⁵⁵.

Llojet e prokurave.

Referuar përcaktimeve të nenit 71 të Kodit Civil rezulton se prokura të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Referuar përkufizimit të bërë në ligj dhe konkretisht në dispozitën e sipërcituar rezulton që si kriter dallues ndërmjet prokurës së përgjithshme dhe asaj të posaçme të jetë vëllimi i tagreve që i jepet përfaqësuesit nga ana e të përfaqësuarit. Kështu në kuptim të ligjit prokura konsiderohet e përgjithshme : *“kur i përfaqësuarit i ka dhënë përfaqësuesit tagra për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i përfaqësuarit i ka përjashtuar shprehimisht”*⁵⁶, ndërsa prokura konsiderohet e posaçme në kuptim të ligjit kur : *“i përfaqësuarit i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të*

⁵² Referoju për këtë qëllim nenit 72 të Kodit Civil

⁵³ Referoju për këtë qëllim përsëri nenit 72 të Kodit Civil

⁵⁴ Referoju për këtë qëllim përsëri nenit 72 të Kodit Civil

⁵⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 73 të Kodit Civil

⁵⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 71 parag 1 të Kodit Civil.

*kryer një ose disa veprime juridike të caktuara që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët*⁵⁷.

Si shembuj prokure të përgjithshme mund të referojmë rastin kur i përfaqësuari i ka dhënë prokurë përfaqësuesit për të administruar dhe për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që i përfaqësuari ka në pronësi të tij, ose kur i përfaqësuari mund t'i ketë dhënë prokurë përfaqësuesit që ky i fundit ta përfaqësojë në të gjitha proceset gjyqësore në të cilat ai si i përfaqësuar mund të jetë palë ndërgjyqëse.

Si shembuj prokure të posaçme mund të referojmë rastin kur i përfaqësuari i ka dhënë prokurë përfaqësuesit për të shitur një send të luajtshëm apo të paluajtshëm që është në pronësi të të përfaqësuarit, ose rastin kur i përfaqësuari i ka dhënë prokurë përfaqësuesit që ky i fundit ta përfaqësojë në një gjykim civil të caktuar në të cilin ai si i përfaqësuar është palë ndërgjyqëse.

Si prokura e përgjithshme ashtu edhe ajo e posaçme mund të përmbajnë kufizime për veprimtarinë e përfaqësuesit. Si shembull mund të referojmë rastin kur i përfaqësuari i ka dhënë prokurë përfaqësuesit për t'i administruar tërë pasurinë e tij ose një pasuri të tij, por jo tjetërsimin e këtyre pasurive. Është e natyrshme që përfaqësuesi duhet t'i kryejë veprimet, të cilat që të konsiderohen në kuptim të ligjit të detyrueshme për të përfaqësuarin duhet që të jenë kryer vetëm brenda kufijve të tagrave që i janë dhënë dhe pikërisht për këtë arsye për të tretin që merr kontakte me përfaqësuesin i intereson të dijë nëse ky i fundit efektivisht është i pajisur me pushtetet e nevojshme nga ana e të përfaqësuarit dhe deri ku shtrihen këto pushtete. Kjo është edhe arsyeja për të cilën përfaqësuesi është i detyruar t'i paraqesë personit të tretë prokurën kur i kërkohet nga ky i fundit në funksion të verifikimit të tagreve me të cilat është i pajisur ai si përfaqësues.

Mbarimi i prokurës

Referuar faktit që prokura jepet në interes të të përfaqësuarit, si dhe lëshohet nga ky i fundit është e qartë se ai ka të drejtë të ndryshojë objektin apo kohëzgjatjen e prokurës së lëshuar prej tij. Gjithashtu i përfaqësuari mund t'i ndryshojë, t'i shtojë apo t'i pakësojë tagrat që i ka dhënë përfaqësuesit në prokurën e lëshuar prej tij, madje i përfaqësuari mund t'i heqë përfaqësuesit pushtetin që i ka dhënë për të vepruar në emër dhe për llogari të tij si i përfaqësuar. Në rastin e fundit bëhet fjalë për shfuqizimin e prokurës, i cili përbën edhe një nga rastet e mbarimit të prokurës të përcaktuara këto shprehimisht në nenin 76 të Kodit Civil⁵⁸. Edhe shfuqizimi i prokurës ashtu sikurse dhënia e prokurës rezulton që të jetë veprim juridik i njëanshëm i të përfaqësuarit. Ashtu sikurse është e mjaftueshme shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për të krijuar marrëdhënien juridike të përfaqësimit dhe konkretisht për t'i dhënë përfaqësuesit pushtetin për të vepruar në emër dhe për llogari të tij si i përfaqësuar, po ashtu rezulton që të jetë e mjaftueshme shfaqja

⁵⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 71 paragraf 2 të Kodit Civil.

⁵⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 76 gërma "d" të Kodit Civil.

e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për t'i dhënë fund marrëdhënies juridike të përfaqësimit duke i hequr për këtë qëllim përfaqësuesit pushtetin e dhënë. Referuar përcaktimeve të nenit 76 të Kodit Civil rezulton që prokura i pushon efektet e saj edhe kur përfaqësuesi heq dorë nga përfaqësimi. Rast tjetër i mbarimit të prokurës dhe konkretisht i mbarimit të efekteve të saj, si veprim juridik i njëanshëm është edhe rasti kur përfaqësuesi i kryen të gjitha veprimet juridike për të cilat prokura është dhënë⁵⁹. Në një rast të tillë është mëse e kuptueshme se kur prokura është dhënë për kryerjen e një veprimi juridik të caktuar, me tu kryer ky veprim realizohet edhe qëllimi për të cilin ishte lëshuar prokura dhe për pasojë ajo në kuptim të ligjit nuk rezulton të ketë më vlerë, si dhe me anë të kësaj prokure nuk mund të kryhen veprime të tjera juridike në kushtet kur ajo është lëshuar vetëm për kryerjen e një veprimi juridik të caktuar. Rast tjetër i parashikuar nga ligji që sjell si pasojë edhe mbarimin e prokurës është kalimi i afatit për të cilin ajo është dhënë⁶⁰. Në një rast të tillë rezulton që të jemi para një veprimi juridik me afat zgjidhës, me plotësimin e të cilit sikurse përcaktohet edhe në nenin 90 të Kodit Civil pasojat e veprimit juridik mbarojnë⁶¹. Rast tjetër i referuar në nenin 76 të Kodit Civil që sjell si pasojë mbarimin e prokurës është edhe rasti : *“kur ka vdekur përfaqësuesi ose i përfaqësuari, ose kur njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar”*⁶². Për analogji duhet pranuar se prokura mbaron edhe kur personi shpallet i vdekur me vendim gjykatë në kushtet kur kjo lloj vdekje në referim të përcaktimeve të nenit 22 të Kodit Civil barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë⁶³.

Në funksion të rastit të sipërcituar që sjell si pasojë mbarimin e prokurës po paraqesim një shembull nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 493, datë 06.03.2003 ndër të tjera rezulton të ketë arsyetuar : *“Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se kontrata e shitjes është lidhur nga trashëgimtarët ligjorë të radhës së tretë të të ndjerës Y pas vdekjes së kësaj të fundit, nga përfaqësuesi me prokurë të lëshuar para vdekjes. Në kuptim të nenit 76 të Kodit Civil prokura e lëshuar nga e ndjera Y ka mbaruar para lidhjes së kontratës së shitjes dhe për rrjedhojë kjo e fundit konsiderohet e pavlefshme për shkak se cilësia e të qënurit përfaqësues kishite mbaruar me vdekjen e të përfaqësuarës”*⁶⁴.

Rast tjetër i parashikuar në nenin 76 të Kodit Civil që sjell si pasojë edhe mbarimin e prokurës është rasti kur ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar⁶⁵.

Në kuadër të trajtimit të rasteve të mbarimit të prokurës ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje, të cilës vlerësoj se e meriton t'i kushtohet vëmendje si për efekt studimor ashtu

⁵⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 76 gërma “a” të Kodit Civil.

⁶⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 76 gërma “b” të Kodit Civil.

⁶¹ Referoju për këtë qëllim nenit 90 parag 2 të Kodit Civil.

⁶² Referoju për këtë qëllim nenit 76 gërma “c” të Kodit Civil.

⁶³ Referoju për këtë qëllim nenit 22 parag 1 të Kodit Civil.

⁶⁴ Referoju për këtë qëllim vendimit nr. 493, datë 06.03.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

⁶⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 76 gërma “ç” të Kodit Civil

edhe në funksion të evidentimit të mangësive që paraqet neni 76 i Kodit Civil në të cilin parashikohen edhe rastet e mbarimit të prokurës do të ishte:

A përbën rast të mbarimit të prokurës rasti kur i përfaqësuari është shpallur si i zhdukur me vendim gjyqësor të formës së prerë ?

Në funksion të pyetjes së parashtuar më lart po paraqesim një shembull, i cili mund të ndeshet në jetën e përditshme.

Personi A rezulton që të ketë lëshuar një prokurë të përgjithshme pa afat për personin B duke e caktuar këtë të fundit si përfaqësues për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme që ai si i përfaqësuar kishte në pronësi të tij. Rreth një vit nga momenti i lëshimit të prokurës i përfaqësuari B humbet kontaktet me familjarët e tij, të cilët pas kalimit të një afati më shumë se 2 (dy) vjet nga momenti i humbjes së kontakteve dhe mungesës së lajmeve për të përfaqësuarin B rezulton që në referim të përcaktimeve të nenit 375 të Kodit të Proçedurës Civile të paraqesin kërkesë në gjykatën e shkallës së parë në territorin e të cilës i përfaqësuari B kishte pasur banimin e tij të fundit me objekt: *“Shpalljen si të zhdukur të të përfaqësuarit B”*⁶⁶. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës gjykata vendos : *“Shpalljen si të zhdukur të të përfaqësuarit B, si dhe në referim të përcaktimeve të nenit 16 parag 2 të Kodit Civil vendos edhe caktimin e personit C si kujdestar për administrimin e pasurisë të të përfaqësuarit B”*⁶⁷.

Në referim të fakteve të paraqitura më lart rezulton që në rastin e paraqitur si shembull të ndodhemi para një mbivendosje pushtetesh përfaqësimi. Konkretisht nga njëra anë kemi përfaqësuesin B të caktuar në referim të vullnetit të shfaqur nga i përfaqësuari A para se ky i fundit të shpallej si i zhdukur, prokurë kjo e cila sikurse parashtuam edhe më lart rezulton që të jetë dhënë pa afat nga ana e të përfaqësuarit A dhe nga ana e tjetër pas shpalljes si të zhdukur të këtij të fundit nga ana e gjykatës në referim të përcaktimeve të nenit 16 parag 2 të Kodit Civil të cilat janë detyruese për gjykatën rezulton që për administrimin e pasurisë së tij të jetë caktuar si përfaqësues ligjor një person tjetër dhe konkretisht personi C.

Kodi Civil dhe konkretisht neni 76 i tij që parashikon edhe rastet e mbarimit të prokurës nuk rezulton që të bëjë ndonjë parashikim lidhur me rastin e referuar sa më sipër. Edhe dispozitat e tjera të Kodit nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim ligjor të situatës së mësipërme. Gjithashtu edhe në doktrinë nuk gjejmë ndonjë mendim lidhur me rastin e referuar më lart.

Nëse do konsiderojmë që përfaqësuesi B do vijojë të ushtrojë pushtetet e përfaqësimit duke kryer për këtë qëllim veprime me qëllim administrimin e pasurisë së të përfaqësuarit A, pra prokura e lëshuar prej këtij të fundit do të vijojë t'i shtrijë efektet e saj, si dhe nga ana tjetër edhe personi C në vijim të ushtrimit të detyrës së tij si përfaqësues ligjor i caktuar nga gjykata do të kryejë veprime me qëllim administrimin e pasurisë së personit A, secili prej tyre referuar për këtë qëllim edhe mënyrës si janë përfutur pushtetet e përfaqësimit do të mund vepronte në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri duke kryer për këtë qëllim në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit A veprime të

⁶⁶ Referoju për këtë qëllim neni 15 të Kodit Civil si dhe neni 375 të Kodit të Proçedurës Civile.

⁶⁷ Referoju për këtë qëllim neni 380 të Kodit të Proçedurës Civile, si dhe neni 16 parag 2 të Kodit Civil

ndryshme juridike me persona të tretë. Kjo veprimtari përfaqësimi e kryer në mënyrë të pavarur nga secili prej përfaqësuesve si rrjedhë e mbivendosjes së pushteteve të përfaqësimit do shkaktonte një situatë kaotike në raport me administrimin e pasurisë së personit të shpallur si të zhdukur, si pasojë e kryerjes së të njëjtave veprime me persona të ndryshëm si rrjedhë e të vepruarit në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri, duke përbërë në këtë mënyrë shkak për lindjen e konflikteve gjyqësore si ndërmjet përfaqësuesve me njëri - tjetrin ashtu edhe ndërmjet tyre dhe personave të tretë me të cilët kishte kontaktuar ndonjëri prej përfaqësuesve, si dhe ndërmjet vetë personave të tretë.

Vlerësimi im personal në lidhje me pyetjen e shtruar më lart, në funksion të së cilës është dhënë edhe shembulli përkatës është se caktimi nga ana e gjykatës në referim të përcaktimeve të nenit 16 parag 2 të Kodit Civil të një kujdestari për administrimin e pasurisë së personit të shpallur si të zhdukur përbën shkak për mbarimin e prokurës të lëshuar nga i përfaqësuarit për arsye se në një rast të tillë vetë ligji ka parashikuar caktimin e një përfaqësuesi ligjor për administrimin e pasurisë së personit të shpallur si të zhdukur dhe si rrjedhë e këtij fakti prokura e lëshuar nga i përfaqësuarit që shpallet si i zhdukur me vendim gjykate nuk mund të vijojë të sjellë më efekte për arsye se si rregull pushtetet e përfaqësimit të fituara në një kohë të mëvonshme lënë pa veprim pushtetet e përfaqësimit të fituara në një kohë të mëparshme pavarësisht shkakut që ka sjellë si pasojë lindjen e pushtetit të përfaqësimit. Pra pavarësisht faktit se tagrat e përfaqësimit janë rrjedhë e vullnetit të të përfaqësuarit apo rrjedhë e parashikimeve ligjore duhet pranuar se të njëjtat tagra të fituara nga përfaqësuesi i mëvonshëm sjellin si pasojë revokimin e të njëjtave tagreve të fituara nga përfaqësuesi i mëparshëm me përjashtim të rastit kur i përfaqësuarit e ka përcaktuar shprehimisht se tagrat e fituara nga përfaqësuesi i mëparshëm do të vijojnë të jenë në fuqi.

Gjithashtu në kuadër të trajtimit të rasteve të mbarimit të prokurës ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje, të cilës gjithashtu vlerësoj se e meriton t'i kushtohet vëmendje si për efekt studimor ashtu edhe në funksion të evidentimit të mangësive që paraqet neni 76 i Kodit Civil në të cilin parashikohen edhe rastet e mbarimit të prokurës do të ishte :

A përbën rast të mbarimit të prokurës rasti kur të përfaqësuarit apo përfaqësuesit i është kufizuar zotësia juridike për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë ?

Edhe lidhur me pyetjen e shtruar më lart nga pikëpamja e faktit situata paraqitet e njëjtë për shkak se në referim të përcaktimeve të nenit 307 të Kodit të Familjes edhe në rastet kur gjykata vendos kufizimin e zotësisë për të vepruar të një personi cakton një kujdestar për tu kujdesur për personin që i është kufizuar zotësia për të vepruar, i cili ka edhe tagre administrimi të pasurisë së këtij të fundit⁶⁸.

Edhe në këtë rast të parashtruar si pyetje nga ana ime nuk rezulton që Kodi Civil dhe konkretisht neni 76 i tij që parashikon edhe rastet e mbarimit të prokurës të bëjë ndonjë parashikim ligjor se çfarë ndodh me prokurat që ka lëshuar personi që i kufizohet zotësia për të vepruar, si dhe çfarë ndodh edhe kur përfaqësuesit i kufizohet zotësia për të vepruar. Gjithashtu edhe në doktrinë nuk gjejmë ndonjë mendim lidhur me rastin e

⁶⁸ Referoju për këtë qëllim neni 307 të Kodit të Familjes.

parashtruar si pyetje nga ana ime.

Në vlerësimin tim personal edhe në një rast të tillë do të vlejë i njëjti mendim që dhashë gjatë përgjigjes së pyetjes së parë të parashtruar nga ana ime. Edhe në një rast të tillë caktimi nga ana e gjykatës në referim të përcaktimeve të nenit 307 të Kodit të Familjes të një kujdestari ndaj personit që i është kufizuar zotësia për të vepruar, i cili ushtron edhe funksione përfaqësuese, si përfaqësues ligjor ndaj personit që i është kufizuar zotësia për të vepruar përbën shkak për mbarimin e prokurës të lëshuar nga i përfaqësuari për arsye se në një rast të tillë vetë ligji ka parashikuar caktimin e një përfaqësuesi ligjor për administrimin e pasurisë së personit të cilit i kufizohet zotësia për të vepruar dhe si rrjedhojë e këtij fakti prokura e lëshuar nga ky i fundit nuk mund të vijojë të sjellë më efekte për arsye se si rregull pushtetet e përfaqësimit të fituara në një kohë të mëvonshme lënë pa veprim pushtetet e përfaqësimit të fituara në një kohë të mëparshme pavarësisht shkakut që ka sjellë si pasojë lindjen e pushtetit të përfaqësimit. Pra pavarësisht faktit se tagrat e përfaqësimit janë rrjedhojë e vullnetit të të përfaqësuarit apo rrjedhojë e parashikimeve ligjore duhet pranuar se të njëjtat tagra të fituara nga përfaqësuesi i mëvonshëm sjellin si pasojë revokimin e të njëjtave tagreve të fituara nga përfaqësuesi i mëparshëm me përjashtim të rastit kur i përfaqësuari e ka përcaktuar shprehimisht se tagrat e fituara nga përfaqësuesi i mëparshëm do të vijojnë të jenë në fuqi.

Ndërsa lidhur me rastin kur përfaqësuesit i kufizohet zotësia për të vepruar edhe në një rast të tillë do jemi para mbarimit të prokurës në referim kjo të përcaktimeve të nenit 64 parag 3 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se: *”Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar”*⁶⁹

Në referim të dispozitës së sipërcituar në kushtet kur përfaqësuesit do t’i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ky i fundit nuk mund të vijojë të jetë përfaqësues me prokurë për shkak se nuk plotëson kushtin e kërkuar nga ligji për të pasur zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Gjithashtu në kuadër të trajtimit të rasteve të mbarimit të prokurës ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje, të cilës gjithashtu vlerësoj se e meriton t’i kushtohet vëmendje si për efekt studimor ashtu edhe në funksion të evidentimit të mangësive që paraqet neni 76 i Kodit Civil në të cilin parashikohen edhe rastet e mbarimit të prokurës do të ishte :

A përbën rast të mbarimit të prokurës rasti kur është vërtetuar kushti zgjidhës i përcaktuar në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuari në referim kjo të përcaktimeve të nenit 85 të Kodit Civil?

Konkretisht në dispozitën e sipërcituar parashikohet ndër të tjera shprehimisht se :
*“...Kushti është zgjidhës kur të drejtat dhe detyrimet shuhen po të ndodhë ngjarja”*⁷⁰.

Në referim të parashikimeve ligjore të sipërcituara supozojmë se i përfaqësuari kohëzgjatjen e prokurës së lëshuar për përfaqësuesin e ka kushtëzuar me një ngjarje të

⁶⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 64 parag 3 të Kodit Civil

⁷⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 85 të Kodit Civil

caktuar, e cila nuk dihet nëse do të ndodhë. Me të drejtë do të shtrohej edhe pyetja e mësipërme në rast të vërtetimit të ngjarjes së përcaktuar në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuari a do të konsiderohet se në kuptim të ligjit kjo prokurë nuk ka më fuqi ligjore.

Edhe në këtë rast të parashtruar si pyetje nga ana ime nuk rezultoi që Kodi Civil dhe konkretisht neni 76 i tij që parashikon edhe rastet e mbarimit të prokurës të bëjë ndonjë parashikim ligjor se çfarë ndodh me prokurën në rast të vërtetimit të ngjarjes që ka kushtëzuar kohëzgjatjen e prokurës së lëshuar nga i përfaqësuari.

Në vlerësimin tim personal edhe në një rast të tillë në kuptim të ligjit duhet të konsiderohet që prokura ka mbaruar për shkak kjo të vërtetimit të kushtit zgjidhës të përcaktuar në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuari.

Si përfundim pavarësisht mendimeve të dhëna nga ana ime si realizues i këtij punimi lidhur me pyetjet dhe situatat e parashtruara më lart në kushtet e ekzistencës së një vakumi ligjor për rastet që unë referova më lart në vlerësimin tim paraqitet e nevojshme që neni 76 i Kodit Civil duhet të pësojë ndryshime, duke u parashikuar si raste të mbarimit të prokurës veç atyre rasteve të përcaktuara shprehimisht në dispozitën e sipërcituar edhe këto raste të tjera :

- a) me shpalljen si të zhdukur të të përfaqësuarit ;
- b) me kufizimin e zotësisë juridike për të vepruar të të përfaqësuarit ose të përfaqësuesit ;
- c) me vërtetimin e kushtit zgjidhës, për rastet kur kohëzgjatja e prokurës lidhet me vërtetimin e një ngjarjeje të caktuar.

ii.i.ç) Delegimi i pushteteve të përfaqësimit (nënprokura).

Në kreun I kur trajtoam karakteristikat e përfaqësimit cituam që një nga karakteristikat bazë të përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile është edhe që përfaqësuesi duhet të veprojë personalisht në kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Karakteristika e sipërcituar rezultoi nga vetë përkufizimi që ligji dhe konkretisht neni 64 i Kodit Civil ka dhënë për përfaqësimin, sipas të cilit : *“Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen brenda tagrave që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuarit)”*⁷¹.

Madje karakteristika e sipërcituar përcaktohej edhe në nenin 69 të Kodit Civil, dispozitë kjo tashmë e shfuqizuar me Ligjin nr. 8781, datë 03.05.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.

Pavarësisht rregullit të sipërcituar pra që përfaqësuesi duhet t'i kryejë personalisht veprimet juridike të ngarkuara nga i përfaqësuari për arsye nga më të ndryshmet ai si përfaqësues në një moment të caktuar mund të gjendet në pamundësi reale të ushtrimit të

⁷¹ Referoju për këtë qëllim nenit 64 parag 1 të Kodit Civil

pushtetit të përfaqësimit, pra të kryerjes së veprimeve juridike të ngarkuara nga i përfaqësuari në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

Ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje është, a do të mundej përfaqësuesi që në rastet kur ndodhet në pamundësi të ushtrimit të pushtetit të përfaqësimit të ngarkonte një person tjetër për kryerjen e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Një rast i tillë në kuptim të ligjit nuk mund të konsiderohet si humbje e pushtetit të përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit për shkak se ky i fundit vijon të jetë mbajtës i prokurës së lëshuar nga i përfaqësuari por për shkaqe nga më të ndryshmet nuk mund t'i kryejë personalisht veprimet juridike apo veprimet e tjera të ligjshme të përcaktuara në prokurë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Sipas autorit rus D.M.Genkin *akti me të cilin përfaqësuesi cakton një person tjetër për kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, për të cilat ai ka qenë i autorizuar në bazë të prokurës të lëshuar nga ky i fundit më parë quhet nënprokurë*⁷².

Po sipas këtij autori të së drejtës nënprokura nuk është një kalim i pushteteve të përfaqësimit te një person tjetër, por një prokurë e lëshuar nga përfaqësuesi i cili vepron brenda caqeve të pushteteve që i ka dhënë i përfaqësuari. Në një rast të tillë nuk kemi të bëjmë me një transferim pushtetesh sepse përfaqësuesi edhe pasi ka caktuar një zëvendës ruan të drejtën për të vepruar si përfaqësues me përfundim të rastit kur përfaqësuesit i janë dhënë pushtete nën kushtin zgjidhës që ato do të marrin fund në rast se ai do të caktojë një përfaqësues tjetër apo një nënpërfaqësues⁷³

Për t'ju rikthyer pyetjes së parashtruar më lart rezulton që dispozita e mëparshme e Kodit Civil dhe konkretisht neni 69 i tij për raste të veçanta të referuara shprehimisht në këtë dispozitë e kishte parashikuar mundësinë që përfaqësuesi në referim të tagreve të dhëna në prokurë nga i përfaqësuari të caktonte një person tjetër për kryerjen e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Si rrjedhojë e shfuqizimit të nenit 69 të Kodit Civil referuar faktit se një ndër karakteristikat thelbësore të përfaqësimit, si institut i veçantë i të drejtës civile është kryerja e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit personalisht nga vetë përfaqësuesi rezulton që në legjislacionin tonë civil dhe konkretisht në dispozitat që rregullojnë përfaqësimin si institut të veçantë të të drejtës civile të krijohet konfuzion lidhur me faktin, nëse përfaqësuesi në rast pamundësie reale të ushtrimit të pushteteve të përfaqësimit qoftë kjo edhe për shkak mungese njohurish në një fushë të caktuar do të mund të caktonte një person tjetër si zëvendës për kryerjen e veprimeve përkatëse në emër

⁷² Referoju për këtë qëllim librit të emërtuar : “E drejta Civile sovjetike” me autor D.M.Genkin, faqe. 298

⁷³ Referoju për këtë qëllim përsëri librit të emërtuar : “E drejta Civile sovjetike” me autor D.M.Genkin, faqe. 298

dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Në kushtet e mungesës së parashikimit ligjor situata do të paraqitej mjaft e diskutueshme edhe në rastet kur i përfaqësuari ja ka njohur shprehimisht përfaqësuesit të drejtën për të caktuar një person tjetër si përfaqësues në rast pamundësie të kryerjes së këtyre veprimeve nga ana e këtij të fundit. Ky ishte një ndër rastet e parashikuara në nenin 69 të Kodit Civil në referim të të cilave përfaqësuesi mund të caktonte një zëvendës për kryerjen e veprimeve juridike dhe veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit krahas edhe dy rasteve të tjera, të cilat ishin :

- a) kur pasuria që përmendej në prokurë ndodhej jashtë territorit të rrethit ku banonte përfaqësuesi ;
- b) kur caktimi i zëvendësit çmohej i nevojshëm për mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarit.

Shfuqizimi që legjislatori i ka bërë dispozitës që në raste të caktuara e lejonte përfaqësuesin për të caktuar një person tjetër si zëvendës mund të interpretohet edhe si ndalim që ligjvënësi ka dashur t'i bëjë një situatë të tillë në kushtet kur më parë e drejta e përfaqësuesit për të caktuar zëvendës ishte përcaktuar shprehimisht në ligj. Ky lloj ndalimi do të kishte efekte negative jo vetëm ndaj veprimtarisë së përfaqësuesit por edhe ndaj vetë interesave të të përfaqësuarit në kushtet kur në raste të caktuara përfaqësuesi mund të mos jetë në gjendje të ushtrojë pushtetin e përfaqësimit në mënyrën më të mirë të mundshme. Si shembull mund të referojmë rastin kur prindërit si përfaqësues ligjor të fëmijës së tyre si rrjedhojë e mungesës së njohurive në fushën e së drejtës nuk do të mund të realizonin një përfaqësim efektiv të interesave të fëmijës së tij në raport me të tretët në ndonjë proces gjyqësor në të cilën fëmija si i përfaqësuar prej tyre ka cilësinë e ndërgjyqësit.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe në rastet e përfaqësimit vullnetar ku përfaqësuesi i caktuar me prokurë nga i përfaqësuari nuk do të mund t'i mbronte në mënyrën më efektive të mundshme interesat e të përfaqësuarit prej tij.

Si përfundim në vlerësimin tim personal në kushtet kur shfuqizimi i nenit 69 të Kodit Civil ka krijuar vakum ligjor lidhur me të drejtën e përfaqësuesit që në raste të caktuara të mund të caktojë një zëvendës për kryerjen e veprimeve juridike dhe veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit paraqitet e domosdoshme që kjo dispozitë të rivendoset në Kodin Civil, në funksion kjo të evitimit të qëndrimeve të ndryshme që mund të ndeshen në praktikë lidhur me të drejtën e përfaqësuesit për të caktuar një zëvendës.

Dallimet e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile nga institute të tjera të të drejtës civile.

Përfaqësimi si institut i veçantë i të drejtës civile paraqet ngjashmëri por edhe dallime thelbësore nga institute të tjera të së drejtës civile ndër të cilët do të veçonim gjerimin e punëve të tjetrit, si institut i parashikuar nga nenet 648 – 652 të Kodit Civil, si dhe kontratën në dobi të personit të tretë të parashikuar nga neni 694 i Kodit Civil.

i) Dallimet e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile nga gjerimi i punëve të tjetrit.

Sikurse kemi cituar edhe më lart në rastin e përfaqësimit gjithmonë përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit në zbatim kjo të tagrave që i janë dhënë nga ana e të përfaqësuarit, nga ligji ose që i janë caktuar nga gjykata. Por mund të ndodhë sikurse do të trajtohet edhe në kreun e mëposhtëm të këtij punimi që përfaqësuesi të veprojë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit pa qenë i pajisur me tagre përfaqësimi prej këtij të fundit, dhe sikurse do të trajtohet edhe më poshtë ky përbën një nga rastet e përfaqësimit pa tagra të parashikuar nga neni 78 i Kodit Civil. Ky lloj përfaqësimi paraqet shumë ngjashmëri me institutin e gjerimit të punëve të tjetrit, institut ky i cili sikurse është cituar edhe më lart parashikohet në nenet 648 – 652 të Kodit Civil, por ndërmjet tyre ato si institute kanë edhe dallime që i bëjnë ata të ndryshëm nga njëri - tjetri.

Gjerimi i punëve të tjetrit përbën një nga kategoritë e veçanta të fakteve juridike që ndryshojnë nga faktet e paligjshme të cilat janë burim detyrimesh. Kuptimi i Gjerimit të punëve të tjetrit rezulton që të jetë dhënë në nenin 648 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Personi që pa qenë i detyruar, merr përsipër me ndërgjegje dhe për një qëllim të arsyeshëm gjerimin e punëve ose interesave të tjetrit, është i detyruar ta vazhdojë atë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të kujdeset vetë”*⁷⁴.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që Gjerimi i punëve të tjetrit ekziston në ato raste kur subjekti (gjeruesi) ose siç njihet në terminologjinë latine : *“negotiorum gestor”*, pa u autorizuar por me vullnetin e tij kryen punë juridike ose faktike që i përkasin një personi tjetër por për llogari të këtij të fundit⁷⁵. Ky është edhe përkufizimi teorik që i jepet Gjerimit të punëve të tjetrit si institut i veçantë i të drejtës civile. Që të ekzistojë gjerimi i punëve të tjetrit duhet ekzistojnë apo të jenë të pranishme këto kushte :

- a) të jetë kryer puna ;
- b) puna të jetë kryer nga një person i paautorizuar ;
- c) të mos ketë ekzistuar ndonjë prokurë, ndonjë marrëveshje paraprake ose kontratë, si dhe ndonjë vendim gjyqësor që e detyronte personin për të kryer punët e tjetrit.

Në Kodin Civil të vitit 1929 gjerimi i punëve të tjetrit (*gestion d'affaires*) parashikohej në nenet 1136 – 1140 të atij kodi. E veçanta lidhur me gjerimin qëndronte në faktin se ratifikimi nga ana e të interesuarit të veprimeve të kryera nga gjeruesi sillte efektet e porosisë edhe sikur kjo punë të ishte kryer nga një person që kujtonte se po gjeronte apo kryente një punë të tij⁷⁶.

Referuar përkufizimit që dhamë për gjerimin e punëve të tjetrit, si dhe referuar edhe kushteve që duhet të plotësohen mund të themi se ky i fundit nuk është gjë tjetër vetëm se një lloj përfaqësimi pa tagra sepse gjeruesi ashtu si dhe përfaqësuesi pa tagra pa qenë i

⁷⁴ Referoju për këtë qëllim nenit 648 të Kodit Civil

⁷⁵ Referoju për këtë qëllim librit me titull : “Traité de Droit Civil” me autor Jacques Chestin, botim i vitit 1980, faqe 313 – 343.

⁷⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 1140 të Kodit Civil të vitit 1929.

autorizuar kryen veprime juridike ose faktike në emër dhe për llogari të një personi tjetër. Një nga profesorët e njohur të së drejtës civile dhe konkretisht Andrea Nathanaili kur fliste për dallimet e institutit të përfaqësimit nga institute të tjera të përafërta me të citon ndër të tjera edhe dallimet e këtij instituti nga institute të tjera të përafërta duke përcaktuar se kur këto veprime nuk gjejnë rregullim në Kodin Civil, në praktikë për këtë rast do të kishte dy zgjidhje :

a) në rast se personi i tretë do i miratonte veprimet e kryera në favor të tij, atëherë këto veprime do të sillnin pasoja për të dhe në këtë rast do të zbatoheshin dispozitat mbi përfaqësimin pa tagra (neni 56 i Kodit Civil të vitit 1981) ;

b) në rast të kundër kur ai nuk pranonte dhe nuk përgjigjej për veprimet e kryera në dobi të tij do të zbatoheshin dispozitat mbi detyrimet që lindnin nga përfitimi pasuror pa të drejtë (nenet 350 – 351 të Kodit Civil të vitit 1981)⁷⁷.

Pavarësisht përcaktimit të mësipërm se gjerimi i punëve të tjetrit është një lloj përfaqësimi pa tagra, ai dallon nga ky i fundit për shkak se sikurse do të referohet në mënyrë të hollësishme në kreun 3 të këtij punimi në rastin e përfaqësimit pa tagra të parashikuar nga neni 78 i Kodit Civil, nga ana e përfaqësuesit kryhen vetëm veprime juridike të cilat nuk janë të detyrueshme për personin në emër dhe për llogari të të cilit janë kryer, ndërsa gjerimi i punëve të tjetrit si nocion është shumë më i gjerë në kushtet kur gjeruesi kryen krahas veprimeve juridike edhe veprime të tjera faktike, si shembull mund të përmendim rastin kur gjeruesi ndërhyr për të shpëtuar pasurinë e një personi tjetër nga zjarri, përmbytja ku si rrjedhojë e mos ndërhyrjes së menjëhershme pasurisë do i shkaktoheshin dëme të konsiderueshme ose vlera e kësaj të fundit do të ulej ndjeshëm. Pra si karakteristikë e gjerimit të punëve të tjetrit është se nga ana e gjeruesit kryhen veprime të menjëhershme dhe të shpejta.

Gjithashtu në rastin e përfaqësimit pa tagra një person konsiderohet se ka vepruar si i tillë edhe në rastin kur ky i fundit i ka kapërcyer tagret e dhëna në prokurë nga i përfaqësuar, ndërsa në rastin e gjerimit të punëve të tjetrit ndërmjet gjeruesit dhe personit të interesuar nuk ka patur ndonjë marrëveshje paraprake në formën e prokurës ku ai të ketë qenë i pajisur me ndonjë tagër dhe që më pas të veprojë në kapërcim të këtyre tagrave.

Në nenin 649 të Kodit Civil parashikohet ndër të tjera se : *“Personi i interesuar duhet të përmbushë detyrimet që gjeruesi ka marrë përsipër në emër të tij, të përjashtojë gjeruesin nga detyrimet që ka marrë në emër të vet dhe t’i paguajë atij shpenzimet e nevojshme e të dobishme që nga dita që janë bërë dhe, kur është rasti, t’i shpërblejë edhe dëmin që mund të ketë pësuar si rrjedhim i gjerimit por me kusht që veprimet e kryera nga gjeruesi, të mos kenë qenë ndaluar nga personi i interesuar. Kur gjeruesit, përveç gjerimit të punëve, i është dashur për këtë qëllim të ushtrojë një profesion, ka të drejtë të shpërblehet në përputhje me çmimet ose tarifën e caktuara për aktivitetet të tilla”*⁷⁸.

Referuar përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezulton se personi i interesuar është i detyruar të pranojë veprimet e gjeruesit, kjo për faktin se edhe pse gjeruesi vepron me vullnetin e tij në favor të personit të interesuar, ligji i njeh të drejtën atij sikur atë punë ta bënte për veten e tij, pra sikur frutet e punës të ishin për të plotësuar interesat ose nevojat

⁷⁷ Referoju për këtë qëllim librit : “E drejta Civile e RPSSH” me autor Andrea Nathanaili dhe Nazmi Biçoku, faqe 86.

⁷⁸ Referoju për këtë qëllim nenin 649 të Kodit Civil

personale e familjare të tij.

Në vijim të asaj që parashtruam më lart mund të themi se ndërsa tek gjerimi i punëve të tjetrit personi i interesuar është i detyruar të pranojë veprimet e gjeruesit, në rastin e përfaqësimit pa tagra një gjë e tillë nuk ndodh sepse veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra nuk janë të detyrueshme për personin në emër dhe për llogari të të cilit janë kryer, përveç kur ky i fundit shfaq vullnet më vonë për miratimin e këtyre veprimeve. Madje në rast se ky miratim nuk jepet personi i tretë që ka qenë me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit që ka pësuar nga personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra.

Referuar përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar rezultojnë edhe një sërë të drejtash të tjera për gjeruesin. Kështu ky i fundit ka të drejtë të kërkojë të përjashtohet nga detyrimet që ka marrë përsipër. Edhe në rastin e përfaqësimit pa tagra, përfaqësuesi ka të drejtë t'i kërkojë të përfaqësuarit që të miratojë veprimet e kryera prej tij si përfaqësues, por ndryshimi qëndron në faktin se ndërsa gjeruesi ka të drejtë të kërkojë që të shkarkohet nga kryerja e atyre punëve me karakter të përditshëm kryesisht veprime administrimi për të cilat ka qenë e nevojshme kryerja e veprimeve të menjëhershme dhe të shpejta, të cilat nuk mund të kryheshin nga personi i interesuar për shkak se ndodhej në pamundësi fizike për t'i kryer ato, si dhe këto veprime gjeruesi është i detyruar t'i vazhdojë derisa personi i interesuar të jetë në gjendje të merret vetë me punët e tij, ndërsa tek përfaqësimi pa tagra nga ana e përfaqësuesit kryhen vetëm veprime juridike të cilat ai si përfaqësues nuk është i detyruar t'i kryejë, si dhe nuk është i detyruar t'i vazhdojë sepse asnjëherë veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra nuk kanë karakter administrimi.

Përfaqësuesi pa tagra asnjëherë nuk paraqitet si palë në veprimet juridike që kryen në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, ndërsa gjeruesi mund të paraqitet si palë në veprimet juridike që ai mund të kryejë me persona të tretë për llogari të personit të interesuar.

Në rast se kërkesës së gjeruesit për shkarkimin nga puna që ka marrë përsipër me vullnetin e tij, i kundërpërgjigjet detyrimi i personit të tretë për ta shkarkuar nga detyrimet që ka marrë përsipër përveç kur vërtetohet se ai nuk ka vepruar si gjerues ose kur veprimet e tij kanë qenë të ndaluara nga personi i tretë, tek përfaqësimi pa tagra personi në emër dhe për llogari të të cilit janë kryer këto veprime ka të drejtë të mos i miratojë ato edhe sikur të jenë kryer në interes të tij si i përfaqësuar.

Gjithashtu në referim të dispozitës së cituar më lart gjeruesi ka të drejtë t'i kërkojë personit të interesuar që t'i paguajë shpenzimet e domosdoshme dhe të dobishme, si dhe dëmin e shkaktuar. Një e drejtë e tillë nuk i njihet përfaqësuesit pa tagra kjo për shkak se tek përfaqësimi pa tagra personi që vepron si përfaqësues nuk kryen veprime të tilla për të cilat nevojiten lëndë e parë ose një angazhim i gjatë në kohë, aq më tepër që si karakteristikë e përfaqësimit është fakti se ai është pa shpërblim, kjo edhe për faktin se ai bazohet në një marrëdhënie të brendshme që ekziston ndërmjet palëve. Gjithashtu gjerimi mund të konsistojë në një akt asistence ose devotshmërie ku si rezultat i këtyre veprimeve gjeruesi mund të pësojë një dëm, si shembull mund të referojmë një person që përpiqet të shpëtojë një automobilist nga flakët por si rezultat i këtij veprimi pëson vetë dëmtime trupore. Në këtë rast gjeruesi ka të drejtë të kërkojë t'i shpërblehet dëmi pavarësisht faktit

nëse arriti ta shpëtojë apo jo, ndërsa tek përfaqësimi pa tagra nuk mund të flitet për dëm që mund të pësojë një person që vepron si i tillë.

Gjëruesi është i detyruar të njoftojë në kohë sa më të shpejtë personin e interesuar për punën e kryer në favor të tij. Një detyrim i tillë vlen edhe për personin që ka vepruar si përfaqësues pa tagra, i cili duhet të njoftojë në kohë dhe menjëherë personin në emër dhe për llogari të të cilit ka vepruar si përfaqësues. Por ndërsa tek përfaqësimi pa tagra personi që vepron si i tillë e njih gjithmonë personin në emër dhe për llogari të të cilit ka vepruar, tek gjerimi i punëve të tjetrit, gjëruesi mund të mos e njohë personin në dobi të të cilit ka vepruar kjo për arsye se njohja e personit të interesuar nuk është kusht por një premisë pozitive për të vënë atë në lëvizje në momente të caktuara për të gjeruar një punë në favor të personit të interesuar. Pra si karakteristikë e gjerimit të punëve të tjetrit është se njohja ose mos njohja nga gjëruesi e personit të interesuar nuk ka lidhje me marrjen përsipër të punës në dobi të këtij të fundit, ndërsa tek përfaqësimi pa tagra, përfaqësuesi pa tagra gjithmonë kryen veprime juridike në interes të një personi të cilin e njih më parë ose me të cilin ka lidhje familjare, miqësie ose pune. Ky dallim bazohet edhe në faktin se gjerimi ka si karakteristikë të tij edhe spontanitetin e ndërhyrjes në punët e tjetrit, karakteristikë kjo e cila nuk ndeshet tek përfaqësimi pa tagra.

Një dallim tjetër esencial që ekziston ndërmjet Gjerimit të punëve të tjetrit dhe përfaqësimit pa tagra është se një person mund të paraqitet si gjërues edhe kur ai beson se po vepron për veten e tij. Si shembull mund të referojmë rastin kur një person kujdeset për një pasuri që beson se e ka fituar si rrjedhojë e trashëgimisë ligjore, si dhe më pas paraqitet një testament që e privon këtë person nga të drejtat mbi këtë pasuri, ndërsa tek përfaqësimi pa tagra, përfaqësuesi vepron gjithmonë në emër dhe për llogari të një personi tjetër.

Gjithashtu në dispozitën e cituar më lart parashikohet ndër të tjera edhe se kur gjëruesit përveç gjerimit të punëve i është dashur për këtë qëllim të ushtrojë një profesion ka të drejtë të shpërblehet në përputhje me çmimet ose tarifat e caktuara për aktivitete të tilla⁷⁹.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton se gjëruesi si rezultat i veprimtarisë që kryen për gjerimin e punëve të tjetrit mund të ushtrojë një profesion të caktuar, ndërsa tek përfaqësimi pa tagra një gjë e tillë nuk ndodh.

Në nenin 650 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht se : *“Gjëruesi ka të drejtë të kryejë veprime juridike në emër të personit të interesuar, në masën që interesi i këtij të fundit plotësohet në mënyrë të përshtatshme”*⁸⁰.

Në referim të dispozitës së sipërcituar duket sikur gjëruesi në raste të tilla vepron si përfaqësues pa tagra referuar faktit se po kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të personit të interesuar pa pasur pushtete përfaqësimi nga ky i fundit. Në referim të kësaj dispozite del qartë vëmendja që duhet t'i kushtojë gjëruesi veprimeve që kryen në emër dhe për llogari të personit të interesuar. Ai duhet të veprojë sikur të tilla veprime po i

⁷⁹ Referoju për këtë qëllim përsëri nenit 649 të Kodit Civil.

⁸⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 650 të Kodit Civil

kryen për veten e tij, si dhe të mos kryejë veprime të panevojshme të cilat do të ndikonin në rritjen e kostos së punës që kryen dhe të mos e zvarrisë afatin e kryerjes së punës. I njëjti detyrim rëndon edhe mbi përfaqësuesin pa tagra, i cili duhet të veprojë gjithmonë në interes të të përfaqësuarit.

Në referim të dispozitës së sipërcituar arrihet në përfundimin se kur gjeruesi kryen akte juridike në emër dhe për llogari të personit të interesuar, gjeruesi paraqitet në pozitën e përfaqësuesit pa tagra, si dhe veprimet e këtij të fundit mund të mos miratohen nga i interesuari kur ato janë kryer në dëm të interesave të këtij të fundit.

Të njëjtin qëndrim mban edhe doktrina Franceze e të drejtës e cila parashikon se kur gjerimi konsiston në akte juridike ato mund të kryhen në dy mënyra : **a)** Gjerim me përfaqësim dhe **b)** Gjerim pa përfaqësim.

Gjerimi me përfaqësim supozon se gjeruesi vepron si përfaqësues i personit të interesuar, duke kryer për këtë qëllim në emër dhe për llogari të këtij të fundit një veprim juridik megjithëse atij si gjerues nuk i është dhënë asnjë tagër përfaqësimi nga personi i interesuar. Qëllimi i gjeruesit në një rast të tillë është që veprimi që ai kryen të japë efekte direkte dhe me përfitim në ngarkim të të zotit. Gjerimi pa përfaqësim presupozon se gjeruesi vepron në emër të tij. Pra në këtë rast ai do të bëhet personalisht kreditori ose debitori i bashkëkontraktuesit të tij. Sipas doktrinës franceze në një rast të tillë gjeruesi vepron si i porositur⁸¹.

I njëjti qëndrim mbahet edhe në doktrinën italiane të së drejtës, në të cilën parashikohet se : *“Jemi para gjerimit të punëve të tjetrit në ato raste kur gjeruesi sillet si një person që ka mandatin e të tjerëve, por pa e patur faktikisht atë”*⁸².

Sipas parashikimeve të Kodit Civil aktual rezulton që Gjerimi i punëve të tjetrit të jetë barazuar me kontratën e porosisë lidhur me detyrimet që rëndojnë mbi gjeruesin. Një gjë e tillë gjendet e sanksionuar shprehimisht në nenin 651 paragraf 1 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Gjeruesi u nënshtrohet detyrimeve të njëjta që rrjedhin nga një kontratë porosie”*⁸³.

Barazimi i detyrimeve të gjeruesit me ato të të porositurit shpjegohet me faktin se gjeruesi ashtu sikurse edhe i porosituri duhet të veprojë gjithmonë në mbrojtje të interesave të personit të interesuar. Në dallim nga kontrata e porosisë ku i porosituri përgjigjet plotësisht për dëmet që me veprimet e tij i ka shkaktuar porositësit në rastin e gjerimit të punëve të tjetrit gjykata duke marrë parasysh rrethanat të cilat kanë ndikuar tek gjeruesi për të marrë përsipër gjerimin mund të pakësojë dëmshpërblimin për dëmin që është shkaktuar për faj të tij. Parashikimi ligjor i sipërcituar gjendet i sanksionuar në nenin 651 paragraf 2 të Kodit Civil⁸⁴.

⁸¹ Referoju për këtë qëllim librit me titull : “Trai’te de Droit Civil” me autor Jacque Chestin, botim i vitit 1980, faqe 313 – 343.

⁸² Referoju për këtë qëllim librit me titull : “Diritto Privato” me autor Francesco Galgano.

⁸³ Referoju për këtë qëllim nenit 651 paragraf 1 të Kodit Civil.

⁸⁴ Referoju për këtë qëllim nenit 651 paragraf 2 të Kodit Civil

Arsyeja e barazimit të gjerimit të punëve të tjetrit me kontratën e porosisë shpjegohet me faktin se gjeruesi ashtu si i porosituri përfitojnë shpërblim lidhur me punën e kryer, ndërkohë që sikurse cituam edhe më lart përfaqësimi ka si karakteristikë të tij ndër të tjera se është pa shpërblim.

ii) Dallimet e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile nga kontrata në dobi të personit të tretë.

Kontrata në dobi të personit të tretë si kontratë e parashikuar nga neni 694 i Kodit Civil⁸⁵ dallon nga përfaqësimi sepse në rastin e kontratës në dobi të një personi të tretë sikurse mund të jetë kontrata e sigurimit të pasurisë e parashikuar nga neni 1134 i Kodit Civil⁸⁶, sipas së cilës kjo kontratë mund të lidhet edhe në dobi të një personi të tretë për të siguruar pasurinë e këtij të fundit ose kontrata e sigurimit të jetës e parashikuar nga neni 1152 i Kodit Civil⁸⁷ përbëjnë kontrata të cilat lidhen pa pasur nevojë që të merret prokurë nga personi i tretë në dobi të të cilit ato si kontrata lidhen. Kjo lloj kontrate sjell vetëm të drejta për personin e tretë në dobi të të cilit ajo është lidhur sepse detyrimet rëndojnë gjithmonë mbi personin që lidh kontratën ndërsa tek përfaqësimi, përfaqësuesi ngarkohet nga ana e të përfaqësuarit për të kryer veprime juridike dhe veprime të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të këtij të fundit, mbi të cilin rëndojnë si të drejtat ashtu edhe detyrimet që lindin si rrjedhojë e veprimeve të kryera nga përfaqësuesi brenda tagreve të dhëna nga i përfaqësuarit ose që i janë dhënë në referim të ligjit.

Në kontratën në dobi të personit të tretë ky i fundit në asnjë rast nuk paraqitet si palë në kontratën që lidhet për llogari dhe në dobi të tij, ndërsa tek veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi gjithmonë palë në këto veprime juridike paraqitet i përfaqësuarit dhe në asnjë rast përfaqësuesi, sepse në të kundërt do të ishim para kontratës së porosisë.

⁸⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 694 të Kodit Civil

⁸⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 1134 të Kodit Civil

⁸⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 1152 të Kodit Civil

Kreu III

Trajtimi i përfaqësimit pa tagra dhe pasojat që sjell ky i fundit në raport me të tretët. Trajtimi i konfliktit të interesit lidhur me institutin e përfaqësimit dhe i pasojave të tij në raport me të përfaqësuarin. Format e ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesave.

III.I Trajtimi i përfaqësimit pa tagra dhe pasojat që sjell ky i fundit në raport me të tretët.

i) Trajtimi i kuptimit të përfaqësimit pa tagra dhe format e shfaqjes së këtij të fundit.

Në përfaqësimin vullnetar përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit në referim të prokurës së lëshuar nga ky i fundit. Ky është rasti i zakonshëm, por mund të ndodhë që kryerja e veprimeve juridike dhe e veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të një personi tjetër të mos paraprihet nga dhënia e tagrave për të bërë një gjë të tillë nga ana e të përfaqësuarit, ose kur përfaqësuesi i kapërcen apo vepron tej tagrave (pushteteve) të dhëna nga ana e të përfaqësuarit në prokurën e lëshuar prej këtij të fundit.

Të vepruarit e përfaqësuesit në situatat e mësipërme rezultojnë që nga ana e teorisë të së drejtës civile të jetë përkufizuar si përfaqësim pa tagra në kushtet kur askujt nuk i lejohet të ndërhyjë me anë të veprimeve juridike të tij në sferën juridike të një personi tjetër, pa e pasur pushtetin apo tagrat për të bërë një gjë të tillë.

Sipas parimeve të të drejtës europiane kontraktore ky rregull shërben për të mbrojtur autonominë e vullnetit të të përfaqësuarit pasi e parandalon për të qënë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve kundër vullnetit të tij.

Situatat e mësipërme rezultojnë që të kenë gjetur rregullim ligjor në nenin 78 të Kodit Civil në të cilin përcaktohet shprehimisht se : *"Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e patur këtë cilësi, si dhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagrat që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë. Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qënë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi"*.

Referuar teknikës legjislative të përdorur nga ana e ligjvënësit në nenin 78 të tij rezultojnë që rastet kur një person konsiderohet se ka vepruar në pozitën e përfaqësuesit pa tagra të jenë shteruese, si dhe duke mos dhënë shkak për interpretim të situatave të tjera.

Konkretisht referuar mënyrës se si është formuluar dispozita e sipërcituar rezultojnë e përcaktuar qartë se një person konsiderohet se ka vepruar në pozitën e përfaqësuesit pa tagra vetëm në këto raste :

- a) Personi fizik apo juridik ka vepruar si përfaqësues pa e patur këtë cilësi.
- b) Përfaqësuesi ka kapërcyer tagrat që i janë dhënë.

Legjislacioni civil gjerman në të kundërt nga legjislacioni ynë rezultojnë që të ketë dhënë një përkufizim më të përgjithshëm lidhur me përfaqësimin pa tagra duke e përkufizuar në

këtë mënyrë : *“Përfaqësim pa tagra(Vertretung ohne Vertretungsmacht) do të kemi kur një veprim juridik kryhet nga një përfaqësues që nuk ka tagra nga i përfaqësuari, pra në mungesë të një marrëveshje të nënshkruar, apo nga marrëdhënie të tjera të parashikuara nga ligji dhe jo vetëm”.*

Sipas parimeve të së drejtës europiane kontraktore (Principle of European Contract Law) rezulton që përfaqësimi pa tagra në nenin 3 : 204 të jetë përkufizuar në këtë mënyrë : *“Kur një person vepron si një përfaqësues pa pasur ose përtej tagrave të caktuara, veprimet e tij nuk kanë fuqi detyruese ndaj të përfaqësuarit dhe palës së tretë”.*

Referuar si doktrinës gjermane lidhur me interpretimin e rasteve të përfaqësimit pa tagra ashtu edhe interpretimit që nga autorë të ndryshëm i janë bërë përfaqësimit pa tagra sipas parimeve të së drejtës europiane kontraktore rezulton që si rast përfaqësimi pa tagra të jetë konsideruar edhe rasti kur një person vepron në cilësinë e përfaqësuesit pas mbarimit të prokurës.

Në dallim nga parimet e të drejtës europiane kontraktore, si dhe në dallim edhe nga doktrina gjermane e të drejtës rasti i të vepruarit të përfaqësuesit pas mbarimit të prokurës sipas legjislacionit tone civil rezulton që të jetë detyrues për të përfaqësuarin ose për trashëgimtarët e tij (neni 77 i Kodit Civil), duke e kushtëzuar këtë detyrim vetëm me faktin që personat e tretë me të cilët janë kryer këto veprime juridike nuk duhet të kenë pasur dijeni për ndryshimet ose mbarimin e prokurës.

Vlerësimi im personal për një rast të tillë është se edhe rasti kur një person vepron si përfaqësues pas mbarimit të prokurës ose pas ndryshimeve të bëra në prokurë duhet të konsiderohet si rast përfaqësimi pa tagra, si dhe që veprimet juridike të kryera në një rast të tillë nuk duhet të jenë të detyrueshme për të përfaqësuarin apo trashëgimtarët e tij.

Arsyeja e një përfundimi të tillë lidhet me këto shkaqe :

Së pari : Të vepruarit e një personi pa pasur cilësinë e përfaqësuesit rezulton që të jetë e barazvlefshme me situatën e të vepruarit pas mbarimit të prokurës. Si në rastin e parë ashtu edhe në rastin e dytë nuk rezulton që personi që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të ketë tagra përfaqësimi.

Së dyti : Mos konsiderimi i një rasti të tillë si përfaqësim pa tagra rezulton që të vijë ndesh me parimet e të drejtës europiane kontraktore lidhur me mbrojtjen e autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit në kushtet kur e detyron këtë të fundit dhe trashëgimtarët e tij për të qenë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve kundër vullnetit të tij apo të tyre.

Së treti : Parimi i shfaqjes së vullnetit rezulton që të jetë element thelbësor për vlefshmërinë e një veprimi juridik. Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim vetë përkufizimit të dhënë nga ana e ligjvënësit për veprimin juridik në nenin 79 të Kodit Civil, në të cilin veprimi juridik rezulton të jetë përkufizuar në këtë mënyrë : *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.*

Edhe në rastin kur përfaqësuesi vepron pas mbarimit të prokurës rezulton që të mungojë shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për të krijuar, ndryshuar apo shuar të drejta ose detyrime civile, si dhe një situatë e tillë nuk mund të trajtohet në mënyrë të ndryshme

nga situata kur personi vepron si përfaqësues pa e pasur një cilësi të tillë.

Së katërti : Ndryshimi i tagrave të dhëna në prokurë në drejtim kjo të kufizimit të tagrave rezulton që të jetë një prej situatave kur përfaqësuesi konsiderohet se ka vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna nga ana e të përfaqësuarit, si dhe trajtimi në mënyrë të diferencuar i një situate të tillë rezulton që të vijë ndesh me parimin e mësipërm.

Përfundimi i sipërcituar rezulton që të jetë në përputhje edhe me qëndrimin e mbajtur nga një prej profesorëve më të njohur të së drejtës tonë civile dhe konkretisht nga ana e Andrea Nathanailit në Komentarin e realizuar prej këtij të fundit për të Drejtën Civile në të cilin renditet si një nga rastet e përfaqësimit pa tagra edhe rasti kur një person vepron si përfaqësues pa tagra edhe pas mbarimit të prokurës.

Në referim të përfundimeve të mësipërme vlerësoj se neni 78 i Kodit Civil lidhur me kuptimin e përfaqësimit pa tagra duhet të riformulohet duke e përfshirë si raste të përfaqësimit pa tagra edhe rastet : **a)** kur përfaqësuesi vepron pas mbarimit të prokurës dhe **b)** kur përfaqësuesi vepron pas ndryshimeve që i janë vënë vëllimit të tagrave të përcaktuara në procure. Për rrjedhojë neni 77 i Kodit Civil duhet të shfuqizohet, si dispozitë kjo që bie ndesh si me parimin e autonomisë së vullnetit të përcaktuar në nenin 79 të Kodit Civil ku dhe jepet përkufizimi i veprimit juridik, ashtu edhe me parimet europiane të të drejtës kontraktore lidhur me mbrojtjen e autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit në kushtet kur e detyron këtë të fundit dhe trashëgimtarët e tij për të qenë mbajtës të të drejtave dhe detyrimeve kundër vullnetit të të përfaqësuarit.

Në kuadër të parashtrimit të rasteve se kur një person konsiderohet se ka vepruar në pozitën e përfaqësuesit pa tagra ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje është fakti :

Nëse duhet të konsiderohet apo jo si përfaqësues pa tagra një person që vepron në referim të një prokure të pavlefshme ?

Vlerësimi im personal në një rast të tillë është se në të tilla raste jemi para një situate mjaft të diskutueshme nga pikëpamja juridike.

Në një përfundim të tillë arrihet duke iu referuar për këtë qëllim vetë parimit të sanksionuar si nga legjislacioni ynë civil ashtu edhe nga parimet europiane të të drejtës kontraktore lidhur me mbrojtjen e autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit përse i përket mungesës së shfaqjes së vullnetit nga ana e këtij të fundit.

Situata në një rast të tillë rezulton që të paraqitet kontradiktore për shkak se në kuptim të ligjit veprimi juridik i pavlefshëm konsiderohet nul e barazvlefshme me mosekzistencën e tij si veprim juridik. Pavlefshmëria e veprimit juridik sikurse është edhe prokura si veprim juridik i njëanshëm mund të konsistojë në mungesën e formës së kërkuar nga ligji, ose kur përmbajtja e veprimit juridik mund të vijë ndesh me një dispozitë urdhëruese të ligjit.

Situata paraqitet e ndërlikuar kur pavlefshmëria e prokurës me të cilën është pajisur përfaqësuesi nga ana e të përfaqësuarit prej tij lidhet me elementë të formës, të

domosdoshme këto për ta konsideruar prokurën të vlefshme, si dhe nuk rezulton që të lidhet me mungesën e shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit.

Nga përmbajtja e prokurës mund të rezultojë e përcaktuar qartë se i përfaqësuari të ketë shfaqur vullnetin e tij që përfaqësuesi të kryejë në emër dhe për llogari të tij një veprim juridik të caktuar sikurse mund të jetë lidhja e një kontrate por mund të rezultojë që prokura e lëshuar nga pikëpamja formale nuk plotëson kushtet për t'u konsideruar e vlefshme.

Në një rast të tillë do të ishte vërtet e diskutueshme nëse personi që ka vepruar në cilësinë e përfaqësuesit duhet të konsiderohet apo jo në pozitën e përfaqësuesit pa tagra, si dhe nëse veprimi juridik i kryer nga ana e përfaqësuesit duhet të konsiderohet apo jo i detyrueshëm për të përfaqësuarin.

Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur jemi para një rasti të përfaqësimit pa tagra referuar për këtë qëllim përkufizimit që i është dhënë veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm, i cili konsiderohet si veprim i paqenë (nul), vlerësimi im personal është se në një rast të tillë i përfaqësuari nuk mund të pretendojë përkundrejt personit të tretë që ka qenë palë në kontratë se veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi nuk është i detyrueshëm për zbatim, kjo për shkak se një pretendim i tillë do të vinte ndesh me vetë parimin që synon të mbrojë përfaqësimi pa tagra dhe konkretisht atë të mbrojtjes së autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit përsa i përket mungesës së shfaqjes së vullnetit nga ana e këtij të fundit.

Thelbësore në përfaqësimin pa tagra është pikërisht mungesa e dijenisë së të përfaqësuarit lidhur me veprime juridike të kryera nga persona që kanë vepruar në emër dhe për llogari të tij pa e pasur cilësinë e përfaqësuesit, ose kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagrat e dhëna në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuari.

Është pikërisht mungesa e dijenisë në kryerjen e veprimeve ajo që e mbron të përfaqësuarin në raport me personin e tretë që është palë në kontratë nga marrja përsipër e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në kontratën e lidhur me këtë të fundit.

Në rastin kur nga përmbajtja e prokurës pavarësisht se kjo e fundit nga pikëpamja formale mund të mos plotësojë kushtet për tu konsideruar e vlefshme rezulton qartë shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për kryerjen nga ana e përfaqësuesit të caktuar prej tij të një veprimi juridik të caktuar, vlerësimi im personal është që në një rast të tillë veprimi juridik i lidhur nga ana e përfaqësuesit do të ishte i detyrueshëm për zbatim për të përfaqësuarin, si dhe në një rast të tillë nuk do të konsiderohej se përfaqësuesi ka vepruar në pozitën e përfaqësuesit pa tagra.

Në një rast të tillë i përfaqësuari nuk do të mund të mbrohet si ndaj të tretit ashtu edhe para gjykatës se nuk ka pasur dijeni dhe se nuk ka shfaqur vullnet për kryerjen e veprimeve juridike nga personi që ka vepruar si përfaqësues i tij duke qenë i pajisur për këtë qëllim nga ana e të përfaqësuarit edhe me një akt përfaqësimi (prokurë), i cili për shkak të mungesës së formës konsiderohet i pavlefshëm. Në të tilla raste përfaqësuesi do

të shmangët nga çdo lloj përgjegjësie përkundrejt personave të tretë në mirëbesim dhe se përgjegjës për shpërblimin e dëmit ndaj këtyre të fundit do të jetë drejtpërdrejtë i përfaqësuarit që refuzon të pranojë vlefshmërinë e veprimit juridik të kryer në emër dhe për llogari të tij nga përfaqësuesi, gjithmonë kur ky i fundit ka vepruar në situatën e përshkruar më lart.

Praktika gjyqësore rastet kur prokura nuk plotëson kushtet formale i ka konsideruar si raste të përfaqësimit pa tagra. Kështu Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin e tyre nr. 10, datë 28.01.2003 kanë përcaktuar ndër të tjera se : *“Që prokura të konsiderohet e rregullt kur kjo e fundit është lëshuar nga një shtetas shqiptar apo i huaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kërkohet që prokura duhet të jetë e pajisur me vulën apostile në zbatim kjo të Konventës së Hagës të datës 05.10.1961”*.

Vlerësimi im personal është që në raste të tilla nuk jemi para rastit të përfaqësimit pa tagra, por para rastit kur akti i përfaqësimit paraqet të meta. Këto të meta nuk rezultojnë që të jenë të tilla që të çënojnë përmbajtjen e prokurës së lëshuar nga ana e të përfaqësuarit për sa kohë që nuk lidhen me një nga elementët thelbësorë të vlefshmërisë së veprimit juridik sikurse është shfaqja e vullnetit, situatë të cilën merr përsipër të rregullojë edhe neni 78 i Kodit Civil.

Të trajtuarit e situatës së sipërcituar si përfaqësim pa tagra vlerësoj se është e gabuar, si dhe vjen ndesh edhe me vetë parashikimet ligjore të nenit 78 të Kodit Civil, parashikime ligjore këto të cilat kanë si element thelbësor mungesën e shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit.

Si përfundim rastet kur akti i përfaqësimit paraqet të meta të cilat nuk lidhen me shfaqjen e vullnetit të të përfaqësuarit, nuk duhet të konsiderohen si raste të përfaqësimit pa tagra dhe për rrjedhojë në të tilla raste nuk mund të gjejnë zbatim përcaktimet e nenit 78 të Kodit Civil, por në të tilla raste autoritetet gjyqësore në referim edhe të përcaktimeve të nenit 176 të Kodit të Proçedurës Civile duhet ti lënë kohën e nevojshme përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit që të rregullojnë të metat që paraqet akti i përfaqësimit, ndër të cilat mund të jetë edhe mungesa e vulës apostile në aktin e përfaqësimit.

Përfundimi do të ishte i ndryshëm në rastin kur prokura mund të paraqitet e rregullt nga pikëpamja formale, por që në përmbajtjen e saj nuk përfaqëson vullnetin e të përfaqësuarit për shkak se nënshkrimi i këtij të fundit në prokurë mund të jetë i falsifikuar.

Në një rast të tillë jemi para rastit të përfaqësimit pa tagra në kushtet kur provohet plotësisht mungesa e dijenisë, si dhe mos shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për kryerjen e veprimit juridik nga ana e personit që ka vepruar si përfaqësues i tij pa e pasur një cilësi të tillë.

Gjithashtu i njëjti përfundim do të ishte edhe në ato raste kur përfaqësuesi mund t'i ketë përfituar tagrat e përfaqësimit si rezultat i dhunës së ushtruar ndaj të përfaqësuarit, ose si rrjedhojë e përdorimit të mashtrimit nga ana e

përfaqësuesit, ose edhe kur prokura mund të jetë lëshuar nga ana e të përfaqësuarit si rrjedhojë e një lajthimi.

Edhe në një rast të tillë nëse do të vërtetohej gjyqësisht nga ana e të përfaqësuarit, se prokura është lëshuar si rrjedhojë e ndonjë prej rasteve të sipërcituara dhe si e tillë do të shpallej si veprim juridik i pavlefshëm nga ana e gjykatës në referim kjo të përcaktimeve të nenit 94 të Kodit Civil, atëherë në kuptim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil edhe në këto raste do të konsiderohet se përfaqësuesi nuk ka pasur tagra përfaqësimi për të kryer veprime juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit dhe si rrjedhojë veprimet e kryera prej këtij përfaqësuesi nuk do të ishin të detyrueshme për të përfaqësuarin, pasi ky i fundit në kuptim të dispozitës së sipërcituar nuk mund të detyrohet të ketë të drejta dhe detyrime kundër vullnetit të tij.

Në raste të tilla do të jemi para veprimesh juridike të kryera si rrjedhojë e një vullneti të vesuar të të përfaqësuarit për të cilat ky i fundit nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi në kuptim të ligjit.

Rast tjetër i përfaqësimit pa tagra rezulton që të jetë edhe rasti kur përfaqësuesi rezulton që të ketë vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna nga ana e të përfaqësuarit.

Situata do të ishte e thjeshtë nëse veprimet e kryera nga përfaqësuesi në mënyrë të dukshme janë kryer tej tagrave të dhëna në prokurë nga ana e të përfaqësuarit, por në jetën e përditshme në jo pak raste përcaktimi i vëllimit të tagrave ose më qartë përcaktimi i pushteteve me të cilat mund të jetë pajisur përfaqësuesi mund të paraqitet shumë i vështirë dhe në jo pak raste edhe shumë i diskutueshëm, duke e bërë në këtë mënyrë rastin që mund të paraqitet për shqyrtim shumë të diskutueshëm.

Referuar praktikës së ndjekur nga ana e noterëve në përpilimin e prokurave, si dhe më pas në nënshkrimin e tyre nga ana e të përfaqësuarve në jo pak raste krijohet konfuzion në përcaktimin e vëllimit të tagrave me të cilat mund të jetë pajisur përfaqësuesi, si dhe mund të sjellin si pasojë edhe besimin nga personat e tretë që rezulton të jenë në mirëbesim se përfaqësuesi rezulton që të jetë pajisur nga ana e të përfaqësuarit me të gjitha tagrat e nevojshme për kryerjen e një veprimi juridik të caktuar në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

Në raste të tilla, pra në rast të ndonjë konflikti gjyqësor lidhur me pretendimin që mund të parashtrohet nga ana e të përfaqësuarit se nga ana e përfaqësuesit është vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna në prokurë, janë një sërë elementësh të cilët duhet të merren në analizë nga ana e gjykatës duke iu referuar për këtë qëllim parimeve të sanksionuara nga ligji dhe konkretisht dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë institutin e

përfaqësimit, ashtu edhe doktrinës së të drejtës lidhur me institutin e përfaqësimit.

Dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë institutin e përfaqësimit kanë si funksion të tyre rregullimin e marrëdhënies ndërmjet të përfaqësuarit, përfaqësuesit dhe personit të tretë që është palë në veprimin juridik të lidhur nga ana e përfaqësuesit në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, duke mbajtur një balancë ndërmjet tagrave të dhëna nga ana e të përfaqësuarit, veprimeve të kryera nga ana e përfaqësuesit dhe besimit të personit të tretë.

Elementët kyç që konstituojnë përfaqësimin si institut janë :

- lidhja ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit;
- shtrirja e kontrollit të të përfaqësuarit ndaj përfaqësuesit;
- përfshirja dhe/ose besimi i palës së tretë;
- përgjegjësia e të përfaqësuarit;
- përgjegjësia e përfaqësuesit;
- shtrirja e pavarësisë së përfaqësuesit.

Në shumicën e rasteve lidhja ndërmjet të përfaqësuarit dhe veprimeve të përfaqësuesit në veprimet juridike të kryera prej këtij të fundit duket e qartë që nga fillimi. Përmban elementët kyç që lidhen me vëllimin e tagrave të përfaqësuesit të caktuara nga i përfaqësuesuari, duke përcaktuar qartë veprimin juridik që do kryhet nga ana e përfaqësuesit në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Megjithatë sikurse u citua edhe më lart në raste të caktuara vëllimi i tagrave me të cilat është pajisur përfaqësuesi në kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit mund të vihet në diskutim.

Lidhur me përfshirjen dhe/ose besimin e palës së tretë ajo që duhet të merret në analizë është fakti nëse pala e tretë ka qenë apo jo në mirëbesim (*in bona fides*), pra ka pasur të gjitha arsyet për të besuar se përfaqësuesi ka pasur tagrat e nevojshme për të kryer veprimin juridik në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Një besim i tillë mund të jetë rrjedhojë edhe e veprimeve apo sjelljeve të të përfaqësuarit para kryerjes së veprimit juridik. Nëse i përfaqësuari ka shfaqur më parë interes për kryerjen e atij veprimi juridik, apo dhe në kryerjen e veprimeve të mëparshme juridike me personin e tretë rezulton që të jetë përfaqësuar nga i njëjti përfaqësues. Këto rrethana mund të provojnë më së miri faktin se personi i tretë rezulton që të ketë qenë në mirëbesim.

Lidhur me përgjegjësinë e përfaqësuesit. Në përcaktimin e përgjegjësisë së përfaqësuesit si doktrina gjermane e së drejtës civile ashtu edhe parimet europiane të së drejtës kontraktore referojnë tek parimi i autoritetit të jashtëm sipas të cilit i përfaqësuari trajtohet njësoj si të kishte dhënë tagra përfaqësimi. Sipas doktrinës gjermane të së drejtës civile, si dhe sipas parimeve europiane të të drejtës kontraktore nëse parimi i autoritetit të jashtëm gjen zbatim kjo nënkupton që prezumohet ekzistenca e tagrave të plota dhe rrjedhimisht edhe kontrata e lidhur do të konsiderohet e vlefshme pavarësisht se është lidhur nga një përfaqësues në kapërcim të tagrave që i janë dhënë.

Sikurse do të trajtohet edhe më poshtë në dallim nga legjislacioni ynë civil që rregullon

përfaqësimit pa tagra sipas të drejtës civile gjermane, si edhe sipas parimeve të të drejtës europiane kontraktore personi i tretë palë në kontratën e lidhur me një përfaqësues pa tagra nëse vihet në dijeni të një fakti të tillë nuk ka detyrim për zbatimin e kësaj kontrate, por nëse ky i fundit zgjedh të zbatojë parimin e autoritetit të jashtëm duke kërkuar për këtë qëllim miratimin e kontratës nga ana e të përfaqësuarit, si dhe arrin të ketë sukses pra arrin të marrë miratimin nga ana e të përfaqësuarit në një rast të tillë si personi i tretë ashtu edhe i përfaqësuarit nuk mund ti shmangen më detyrimeve të përcaktuara në kontratë me pretendimin se personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra nuk ka pasur autoritetin e nevojshëm për lidhjen e kontratës. Në raste të tilla kontrata konsiderohet e vlefshme.

Edhe në rastin kur i përfaqësuarit e jep miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra ose shfaq vullnet për të pranuar veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra personi i tretë nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata me pretendimin se në momentin e lidhjes së kontratës i përfaqësuarit nuk ka pasur vullnet për lidhjen e kontratës, si dhe nuk mund të identifikojë si përgjegjës për dëmet e pretenduara personin që ka vepruar në pozitën e përfaqësuesit pa tagra.

Autoriteti i jashtëm i referuar si nga doktrina gjermane e së drejtës ashtu edhe nga parimet europiane të të drejtës kontraktore rezulton që të ketë në themel të tij mbrojtjen e dyshimit të arsyeshëm.

Parimi i dyshimit të arsyeshëm nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se nëse referuar përmbajtjes së prokurës së paraqitur nga përfaqësuesi mund të përcaktohet qartë si vëllimi i tagrave që i janë dhënë përfaqësuesit nga ana e përfaqësuarit, qëllimi i vërtetë për të cilin është lëshuar prokura nga ana e të përfaqësuarit, si dhe nga vlerësimi i sjelljes së përfaqësuesit, si dhe referuar edhe marrëdhënies përfaqësues/i përfaqësuar ekzistojnë të gjitha rrethanat mbi bazën e të cilave mund të krijohet dyshimi i arsyeshëm nga ana e personit të tretë se përfaqësuesi nuk ka tagra përfaqësimi për të kryer veprime juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit atëherë nga ana e personit të tretë nuk mund të pretendohet mungesa e dijenisë se përfaqësuesi nuk kishte tagra për të kryer veprimin juridik përkatës si dhe në një rast të tillë përfaqësuesi shmanget edhe nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit ndaj personit të tretë.

Një parim i tillë rezulton që të jetë në përputhje të plotë me dispozitat që rregullojnë përfaqësimin pa tagra në kushtet kur ligji rezulton që t'i ketë garantuar mbrojtje vetëm personit të tretë që është në mirëbesim (in buona fides), si dhe kjo mbrojtje nuk mund ti garantohet apo t'i ofrohet personit të tretë që është në keqbesim ose atij personi të tretë që ishte në gjendje të kuptonte që përfaqësuesi nuk kishte tagra apo nuk kishte tagrat e nevojshme për të kryer veprimin juridik.

Në funksion të asaj që u parashtrua më lart do të marrim në analizë për këtë qëllim edhe një rast të praktikës gjyqësore.

Në vitin 2012 personi A rezulton që të ketë lëshuar për personin B një

prokurë të përgjithshme me anë të së cilës këtij të fundit i ka dhënë këtë vëllim tagrash në prokurën e përgjithshme të lëshuar prej tij :

“Emëroj përfaqësues të përgjithshëm B, të cilit i jap të drejtë dhe kompetencë të plotë që në emër dhe për llogarinë time të më përfaqësojë :

a) Në të gjitha organet e administratës shtetërore pa përjashtim, institucioneve private, të kërkojë, dorëzojë dhe tërheqë dokumentacion, duke nënshkruar lirisht çdo dokument që do t’i kërkohet.

b) Të më përfaqësojë në zyrën e noterisë, për të nënshkruar në emrin tim në të gjitha llojet e akteve noteriale pa kufizim të cilat janë në mbrojtje të interesave të mia pasurore, duke përfshirë këtu edhe kontratat e shitblerjes së pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme në të cilat unë do të jem në cilësinë e shitësit të çdo lloj pasurie të luajtshme apo të paluajtshme që ekziston në emrin tim. Të përcaktojë çmimin, mënyrën e pagesës, blerësin, si dhe të gjithë kushtet e tjera të kontratës si ta shohë ai vetë të arsyeshme në mbrojtje të interesave të mia pasurore.

c) Të nënshkruajë në çdo lloj kontrate tjetër pa kufizim me kusht që të jetë në mbrojtje të interesave të mia pasurore, si dhe të mos çënojnë interesat e mia pasurore duke përfshirë këtu kontratat e sipërmarrjes, porosisë, kontrata investimi...etj.

ç) Të më përfaqësojë në zyrën e noterisë për të nënshkruar në çdo lloj kontrate të nevojshme për blerjen e pasurive në emrin tim, qofshin kontrata paraprake apo shitblerje. Të përcaktojë çmimin mënyrën e pagesës, si dhe të gjithë kushtet e tjera të kontratës si ta shohë ai vetë të arsyeshme.

d) Në të gjitha shkallët e gjyqësorit, nëse do të jetë e nevojshme, të ketë të drejta të plota për të kryer çdo lloj procedure pa kufizim, të emërojë avokat.

d) Në ZVRPP për të kryer çdo procedurë të nevojshme, të dorëzojë dhe tërheqë dokumentacionin, duke nënshkruar lirisht çdo dokument që do t’i kërkohet.

dh) Në të gjitha bankat e nivelit të dytë, për të kryer çdo lloj transaksioni bankar me llogaritë e mija, pa kufizim, të tërheqë, të derdhë në llogari, të hapë llogari në emrin tim, të bëjë transfertë bankare... etj”.

Përfaqësuesi B në referim të tagrave të dhëna në prokurën e përgjithshme të lëshuar nga ana e personit A rezulton që 3 (tre) vite më vonë nga momenti i lëshimit të prokurës së përgjithshme dhe konkretisht në vitin 2015 duke u bazuar në prokurën e përgjithshme të vitit 2012 të ketë garantuar me pasuritë e paluajtshme që gjendeshin të regjistruara në emër të personit A një detyrim monetar dhe konkretisht një kredi bankare të marrë nga ana e një personi tjetër dhe konkretisht nga ana e personit C në një Institucion Financiar.

Në funksion të garantimit të detyrimit të sipërcituar rezulton që përfaqësuesi B të ketë lidhur me Institucionin Financiar kredidhënës të personit C edhe një kontratë hipoteke, e cila ishte regjistruar edhe në regjistrat publikë.

Personi A pas vënies në dijeni të kontratës së hipotekës që përfaqësuesi i tij B kishte lidhur me Institucionin Financiar Kredidhënës rezulton që të ketë paraqitur kërkesë – padi në Gjykatë duke e kundërshtuar gjyqësisht veprimin juridik që përfaqësuesi i tij B kishte lidhur me Institucionin Financiar Kredidhënës duke parashtruar si pretendim të tij, pretendim i cili

përbënte edhe thelbin e mosmarrëveshjes se përfaqësuesi i tij B kishte vepruar në kapërcim të tagrave të përcaktuara në prokurën e përgjithshme të lëshuar prej tij si i përfaqësuar në vitin 2012 dhe se për rrjedhojë veprimi juridik dhe konkretisht kontrata e hipotekës që përfaqësuesi i tij B kishte lidhur me Institucion Financiar nuk ishte i detyrueshëm për atë si i përfaqësuar në kushtet kur ai nuk kishte shfaqur vullnet lidhur me veprimin juridik të kryer nga ana e përfaqësuesit të tij B.

Sipas pretendimeve të parashtruara nga ana e Institucionit Financiar Kredidhënës veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi B ishte i detyrueshëm për të përfaqësuarin A për shkak se referuar përmbajtjes së prokurës së përgjithshme të vitit 2012 ku dhe ishin bazuar tagrat e përfaqësuesit B për të nënshkruar kontratën e hipotekës me atë si Institucion Financiar Kredidhënës arrihej në përfundimin se përfaqësuesi B kishte pasur tagra për të vepruar në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit A duke nënshkruar për këtë qëllim në emër dhe për llogari të këtij të fundit dhe kontratën e hipotekës objekt kundërshtimi.

Pas shqyrtimit të provave, si dhe pas analizës së fakteve, rrethanave, argumenteve të parashtruara nga përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, nga ana e gjykatës rezultoi që të jetë arritur në përfundimin se veprimi juridik kontratë hipoteke i lidhur ndërmjet Institucionit Financiar Kredidhënës dhe të përfaqësuarit A, në emër dhe për llogari të të cilit kishte nënshkruar përfaqësuesi B duke u bazuar për këtë qëllim në prokurën e përgjithshme të vitit 2012 duhet të konsiderohej si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm referuar për këtë qëllim mungesës së shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit A për lidhjen e një kontrate të tillë në kushtet kur përfaqësuesi i tij B rezultonte që të kishte vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna në prokurën e përgjithshme të vitit 2012. Në rrethanat kur përfaqësuesi B kishte nënshkruar kontratën në kapërcim të tagrave të dhëna veprimi juridik në referim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil nuk mund të ishte i detyrueshëm për të përfaqësuarin A, si dhe nuk rezultonte që ky i fundit me ndonjë veprim të mëpasshëm apo me sjelljen e tij ta kishte miratuar veprimin juridik të kryer nga ana e përfaqësuesit B në kapërcim të tagrave që i ishin dhënë. Mungesa e shfaqjes së vullnetit element ky i domosdoshëm për vlefshmërinë e veprimit juridik dhe i sanksionuar edhe në nenin 663 të Kodit Civil e bënte kontratën e hipotekës veprim juridik absolutisht të pavlefshëm.

Në arritjen e përfundimit të sipërcituar rezultoi që gjykata të jetë referuar përcaktimeve të neneve 71, 78 dhe 663 të Kodit Civil, si dhe përmbajtjes së prokurës së përgjithshme të vitit 2012 të lëshuar nga ana e të përfaqësuarit A për përfaqësuesin B.

Le të marrim në analizë rastin konkret me qëllim arritjen më pas në përfundimin nëse vendimarrja e gjykatës në rastin konkret rezultoi të ketë qenë e drejtë apo jo përse i përket përfundimit se përfaqësuesi B rezultoi që të ketë vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna me prokurën e përgjithshme të vitit 2012 nga i përfaqësuarit A.

Objekt analize në rastin konkret do të jetë jo vetëm lloji i prokurës dhe vëllimi i tagrave që i përfaqësuarit A rezultojnë t'i ketë dhënë përfaqësuesit B me anë të prokurës së vitit 2012, për të përcaktuar më pas nëse përfaqësuesi B rezultojnë të ketë vepruar apo jo në kapërcim të tagrave të dhëna nga ana e të përfaqësuarit A, por kjo analizë do të shtrihet edhe ndaj sjelljes së personit të tretë në funksion kjo të përcaktimit të pozitës së këtij të fundit nëse duhet të konsiderohet apo jo se ka vepruar në mirëbesim (in buona fides), si dhe nëse nga ana e tij është treguar gjithë kujdesi i nevojshëm në verifikimin e vëllimit të tagrave që i përfaqësuarit A rezultojnë t'i ketë dhënë përfaqësuesit B me anë të prokurës së përgjithshme të vitit 2012.

Sikurse është referuar edhe më lart rezultojnë që prokura që i përfaqësuarit A t'i ketë dhënë përfaqësuesit B të jetë prokurë e cila në referim të përcaktimeve të nenit 71 paragraf 1 të Kodit Civil konsiderohet prokurë e përgjithshme me anë të së cilës i përfaqësuarit A rezultojnë që t'i ketë dhënë përfaqësuesit B tagra për kryerjen e veprimeve juridike të shumëllojshme, veprime juridike këto të cilat duhet të kishin si qëllim kryesor mbrojtjen e interesave pasurore të të përfaqësuarit.

Referuar përmbajtjes së prokurës së përgjithshme të vitit 2012 rezultojnë që i përfaqësuarit A t'i ketë dhënë tagra përfaqësuesit B për të lidhur kontrata noteriale me kushtin që këto kontrata duhet të ishin në mbrojtje të interesave të tij pasurore duke përjashtuar në këtë mënyrë indirekt ato lloj veprimesh juridike të cilat do të cënonin apo vinin në rrezik interesat pasurore të atij si i përfaqësuar.

Sikurse është cituar edhe gjatë trajtimit të prokurës së përgjithshme në pjesët e mësipërme të këtij punimi në praktikën e përditshme jo gjithmonë është e mundshme që i përfaqësuarit të bëjë një përjashtim të shprehur të veprimeve juridike të cilat ia ka ndaluar përfaqësuesit. Në jo pak raste ky përjashtim mund të jetë i nënkuptuar, ose përjashtimi mund të ketë një karakter të përgjithshëm sikurse rezultojnë të jetë edhe ai i përcaktuar në prokurën e përgjithshme të lëshuar nga i përfaqësuarit A, sipas së cilës ky i fundit rezultojnë që t'i ketë ndaluar përfaqësuesit B të gjitha ato veprime juridike të cilat do të cënonin apo do të vinin në rrezik interesat pasurore të të përfaqësuarit A.

Në rrethana të tilla arrihet në përfundimin se përfaqësuesi B të mos ketë pasur tagra përfaqësuesimi për kryerjen e atyre veprimeve juridike nga të cilat do të cënoheshin ose do të viheshin në rrezik interesat pasurore të të përfaqësuarit A.

Ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje është fakti nëse kontrata e hipotekës e lidhur ndërmjet Institucionit Financiar Kredidhënës dhe përfaqësuesit B me anë të të cilës ky i fundit rezultojnë që të ketë garantuar detyrimet e personit C me pasuritë e paluajtshme që ishin në pronësi të të përfaqësuarit A duhet të konsiderohet apo jo veprim juridik i asaj natyre që do të vinte në rrezik apo do të cënonte interesat pasurore të të përfaqësuarit A.

Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë në përcaktimet e nenit 530 paragraf 2 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : ***“Një pronë mund të rëndohet nga pronari i saj, me qëllim që të sigurohet pagimi i një detyrimi”.***

Vetë funksioni garantues që Hipoteka ka për përmbushjen e detyrimeve të shpie në përfundimin se veprimi juridik i kryer nga ana e përfaqësuesit B dhe konkretisht kontrata

e hipotekës që ky i fundit ka lidhur me Institucionin Financiar Kredidhënës me qëllim për të garantuar detyrimin që personi C kishte ndaj Institucionit Financiar Kredidhënës duhet të konsiderohet si një veprim juridik me natyrë cënuese të interesave pasurore të të përfaqësuarit A dhe si i tillë nuk bënte pjesë në bashkësinë e atyre veprimeve juridike për të cilat përfaqësuesi B kishte tagra përfaqësimi.

Në rrethana të tilla arrihet në përfundimin se përfaqësuesi B të ketë vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna në prokurën e përgjithshme të vitit 2012 nga ana e të përfaqësuarit A dhe për rrjedhojë në kuptim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil duhet të konsiderohet se ka vepruar si përfaqësues pa tagra në kryerjen e veprimit juridik në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit A me Institucionin Financiar Kredidhënës.

Referuar rrethanave të cituara më lart nuk rezulton që i përfaqësuarit A me ndonjë nga format e përcaktuara në nenin 80 të Kodit Civil ta ketë miratuar më vonë veprimin juridik të kryer nga ana e përfaqësuesit B, si dhe nuk rezulton që nga ana e Institucionit Financiar Kredidhënës t'i jetë kërkuar të përfaqësuarit A miratimi i veprimit juridik të kryer nga ana e përfaqësuesit B.

Në kushtet kur përfaqësuesi B në lidhjen e kontratës së hipotekës me Institucionin Financiar Kredidhënës rezulton që të ketë vepruar si përfaqësues pa tagra dhe se ky veprim juridik nuk rezulton që të jetë miratuar më vonë me ndonjë nga format e shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit A arrihet në përfundimin se në referim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil kontrata e hipotekës nuk mund të jetë e detyrueshme për të përfaqësuarin A për shkak se ky i fundit nuk rezulton që të ketë shfaqur vullnet për lidhjen e kësaj kontrate, element ky i domosdoshëm në referim kjo të përcaktimeve të nenit 663 të Kodit Civil.

Në këndvështrim të saj që u parashtrua më lart vlerësoj se përfundimi i gjykatës lidhur me zgjidhjen e rastit konkret të ketë qenë i drejtë.

Lidhur me pozitën e Institucionit Financiar Kredidhënës si person i tretë në lidhjen e kontratës së hipotekës me përfaqësuesin B duke iu referuar rrethanave të parashtruara më lart vlerësoj se nuk rezulton të ketë qenë në pozitën e personit të tretë me mirëbesim (in buona fides) për arsye se referuar parimit të dyshimit të arsyeshëm që zbatohet si nga ana e parimeve europiane të të drejtës kontraktore ashtu edhe nga doktrina gjermane e të drejtës për të përcaktuar pozitën e personit të tretë, parim ky i cili rezulton që të jetë në përputhje edhe me dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë institutin e përfaqësimit arrihet në përfundimin se personi i tretë në kontratë dhe konkretisht Institucioni Financiar Kredidhënës referuar përmbajtjes së prokurës së përgjithshme të paraqitur nga përfaqësuesi B i kishte të gjitha mundësitë për të përcaktuar si vëllimin e tagrave që i ishin dhënë këtij të fundit nga ana e të përfaqësuarit A. Konkretisht vëllimi tagrave që i ishin dhënë përfaqësuesit B ishte i tillë që nuk e lejonte këtë të fundit për të lidhur kontratën e hipotekës me qëllim për të garantuar detyrimet që personi C kishte ndaj tij si Institucion Financiar Kredidhënës. Gjithashtu referuar natyrës së veprimit juridik që po kryhej nga ana e përfaqësuesit B ekzistonin të gjitha rrethanat mbi bazën e të cilave të krijohet dyshimi i arsyeshëm se përfaqësuesi B po vepronte në kapërcim të tagrave që i ishin dhënë nga ana e të përfaqësuarit A në kushtet kur me anë të këtij veprimi juridik

nga ana e përfaqësuesit B mund të cënoheshin apo viheshin në rrezik interesat pasurore të të përfaqësuarit A.

Në rrethanat e sipërcituara nga ana e personit të tretë Institucionit Financiar Kredihënës nuk mund të pretendohet mungesa e dijenisë se përfaqësuesi B po vepron në kapërcim të tagrave që i ishin dhënë nga ana e të përfaqësuarit A me anë të prokurës së përgjithshme të lëshuar prej këtij të fundit në vitin 2012, si dhe në një rast të tillë ekzistojnë të gjitha kushtet që përfaqësuesi B të shmanget edhe nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit që mund të pretendohet nga ana e Institucionit Financiar Kredihënës se i është shkaktuar si rezultat i veprimit juridik të kryer nga ana e përfaqësuesit B.

ii) Natyra e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra

Referuar mënyrës si është formuluar dispozita nga ana e ligjvënësit dhe konkretisht mënyra si është formuluar neni 78 i Kodit Civil nuk paraqitet e qartë nëse personit të tretë pjesmarrës në veprimin juridik të lidhur me përfaqësuesin pa tagra i njihet apo jo e drejta që të tërhiqet nga kontrata ose më qartë të revokojë veprimin juridik të lidhur me përfaqësuesin pa tagra para miratimit të këtij veprimi juridik nga ana e të përfaqësuarit.

Mungesa e qartësisë lidhur me një fakt të tillë shpjegohet edhe me arsyen se neni 78 i Kodit Civil ka për qëllim mbrojtjen e autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit përsa i përket mungesës së shfaqjes së vullnetit nga ana e këtij të fundit për të qenë palë pjesmarrëse në një veprim juridik, si dhe nuk rezulton që të kenë për qëllim mbrojtjen e interesave të personit të tretë në raport me të përfaqësuarin.

Referuar mënyrës se si është formuluar neni 78 i Kodit Civil duket sikur ligjvënësi barazpeshimin e interesave ndërmjet personit të tretë me mirëbesim dhe të përfaqësuarit ta ketë zgjidhur duke i njohur mundësinë personit të tretë që është në mirëbesim të drejtën që të kërkojë dëmshpërblim nga përfaqësuesi pa tagra për dëmet që personit të tretë i janë shkaktuar si rrjedhojë e veprimeve të përfaqësuesit pa tagra gjithmonë nëse këto veprime nuk miratohen nga ana e të përfaqësuarit.

Legjislacionet në vende të ndryshme dhe kryesisht në ato europiane japin përkufizime të ndryshme lidhur me natyrën e marrëdhënies që lind nga veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra.

Sipas legjislacionit hollandez që rregullon veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra këto lloj veprimesh juridike konsiderohen si veprime juridike të pavlefshme referuar faktit se në këto veprime juridike mungon një prej elementëve thelbësorë për vlefshmërinë e veprimit juridik që është shfaqja e vullnetit për marrjen përsipër të të drejtave dhe detyrimeve nga ana e të përfaqësuarit. Legjislacioni hollandez në ndryshim nga ai i yni, si dhe në ndryshim edhe nga legjislacioni gjerman që rregullon përfaqësimin pa tagra nuk bën tërësisht të qartë faktin nëse i përfaqësuari mund t'i miratojë në një moment të mëvonshëm veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Legjislacioni ynë sikurse edhe ai gjerman e sanksionuar kjo edhe në parimet europiane të të drejtës kontraktore nuk rezulton që veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra t'i ketë konsideruar veprime juridike menjëherë të pavlefshme, por në dallim nga legjislacioni gjerman duket sikur ligjvënësi ynë vlefshmërinë e këtyre veprimeve juridike ta ketë kushtëzuar vetëm me vullnetin e të përfaqësuarit në emër dhe për llogari të të cilit rezulton që të jenë kryer këto veprime juridike nga ana e përfaqësuesit pa tagra dhe jo edhe me dëshirën e personit të tretë që rezulton të ketë qenë në mirëbesim.

Sipas doktrinës gjermane sapo një përfaqësues pa tagra përfundon një kontratë me një palë të tretë, kjo kontratë do të kontrollohet nga parimi juridik gjerman i quajtur "*schwebende Unwirksamkeit*"⁸⁸ dhe që nënkupton qënien e këtij veprimi juridik në ajër.

Me anë të këtij parimi synohet të shpjegohet natyra e marrëdhënies së krijuar nga veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Sipas këtij parimi kontrata nuk konsiderohet menjëherë absolutisht e pavlefshme (nul) dhe as menjëherë e detyrueshme, por konsiderohet si e një natyre të ndërmjetme. Nga një pjesë e mirë e juristëve këto lloj veprimesh juridike dhe konkretisht veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesve pa tagra konsiderohen sikur janë në ajër dhe presin për një moment të dytë për tu miratuar ose për tu refuzuar nga i përfaqësuarit ose edhe për tu revokuar nga personi i tretë.

Sipas të drejtës dhe doktrinës gjermane të së drejtës, si edhe sipas parimeve europiane të të drejtës kontraktore në dallim nga legjislacioni ynë në mënyrë të qartë përcaktohet se personit të tretë i njihet mundësia që të tërhiqet nga kontrata deri para dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit, ose të kërkojë nga ky i fundit që të bëjë një qartësim të situatës në lidhje me tagrat e përfaqësimit, apo dhe nëse i përfaqësuarit do ta miratojë apo jo kontratën.

Parashikimi ligjor i përcaktuar në nenin 78 të Kodit Civil nuk rezulton që të vijë ndesh me parashikimet e tjera ligjore referuar faktit se personi i tretë që ka qenë në mirëbesim rezulton që ta ketë shfaqur vullnetin e tij për kryerjen e veprimit juridik me personin në emër dhe për llogari të të cilit është vepruar duke e kushtëzuar në këtë mënyrë vlefshmërinë e këtij veprimi juridik vetëm me shfaqjen e vullnetit nga ky i fundit.

Sikurse është cituar edhe më lart përcaktimet e nenit 78 të Kodit Civil kanë për qëllim mbrojtjen e autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit përsa i përket mungesës së shfaqjes së vullnetit nga ana e këtij të fundit për të qenë palë pjesmarrëse në një veprim juridik, si

⁸⁸ Larenz and Wolf, Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Rechts, § 49, nr. 4 et seq.; Schramm, Münchener Kommentar zum BGB, Kommentar i Kodit Civil Gjerman, neni 177, nr. 15 et seq.

⁸⁸ K.-H. Schramm, in F. J. Sacker (ed.), Münchener Kommentar zum Bürgerlichen Gesetzbuch, Vol. I §§ 1-240, 5th edn (München: Beck-Verlag, 2006), § 164, no. 68. Similarly, K. Larenz and M. Wolf, Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Rechts, 9th edn (München: Beck-Verlag, 2007).

⁸⁸ Neni 3:301(1) PECL: Ky kre, jep tagra, një përfaqësuesi ose një personi tjetër, për të lidhur një kontratë duke i ngarkuar detyrime një të përfaqësuarit me një palë të tretë.

⁴ Lando and Beale, Principles of European Contract Law. Parts I and II, faqe 197.

dhe nuk rezulton që të kenë për qëllim mbrojtjen e interesave të personit të tretë në raport me të përfaqësuarin, por personit të tretë me mirëbesim i është njohur e drejta për të kërkuar dëmshpërblim nga personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra.

Ky parashikim ligjor rezulton që të jetë edhe në përputhje me parimin e njohur të të drejtës civile dhe konkretisht me parimin e shfaqjes së vullnetit ose i njohur ndryshe në teorinë e së drejtës civile si parimi i përputhshmërisë së vullneteve. E thënë ndryshe në një marrëdhënie kontraktore të dyanshme vullnetit të njëres prej palëve për të marrë përsipër të drejta dhe detyrimeve në këtë marrëdhënie kontraktore duhet t'i korrespondojë edhe vullneti i palës tjetër për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në këtë marrëdhënie kontraktore.

Në rastin e përfaqësimit pa tagra marrëdhënia konsiderohet e vesuar për shkak të mungesës së shfaqjes së vullnetit në lidhjen e kontratës nga personi në emër dhe për llogari të të cilit është vepruar nga një person i caktuar pa e pasur cilësinë e përfaqësuesit ose kur ky i fundit ka vepruar në kapërcim të tagrave të dhëna nga i përfaqësuari.

Në raste të tilla ligjvënësi ynë sikurse edhe ai gjerman nuk rezulton që të ketë pasur për qëllim që këto veprime juridike t'i konsiderojë menjëherë si veprime juridike të pavlefshme referuar edhe faktit se mungesa e njëkohshmërisë për shfaqjen e vullnetit nuk rezulton që të përbëjë element thelbësor për ta konsideruar një veprim juridik të pavlefshëm në kuptim të ligjit, si dhe vetë dispozita rezulton që miratimit të të përfaqësuarit t'i ketë dhënë fuqi prapavepruese duke e konsideruar të vlefshëm që në momentin e kryerjes së veprimit juridik.

Në një përfundim të tillë arrihet edhe referuar kuptimit që ligjvënësi në nenin 79 të Kodit Civil i ka dhënë veprimit juridik ku ka përcaktuar se : *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”*.

Edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr. 1, datë 06.01.2009 ndër të tjera kanë përcaktuar se : *“Veprimi juridik nuk është gjë tjetër veçse shfaqja e ligjshme dhe e lirë e vullnetit të personit fizik ose juridik. Shfaqja e vullnetit synon ardhjen e pasojave të caktuara në lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave ose detyrimeve. Si rrjedhojë është mëse e domosdoshme që personi fizik ose juridik jo vetëm të (1) shfaqë vullnetin e tij të lirë por edhe (2) ky vullnet të jetë i ligjshëm”*.

Referuar mënyrës së formulimit të dispozitës së sipërcituar, si dhe interpretimit që i është bërë kësaj dispozitë edhe nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë duket qartë se thelbësore për vlefshmërinë e një veprimi juridik të jetë shfaqja e ligjshme e vullnetit duke mos e kushtëzuar që kjo shfaqje vullneti duhet të jetë e njëkohshme nga ana e palëve pjesëmarrëse në këtë veprim juridik.

Gjithsesi qëndrimi im personal në një rast të tillë pajtohet me qëndrimin e doktrinës gjermane, si dhe me atë të sanksionuar në parimet europiane të të drejtës kontraktore sipas të cilave personit të tretë i njihet e drejta për tu tërhequr nga veprimet juridike të

lidhura me një përfaqësues pa tagra ose e thënë ndryshe e drejta për të revokuar në mënyrë të njëanshme veprimin juridik të kryer me përfaqësuesin pa tagra. Por kjo e drejtë për të revokuar këto veprime juridike mund dhe duhet të ushtrohet deri në momentin që i përfaqësuarit nuk i ka miratuar veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra, në të kundërt pra nëse kjo shfaqje vullneti për tu tërhequr nga kontrata nuk është ushtruar deri në momentin kur i përfaqësuarit jep miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra atëherë veprimi juridik do të jetë i detyrueshëm për zbatim nga ana e personit të tretë.

Ky qëndrim bazohet në faktin se në kushtet kur veprimi juridik i lidhur ndërmjet personit të tretë dhe përfaqësuesit pa tagra konsiderohet se nuk ka fituar vlerë ligjore deri në momentin kur i përfaqësuarit nuk ka dhënë miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra atëherë në kuptim të ligjit ky veprim juridik konsiderohet i paqenë dhe përsa kohë konsiderohet i tillë personi i tretë mund të tërhiqet nga të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë veprim juridik i cili nuk ka fituar akoma vlerë ligjore.

Në një përfundim të tillë arrihet edhe referuar faktit se sipas nenit 78 të Kodit Civil në kuadër të barazpeshimit të interesave në një marrëdhënie juridike e drejta për të përfituar dëmshpërblim i njihet vetëm personit të tretë në mirëbesim ndërsa personi i tretë që është në keqbesim nuk gëzon mbrojtje ligjore në kuptim të dispozitës së sipërcituar.

Në rrethana të tilla në kuadër të barazpeshimit të interesave të palëve pjesëmarrëse në një veprim juridik të kryer nga një përfaqësues pa tagra edhe personit të tretë qoftë me mirëbesim apo keqbesim duhet t'i njihet e drejta për tu tërhequr apo për të revokuar veprimet juridike të kryera me një përfaqësues pa tagra me kusht që kjo tërheqje apo revokim nga ana e personit të tretë të bëhet para dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit për shkak se veprimi juridik akoma nuk i ka filluar efektet e tij.

Vetë legjislacioni ynë civil dhe konkretisht neni 696 i Kodit Civil e ka kushtëzuar të drejtën për tu tërhequr nga kontrata në rast se ndonjëherë prej palëve në kontratë i është njohur kjo e drejtë me faktin që kontrata nuk duhet të ketë filluar të zbatohet.

Si përfundim vlerësoj se neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u përcaktuar në mënyrë të qartësishme nga ana e ligjvënësit se personit të tretë duhet t'i njihet e drejta për tu tërhequr nga kontrata me kushtin që kjo e drejtë të ushtrohet para dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit për veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Ky parashikim i ri ligjor duhet të konsiderohet si një barazpeshim i mbrojtjes së interesave ndërmjet të përfaqësuarit dhe personave të tretë në mënyrë të veçantë të atyre që janë në mirëbesim referuar faktit se përpjekjet e këtyre të fundit për të përfituar dëmin e shkaktuar nga përfaqësuesi pa tagra për shkaqe të ndryshme përfshirë këtu edhe insolvabilitetin e personit që ka vepruar si përfaqësues pa tagra mund të rezultojnë të pasukseshme, si dhe të dëmshme edhe për veprimarinë e tyre tregtare si persona të tretë në kushtet kur vonimi në kohë i përfitimit të dëmit të pretenduar mund të ketë ndikim negativ në veprimtarinë e tyre tregtare.

Ky parashikim ligjor duhet të konsiderohet edhe si një mundësi që i jepet personave të tretë të cilët ishin në dijeni të mungesës së tagrave nga ana e përfaqësuesit ose se ky i

fundit po vepronte në kapërcim të tagrave të dhëna për tu tërhequr nga këto veprime juridike të cilat do të rezultojnë të dëmshme për veprimtarinë e tyre si persona të tretë.

Ky parashikim i ri ligjor do të ishte edhe në funksion të përshtatjes së legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian në kushtet kur sikurse është cituar edhe më lart sipas parimeve europiane të të drejtës kontraktore personave të tretë u njihet e drejta për tu tërhequr nga kontrata e lidhur me përfaqësuesin pa tagra deri para dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit.

iii) Koha e nevojshme për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra, si dhe forma e miratimit.

Koha e nevojshme për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra.

Ajo çfarë vlen për tu theksuar dhe që konsiderohet si mangësi në legjislacion tonë civil që rregullon përfaqësimin pa tagra në nenin 78 të Kodit Civil është fakti se nga ana e ligjvënësit nuk është parashikuar ndonjë periudhë kohore brenda së cilës i përfaqësuari duhet të japë miratimin e tij për veprimet e kryera në emër dhe për llogari të këtij të fundit nga ana e personit që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur një cilësi të tillë.

Konkretisht në nenin 78 të Kodit Civil ligjvënësi është mjaftuar vetëm me shprehjen se : *“...përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë”*.

Legjislacioni gjerman dhe konkretisht dispozitat e Kodit Civil gjerman që rregullojnë përfaqësimin pa tagra në nenet 177/2 dhe 178 kanë përcaktuar qartë se personi në emër dhe për llogari të të cilit ka vepruar përfaqësuesi pa tagra duhet të japë miratimin e tij për veprimet e kryera nga ky i fundit brenda një periudhe 2 (dy) javore.

Natyrisht që kjo periudhë 2 (dy) javore fillon nga momenti që i përfaqësuari ka ardhur në dijeni ose konsiderohet se ka ardhur në dijeni të veprimeve të kryera në emër dhe për llogari të tij nga personi që nuk ka pasur cilësinë e përfaqësuesit të tij.

Përcaktimin e afatit kohor të sipërcituar legjislacioni gjerman rezulton që ta ketë lidhur edhe me vetë natyrën e veprimeve juridike që kryhen nga ana e përfaqësuesit pa tagra, veprime këto të cilat sikurse është cituar edhe më lart nuk konsiderohen menjëherë të pavlefshme, por si veprime juridike që mbeten pezull, ose si veprime juridike të ngrira. Vazhdimi i kësaj situate për një periudhë të pacaktuar do të ishte i dëmshëm jo vetëm për personin e tretë por edhe për vetë personin që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi.

Referuar parimeve europiane të të drejtës kontraktore (PECL) edhe në këto të fundit sikurse në nenin 78 të Kodit Civil nuk gjendet ndonjë parashikim konkret lidhur me afatin kohor brenda të cilit duhet të jepet miratimi nga ana e të përfaqësuarit, por në ndryshim nga legjislacioni ynë në këto parime rezulton që të jetë përcaktuar një afat i

përgjithshëm që nuk duhet kaluar dhe që sipas këtyre parimeve rezultojnë që të jetë 3 (tre) vjeçar. Një parashikim i tillë gjendet i përcaktuar në nenin 14 : 201 të parimeve europiane të të drejtës kontraktore.

Vlerësoj se ky afat maksimal i caktuar sipas parimeve europiane të të drejtës kontraktore nuk kushtëzohet me ardhjen apo jo në dijëni të të përfaqësuarit lidhur me veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Pavarësisht ardhjes apo jo në dijëni nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra me kalimin e afatit 3 (tre) vjeçar personi i tretë nuk mund të mbahet i lidhur me detyrimet që i burojnë nga veprimet juridike të kryera me përfaqësuesin pa tagra, kjo edhe për faktin se personi i tretë nuk mund të mbahet përjetësisht i lidhur me veprimet juridike të kryera me një person që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi.

Një parashikim të ndryshëm ligjor gjejmë në parimet e të drejtës ndërkombëtare tregtare (UNIDROIT 2004)⁸⁹. Sipas këtyre parimeve periudha maksimale e dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit është 10 (dhjetë) vjet. Ky afat 10 (dhjetë) vjeçar fillon nga dita e nesërme e kryerjes së veprimit juridik ndërmjet personit të tretë dhe përfaqësuesit pa tagra.

Ky afat i vendosur në parimet e të drejtës ndërkombëtare tregtare rezultojnë që të jetë dukshëm i ndryshëm nga afatet e vendosura sipas të drejtës gjermane dhe sipas parimeve europiane të të drejtës kontraktore.

Vlerësimi im personal është se afati i mësipërm duhet interpretuar si afat me karakter shues ndaj të drejtës së të përfaqësuarit për të miratuar veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra. Vlerësimi im është se kalimi i këtij afati i heq të drejtën të përfaqësuarit për të pasur pretendime përkundrejt veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra dhe se këto veprime do t'i shtrijnë pasojat e tyre ndaj të përfaqësuarit.

Referuar legjislacionit tonë dhe konkretisht përcaktimeve të nenit 114 të Kodit Civil rezultojnë që të jetë parashikuar shprehimisht se : *“Parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë”*.

Referuar parashikimit ligjor të mësipërm vlerësoj se edhe sipas legjislacionit tonë me kalimin e afatit 10 (dhjetë) vjeçar i përfaqësuarit humbet të drejtën për të pasur pretendime ndaj veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra dhe se këto veprime do t'i shtrijnë efektet ndaj tij si i përfaqësuar.

*Në kuadër të intensifikimit të marrëdhënive tregtare në jo pak raste para gjykatave shqiptare do të vihet në bisedim si çështje se **sa do të konsiderohet kohë e arsyeshme që i përfaqësuarit të japë miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra.***

⁸⁹ Rome: International Institute for the Unification of Private Law, 2004. Teksti i plotë shoqëruar me komentarin: eeë.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2004/integralversionprinciples2004-e.pdf. UNIDROIT Agency Convention D. Busch, Indirect Representation in European Contract Law (The Hague: Kluwer Law International, 2005), faqe 95-175

Vlerësimi im personal është që përcaktimi i afatit kohor brenda të cilit personi në emër dhe për llogari të të cilit është vepruar nga ana e një personi që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur një cilësi të tillë merr rëndësi përcaktuese jo vetëm për shkak të natyrës së marrëdhënies që krijohet, marrëdhënie kjo e cila edhe sipas parashikimeve të legjislacionit tonë nuk konsiderohet menjëherë e paqenë, por merr një rëndësi thelbësore edhe për vetë personin e tretë dhe konkretisht lidhur me angazhimin e këtij të fundit për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga kjo marrëdhënie që në kuptim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil mbetet e pezulluar (*suspending*) deri në dhënien e miratimit nga ana e të përfaqësuarit.

Një veprim juridik i caktuar në momentin fillestar të lidhjes së tij, rasti klasik është ai i lidhjes së një kontrate si veprim juridik i dyanshëm mund të mos jetë në interes të personit në emër dhe për llogari të të cilit është lidhur nga një person pa e pasur cilësinë e përfaqësuesit, por në një kohë të mëvonshme relativisht jo të largët mund të shndërrohet në një veprim juridik shumë të leverdisshëm për personin në emër dhe për llogari të të cilit është lidhur ky veprim juridik, si dhe aspak i leverdisshëm nga pikëpamja ekonomike për personin e tretë, i cili rezulton që të ketë qenë në mirëbesim.

Rasti klasik do të ishte blerja e një sasive të caktuar mallrash me një çmim i cili në momentin fillestar të lidhjes së kontratës mund të duket jo e leverdisshme nga pikëpamja ekonomike për personin në emër dhe për llogari të të cilit është vepruar nga ana e personit që nuk e ka pasur tagrat për të qenë përfaqësues ose edhe kur këto tagra janë kapërcyer, por që në një periudhë të shkurtër kohore le të themi disa mujore si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për këto mallra çmimi i tyre në treg mund të pësojë një rritje të tillë që do ishte shumë e leverdisshme për personin në emër dhe për llogari të të cilit është vepruar nga ana e personit që nuk ka pasur tagrat apo ka kapërcyer tagrat e dhëna.

Rast tjetër mund të ishte edhe rasti i shitjes apo blerjes së një pasurie të paluajtshme çmimi i së cilës në momentin fillestar të lidhjes së kontratës mund të jetë aspak i leverdisshëm për personin në emër dhe për llogari të të cilit është vepruar nga një person që nuk e ka pasur cilësinë e përfaqësuesit, por që në një moment të mëvonshëm jo shumë të largët si rezultat i rënies apo rritjes drastike të çmimeve mund të shndërrohet në veprim juridik shumë të leverdisshëm për të përfaqësuarin.

Natyrisht që nuk do të kishte kuptim që personi i tretë të mbetet pafundësisht i lidhur me veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra, në pritje kjo të dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit.

Kjo pritje pa kufi do të vinte ndesh me vetë parimin e barazpeshimit të interesave të palëve në një marrëdhënie juridike dhe aq më tepër kur bëhet fjalë për një person të tretë i cili ka vepruar në mirëbesim, por do të shndërrohej edhe në cënuesë të interesave të këtij të fundit.

Si barazpeshim i interesave të palëve në rastet e marrëdhënieve që krijohen nga veprimet juridike të realizuara nga përfaqësuesi pa tagra nuk duhet të konsiderohet vetëm njohja e të drejtës së personit të tretë që ka qenë në mirëbesim për të kërkuar dëmshpërblim në rastet kur këto veprime juridike nuk miratohen nga ana e të përfaqësuarit, por edhe

përcaktimi i afatit kohor brenda të cilit i përfaqësuari duhet të japë miratimin për veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Vlerësimi im personal është që ky afat duhet të jetë i shkurtër sikurse edhe afatet dekadente që njihen në Kodin Civil, si dhe në asnjë rast nuk mund të jetë më i gjatë se 1 (një) muaj në varësi kjo edhe të rrethanave konkrete në të cilat ndodhet i përfaqësuari.

Pavarësisht se referuar mënyrës sipas së cilës është formuluar neni 78 i Kodit Civil duket sikur personi i tretë nuk ka të drejtë t'i caktojë afat të përfaqësuarit për të miratuar ose jo veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra. Vlerësimi im personal në referim edhe të asaj për parashtrova më lart pra në kuadër të parimit të barazpeshimit të interesave të palëve në një marrëdhënie juridike është se ndërmarrja e të gjitha veprimeve të nevojshme nga ana e personit të tretë për të kontraktuar drejtpërdrejt me të përfaqësuarin si dhe për t'i caktuar afat këtij të fundit për miratimin ose jo të veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra nuk vjen ndesh me përcaktimet e dispozitës së sipërcituar, si dhe nuk vjen ndesh edhe me ndonjë parim të së drejtës të njohur nga ligji dhe nga doktrina e së drejtës.

Referuar parimeve europiane të të drejtës kontraktore (PECL), në këto parime dhe konkretisht në nenin 3 : 208 personit të tretë i është njohur shprehimisht e drejta për të detyruar të përfaqësuarin të sqarojë nëse i miraton apo jo veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra duke i kërkuar për këtë qëllim një përgjigje me shkrim brenda një afati të caktuar ose mund të kërkojë dhënien drejtpërdrejt të miratimit nga ana e të përfaqësuarit.

Referuar interpretimit që i është bërë dispozitës së sipërcituar dhe konkretisht nenit 3 : 208 të parimeve europiane të të drejtës kontraktore një barrë e tillë mund t'i ngarkohet të përfaqësuarit vetëm për një arsye të mirë⁹⁰.

Të quajturën arsye të mirë rezulton që ta kenë kushtëzuar me këto elementë :

- a) Sjelljet ose veprimet e të përfaqësuarit të cilat kanë krijuar një përfytyrim të gabuar te personi i tretë për tagrat që i janë caktuar përfaqësuesit ;
- b) Personi i tretë duhet të ketë dyshime mbi tagrat. Këto dyshime duhet të kenë një bazë të llogjikshme;
- c) Personi i tretë duhet të jetë në mirëbesim

Në referim të saj që parashtrova më lart personi i tretë menjëherë sapo të vihet në dijeni që personi që ka vepruar si përfaqësues nuk e ka pasur këtë cilësi ose edhe në rast dyshimi të arsyeshëm lidhur me tagrat e përfaqësuesit ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të kontraktuar me të përfaqësuarin duke i kërkuar këtij të fundit sqarimet e nevojshme lidhur me pozitën e përfaqësuesit, duke i caktuar të përfaqësuarit për këtë qëllim edhe një afat brenda të cilit ai duhet të japë miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra, duke i përcaktuar të përfaqësuarit edhe se në rast të mos dhënies së miratimit brenda afatit të caktuar ai si person i tretë do të çlirohet nga

⁹⁰ Lando and Beale, Principles of European Contract Law. Parts I and II, faqe 197.

detyrimet juridiko - civile që i linden nga veprimet juridike të kryera me përfaqësuesin pa tagra ose duke i përcaktuar si pasojë se veprimet e kryera nga përfaqësuesi do të konsiderohen se janë kryer me autorizim të të përfaqësuarit.

Nga ana e personit të tretë në caktimin e afatit që do i caktohet të përfaqësuarit duhet të merren në konsideratë një sërë rrethanash sikurse mund të jenë vendi ku ndodhet i përfaqësuari, mjetet e komunikimit me këtë të fundit, si dhe e gjithë koha e nevojshme që mund t'i nevojitet të përfaqësuarit për të vendosur lidhur me miratimin ose jo të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Në mungesë të afatit kohor të përcaktuar në nenin 78 të Kodit Civil në rast të konflikteve të ndryshme që mund të linden lidhur me kohën e nevojshme që do i duhet të përfaqësuarit për të vendosur miratimin ose jo të veprimeve të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra është gjykata ajo që do vendosë nëse afati i caktuar nga ana e personit të tretë duhet të vlerësohet apo jo si afat i arsyeshëm. Një vlerësim i tillë do të bëhet duke pasur parasysh kriteret e mësipërme, si dhe kritere të tjera objektive në varësi kjo të rastit që do të paraqitet për shqyrtim para gjykatës.

Nëse nga ana e gjykatës do të arrihet në përfundimin se afati i caktuar nga personi i tretë nuk plotëson kushtet për t'u konsideruar afat i arsyeshëm brenda të cilit i përfaqësuari duhet të vendoste për miratimin ose jo të veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra atëherë :

Së pari : Personi i tretë nuk mund të pretendojë shmangien nga përbushja e detyrimeve që rëndojnë mbi këtë të fundit, si rrjedhojë e veprimeve juridike të lidhura me përfaqësuesin pa tagra për shkak të mosdhënies së miratimit nga i përfaqësuari brenda afatit të caktuar nga personi i tretë.

Së dyti : Personit të tretë me mirëbesim nuk do i njihet as e drejta për të kërkuar shpërblim dëmi nga personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra.

Gjithashtu është gjykata ajo që do të vlerësojë edhe pretendimet e personave të tretë për shmangien e tyre nga detyrimet që rrjedhin nga veprimet juridike të kryera me përfaqësuesi pa tagra për shkak se miratimi nga ana e të përfaqësuarit është dhënë tej një afati të arsyeshëm.

Edhe në një rast të tillë në vlerësimin e afatit të arsyeshëm nga ana e gjykatës duhet të mbahen parasysh kriteret e mësipërme, si dhe kritere të tjera objektive në varësi kjo të rastit që do të paraqitet për shqyrtim para gjykatës.

Nëse nga ana e gjykatës do të arrihet në përfundimin se miratimi nga ana e të përfaqësuarit është dhënë tej një afati të arsyeshëm, atëherë :

Së pari : Personi i tretë do të shmanget nga përbushja e detyrimeve që rrjedhin nga veprimet juridike të kryera me përfaqësuesin pa tagra.

Së dyti : Personit të tretë me mirëbesim i njihet e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar si rrjedhojë e veprimeve të përfaqësuesit pa tagra.

Si përfundim vlerësoj se neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u përcaktuar në mënyrë të qartësishme nga ana e ligjvënësit afati kohor brenda të cilit i përfaqësuari duhet të japë miratimin e tij lidhur me veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra, ose që personit të tretë që është në mirëbesim t'i njihet shprehimisht e drejta për t'i caktuar të përfaqësuarit një afat brenda të cilit ai duhet të vendosë për miratimin ose jo të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Deri në ndonjë riformulim të mundshëm të nenit 78 të Kodit Civil lidhur me caktimin e afatit kohor brenda të cilit i përfaqësuari duhet të japë miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra është gjykata ajo që në rast të ndonjë konflikti të mundshëm lidhur me afatin kohor të dhënies së miratimit nga i përfaqësuari do të vendosë nëse ky miratim është dhënë apo jo brenda një afati të arsyeshëm. Ky afat kohor do të përcaktohet rast pas rasti duke pasur parasysh rrethanat konkrete, mjetet e komunikimit, si dhe kohën e nevojshme që i duhet të përfaqësuarit për të vendosur lidhur me miratimin apo jo të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Përcaktimi i afatit të arsyeshëm do të shërbejë më pas edhe për rregullimin e pasojave të ardhura nga këto marrëdhënie si lidhur me personin e tretë, personin që ka vepruar si përfaqësues pa tagra ashtu edhe lidhur me të përfaqësuarin.

Nëse miratimi është dhënë tej një afati të arsyeshëm atëherë personit të tretë i lind e drejta për të mos përmbushur detyrimet që i rrjedhin nga veprimet juridike të lidhura me përfaqësuesin pa tagra, si dhe ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që mund t'i jetë shkaktuar nga veprimet e personit që ka vepruar si përfaqësues pa tagra.

Nëse miratimi rezulton që të jetë dhënë brenda një afati të arsyeshëm referuar faktit se ky miratim rezulton që të ketë fuqi prapavepruese atëherë si personi i tretë ashtu edhe i përfaqësuari do të duhet të përmbushin përkundrejt njëri – tjetrit të gjitha detyrimet që kanë lindur nga veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra, si dhe personi i tretë nuk mund të pretendojë ekzistencën e ndonjë dëmi të shkaktuar nga veprimet e përfaqësuesit pa tagra.

Situata mund të paraqitet e komplikuar nëse i përfaqësuari mund të miratojë pjesërisht veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra duke refuzuar në këtë mënyrë pjesën tjetër të veprimeve të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Një rast i tillë nuk rezulton që të ketë gjetur rregullim në legjislacionin tonë dhe konkretisht në nenin 78 të Kodit Civil.

Në jo pak raste mund të gjendemi para situatave që nga ana e të përfaqësuarit mund të miratohen pjesërisht veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Për shembull mund të ndodhë që nga ana e të përfaqësuarit të miratohet veprimi i kryer nga ana e përfaqësuesit pa tagra për blerjen e një sasive të caktuar mallrash, por mund të refuzohet sasia dhe çmimi për të cilin këto mallra janë kontraktuar.

Vlerësimi im personal në situata të tilla duke iu referuar për këtë qëllim edhe përmbajtjes së nenit 78 të Kodit Civil është se në parim nuk mund të kemi miratim të pjesshëm apo të

kushtëzuar nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Në një përfundim të tillë arrihet referuar vetë shprehjes së cituar nga ana e ligjvënësit në nenin 78 të Kodit Civil ku përcaktohet shprehimisht se : **“...përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë”**.

Vetë shprehja e sipërcituar e përdorur nga ana e ligjvënësit nënkupton miratim të plotë nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Në rrethana të tillë miratimi i pjesshëm apo i kushtëzuar nga ana e të përfaqësuarit nuk mund të jetë detyrues për personin e tretë kjo për shkak se miratimi i pjesshëm në jo pak raste mund të ketë ndikim thelbësor në vetë përmbajtjen e veprimit juridik të lidhur ndërmjet personit të tretë dhe përfaqësuesit pa tagra dhe se ky miratim i pjesshëm apo i kushtëzuar nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se shfaqje vullneti nga ana e të përfaqësuarit për të ndryshuar veprimin juridik që personi i tretë ka lidhur me përfaqësuesin pa tagra.

Megjithatë në rrethana të caktuara personi i tretë mund të detyrohet për të pranuar një miratim të pjesshëm ose edhe një miratim të kushtëzuar nga ana e të përfaqësuarit në funksion kjo të zvogëlimit të dëmit që mund t'i jetë shkaktuar nga veprimet e personit që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi.

Format e miratimit të veprimeve të përfaqësuesit pa tagra nga ana e të përfaqësuarit.

Sikurse e kemi cituar edhe më lart në pjesën e mësipërme të këtij kreu qëllimi i dispozitës që rregullon përfaqësimin pa tagra dhe konkretisht përcaktimet e nenit 78 të Kodit Civil rezultojnë të jetë mbrojtja e interesave të të përfaqësuarit nga veprimet e kryera nga personat që nuk kanë cilësinë e përfaqësuesit ose kur ky i fundit me apo pa vetëdije i kalon kufijtë apo pushtetet e caktuara në prokurë. Është e qartë se askujt nuk i lejohet të ndërhyjë me anë të veprimeve të tij në sferën juridike të një personi tjetër pa qenë i pajisur me tagrat apo pushtetin e nevojshëm për të bërë një gjë të tillë. Kjo është edhe arsyeja që në kuptim të ligjit veprimet e kryera prej personit që vepron si përfaqësues i një personi tjetër pa e pasur një cilësi të tillë, ose kur i ka kaluar kufijtë e kompetencave të dhëna nga i përfaqësuari nuk sjellin asnjë pasojë në aspektin juridik për të përfaqësuarin. Në rrethana të tilla puna e kryer nga përfaqësuesi pa tagra nuk prodhon asnjë pasojë në sferën juridike të të përfaqësuarit.

Megjithatë referuar përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil rezultojnë që të përfaqësuarit t'i jetë njohur mundësia që të shfaqë vullnetin e tij për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra, duke i dhënë në këtë mënyrë vlerë ligjore veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra. Sikurse do të përshkruhet edhe më poshtë ky miratim ka fuqi prapavepruese (ex tunc) duke i dhënë për këtë qëllim vlerë këtyre veprimeve nga momenti i realizimit të tyre.

Kjo shfaqje vullneti nga ana e të përfaqësuarit për të pranuar veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra në referim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil është

quajtur miratim. Me anë të këtij akti personi në emër dhe për llogari të të cilit është kryer veprimi juridik i jep vlerë ligjore veprimeve juridike të kryera nga një person që nuk e kishte cilësinë e përfaqësuesit.

Miratimi i dhënë nga i përfaqësuari në një rast të tillë nuk përbën gjë tjetër vetëm se një veprim juridik të njëanshëm ashtu sikurse edhe prokura me anë të të cilit i përfaqësuari shfaq vullnetin e tij për pranimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Referuar përmbajtjes së nenit 78 të Kodit Civil nuk rezulton e përcaktuar qartë se kujt i drejtohet miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit, thjesht sikurse është cituar edhe më lart dispozita mjaftohet me shprehjen : “*...përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë*”.

Vlerësimi im personal në një rast të tillë është se si rregull miratimi nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra duhet t'i drejtohet personit të tretë me të cilin është kryer veprimi juridik nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Nuk përjashtohet mundësia që këtë miratim i përfaqësuari t'ia drejtojë edhe personit që ka vepruar si përfaqësues pa tagra në kushtet kur referuar përmbajtjes së nenit 78 të Kodit Civil një gjë e tillë nuk ndalohet, por në një rast të tillë personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra ka detyrimin që miratimin e dhënë nga ana e të përfaqësuarit t'ia njoftojë personit të tretë me të cilin ka kryer veprimin juridik.

Arsyeja për të cilën nga ana e ligjvënësit nuk rezulton që të jetë përcaktuar se kujt duhet t'i drejtohet miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit lidhet edhe me faktin se sikurse do të parashtrohet edhe më poshtë shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra mund të bëhet edhe me veprime konkludente nga të cilat rezulton qartë se i përfaqësuari i ka miratuar veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra. Një rast i tillë do të trajtohet në mënyrë më të hollësishme në pjesën e mëposhtme.

Edhe legjislacioni gjerman sikurse edhe legjislacioni ynë nuk rezulton që të ketë parashikuar se miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra kujt duhet t'i drejtohet. Sipas qëndrimit të mbajtur nga doktrina gjermane e së drejtës si rregull ky miratim duhet t'i drejtohet personit të tretë kjo edhe për faktin se në referim të përcaktimeve të nenit 177/2 të Kodit Civil gjerman një veprim i tillë mund të bëhet i pavlefshëm pasi personi i tretë në ndryshim nga legjislacioni ynë mund të tërhiqet nga kontrata kur miratimi nuk i ka mbërritur akoma këtij të fundit. Kjo është edhe arsyeja pse në doktrinën gjermane mbahet qëndrimi që për të shmangur problematika të tilla miratimi nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra duhet t'i drejtohet drejtpërdrejt personit të tretë me të cilin përfaqësuesi pa tagra ka kryer veprimin juridik.

Sipas opinionit tradicional të shumës së juristëve miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit është konsideruar si një prokurë e mëpasshme, ose një veprim juridik i njëanshëm me anë të të cilit i përfaqësuari i bën të vetat veprimet që ka kryer një person tjetër që nuk e ka pasur cilësinë për ta përfaqësuar ose që i ka kapërcyer kufijtë e tagrave

apo pushteve të dhëna nga i përfaqësuari në prokurën e lëshuar prej këtij të fundit.

Ajo që me të drejtë mund të shtrohet si pyetje dhe që është ndeshur edhe në praktikën gjyqësore shqiptare është fakti nëse miratimi i veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra mund të jepet apo jo nga ana e trashëgimtarëve të të përfaqësuarit nëse ky i fundit rezulton të ketë ndërruar jetë para se të vihej në dijeni të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra, si dhe në rastin e personave juridikë ky miratim mund të jepet apo jo nga personi juridik të cilit i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e personit të mëparshëm juridik kur ky i fundit ka qenë në pozitën e të përfaqësuarit, rast tipik ky në fushën e të drejtës tregtare apo edhe kur personi juridik i përfaqësuar përthithet nga një shoqëri më e madhe.

Në kushtet kur në kuptim të ligjit dhe konkretisht në referim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil nuk rezulton që të ketë ndonjë ndalim ligjor të shprehur, referuar për këtë qëllim edhe faktit se e drejta për miratimin e veprimeve juridike të përfaqësuesit pa tagra nga ana e të përfaqësuarit nuk rezulton të bëjë pjesë në kategorinë e atyre të drejtave me karakter të ngushtë personal arrihet në përfundimin se miratimi i veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra mund të jepet edhe nga ana e trashëgimtarëve të të përfaqësuarit nëse ky i fundit ka vdekur para se të vihet në dijeni të këtyre veprimeve, si edhe nëse është vënë në dijeni nuk rezulton që para vdekjes të ketë shfaqur vullnetin e tij për miratimin ose jo të këtyre veprimeve.

Përfundimi do të ishte i njëjtë edhe për rastin e personave juridikë të përfaqësuar kur të drejtat dhe detyrimet e këtyre të fundit u kanë kaluar personave të tjerë juridikë me kusht që personi juridik i mëparshëm që rezulton të ketë qenë në pozitën e të përfaqësuarit të mos ketë shfaqur më parë vullnetin e tij për miratimin ose jo të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Referuar përmbajtjes së nenit 78 i Kodit Civil nuk rezulton që nga ana e ligjvënësit të jetë përcaktuar qartë se çfarë forme duhet të ketë shfaqja e vullnetit të të përfaqësuarit me anë të të cilës i përfaqësuari i miraton veprimet juridike të kryera nga ana e personit që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur një cilësi të tillë.

Mungesa e parashikimit nga ana e ligjvënësit të ndonjë forme të caktuar me anë të së cilës i përfaqësuari duhet të shfaqë vullnetin e tij për të pranuar veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra të shpie në përfundimin se forma e shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra nuk rezulton që të ketë rëndësi thelbësore.

Në kushtet kur nga ana e ligjvënësit nuk rezulton që të jetë përcaktuar ndonjë formë e caktuar sipas së cilës i përfaqësuari duhet të shfaqë vullnetin e tij për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra arrihet në përfundimin se shfaqja e vullnetit për miratimin e këtyre veprimeve mund të bëhet në të gjitha format e përcaktuara në nenin 80 të Kodit Civil dhe konkretisht : **a)** në mënyrë verbale ; **b)** me shkrim ; **c)** me heshtje dhe **ç)** me veprime konkludente.

Sipas opinionit të disa juristëve në rastet kur përfaqësuesi pa tagra ka kryer një veprim juridik i cili sipas ligjit duhet të kryhet me akt noterial atëherë edhe miratimi i të përfaqësuarit meqenëse konsiderohet si një prokurë e mëpasshme duhet të bëhet me anë të një akti noterial në të kundërt ky miratim nuk ka vlerë juridike. Ky opinion i tyre rezulton që të bazohet në përcaktimet e nenit 72 të Kodit Civil sipas të cilit : *“Çdo prokurë për të lidhur një kontratë, e cila sipas ligjit mund të bëhet vetëm me akt noterial, duhet të përpilohet në këtë formë, përndryshe është e pavlefshme”*.

Në vlerësimin tim opinionin i sipërcituar duhet të konsiderohet i gabuar për arsye se sikurse është parashtruar edhe më lart shfaqja e vullnetit me anë të të cilit i përfaqësuarit miraton veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra përbën një veprim juridik të njëanshëm.

Referuar parashikimeve ligjore dhe konkretisht dispozitave të përcaktuara në Titullin III të Kodit Civil që bëjnë fjalë për veprimet juridike rezulton që kur ligjvënësi vlefshmërinë e një veprimi juridik e ka lidhur me një formë të caktuar e ka përcaktuar shprehimisht në ligj. Në një përfundim të tillë arrihet referuar përmbajtjes së nenit 83 parag 2 të Kodit Civil në të cilin përcaktohet shprehimisht se : *“Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë”*.

Vetë përcaktimi ligjor i sipërcituar të shpie në përfundimin se forma e një veprimi juridik merr rëndësi përcaktuese në vlefshmërinë e tij, kur kjo formë përcaktohet shprehimisht në ligj.

Sikurse kemi parashtruar edhe më lart referuar përmbajtjes së nenit 78 të Kodit Civil nuk rezulton që nga ana e ligjvënësit të jetë përcaktuar ndonjë formë e caktuar për dhënien e miratimit nga ana e të përfaqësuarit lidhur me veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra duke arritur në këtë mënyrë në përfundimin se ky miratim mund të jepet në të gjitha format e shfaqjes së vullnetit të përcaktuara këto në nenin 80 të Kodit Civil.

Parashikimi ligjor i sipërcituar dhe konkretisht parashikimet e nenit 78 të Kodit Civil rezulton që të jenë në përputhje si me parashikimet ligjore të Kodit Civil gjerman ashtu edhe me parashikimet e parimeve europiane të të drejtës kontraktore, si dhe me një sërë legjislacionesh të tjera të vendeve që i përkasin familjes së Civil Law, të cilët nuk kanë parashikuar ndonjë formë të caktuar të shfaqjes së vullnetit të të përfaqësuarit për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Konkretisht referuar nenit 3 : 207 të parimeve europiane të të drejtës kontraktore nuk rezulton që të jetë parashikuar ndonjë formë e caktuar sipas së cilës i përfaqësuarit duhet të shfaqë vullnetin e tij për miratimin e veprimeve të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Edhe referuar komentit që i është bërë dispozitës së sipërcituar në librin me autor Lando and Beale të emërtuar : *“Principle of European Contract Law”* rezulton se këta autorë të kenë përcaktuar se miratimi mund të bëhet edhe me një deklaram të thjeshtë verbal, por

miratimi mund të shprehet edhe me veprime konkludente nga ana e të përfaqësuarit të cilat pa asnjë dyshim shfaqin qëllimin e të përfaqësuarit për të zbatuar atë kontratë të lidhur nga përfaqësuesi⁹¹.

Këta autorë në librin e sipërcituar japin edhe një shembull që është⁹²: Rezulton që në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit A me profesion tregtar është lidhur një kontratë nga përfaqësuesi i tij me një person të tretë me objekt : “*Blerjen e modeleve më të reja të kompjuterave për shumën prej 22.500 euro*”. Përfaqësuesi në fakt kishte tagra për të kryer blerje deri në shumën prej 20.000 euro dhe për këtë fakt personi i tretë nuk kishte dijeni. I përfaqësuarit pasi vihet në dijeni të veprimit të kryer nga përfaqësuesi i dërgon personit të tretë udhëzimet e nevojshme mbi mënyrën se si duhet të dërgoheshin⁹³ pajisjet e blera nga përfaqësuesi.

Sipas autorëve të sipërcituar ky veprim konsiderohet si miratim nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve të kryera nga përfaqësuesi në kapërcim të tagrave që i ishin dhënë këtij të fundit në prokurë.

Edhe sipas këtyre autorëve miratimi nga ana e të përfaqësuarit përveç formës së shkruar mund të bëhet me një deklaram të thjeshtë verbal nga ana e të përfaqësuarit, si dhe ky miratim mund të shprehet edhe me veprime të të përfaqësuarit të cilat pa asnjë dyshim shfaqin qëllimin e të përfaqësuarit për të zbatuar kontratën e lidhur nga përfaqësuesi⁶.

Edhe sipas legjislacionit gjerman që rregullon përfaqësimin pa tagra sikurse edhe në legjislacionin tonë nuk rezulton që të jenë parashikuar kushte të caktuara për dhënien e miratimit nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra. Madje referuar edhe qëndrimit të doktrinës gjermane të së drejtës civile dhe konkretisht referuar qëndrimit të mbajtur nga autorët Larenz and Wolf në Komentarin e Kodit Civil Gjerman⁹⁴, këta të fundit mbajnë qëndrimin se nuk është e nevojshme që miratimi të jetë i qartë.. Sipas këtyre autorëve mjafton që i përfaqësuarit nuk ka kundërshtime me kontratën dhe mjafton që me veprime ose me sjellje të lë të kuptosh se miratimi është dhënë. Sipas doktrinës gjermane ky lloj miratimi konsiderohet si miratim i nënkuptuar.

Miratimi i nënkuptuar përkufizohet si një gjendje e tillë që i përfaqësuarit është në dijeni të mungesës së tagrave të përfaqësuesit, se është dakord me këtë mungesë tagrash dhe se nuk ka kundërshtime ndaj veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Autorët e sipërcituar ndër të tjera shprehen se në jurisprudencën gjermane ka pasur raste në të cilat edhe një sjellje pasive ka qenë e mjaftueshme që të konsiderohej si miratim nga ana e të përfaqësuarit. Në funksion të këtij fakti ata referojnë edhe 1 (një) rast të praktikës gjyqësore gjermane dhe konkretisht rastin Reichsgericht të vitit 1921. Në këtë çështje

⁹¹ Lando and Beale, Principles of European Contract Law. Parts I and II, p. 213

⁹² Ibid., faqe. 213-14

⁹³ Lando and Beale, Principles of European Contract Law. Parts I and II,

⁹⁴ Larenz and Wolf, Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Rechts, § 49, nr. 4 et seq.; Schramm, Münchener Kommentar zum BGB, Komentari i Kodit Civil Gjerman

personi A paraqiti padi kundër personit B duke pretenduar ndaj këtij të fundit një dëm kontraktor të ardhur si pasojë e mospërfundimit të një kontrate furnizimi. Personi B parashtrroi para gjykatës se nuk kishte lidhur asnjë kontratë me personin A pasi personi që kishte nënshkruar në emër dhe për llogari të tij nuk kishte tagra përfaqësimi për të lidhur kontratë furnizimi me personin A. Personi A parashtrroi para gjykatës se pas vënies në dijëni se përfaqësuesi i personit B nuk kishte tagra përfaqësimi kishte zhvilluar një bisedë telefonike me këtë të fundit, si dhe më pas i kishte dërguar edhe një letër duke e vënë në dijëni të kushteve të kontratës së nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të personit B. Personi B pavarësisht se kishte marrë dijëni për letrën e dërguar nga personi A nuk i ishte përgjigjur këtij të fundit.

Gjykata gjermane pas shqyrtimit të rastit të sipërcituar arriti në përfundimin se në fushën tregtare heshtja është e mjaftueshme për të krijuar një miratim referuar për këtë qëllim përcaktimeve të nenit 177 të Kodit Civil gjerman.

Shembulli i sipërcituar shërben edhe për të ilustruar përfundimin e arritur më lart se edhe sipas legjislacionit tonë miratimi nga ana e të përfaqësuarit për veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra mund të jepet edhe me heshtje, si një nga format e shfaqjes së vullnetit sipas përcaktimeve të nenit 80 të Kodit Civil.

Në teorinë e së drejtës civile ekziston mendimi se miratimi nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra ka një fuqi më të madhe se sa dhënia e prokurës sepse me anë të miratimit si veprim juridik i njëanshëm krijohet një marrëdhënie kontraktore ose e thënë ndryshe i jepet vlerë një marrëdhënie kontraktore, ndërsa dhënia e pushteteve që i përfaqësuarit i jep përfaqësuesit me anë të prokurës është vetëm një konditë paraprake e lidhjes së kontratës ose e kryerjes së veprimeve të tjera juridike.

Ky mendim më duket i drejtë sepse deri në momentin miratimit të dhënë nga ana e personit në emër dhe për llogari të të cilit është kryer veprimi juridik, ky i fundit qëndron pezull duke mos sjellë pasojat deri në momentin e dhënies së miratimit nga i përfaqësuarit. Vetëm nga momenti i dhënies së miratimit, i cili siç dihet ka fuqi prapavepruese duke vepruar ex tunc, fillojnë të vijnë dhe pasojat e veprimit juridik të lidhur nga ana e përfaqësuesit pa tagra. Me të drejtë mund të themi se miratimi i të përfaqësuarit i jep jetë veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra, ndërsa tek prokura i përfaqësuarit thjesht e pajis përfaqësuesin me tagra për të kryer veprime juridike të caktuara. Përfaqësuesi duhet të kryejë vetëm veprimet juridike për të cilat është i autorizuar, pra mund të themi se prokura është një kusht paraprak për kryerjen e veprimeve juridike, por ky kusht jo gjithmonë mund të sjellë kryerjen e këtyre veprimeve.

Gjithashtu miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit është i përvokueshëm dhe ka fuqi retrospektive duke sjellë në këtë mënyrë efekte prapavepruese (ex tunc). Pra veprimi juridik i sjell pasojat e tij që nga momenti i kryerjes së tij nga ana e përfaqësuesit pa tagra. E thënë ndryshe nëse i përfaqësuarit jep miratimin e tij për veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra, miratimi i dhënë në një rast të tillë nuk mund të revokohet më nga ana e të përfaqësuarit në ndryshim nga prokura të cilën i përfaqësuarit ka të drejtë ta revokojë atë në çdo moment sipas parashikimeve të nenit 75 të Kodit Civil.

Miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit nuk mund të revokohet as me pëlqimin e personit të tretë me të cilin rezulton që të ketë kryer veprimin juridik përfaqësuesi pa tagra, por kjo nuk i ndalon palët që me marrëveshje ndërmjet tyre të zgjidhin kontratën e lidhur me përfaqësuesin pa tagra, për lidhjen e së cilës i përfaqësuari rezulton të ketë dhënë më vonë miratimin e tij. Kjo shpjegohet me faktin se menjëherë pas dhënies së miratimit veprimi juridik i kryer nga personi që nuk e ka pasur cilësinë e përfaqësuesit ose i ka kapërcyer tagrat apo pushtetet e dhëna me prokurë nga ana e të përfaqësuarit merr fuqi dhe fillon të sjellë pasoja për palët. Nëse veprimi juridik i kryer është kontratë, ajo në referim të përcaktimeve të nenit 650 të Kodit Civil fiton forcën e ligjit për palët. Për rrjedhojë pas dhënies së miratimit kjo kontratë mund të zgjidhet ose të ndryshohet vetëm me pëlqimin e ndërsjelltë të të dyja palëve.

Veçori tjetër e miratimit që nga ana e të përfaqësuarit i bëhet veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra është se sikurse kemi cituar edhe në pjesët e mësipërme ky miratim nuk mund të jetë i pjesshëm, pra i përfaqësuari nuk mund të miratojë vetëm një pjesë të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra, si dhe as nuk mund të kufizojë nëpërmjet miratimit përmbajtjen e veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra. Megjithatë në rast se përfaqësuesi pa tagra ka kryer dy ose më shumë veprime juridike të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me njëra tjetrën, si dhe mos miratimi i ndonjërit prej këtyre veprimeve juridike nuk ndikon në veprimet e tjera atëherë ekziston mundësia që i përfaqësuari të miratojë një ose disa prej këtyre veprimeve juridike. Megjithatë nëse këto veprime juridike nga ana e përfaqësuesit pa tagra janë kryer me të njëjtin person atëherë mundësia e të përfaqësuarit për të miratuar vetëm një ose disa prej këtyre veprimeve kufizohet nëse do të rezultojë se personi i tretë nuk do t'i kishte kryer këto veprime juridike pa njëri – tjetrin. Në një rast të tillë personi i tretë ka të drejtë të pretendojë se jemi para një miratimi të pjesshëm, i cili nuk mund të ketë efekte detyruese ndaj tij si person të tretë.

Në rast konflikti gjyqësor në një rast të tillë personi i tretë duhet të provojë para gjykatës se rezulton të ketë qenë pikërisht ato veprime juridike që nuk janë miratuar nga i përfaqësuari shkaku për lidhjen e veprimeve të tjera juridike me përfaqësuesin pa tagra dhe se si rrjedhojë e mos miratimit të të gjitha veprimeve juridike nga ana e të përfaqësuarit, veprimet juridike të refuzuara do të ndikonin drejtpërdrejt në përmbajtjen e veprimeve juridike të miratuara, si rrjedhojë e zbatimit të të cilave interesat e tij si person i tretë do të çenoheshin rëndë.

Le të marrim një shembull për të ilustruar situatën e mësipërme.

I përfaqësuari A tregtar i lëshon një prokurë personit B me anë të të cilës rezulton t'i ketë dhënë tagra këtij të fundit për të blerë një sasi prej 400 (katërqind) televizorësh të markës SONY me një madhësi 30 inç me një çmim prej 450 (katërqind e pesëdhjetë) Euro secili. Personi i tretë C me të cilin përfaqësuesi B hyn në bisedime për të blerë sasinë e televizorëve të porositur nga ana e të përfaqësuarit A i ofron mundësinë se në rast se përfaqësuesi B do të blinte për secilin prej televizorëve edhe nga një pajisje satelitore me një çmim prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro secila do i ofronte 400 (katërqind) televizorë të markës SONY me një madhësi prej 40 inç me një çmim prej 500 (pesëqind)

Euro për secilin prej tyre. Përfaqësuesi B pranon propozimin e ofruar nga personi i tretë C, si dhe nënshkruan me këtë të fundit edhe kontratat përkatëse për blerjen e sasisë prej 400 (katërqind) televizorësh të markës SONY me madhësi 40 inç me çmimin prej 500 (pesëqind) euro secili, si dhe për blerjen e 400 (katërqind) pajisjeve satelitore me çmimin prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro secila.

I përfaqësuari A pas vënies në dijëni të veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi B jep miratimin e tij vetëm lidhur me kontratën e lidhur nga përfaqësuesi B për blerjen e 400 (katërqind) televizorëve të markës SONY me madhësi 40 inç me çmimin 500 (pesëqind) euro secili, ndërsa lidhur me veprimin tjetër juridik të kryer nga përfaqësuesi B për blerjen e pajisjeve satelitore refuzon të japë miratimin e tij. Këtë miratim të pjesshëm i përfaqësuari A ia njofton drejtpërdrejtë personit të tretë C duke i bërë të ditur këtij të fundit se përfaqësuesi i tij B për kryerjen e veprimeve juridike të mësipërme nuk kishte pasur tagra përfaqësimi duke i vënë në dispozicion për këtë qëllim edhe prokurën që kishte lëshuar për përfaqësuesin B nga përmbajtja e së cilës përcaktohej qartë se përfaqësuesi B nuk kishte pasur tagra përfaqësimi për kryerjen e veprimeve juridike të mësipërme.

Personi i tretë C pas vënies në dijëni të faktit se përfaqësuesi B nuk kishte tagra përfaqësimi për të nënshkruar në emër dhe për llogari të personit A veprimet juridike përkatëse për blerjen e sasisë së televizorëve të markës SONY me madhësi 40 inç, si dhe për blerjen e sasisë së pajisjeve satelitore refuzon të zbatojë detyrimet e tij përkundrejt të përfaqësuarit A për dorëzimin e televizorëve përkundrejt pagesës nga ana e këtij të fundit të çmimit prej 500 (pesëqind) Euro për secilin televizor me pretendimin se miratimi i pjesshëm i dhënë nga ana e të përfaqësuarit A nuk kishte efekte detyruese ndaj tij si person i tretë në kushtet kur veprimet juridike të lidhura nga ana e përfaqësuesit B, si përfaqësues pa tagra ishin të ndërlidhur me njëri – tjetrin dhe se pa kryerjen nga ana e këtij të fundit të veprimit juridik për blerjen e pajisjeve satelitore nuk do të kryhej veprimi juridik për blerjen e sasisë prej 400 (katërqind) televizorësh të markës SONY me madhësi 40 inç me çmimin 500 (pesëqind) Euro secili.

Në funksion të asaj që kemi parashtruar më lart ajo që do të vihet në diskutim në rastin konkret është fakti nëse miratimi i pjesshëm i dhënë nga ana e të përfaqësuarit A ka apo jo efekt detyrues ndaj personit të tretë C që rezulton të ketë qenë në mirëbesim.

Sikurse e kemi cituar edhe më lart miratimet e pjesshme nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra nuk mund të kenë efekt detyrues ndaj personit të tretë që rezulton të kenë qenë në mirëbesim në kryerjen e këtyre veprimeve juridike dhe aq më tepër kur këto veprime juridike janë të ndërlidhur me njëri – tjetrin dhe si rrjedhojë e refuzimit të ndonjërit prej këtyre veprimeve mund të çenohet në tërësi marrëdhënia juridike e lindur ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë që rezulton të ketë qenë në mirëbesim.

Në rastin konkret referuar përshkrimit të fakteve të cituara më lart rezulton që miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit A të jetë miratim i pjesshëm, si dhe që veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit B, i cili rezulton që të ketë vepruar si përfaqësues pa tagra me personin e tretë C të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me njëri – tjetrin në kuptimin që blerja e 400 (katërqind) televizorëve të markës SONY me madhësi 40 inç nga ana e

përfaqësuesit B përkundrejt çmimit prej 500 (pesëqind) Euro për secilin, të jetë kushtëzuar me nënshkrimin nga ana e këtij të fundit të kontratës për blerjen e 400 (katërqind) pajisjeve satelitore me çmimin prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro secila. Pa realizimin e veprimit juridik për blerjen e pajisjeve satelitore përkundrejt çmimit të sipërcituar nuk do të realizohej veprimi tjetër juridik për blerjen e televizorëve.

Në rrethanat e sipërcituara arrihet në përfundimin se miratimi i pjesshëm nga ana e të përfaqësuarit A të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit B, i cili sikurse është cituar edhe më lart rezulton që të ketë vepruar si përfaqësues pa tagra nuk mund të ketë efekte detyruese ndaj personit të tretë C, për shkak se veprimi juridik miratimi i të cilit refuzon të jetë miratuar nga ana e të përfaqësuarit A rezulton që të ketë qenë kusht i domosdoshëm për realizimin e veprimit juridik të miratuar nga ana e këtij të fundit.

Megjithatë një situatë e tillë mund të lërë vend për diskutim në rrethanat kur në referim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil personit të tretë që ka qenë në mirëbesim i është njohur shprehimisht e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar nga ana e përfaqësuesit pa tagra për shkak të mos miratimit të veprimeve të këtij të fundit nga ana e të përfaqësuarit.

Gjithsesi nëse rasti i mësipërm do të ishte pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor në përfundim të të cilit nga ana e gjykatës do të arrihej në përfundimin se miratimin i pjesshëm i dhënë në rastin konkret nga ana e të përfaqësuarit A do të kishte efekt detyrues përkundrejt personit të tretë C që rezulton të ketë qenë në mirëbesim, atëherë ky i fundit do të legjitimohej për t'i kërkuar përfaqësuesit B dëmin që ky i fundit i ka shkaktuar si rezultat i mosmiratimit të veprimit juridik për blerjen e pajisjeve satelitore nga ana e të përfaqësuarit A.

Si përfundim vlerësimi im personal sikurse e kam parashtruar edhe në pjesët e mësipërme të këtij punimi është se neni 78 i Kodit Civil ka nevojë për riformulim në funksion kjo të barazpeshimit të interesave ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë që rezulton të ketë qenë në mirëbesim, referuar për këtë qëllim për të mos kaluar në përsëritje të gjitha shkaqeve që unë kam cituar në pjesën e mësipërme të këtij punimi.

iii.ii.i) Ekzistenca e veprimeve juridike që nuk kanë nevojë për miratim.

Me të drejtë mund të shtrohet si pyetje fakti nëse ka apo jo veprime juridike për të cilat mund të mos jetë e nevojshme dhënia e miratimit nga ana e të përfaqësuarit. Përgjigjia e një pyetje të tillë do të ishte mjaft e diskutueshme për shkak se në praktikë mund të ndeshen raste kur miratimi i të përfaqësuarit e humbet kuptimin e tij. Një qëndrim i tillë mbahet edhe nga doktrina e së drejtës sipas së cilës në raste të caktuara miratimi nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra është i panevojshëm.

Konkretisht referuar Komentarit të Kodit Civil të vitit 1929, botim i Ministrisë së Drejtësisë i vitit 1932 në pjesën që bën fjalë për përfaqësimin pa tagra të emërtuar si : *“përfaqësimi pa pushtete”*, kur flitet për miratimin që i përfaqësuarit i bën veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra thuhet se vetëm në një rast përfaqësuesi pa pushtete mund të kryejë një veprim juridik që ka efekt të pandërmjetëm për të përfaqësuarin, pa

qenë nevoja që ky i fundit ta miratojë këtë veprim dhe ky është ekzekutimi i një detyrimi të të përfaqësuarit⁹⁴.

Rasti i sipërcituar rezulton që të parashikohet edhe në Kodin Civil aktual dhe konkretisht në nenin 460 të tij në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Detyrimi mund të ekzekutohet edhe nga një person i tretë që nuk është debitor...”*.

Në një rast të tillë miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit paraqitet i panevojshëm për shkak se mosdhënia e këtij miratimi nuk e bën të pavlefshëm veprimin juridik të kryer nga personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra duke ekzekutuar për këtë qëllim në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit një detyrim që ky i fundit kishte ndaj personave të tretë. Efektet e këtij veprimi juridik në rastin konkret nuk qëndrojnë të pezulluara deri në miratimin e tij nga ana e të përfaqësuarit.

Le të marrim një shembull për të ilustruar rastin e sipërcituar.

Personi A vihet në dijeni se miku i tij B ishte debitor përkundrejt personit të tretë C në një shumë prej x lekësh, detyrim monetar ky të cilin personi B duhet ta shlyente brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh. Personi A me qëllim për të ndihmuar mikun e tij B që ishte në vështirësi ekonomike ndërmerr veprimet përkatëse duke vepruar në emër dhe për llogari të personit B për shlyerjen e detyrimit që ky i fundit kishte ndaj personit C.

Në një rast të tillë paraqitet e panevojshme që personi B të japë miratimin e tij për veprimin e kryer nga personi A, i cili duke vepruar në emër dhe për llogari të personit B pa qenë i pajisur nga ky i fundit me tagrat përkatëse për të bërë një veprim të tillë rezulton që të ketë vepruar si përfaqësues pa tagra. Në një rast të tillë veprimi i kryer nga personi A i shtrin efektet e tij në mënyrë të menjëhershme pa pasur nevojë për dhënie miratimi nga ana e personit B.

Rast tjetër kur miratimi i dhënë nga ana e të përfaqësuarit nuk paraqitet i nevojshëm që veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi pa tagra të konsiderohet i vlefshëm është edhe rasti kur përfaqësuesi pa tagra bëhet trashëgimtar i të përfaqësuarit. Në një rast të tillë veprimi juridik i kryer nga ana e përfaqësuesit pa tagra bëhet i vlefshëm vetvetiu pa qenë nevoja e miratimit. Në një rast të tillë do të ishte kundër llogjikës që përfaqësuesi pa tagra të jepte miratim për një veprim që e ka kryer ai vetë. Në rastin konkret është e vërtetë që fillimisht veprimi i kryer nga përfaqësuesi pa tagra qëndron pezull deri në dhënien e miratimit nga ana e të përfaqësuarit, por me vdekjen e këtij të fundit ky miratim e humbet vlerën e tij meqenëse efektet e këtij veprimi juridik do të shtrihen drejtpërdrejt mbi personin që ka vepruar si përfaqësues pa tagra në kushtet kur rezulton të jetë trashëgimtar i vetëm i të përfaqësuarit.

Rast tjetër kur dhënia e miratimit nga ana e të përfaqësuarit paraqitet e panevojshme është edhe rasti kur përfaqësuesi pa tagra e vehtëson për vete të drejtën reale ose sendin që ka blerë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit si rezultat i veprimit juridik që ka kryer me një person të tretë. Edhe në këtë rast nuk është e nevojshme që ky veprim të miratohet nga ana e të përfaqësuarit. Pavarësisht se në pamje të parë duket se jemi para një situate

⁹⁴ Referoju për këtë qëllim Komentarin të Kodit Civil të vitit 1929, botim i Ministrisë së Drejtësisë viti 1932.

jo llogjike në kushtet kur përfaqësuesi pa tagra veprimin juridik e kryen në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit dhe se ky veprim fillimisht mbetet pezull deri në dhënien e miratimit nga ana e të përfaqësuarit ekzistojnë kushtet që një situatë e tillë të evitohet për shkak se përfaqësuesi pa tagra mund ta bëjë të vlefshëm këtë veprim juridik për veten e tij. Në një rast të tillë miratimi nuk është i nevojshëm sepse veprimi juridik nuk i shtrin më efektet ndaj të përfaqësuarit por ndaj përfaqësuesit pa tagra.

Le të marrim një shembull për të ilustruar rastin e sipërcituar.

Personi A vihet në dijeni se i afërmi i tij B kishte shfaqur dëshirë për blerjen e një automjeti të markës Toyota. Disa kohë më vonë personit A i paraqitet një rast i leverdisshëm për blerjen e një makine të markës së sipërcituar dhe për këtë shkak vendos ta blejë këtë makinë duke lidhur për këtë qëllim edhe kontratën përkatëse në emër dhe për llogari të B – së me personin e tretë C. Pasi realizimit të këtij veprimi juridik ai vendos që makinën mos t’ia japë të afërmit të tij B por ta mbajë për vete si dhe për këtë shkak paguan edhe çmimin përkatës ndaj personit të tretë C. Në një rast e tillë nuk është e nevojshme që personi B të miratojë veprimin juridik të kryer nga ana e përfaqësuesit A në kushtet kur ky i fundit rezulton t’i ketë përmbushur vetë detyrimet përkundrejt personit të tretë C me qëllim që më pas ky veprim juridik t’i shtrijë efektet e veta juridike ndaj tij si përfaqësues.

iv) Shtrirja e përfaqësimit pa tagra.

Me të drejtë mund të shtrohet si pyetje fakti nëse ka apo jo kufizime lidhur me ushtrimin e përfaqësimit pa tagra, pra nëse një person mund të veprojë si përfaqësues pa tagra vetëm në kryerjen e veprimeve juridike apo edhe në kryerjen e veprimeve të ndryshme përfshirë këtu edhe ato proceduriale para autoriteteve gjyqësore ose atyre administrative.

Situata në një rast të tillë paraqitet e qartë dhe nuk lë vend për diskutim në kushtet kur vetë përcaktimet e nenit 78 të Kodit Civil dispozitë kjo që trajton përfaqësimin pa tagra e referojnë përfaqësimin pa tagra vetëm në kryerjen e veprimeve juridike.

Paraqitja e padisë në emër të një personi tjetër, apo kryerja e veprimeve të tjera proceduriale para autoriteteve gjyqësore dhe atyre administrative nuk bën pjesë në kategorinë e veprimeve juridike dhe për rrjedhojë në raste të tilla nuk mund të jenë të zbatueshme përcaktimet e nenit 78 të Kodit Civil.

Ndalimi i të vepruarit në emër dhe për llogari të një personi tjetër në fushën proceduriale rezulton që të jetë e ndaluar shprehimisht në ligj dhe konkretisht në nenin 90 paragraf 2 të Kodit të Proçedurës Civile në të cilin parashikohet shprehimisht se : ***“Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe”***.

Në një përfundim të tillë arrihet edhe referuar përcaktimeve të nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile, dispozitë kjo e emërtuar : ***“Pajisja me prokurë e përfaqësuesit”***.

Referuar dispozitës së sipërcituar që të mund të jesh përfaqësues i një pale në një proçes gjyqësor civil duhet që detyrimit të jesh i pajisur me prokurë nga ana e personit në emër

dhe për llogari të të cilit po vepron.

I njëjti përfundim vlen edhe për përfaqësimin para organeve të administratës shtetërore.

v) Përgjegjësia e përfaqësuesit pa tagra (falsus procurator).

Në nenin 78 të Kodit Civil ndër të tjera parashikohet shprehimisht se : “...Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi”.

Sikurse kemi cituar edhe më lart veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra nuk kanë efekt detyrues ndaj personit në emër dhe për llogari të të cilit janë kryer këto veprime me përjashtim të rastit kur i përfaqësuarit shfaq vullnetin e tij në një nga format e përcaktuara në nenin 80 të Kodit Civil për miratimin e këtyre veprimeve.

Në funksion të barazpeshimit të interesave ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë që rezulton të ketë qenë në mirëbesim ligjvënësi rezulton që të ketë parashikuar që këtij të fundit i njihet e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit që ai ka pësuar si rezultat i veprimeve juridike të kryera me përfaqësuesin pa tagra, veprime këto për të cilat nuk rezulton që të jetë dhënë miratimi nga ana e të përfaqësuarit.

Arsyeja për të cilën nga ana e ligjvënësit rezulton që të jetë parashikuar se përfaqësuesi pa tagra përgjigjet për dëmet që i janë shkaktuar personit të tretë vetëm në rast se i përfaqësuarit nuk i ka miratuar veprimet e kryera nga përfaqësuesi pa tagra rezulton që të shpjegohet me faktin se si pasojë e efektit prapaveprues të miratimit, personi i tretë si rregull nuk mund të ketë pësuar ndonjë dëm.

Vlerësimi im personal është që parashikimi ligjor i sipërcituar bazuar edhe në parimin në të cilin mbështetet dhe konkretisht në efektin prapaveprues të miratimit paraqet mangësi lidhur me mbrojtjen e të drejtave të personit të tretë që ka qenë në mirëbesim për shkak se nuk përjashtohet mundësia që ky i fundit të pësojë dëme edhe si rrjedhojë e miratimit nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Në funksion të asaj që parashikohet më lart po paraqes një shembull që është tregues i qartë i përfundimit të sipërcituar.

Personi A nënshkruan një kontratë huaje në emër dhe për llogari të personit B pa qenë i pajisur me prokurë nga ky i fundit me personin e tretë C. Personi A me qëllim për të garantuar detyrimin që B kishte përkundrejt personit të tretë C lidh me këtë të fundit edhe një kontratë hipoteke duke vendosur si garanci reale me qëllim për të garantuar përmbushjen e detyrimit të personit B, një pasuri të paluajtshme në pronësi të këtij të fundit.

Para se i përfaqësuarit B të vihej në dijeni të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra A lidh një kontratë huaje me personin D, si dhe me qëllim për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj këtij të fundit lidh edhe një kontratë hipoteke duke vendosur si garanci reale të njëjtën pasuri të paluajtshme që kishte vendosur edhe personi

A. Kjo kontratë hipoteke regjistrohet edhe në regjistrat publikë duke u vendosur e para në radhë sipas parashikimeve të nenit 574 të Kodit Civil.

I përfaqësuari B pasi vihet në dijeni të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra A shfaq vullnetin e tij për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga ky i fundit përfshirë këtu dhe kontratën e hipotekës. Pas dhënies së miratimit nga i përfaqësuari A për veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra B regjistrohet në regjistrat publikë edhe kontrata e hipotekës që përfaqësuesi pa tagra A kishte lidhur në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit B me personin e tretë C, duke u renditur kjo kontratë në referim të përcaktimeve të nenit 574 të Kodit Civil si e dyta në radhë dhe konkretisht pas kontratës së hipotekës që i përfaqësuari B kishte lidhur me personin D.

Si rrjedhojë e mospërbushjes së detyrimeve nga ana e personit B për kthimin e huasë si ndaj kreditorit C ashtu edhe ndaj kreditorit D nga këta të fundit vijnë procedurat për ekzekutimin e detyrimit duke vënë dorë për këtë qëllim mbi pasurinë e paluajtshme që ishte në pronësi të personit B të vendosur si hipotekë.

Si rrjedhojë e shitjes me ankand të pasurisë së paluajtshme të vendosur si hipotekë arrihet të shlyhet vetëm detyrimi që personi B kishte ndaj personit D, si dhe vetëm një pjesë e detyrimit që personi B kishte ndaj personit C për shkak se kontrata e hipotekës e lidhur me personin D në kushtet kur ishte regjistruar e para kishte përparësi ndaj kontratës së hipotekës së lidhur me personin C në referim kjo të përcaktimeve të nenit 574 të Kodit Civil.

Në rrethanat e sipërcituara rezulton që personi i tretë C pavarësisht miratimit nga ana e të përfaqësuarit B të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra A rezulton që nga veprimet e këtij të fundit të ketë pësuar dëm si rrjedhojë e faktit se kontrata e hipotekës pavarësisht se ka datë të mëparshme nga kontrata e hipotekës që i përfaqësuari B kishte lidhur me personin D rezulton të jetë regjistruar më vonë se kjo e fundit. Si rrjedhojë e këtij fakti rezulton që personi C të ketë pësuar humbje për shkak se e drejta e tij mbi të njëjtin send të paluajtshëm që rezulton të jetë lënë si garanci reale nuk është e para në radhë.

Ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje në rastin konkret është fakti nëse personit të tretë C në referim të përcaktimeve të nenit 78 të Kodit Civil i njihet apo jo e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar nga veprimet e përfaqësuesit pa tagra A pavarësisht miratimit të veprimeve të këtij të fundit nga ana e të përfaqësuarit B.

Sikurse e përshkruam edhe më lart referuar mënyrës sipas së cilës është formuluar neni 78 i Kodit Civil çështja nuk lë vend për diskutim për shkak se sikurse kemi cituar edhe më lart në kuptim të kësaj dispozite personit të tretë që ka qenë në mirëbesim i njihet e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi pa tagra vetëm në rastin kur miratimi nuk është dhënë nga ana e të përfaqësuarit.

Kjo dispozitë nuk merr përsipër të rregullojë rastet kur personi i tretë që ka qenë në mirëbesim pëson dëme nga veprimet e përfaqësuesit pa tagra edhe si rrjedhojë e miratimit të këtyre veprimeve nga ana e të përfaqësuarit.

Në Parimet Europiane të të Drejtës Kontraktore dhe konkretisht në nenin 3 : 207(2) në dallim nga legjislacioni ynë dhe konkretisht në dallim nga neni 78 i Kodit Civil rezulton që të jetë parashikuar shprehimisht se : *“Miratimi nuk cënon të drejtat e palëve të tjera”*.

Në referim të kësaj dispozite nëse personi i tretë që është palë në veprimin juridik të lidhur me përfaqësuesin pa tagra pëson ndonjë dëm pavarësisht miratimit nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra, ky i fundit do të jetë përgjegjës për dëmin që ka pësuar personi i tretë.

Si përfundim vlerësoj se neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u shtuar një paragraf në të cilin të përcaktohet shprehimisht se : **“Miratimi nuk cënon të drejtat e palëve të tjera”**, në përputhje kjo edhe me parimet europiane të të drejtës kontraktore.

Ky parashikim i ri ligjor duhet të vendoset edhe në funksion të barazpeshimit të interesave ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë që rezulton të ketë qenë në mirëbesim në kuadër kjo edhe të përshtatjes së legjislacionit tonë me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Sikurse rezulton e përcaktuar shprehimisht në nenin 78 të Kodit Civil parashikimet e kësaj dispozite lidhur me përfitimin e dëmshpërblimit gjejnë zbatim vetëm për personat e tretë që rezulton të kenë qenë në mirëbesim. Në interpretimin e kundërt (al contrario) rezulton që parashikimet e kësaj dispozite nuk gjejnë zbatim në rastet kur personi i tretë me të cilin përfaqësuesi pa tagra ka kryer veprimet juridike nuk rezulton që të ketë qenë në mirëbesim.

Kjo nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se kur rezulton të ndodhemi para këtyre situatave :

a) Personi i tretë ishte në dijeni të mungesës së tagrave ose të kapërcimit të tagrave të dhëna në prokurë nga ana e personit që po vepronte si përfaqësues.

b) Personi i tretë nuk kishte si të mos ishte në dijeni të mungesës së tagrave nga ana e përfaqësuesit ose se ky i fundit po vepronte në kapërcim të tagrave që i ishin dhënë nga ana e të përfaqësuarit.

Parashikimi ligjor i sipërcituar dhe konkretisht parashikimet e nenit 78 të Kodit Civil sipas të cilit e drejta për të përfituar shpërblimin e dëmit të ardhur si pasojë e mos miratimit nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra i përket vetëm personit të tretë që është në mirëbesim rezulton që të jenë në përputhje, si me parashikimet ligjore të Kodit Civil gjerman, atij italian, ashtu edhe me parashikimet e parimeve europiane të të drejtës kontraktore, si dhe me një sërë legjislacionesh të tjera të vendeve që i përkasin familjes së Civil Law.

Edhe sipas legjislacioneve të sipërcituar personit të tretë i cili ishte në dijeni të mungesës së tagrave ose nuk kishte si të mos ishte në dijeni të mungesës së tagrave nuk i njihet e drejta për të përfituar shpërblim dëmi nga përfaqësuesi pa tagra.

Përcaktimi i qënies apo jo të personit të tretë në mirëbesim në mjaft raste mund të paraqitet shumë e diskutueshme, gjithsesi ajo që vlen për tu theksuar është fakti se në përcaktimin e pozitës së personit të tretë nëse ky i fundit ka qenë apo jo në mirëbesim duhet të aplikohet doktrina e besueshmërisë së përfaqësuesit pa tagra e cila synon të mbrojë dyshimet e arsyeshme të personit të tretë. Kjo nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se personi i tretë duhet të ketë besuar në vlefshmërinë e veprimit juridik që ai ka kryer me

përfaqësuesin pa tagra. Në shumë raste kjo besueshmëri mund të jetë edhe rrjedhojë e marrëdhënieve juridike të mëparshme të personit të tretë me të përfaqësuarin, në të cilat ky i fundit është përfaqësuar nga i njëjti përfaqësues.

Në doktrinë mbahet qëndrimi se besueshmëria e përfaqësuesit pa tagra është e bazuar në dhënien e garancisë së tagrave nga ana e këtij të fundit duke paraqitur për këtë qëllim një akt ligjor⁹⁵.

Sipas të drejtës civile hollandeze që personi i tretë të konsiderohet në mirëbesim është e nevojshme që ky i fundit të ketë krijuar një bindje mbi ekzistencën e mjaftueshme të tagrave nga ana e përfaqësuesit për të kryer veprimin juridik përkatës në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Referuar sistemit belg dhe francez të së drejtës në vlerësimin e mirëbesimit të personit të tretë dhe konkretisht në përcaktimin e besimit të krijuar te personi i tretë se përfaqësuesi kishte tagra përfaqësimi për të kryer veprimin juridik ata marrin në konsideratë edhe statusin social të personit të tretë, shkollimin dhe punësimin e personit të tretë, detaje që lidhen me tipin e personalitetit që përfshihen në punësimin e personit të tretë. Kështu në doktrinën franceze mbahet qëndrimi se ata që nuk janë profesionistë e kanë më të lehtë të justifikojnë bindjen e tyre se sa ata që janë profesionistë.

Referuar parimeve të të drejtës ndërkombëtare tregtare UNIDROIT 2004⁹⁶ në vlerësimin e faktit nëse personi i tretë ka qenë në mirëbesim i vetmi kusht është që ky i fundit të ketë besuar mbi baza të arsyes së shëndoshë që përfaqësuesi ka pasur tagra.

Në doktrinë nuk gjejmë ndonjë dallim të qartë ndërmjet rasteve në të cilat personi i tretë e dinte që përfaqësuesi nuk ka pasur tagra përfaqësimi dhe rasteve kur personi i tretë dyshon që përfaqësuesi po vepron pa tagra përfaqësimi, si dhe ka dështuar për të vërtetuar këtë dyshim si rezultat i një sjelljeje jo të arsyeshme.

Megjithatë legjislacioni civil hollandez paraqitet më i qartë në drejtim të përcaktimit të asaj që duhet të konsiderohet si sjellje e arsyeshme nga ana e personit të tretë dhe që si pasojë e mungesës së kësaj sjelljeje personi i tretë nuk konsiderohet të jetë në mirëbesim. Ky legjislacion referon këto raste të cilat janë tregues i sjelljes jo të arsyeshme nga ana e personit të tretë dhe konkretisht :

a) Rasti i parë është kur përfundimi i tagrave të përfaqësuesit është njoftuar publikisht nga ana e të përfaqësuarit, por personi i tretë si rrjedhojë e një sjelljeje jo të kujdesshme nuk e ka vënë re këtë njoftim publik mbi përfundimin e tagrave të përfaqësuesit.

b) Rasti i dytë është kur ka ndodhur vdekja e të përfaqësuarit dhe se ky fakt është bërë i ditur edhe publikisht në shumë media për shkak se i përfaqësuari është një person i njohur. Edhe në një rast të tillë personi i tretë nuk rezulton të ketë treguar kujdesin e

⁹⁵ Ibid., faqe. 208.

⁹⁶ Rome: International Institute for the Unification of Private Law, 2004. Teksti i plotë shoqëruar me komentarin: www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2004/integralversionprinciples2004-e.pdf. UNIDROIT Agency Convention D. Busch, Indirect Representation in European Contract Law (The Hague: Kluwer Law International, 2005), faqe 95-175.

duhur lidhur me marrjen dijëni të faktit se tagrat e përfaqësuesit rezultojn të kenë përfunduar si rrjedhojë e vdekjes së të përfaqësuarit.

c) Rasti i tretë është kur përfaqësuesi tagrat e përfaqësimit i bazon në marrëdhënien e punës që ka me të përfaqësuarin dhe se përfundimi i kësaj marrëdhënie pune rezultojn që të jetë bërë e ditur në mënyrë publike, si dhe rezultojn t'i jetë bërë e ditur edhe personit të tretë.

ç) Rasti i katërt është kur personi i tretë në kryerjen e veprimit juridik me përfaqësuesin pa tagra është mbështetur ekskluzivisht vetëm në pohimin e përfaqësuesit se ka tagra përfaqësimi pa bërë as përpjekjet minimale për të verifikuar një pohim të tillë.

Është pikërisht standarti i sjelljes së personit të tretë ai që do të jetë përcaktues në arritjen e përfundimit nëse ky i fundit duhet të konsiderohet që ka qenë në mirëbesim apo jo. Natyrisht që ky standart sjelljeje nuk mund të jetë i njëjtë për të gjithë personat. Në përcaktimin e këtij standarti krahas faktorëve objektivë duhet të vlerësohen edhe faktorë të tjerë që sikurse përshkruhet edhe nga doktrina franceze e së drejtës lidhen me statusin social të personit të tretë, nivelin arsimor të këtij të fundit, personalitetin e tij dhe llojin e punës që ai kryen.

Nuk mund të kemi vlerësim të njëjtë të rrethanave në rastet kur veprimi juridik kryhet ndërmjet një personi të tretë që nuk ka njohuri në fushën ligjore me atë që ka njohuritë përkatëse në këtë fushë dhe që për rrjedhojë duhet të tregonte të gjithë kujdesin e nevojshëm në vërtetimin e dyshimeve të tij se përfaqësuesi nuk kishte tagra përfaqësimi, ose se po vepronte në kapërcim të tagrave të dhëna nga i përfaqësuarit.

Gjithsesi vlerësimi im personal është se në çdo rast do të jenë rrethanat konkrete ato që do të përcaktojnë nëse personi i tretë ka pasur një përshtypje të krijuar apo jo lidhur me ekzistencën e tagrave nga ana e përfaqësuesit për të kryer veprimin juridik, ose se ky i fundit po vepronte apo jo brenda tagrave të caktuara në prokurë nga ana e të përfaqësuarit, shoqëruar kjo edhe me një analizë të sjelljes që duhet të tregonte personi i tretë në rastin konkret duke iu referuar për këtë qëllim edhe kriterëve të sipërcituara. Në varësi të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik dhe sjelljes së personit të tretë do të përcaktohet nëse arsyeja dhe besimi i krijuar te personi i tretë ishin apo jo të tilla që të shoqëroheshin edhe me detyrimin e këtij të fundit për të hetuar nëse përfaqësuesi kishte apo jo tagra përfaqësimi, si dhe nëse i kishte apo jo të mjaftueshme këto tagra për të kryer edhe veprimin juridik përkatës.

Ajo çfarë vlen për tu theksuar është fakti se përcaktimin e ekzistencës së mirëbesimit tek personi i tretë nuk duhet ta bazojmë në kriterë formale, mosrespektimi i të cilave të na shpjerë apriori në përfundimin se mirëbesimi nuk ekziston dhe për rrjedhojë personi i tretë të mos legjitimohet të kërkojë shpërblimin e dëmit nga personi që ka vepruar si përfaqësues pa tagra. Në përcaktimin e ekzistencës ose jo të mirëbesimit të personit të tretë që ka kryer veprimin juridik me përfaqësuesin pa tagra duhet të bazohemi në kriterë objektivë duke vlerësuar rrethanat në të cilat ka vepruar ky person dhe standartin të sjelljes që ai duhet të tregonte në rastin konkret.

Në rast se nga vlerësimi objektiv i rrethanave në të cilat ka vepruar personi i tretë do na rezultojë se te ky i fundit është krijuar bindja se personi me të cilin po kryen veprimin juridik është përfaqësues i palës në emër dhe për llogari të të cilit po kryen veprimin

juridik pavarësisht faktit se nuk ishte i pajisur me prokurë për të kryer këtë veprim juridik dhe se nuk kishte arsye të besonte se ky veprim juridik nuk do të miratohej më pas nga pala tjetër do të konsiderohet se ky person ka vepruar në mirëbesim dhe në rast të mos miratimit të veprimit juridik nga i përfaqësuari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi pa tagra.

Në rastet e konflikteve gjyqësore ndërmjet personit të tretë dhe përfaqësuesit pa tagra në të cilat nga ana e personit të tretë do të pretendohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar si rrjedhojë e mos dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit të veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra barrën e provës për të provuar ekzistencën e mirëbesimit në kryerjen e këtyre veprimeve do e ketë gjithmonë personi i tretë. Është pikërisht ky i fundit ai që duhet të provojë para gjykatës se nuk ishte në dijeni të mungesës së tagrave ose të kapërcimit të tagrave nga ana e përfaqësuesit dhe se nuk kishte si të mos ishte në dijeni të mungesës së tagrave nga ana e përfaqësuesit ose se ky i fundit po vepronte në kapërcim të tagrave të dhëna nga i përfaqësuari.

Referuar përmbajtjes së nenit 78 të Kodit Civil rezulton që ligjvënësi ta ketë lënë në diskrecion të gjykatës vlerësimin e faktit nëse personi i tretë duhet të konsiderohet që ka qenë në mirëbesim apo jo. Sikurse kemi parashtruar edhe më lart vlerësimi i mirëbesimit nga ana e gjykatës nuk duhet të bëhet duke u bazuar në kritere formale për shkak se këto të fundit shpesh herë mund të bëhen pengesë për zbulimin e së vërtetës objektive. Ajo që duhet marrë në analizë nga ana e gjykatës është qëndrimi efektiv që personi i tretë ka mbajtur ose që kishte mundësi të mbante në raport me personin që ka vepruar si përfaqësues pa e pasur këtë cilësi me qëllim që të arrijë në një përfundim sa më të drejtë lidhur me faktin nëse personi i tretë rezulton të ketë qenë apo jo në mirëbesim, kusht ky i domosdoshëm për tu përfituar shpërblimi i dëmit nga ana e këtij të fundit.

Parashikim ligjor i sipërcituar rezulton që të jetë në përputhje me parashikimet ligjore të Kodit Civil gjerman, italian, hollandez, me parashikimet e parimeve europiane të të drejtës kontraktore, ashtu edhe me parashikimet e parimeve të të drejtës ndërkombëtare tregtare (UNIDROIT), si dhe me një sërë legjislacioneesh të tjera të vendeve që i përkasin familjes së Civil Law.

Edhe sipas legjislacioneve të sipërcituara përcaktimi i mirëbesimit të personit të tretë rezulton të jetë lënë në diskrecion të gjykatës, duke ja besuar në këtë mënyrë kësaj të fundit hapësirën e përcaktimit të mirëbesimit të personit të tretë.

Ajo çfarë vlen për tu theksuar është se në këtë lloj gjykimi nuk është e domosdoshme që të jetë i pranishëm ekzistenca e qëllimit të keq të përfaqësuesit pa tagra. Nuk ka nevojë që të jetë e domosdoshme që përfaqësuesi pa tagra të ketë vepruar me faj. Edhe në ato raste kur përfaqësuesi nuk ka ditur dhe as nuk ka pasur mundësinë të dinte se nuk kishte tagra apo se këto tagra ishin të pamjaftueshme përsëri do të jetë përgjegjës përkundrejt personit të tretë.

Si rregull përfaqësuesi pa tagra do të përgjigjet ndaj personit të tretë edhe kur veprimet juridike me këtë të fundit i ka kryer nisur nga qëllimi i mirë për të mbrojtur si interesat e

të përfaqësuarit ashtu edhe interesat e personit të tretë, kjo për shkak se përfaqësuesi ka detyrimin për të pasur tagra të vlefshme dhe njëkohësisht për të provuar ekzistencën e tyre⁹⁷.

Ajo që vlen për tu diskutuar është fakti nëse përfaqësuesi pa tagra duhet të përjashtohet apo jo nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit nëse provon para gjykatës, se miratimi nuk është dhënë nga ana e të përfaqësuarit për shkak se ky i fundit ka rënë në paaftësi paguese dhe rezulton që të ketë qenë pikërisht kjo paaftësi paguese shkak për caktues i mos dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit për veprimet juridike të kryera nga ana e tij si përfaqësues pa tagra.

Legjislacioni ynë lidhur me një fakt të tillë nuk rezulton që të ketë ndonjë parashikim ligjor, sikurse e kemi përshkruar edhe më lart thjesht mjaftohet me shprehjen : **“Kur miratimi nuk është dhënë...”**, duke bërë në këtë mënyrë thjesht një parashikim të përgjithshëm, sipas të cilit do të rezultonte që përfaqësuesi të jetë përgjegjës përkundrejt personit të tretë edhe në rastin kur mungesa e dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit të jetë rrjedhojë e rënies në paaftësi paguese të këtij të fundit.

Edhe në doktrinën tonë të së drejtës nuk gjejmë ndonjë trajtim teorik të situatës së sipërcituar, si edhe rastet e praktikës gjyqësore lidhur me një rast të tillë mungojnë.

Edhe legjislacionet e cituara më lart ashtu sikurse legjislacioni ynë bëjnë një parashikim të përgjithshëm duke përcaktuar se mungesa e miratimit nga i përfaqësuari përbën shkak që personi i tretë që ka qenë në mirëbesim të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi.

Autorët e së drejtës Lando and Beale në librin e emërtuar : *“Principle of European Contract Law”* në komentin që i kanë bërë nenit 3 : 204 (2) të parimeve europiane të të drejtës kontraktore, dispozitë kjo në të cilën trajtohet përgjegjësia e përfaqësuesit pa tagra kanë përcaktuar ndër të tjera se ky i fundit përjashtohet nga përgjegjësia përkundrejt personit të tretë kur ai provon se mungesa e miratimit nga ana e të përfaqësuarit ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së aftësisë paguese të këtij të fundit.

Përfundimi i sipërcituar rezulton të jetë rrjedhojë e interpretimit të dispozitës së sipërcituar jo mbi bazën e kritereve formale të përcaktuara në këtë dispozitë, por rrjedhojë e interpretimit të saj në funksion të qëllimit për të cilin është vendosur. Në rastin konkret mungesa e shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për miratimin e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra rezulton që të jetë e kushtëzuar nga rrethana të cilat nuk lidhen me vullnetin e të përfaqësuarit, pa të cilat ky i fundit në mënyrë të padyshimtë do ta kishte shfaqur vullnetin për miratimin e veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra.

Referuar doktrinës gjermane dhe konkretisht referuar Komentarit të Kodit Civil Gjerman nuk rezulton që situata e përshkruar më lart të jetë konsideruar si rast përjashtimi nga

⁹⁷ Schramm, Münchener Kommentar zum BGB, Kommentar i Kodit Civil Gjerman neni 179, nr. 20

përgjegjësia të përfaqësuesi pa tagra⁹⁸.

Sipas doktrinës gjermane të së drejtës ekzistojnë vetëm 2 (dy) përjashtime nga ngarkimi me përgjegjësi të përfaqësuesit pa tagra dhe këto janë :

a) kur personi i tretë kishte dijeni, ose nga tërësia e kushteve dhe rrethanave nuk mund të mos kishte dijeni për mungesën e tagrave të përfaqësuesit ose për kapërcimin nga ana e këtij të fundit të tagrave të dhëna nga ana e të përfaqësuarit ;

b) kur personi që ka vepruar si përfaqësues nuk ka pasur zotësi për të vepruar dhe për rrjedhojë në rrethana të tilla, ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për shkak se nuk është në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimeve që kryen

Vlerësimi im personal në rastin konkret është i ndryshëm nga përfundimi i arritur nga autorët e sipërcituar për arsye se referuar mënyrës sipas së cilës është formuluar neni 78 i Kodit Civil bartës i riskut për të vuajtur pasojat e mos dhënies së miratimit nga i përfaqësuarit edhe në rastet kur mungesa e dhënies së miratimit është kushtëzuar nga rrethana të cilat nuk lidhen me vullnetin e të përfaqësuarit, pa të cilat ky i fundit në mënyrë të padyshimtë do ta kishte shfaqur vullnetin për miratimin e veprimeve të kryera nga përfaqësuesi pa tagra është ky i fundit. Në një përfundim të tillë arrihet edhe referuar faktit se doktrina e përgjegjësive të përfaqësuesit pa tagra ka për qëllim të mbrojë nga pasojat personin e tretë që ka qenë në mirëbesim.

Si përfundim unë vlerësoj se në rast të një situate të tillë mund të ketë vend për kufizimin e përgjegjësive të përfaqësuesit pa tagra, por jo për përjashtimin e tij nga përgjegjësia.

Gjithashtu një rast tjetër që do të merret në diskutim është nëse përfaqësuesi pa tagra duhet të përjashtohet apo jo nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit nëse provon para gjykatës, se nuk ka qenë në dijeni të faktit se nuk kishte tagra përfaqësimi, si dhe nga tërësia e kushteve dhe rrethanave nuk mund të kishte dijeni për mungesën e tagrave të përfaqësimit.

Përgjigjia edhe për rastin e sipërcituar mbetet e njëjtë me situatën e përshkruar më lart për shkak se referuar mënyrës sipas së cilës është formuluar neni 78 i Kodit Civil nuk mund të flitet për përjashtim apo kufizim të përgjegjësive të përfaqësuesit pa tagra kur vërtetohet se personi i tretë ka qenë në mirëbesim.

Në ndryshim nga legjislacioni ynë rezulton që legjislacioni gjerman dhe konkretisht në nenin 179 të Kodit Civil ka parashikuar si rast të kufizimit të përgjegjësive të përfaqësuesit pa tagra kur ky i fundit nuk ka qenë në dijeni se nuk ka tagra përfaqësimi, por kusht i domosdoshëm për të kufizuar përgjegjësinë e këtij të fundit është që përfaqësuesi pa tagra duhet të provojë para gjykatës se në kohën kur është kryer veprimi juridik nuk ka pasur dijeni dhe nga tërësia e kushteve dhe rrethanave nuk mund të kishte dijeni për mungesën e tagrave.

Sipas legjislacionit gjerman në një rast të tillë përgjegjësia e përfaqësuesit pa tagra

⁹⁸ Schramm, Münchener Kommentar zum BGB, Kommentar i Kodit Civil Gjerman neni 179, nr. 22

kufizohet vetëm në pagimin e atyre interesave që ka humbur personi i tretë nga pritja duke menduar se përfaqësuesi kishte tagra përfaqësimi.

Sistemi hollandez në ndryshim nga ai gjerman rastin që kemi paraqitur për diskutim e njeh si rast të përjashtimit të përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra, kur ky i fundit nuk kishte dijeni ose nga tërësia e rrethanave nuk mund të kishte dijeni se nuk kishte tagra përfaqësimi.

Në drejtim të kufizimit të përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra vlerësoj se legjislacioni gjerman paraqitet më i përshtatshëm se legjislacioni ynë për arsye se në dallim nga legjislacioni ynë që nuk bën asnjë diferencim në kuadër të përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra, legjislacioni gjerman e bën një diferencim të tillë duke e kufizuar përgjegjësinë e përfaqësuesit pa tagra përkundrejt personit të tretë kur ai arrin të provojë para gjykatës se në kohën kur është kryer veprimi juridik nuk ka pasur dijeni dhe nga tërësia e kushteve dhe rrethanave nuk mund të kishte dijeni për mungesën e tagrave.

Në të kundërt nga parashikimi i sistemit hollandez vlerësoj se në rastin e sipërcituar nuk ka vend për përjashtimin nga përgjegjësia të përfaqësuesit pa tagra referuar faktit se sikurse kam përshkruar edhe më lart doktrina e përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra ka për qëllim të mbrojë nga pasojat personin e tretë që ka qenë në mirëbesim dhe jo përfaqësuesin pa tagra.

Si përfundim vlerësoj se neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u shtuar një paragraf në të cilin të përcaktohen disa raste përjashtimore të kufizimit të përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra përkundrejt personit të tretë që ka qenë në mirëbesim.

Kusht tjetër për ngarkimin me përgjegjësi të përfaqësuesit pa tagra është edhe fakti se si rezultat i veprimeve të këtij të fundit personi i tretë duhet të ketë pësuar dëm. Ky dëm duhet të ketë ardhur detyrimisht si pasojë e mungesës së tagrave të përfaqësimit.

Ky dëm nuk përbën gjë tjetër vetëm se të ardhurat që personi i tretë do të nxirrte nëse kontrata e lidhur me përfaqësuesin pa tagra do të ishte miratuar nga ana e të përfaqësuarit.

Gjithsesi dëmi duhet të jetë objekt i të provuarit nga ana e personit të tretë që ka qenë në mirëbesim dhe se përfaqësuesi pa tagra do të përgjigjet vetëm për dëmin real që ka pësuar personi i tretë në mirëbesim.

Dëmi i pësuar nga ana e personit të tretë me mirëbesim duhet të jetë i natyrës financiare.

Le të marrim një shembull për të ilustruar situatën e sipërcituar.

Personi A në pozitën e përfaqësuesit pa tagra hyn në marrëdhënie kontraktore me personin e tretë C për t'i shitur këtij të fundit një sasi vaji që i përket të përfaqësuarit B. Gjatë kohës që personi i tretë C ishte në pritje të dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit B, çmimi i vajit pëson rritje. I përfaqësuarit B pasi vihet në dijeni të veprimit

juridik të kryer nga personi A që kishte vepruar në emër dhe për llogari të këtij të fundit pa e pasur cilësinë e përfaqësuesit nuk e miraton veprimin juridik (kontratën e lidhur nga personi A). Personi i tretë C pas refuzimit të dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit B detyrohet të lidhë një kontratë tjetër me personin D për blerjen e sasisë së vajit të përcaktuar në kontratën e lidhur me përfaqësuesin pa tagra A me një çmim më të lartë se ai i përcaktuar në kontratën e lidhur me këtë të fundit.

Ato që do të shtroheshin si pyetje në rastin konkret janë :

- a) nëse personi i tretë C rezulton që të ketë pësuar dëm, si pasojë e mungesës së tagrave nga ana e personit A ;
- b) nëse ka pësuar dëm, si do të përllogaritej ai në rastin konkret.

Referuar rrethanave që kemi parashtruar më lart është qartësisht e provuar se personi C si rezultat i veprimit të kryer me përfaqësuesin pa tagra A të ketë pësuar dëm, si dhe ky dëm rezulton që t'i jetë shkaktuar si pasojë e mungesës së tagrave të përfaqësimit nga personi A.

Dëmi real që rezulton të ketë pësuar personi i tretë C në rastin konkret është se gjatë kohës së pritjes së miratimit nga ana e të përfaqësuarit B të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi pa tagra A, çmimi i vajit rezulton të ketë pësuar rritje.

Në rastin konkret personi C duhet të kompensohet nga personi A me diferencën e çmimit që ai ka paguar më tepër për blerjen e sasisë së vajit që kishte porositur në kontratën e lidhur me përfaqësuesin pa tagra A, veprim juridik ky i cili nuk rezulton që të jetë miratuar nga ana e të përfaqësuarit B.

III.II. Trajtimi i konfliktit të interesit lidhur me institutin e përfaqësimit dhe i pasojave të tij në raport me të përfaqësuarin.

Fenomeni i konfliktit të interesave në kuadrin e disiplinës të veseve të vullnetit të parashikuara në Kodin Civil, i është nënshtruar vazhdimisht një përpunimi teorik të doktrinës së sotme juridike, e cila ka shpallur ekzistencën e dallimit të pasojave që sjell konflikti i interesave i reduktuar në abuzimin e përfaqësimit nga ato që sjell mungesa e përfaqësimit.

Situata e abuzimit të përfaqësuesit me tagrat apo pushtetet që i janë dhënë nga ana e të përfaqësuarit me anë të prokurës së lëshuar prej këtij të fundit, apo si rrjedhojë e qënies përfaqësues për shkak të ligjit rezulton që të ketë gjetur rregullim ligjor në nenin 67 të Kodit Civil, dispozitë kjo në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk çënon interesat e tij”*.

Parashikimi ligjor i sipërcituar rezulton që të jetë në përputhje si me legjislacionin gjerman dhe konkretisht me Kodin Civil Gjerman ashtu edhe me legjislacionin italian dhe konkretisht me Kodin Civil Italian.

Kështu në nenin 181 të Kodit Civil gjerman parashikohet shprehimisht se : *“Një përfaqësues nuk mund të hyjë në një marrëdhënie juridike në emër të të përfaqësuarit, me veten e tij ose si përfaqësues i një pale të tretë, pa e lejuar më parë ose nëse veprimi juridik konsiston në përmbushjen e një detyrimi”*⁹⁹.

Po t’i referohemi Kodit Civil italian në nenin 1395 të tij parashikohet shprehimisht se : *“Është e anullueshme kontrata që përfaqësuesi ka lidhur me veten e tij si përfaqësues i palës tjetër, përveç rastit kur i përfaqësuarit e ka autorizuar ose kur përmbajtja e kontratës është e konceptuar në mënyrë që të përjashtohet mundësia e konfliktit të interesave mes palëve”*¹⁰⁰.

Arsyeja e parashikimit të një ndalimi të tillë nga ana e ligjvënësit lidhet me vetë qëllimin e institutit të përfaqësimit, sipas të cilit përfaqësuesi gjithmonë konsiderohet si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të të përfaqësuarit dhe për rrjedhojë veprimet e tij si përfaqësues në asnjë rast nuk mund të vijnë ndesh me interesat e të përfaqësuarit. Ky qëllim mund të vihet në pikëpyetje në rast të ndeshjes apo përplasjes së interesave të përfaqësuesit me ato të të përfaqësuarit.

Nga kjo arrihet në përfundimin se qëllimi i dispozitës së sipërcituar rezulton të jetë pikërisht evitimi i situatës së konfliktit të interesit ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, kjo në funksion që përfaqësuesi të mos ndodhet në dilemën e mbrojtjes së interesave të veta apo mbrojtjes së interesave të të përfaqësuarit.

Nga sa më sipër mund të themi se parashikimet e nenit 67 të Kodit Civil janë të tilla që të mos lejojnë hapësirë që të ndërhyjnë elementët e vlerësimit subjektiv nga ana e përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, kjo edhe për faktin e thjeshtë se është e vështirë që interesat e përfaqësuesit të përputhen me ato të të përfaqësuarit në fenomenin e konfliktit të interesave nga pikëpamja e këndvështrimit subjektiv. Si rrjedhojë e prezumimit të mos përputhjes së interesave ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit lind edhe konflikti i interesave.

Mos respektimi nga ana e përfaqësuesit i ndalimit ligjor të parashikuar në nenin 67 të Kodit Civil i bën veprimet juridike të kryera prej tij si absolutisht të pavlefshme në kuptim kjo të përcaktimeve të nenit 92 gërma “a” të Kodit Civil.

Sipas Kodit Civil Italian në dallim nga legjislacioni ynë civil veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi me veten e tij konsiderohen të anullueshme pra relativisht të pavlefshme, ndërsa sipas Kodit Civil Gjerman ato sikurse edhe legjislacioni ynë konsiderohen absolutisht të pavlefshme.

Sipas legjislacionit dhe doktrinës gjermane në dallim nga legjislacioni apo doktrina jonë rasti kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me veten e tij ose me persona të përfaqësuar prej tij konsiderohet si një nga rastet kur përfaqësuesi ka vepruar si përfaqësues pa tagra. Kjo është edhe arsyeja që në legjislacionin gjerman dispozita që bën fjalë për konfliktin e interesit përfshihet te dispozitat që trajtojnë përfaqësimin pa

⁹⁹ Neni 181 i Kodit Civil Gjerman

¹⁰⁰ Neni 1395 i Kodit Civil Italian

tagra.

Të trajtuarit e përfaqësuesit që ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit duke kryer për këtë qëllim veprime juridike me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, si përfaqësues pa tagra lë vend për diskutim.

Arsyeja për diskutim lidhet me faktin se edhe në një rast të tillë duket sikur përfaqësuesi veprimet juridike me veten e tij apo me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij i kryen pa pasur tagra për t'i kryer këto veprime. Këtë mungesë tagrash e referon vetë ligji. Për kryerjen e këtyre veprimeve përfaqësuesi duhet të ketë tagër të shprehur nga ana e të përfaqësuarit, në të kundërt konsiderohet se i përfaqësuar nuk ka shfaqur vullnet që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Duke u konsideruar si rast përfaqësimi pa tagra dhënia e vlefshmërisë së këtij veprimi juridik lidhet me vullnetin e të përfaqësuarit, i cili mund ta shfaqë vullnetin e tij për miratimin e veprimeve të kryera nga përfaqësuesi në situatat e mësipërme edhe në një moment të mëvonshëm. Deri në momentin e shfaqjes së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit këto veprime nuk sjellin pasoja ndaj këtij të fundit, si dhe efektet e tyre qëndrojnë pezull nga pikëpamja juridike.

Legjislacioni gjerman në dallim nga legjislacioni ynë vlefshmërinë e këtyre veprimeve e lidh vetëm me vullnetin e të përfaqësuarit, i cili ka të drejtë të mos i miratojë veprimet e kryera nga përfaqësuesi në situatat e mësipërme pavarësisht faktit se nga këto veprime interesat e tij si i përfaqësuar nuk rezultojnë të jenë cënuar.

Sikurse do të trajtohet edhe më poshtë në referim të legjislacionit tone, të përfaqësuarit nuk i njihet e drejta për të kundërshtuar për pavlefshmëri veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij në rast se nga përmbajtja e këtyre veprimeve nuk rezultojnë të jenë cënuar interesat e të përfaqësuarit.

Vlerësimi im personal në një rast të tillë është se zgjidhja e ofruar nga ana e legjislacionit tonë duke e trajtuar konfliktin e interesit përfaqësues/i përfaqësuar jo në kuadër të përfaqësimit pa tagra, por si rast të veçantë paraqitet më e përshtatshme se ajo e parashikuar nga legjislacioni gjerman.

Arsyeja e arritjes në një përfundim të tillë lidhet me vetë qëllimin që ka instituti i përfaqësimit, sipas të cilit përfaqësuesi gjithmonë konsiderohet si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të të përfaqësuarit dhe për rrjedhojë veprimet e tij si përfaqësues në asnjë rast nuk mund të vijnë ndesh me interesat e të përfaqësuarit. Në rast se vërtetohet se nga veprimet që përfaqësuesi ka kryer me veten e tij apo me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij interesat e të përfaqësuarit nuk janë cënuar pra kemi një përputhje të interesave do të ishte e paarsyeshme që të konsideruarit e këtyre veprimeve si të vlefshme apo jo të lidhej pazgjidhshmërisht vetëm me dhënien e miratimit nga ana e të përfaqësuarit.

Sipas parashikimeve të nenit 67 të Kodit Civil një ndër rastet e konfliktit të interesave është kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me veten e tij duke nënshkruar në këtë mënyrë dy herë, një herë për llogari të tij dhe një herë në emër dhe për llogari të të

përfaqësuarit.

Le të marrim një shembull për të ilustruar situatën e sipërcituar.

Personi A lëshon një prokurë të posaçme për personin B duke e caktuar këtë të fundit si përfaqësues për shitjen e një apartamenti që i përfaqësuarit A kishte në pronësi të tij. Në prokurën që i përfaqësuarit A i ka lëshuar përfaqësuesit B rezulton t'i ketë përcaktuar këtë të fundit edhe çmimin me të cilin ky apartament do të shitej. Meqenëse përfaqësuesi B kishte nevojë për shtëpi duke shfrytëzuar mundësinë e dhënë e kryen veprimin juridik të shitjes së apartamentit që ishte në pronësi të të përfaqësuarit A me veten e tij si përfaqësues me çmimin që i përfaqësuarit A kishte përcaktuar në prokurën e lëshuar prej tij.

Në rastin konkret rezulton që përfaqësuesi B të ketë nënshkruar dy herë në veprimin juridik të sipërcituar dhe konkretisht nga njëra anë ai ka nënshkruar si përfaqësues i personit A në cilësinë e shitësit dhe nga ana tjetër ka nënshkruar për veten e tij si blerës.

Në situatën e sipërcituar ajo që me të vërtetë do të shtrohet si pyetje është që për ta konsideruar këtë veprim juridik si absolutisht të pavlefshëm do të ishte e mjaftueshme vetëm gjendja objektive e konfliktit të interesave apo do të duhet të hetohet edhe ndonjë element tjetër ?

Referuar parashikimeve të nenit 67 të Kodit Civil në pamje të parë duket sikur është e mjaftueshme gjendja objektive e konfliktit të interesave për ta konsideruar veprimin juridik të kryer në një situatë të tillë si absolutisht të pavlefshëm, kjo edhe për shkak të ekzistencës së prezumimit se në rast të përplasjes së interesave të të përfaqësuarit me ato të përfaqësuesit, përparësi për këtë të fundit do të kishin interesat e tij dhe jo ato të të përfaqësuarit.

Sikurse kemi përshkruar edhe më lart kjo rezulton që të ketë qenë edhe arsyeja e parashikimit të një dispozite të tillë nga ana e ligjvënësit. Megjithatë referuar përmbajtjes së nenit 67 të Kodit Civil nuk duket që e mjaftueshme për ta konsideruar këtë veprim juridik si absolutisht të pavlefshëm të jetë vetëm gjendja objektive e konfliktit të interesit, pra që të jetë e mjaftueshme që përfaqësuesi ta ketë kryer veprimin juridik me veten e tij.

Në një përfundim të tillë arrihet referuar vetë përmbajtjes së nenit 67 të Kodit Civil në të cilin ndër të tjera parashikohet : *“... ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk çënon interesat e tij”*.

Referuar parashikimit ligjor të sipërcituar rezulton që nga ana e ligjvënësit të jetë parashikuar mundësia që veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi me veten e tij të mund t'i nënshtrohet verifikimit gjyqësor me qëllim për të arritur më pas në përfundimin nëse nga ky veprim juridik që përfaqësuesi ka kryer me veten e tij janë çënuar apo jo interesat e të përfaqësuarit.

Nga parashikimi ligjor i sipërcituar rrjedh përfundimi që për ta konsideruar veprimin juridik që përfaqësuesi ka lidhur me veten e tij si absolutisht të pavlefshëm nuk është e mjaftueshme vetëm gjendja objektive e konfliktit të interesit, por duhet detyrimisht që

nga ky veprim të jenë cënuar interesat e të përfaqësuarit.

Në rastin konkret që kemi marrë si shembull nuk rezulton që interesat e të përfaqësuarit A të jenë cënuar referuar faktit se apartamenti rezulton të jetë shitur përkundrejt të njëjtit çmim që ky i fundit i ka përcaktuar përfaqësuesit B në prokurën që i ka lëshuar këtij të fundit.

Në rrethanat e sipërcituara do të arrihet në përfundimin se veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi B me veten e tij nuk duhet të konsiderohet si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, në kushtet kur nga ky veprim juridik nuk rezulton që të jenë cënuar interesat e të përfaqësuarit. Në këtë rast gjendemi në situatën e përputhshmërisë së interesave të përfaqësuesit me ato të të përfaqësuarit.

Në jetën e përditshme mund të gjendemi edhe para situatave të cilat mund të jenë shumë të diskutueshme lidhur me faktin nëse interesat e të përfaqësuarit janë cënuar apo jo si rezultat i veprimeve që përfaqësuesi ka kryer me veten e tij.

Në raste të tilla çdo paqartësi që mund të rezultojë nga rrethanat në të cilat është kryer veprimi juridik, si dhe nëse kjo paqartësi nuk do të jetë e mundur të sqarohet duke e bërë në këtë mënyrë rastin shumë të diskutueshëm, mendimi im është se situata të tilla duhet të vlerësohen në favor të të përfaqësuarit dhe jo në favor të përfaqësuesit, në kushtet kur në referim të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil përparësi në situatat kur përfaqësuesi ka kryer veprime me veten e tij marrin gjithmonë interesat e të përfaqësuarit dhe jo interesat e përfaqësuesit. Në një përfundim të tillë arrihet referuar ndalimit të përcaktuar shprehimisht në ligj se përfaqësuesi nuk duhet të kryejë veprime juridike me veten e tij.

Gjithsesi në çdo rast vlerësimi i cënimit apo jo të interesave të të përfaqësuarit do të duhet të bazohet në kritere objektive dhe jo subjektive

Le të marrim një shembull për të ilustruar situatën e sipërcituar.

Personi A lëshon një prokurë të posaçme për personin B duke e caktuar këtë të fundit si përfaqësues për shitjen e një apartamenti që i përfaqësuarit A kishte në pronësi të tij. Në prokurën që i përfaqësuarit A i ka lëshuar përfaqësuesit B rezulton t'i ketë përcaktuar këtij të fundit edhe se apartamenti duhet të shitej me një çmim jo më të ulët se 40.000 (dyzetë mijë) Euro. Meqenëse përfaqësuesi B kishte nevojë për shtëpi duke shfrytëzuar mundësinë e dhënë e kryen veprimin juridik të shitjes së apartamentit që ishte në pronësi të të përfaqësuarit A me veten e tij si përfaqësues, duke vendosur si çmim shitjeje shumë prej 40.000 (dyzetë mijë) Euro.

Personi A pasi vihet në dijeni të veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi B e kundërshton gjyqësisht këtë veprim me pretendimin se ky i fundit kishte vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe se nga ky veprim atij si i përfaqësuar i ishin cënuar interesat.

Ajo që do të merret në shqyrtim në rastin konkret është nëse veprimi juridik që përfaqësuesi B rezulton që të ketë kryer me veten e tij duhet të konsiderohet apo jo i

pavlefshëm në referim kjo të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil.

Sikurse e parashtruar edhe më lart kushtet kumulative të cilat e bëjnë veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm në referim të dispozitës së sipërcituar janë : **a)** gjendja objektive e konfliktit të interesit dhe **b)** nga veprimi juridik i kryer të jenë çënuar interesat e të përfaqësuarit.

Në rastin konkret kushti i parë rezulton që të plotësohet për shkak se përfaqësuesi B rezulton që ta ketë kryer veprimin juridik me veten e tij në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit 67 të Kodit Civil, si dhe kryerja e këtij veprimi nuk rezulton që të jetë lejuar shprehimisht nga ana e të përfaqësuarit në prokurën e lëshuar prej këtij të fundit.

Lidhur me kushtin e dytë situata rezulton që të paraqitet mjaft e diskutueshme referuar faktit se ky veprim juridik rezulton që të jetë kryer nga ana e përfaqësuesit duke vendosur si çmim në kontratë vlerën minimale të përcaktuar nga vetë i përfaqësuari në prokurën e lëshuar prej këtij të fundit.

Në funksion të verifikimit të faktit nëse nga ana e përfaqësuesit B me veprimin juridik që ky i fundit ka kryer me veten e tij janë çënuar apo jo interesat e të përfaqësuarit A, do të ishte e domosdoshme që të hetohej nëse çmimi i përcaktuar në kontratë përfaqëson apo jo vlerën reale të apartamentit që ishte në pronësi të të përfaqësuarit A.

Një hetim i tillë do të konsistonte në : **Së pari** : Në verifikimin e çmimeve të shitjes së pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodhet apartamenti në pronësi të të përfaqësuarit A dhe **Së dyti** : Në verifikimin e kërkesës për blerje të pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodhet apartamenti që është në pronësi të të përfaqësuarit A.

Nëse nga hetimi i kryer do të rezultojë se çmimi i përcaktuar në kontratë ka qenë më i ulët se çmimet e shitjes së pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodhet apartamenti në pronësi të të përfaqësuarit A dhe se kërkesa për blerje të pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodhet apartamenti në pronësi të të përfaqësuarit A në kohën kur është kryer veprimi juridik të ketë qenë e lartë, atëherë veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi B me veten e tij në referim të nenit 67 të Kodit Civil duhet të konstatohet si i pavlefshëm, pavarësisht se në kontratë si çmim shitjeje rezulton që të jetë vendosur vlera minimale e përcaktuar në prokurë nga i përfaqësuari A. Në të kundërt pra nëse do të rezultojë se çmimi i vendosur në kontratë të ketë qenë më i lartë ose në përputhje me çmimet e shitjes së pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodhet apartamenti në pronësi të të përfaqësuarit A pavarësisht kërkesave që mund të kishte për pasuri të paluajtshme në zonën ku ndodhet ky apartament atëherë pavarësisht se përfaqësuesi B këtë veprim juridik rezulton që ta ketë kryer me veten e tij, ky veprim duhet të konsiderohet i vlefshëm në kushtet kur nga kryerja e këtij veprimi juridik nuk rezulton që të jenë çënuar interesat e të përfaqësuarit A.

Sipas parashikimeve të nenit 67 të Kodit Civil rast tjetër i konfliktit të interesave është edhe kur përfaqësuesi e kryen veprimin juridik me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Në situata të caktuara mund të ndodhë që një person i caktuar të jetë në pozitën e përfaqësuesit të dy ose më shumë personave, duke u gjendur në mënyrë të njëkohshme si

mbrojtës dhe mbajtës i interesave të këtyre të fundit.

Nga ana e ligjvënësit të ndaluarit e të kryerit të veprimeve juridike nga ana e përfaqësuesit me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij rezulton që të jetë konsideruar si konflikt interesi referuar faktit se ai paraqitet si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të të dyja palëve në kontratë dhe duke qenë i tillë ai mund të përdorë pushtetin apo tagrat që i janë dhënë nga njëra palë në funksion të realizimit të interesave të palës tjetër dhe anasjelltas. Në këtë rast kemi të bëjmë me konkurrencë të interesave ndërmjet të përfaqësuarve gjë e cila mund të sjellë si pasojë sakrifikimin e interesave të njërit prej të përfaqësuarve përkundrejt interesave të të përfaqësuarit tjetër.

Pikërisht me qëllim për të evituar përplasjen e interesave ndërmjet të përfaqësuarve nga ana e ligjvënësit rezulton që të jetë parë e arsyeshme ndalimi i kryerjes së veprimeve juridike ndërmjet tyre gjithmonë kur ato përfaqësohen nga i njëjti person.

Për efekt krahasimor legjislacioni italian paraqitet më i paqartë se legjislacioni ynë lidhur me përcaktimin si rast të konfliktit të interesit rastin kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij. Kështu po t'i referohemi neneve neneve 1394 dhe 1395 të Kodit Civil Italian, dispozita këto në të cilat përshkruhen rastet kur përfaqësuesi konsiderohet se ka vepruar në konflikt interesi nuk parashikohet shprehimisht si një rast i tillë kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij. Megjithatë referuar trajtimeve doktrinale të autorëve italianë të së drejtës dhe konkretisht profesorit Francesco Galgano në librin e tij e Drejta Private, ky i fundit referon si një ndër rastet kur përfaqësuesi konsiderohet se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesi edhe rastin kur ai ka kryer veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij¹⁰¹.

Le të marrim një shembull për të ilustruar situatën e sipërcituar.

Personi A rezulton që me prokurë të posaçme të ketë caktuar si përfaqësues të tij personin C të cilit rezulton t'i ketë dhënë tagra për blerjen e një autoveture. Në të njëjtën kohë personi B rezulton të ketë caktuar si përfaqësues të tij me prokurë të posaçme po personin C të cilit rezulton t'i ketë dhënë tagra për shitjen e një autoveture që ai si i përfaqësuar kishte në pronësi të tij.

Në një rast të tillë interesi i të përfaqësuarit A është që përfaqësuesi i tij C t'i blejë një autoveturë shumë të mirë me çmimin më të lirë të mundshëm, ndërsa interesi i të përfaqësuarit B është që përfaqësuesi i tij C ta shesë autoveturën me çmimin më të lartë të mundshëm. Në një rast të tillë interesi i të përfaqësuarit A ndodhet në konkurrencë me interesin e të përfaqësuarit B dhe në rast se përfaqësuesi C do të realizojë interesin e të përfaqësuarit A duke blerë për këtë qëllim në emër dhe për llogari të këtij të fundit autoveturën më lirë nga çmimi real i saj dhe anasjelltas do ta shesë më shtrenjtë se çmimi real i saj në këtë rast realizimi i interesit të të përfaqësuarit A do të sjellë sakrifikimin apo cënimin e interesit të të përfaqësuarit B dhe anasjelltas realizimi i interesit të të përfaqësuarit B do të sjellë si pasojë sakrifikimin apo cënimin e interesit të të përfaqësuarit A.

¹⁰¹ Diritto Privato (E drejta Private) me autor Francesco Galgano, fq 310 – 311.

Në rast të realizimit të kontratës së shitjes ndërmjet të përfaqësuarve A dhe B të cilët do të përfaqësoheshin në kryerjen e veprimit juridik nga i njëjti përfaqësues C do të ndodheshin para një situatë objektive të ekzistencës së konfliktit të interesit dhe do të përbënte shkak në vetvete që secili prej të përfaqësuarve të kërkonte pavlefshmërinë e veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi i tyre C. Për të evidentuar një fakt të tillë e mjaftueshme do të ishte vetëm paraqitja e kontratës përkatëse të shitjes në të cilën përfaqësuesi C rezulton të ketë nënshkruar edhe në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit A, si edhe në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit B.

Sikurse kemi përshkruar edhe gjatë analizës së rastit kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me veten e tij edhe në rastin kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij për të arritur në përfundimin se veprimi juridik duhet të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm nuk është e mjaftueshme vetëm gjendja objektive e konfliktit të interesit, pra që përfaqësuesi ta ketë kryer veprimin juridik në ndalim të parashikimeve të nenit 67 të Kodit Civil. Edhe në rastin kur përfaqësuesi kryen veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij duhet detyrimisht që interesi i ndonjërit prej tyre të jetë çenuar, në të kundërt pra nëse interesi i asnjërit prej të përfaqësuarve nuk është çenuar ky veprim juridik nuk mund të konsiderohet i pavlefshëm.

Përcaktimi i cënimit të interesit të ndonjërit prej të përfaqësuarve do të jetë objekt hetimi dhe verifikimi nga ana e gjykatës, nëse nga ndonjë prej të përfaqësuarve do të kundërshtohet veprimi juridik që rezulton të ketë kryer përfaqësuesi i tyre. Në çdo rast hetimi gjyqësor do të duhet të bazohet vetëm në kritere objektive duke shmangur vlerësimin subjektiv të situatës në të cilën rezulton të jetë kryer veprimi juridik i kundërshtuar për pavlefshmëri.

Edhe në raste të tilla çdo paqartësi që mund të rezultojë nga rrethanat në të cilat është kryer veprimi juridik, si dhe nëse kjo paqartësi nuk do të jetë e mundur të sqarohet duke e bërë në këtë mënyrë rastin shumë të diskutueshëm mendimi im është se situata të tilla duhet të vlerësohen në favor të të përfaqësuarit që ka kundërshtuar veprimin juridik referuar për këtë qëllim prezumimit se veprimi juridik i kryer nga përfaqësuesi është bërë për të favorizuar interesat e ndonjërit prej të përfaqësuarve. Në një përfundim të tillë arrihet referuar ndalimit të përcaktuar shprehimisht në ligj se përfaqësuesi nuk duhet të kryejë veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Sikurse është përcaktuar shprehimisht në nenin 67 të Kodit Civil rregulli i përgjithshëm është që përfaqësuesi nuk ka të drejtë të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Ligjvënësi rezulton që të ketë parashikuar përjashtimin e zbatimit të këtij rregulli të përgjithshëm kur është lejuar shprehimisht nga ana e të përfaqësuarit që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Arsyeja e një përjashtimi të tillë shpjegohet me faktin se rregulli i përgjithshëm i parashikuar nga ligjvënësi duhet të konsiderohet si një garanci e njohur shprehimisht nga ligji në funksion të mbrojtjes së interesave të të përfaqësuarit, duke e lënë në këtë mënyrë në zgjedhjen e këtij të fundit që me anë të një deklarimi të shprehur të shfaqë vullnetin që

ky rregull të mos zbatohet.

Në jetën e përditshme mund të gjendemi para situatave kur pavarësisht se nga ana e të përfaqësuarit është lejuar shprehimisht kryerja e veprimeve juridike të përfaqësuesit me veten e tij, ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, si dhe në referim të këtij lejimi të shprehur nga ana e përfaqësuesit janë kryer këto veprime juridike nga përmbajtja e të cilave do të rezultonte se interesat e të përfaqësuarit janë cënuar me të drejtë do të shtrohej pyetja nëse ky i fundit në referim të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil do të mund t'i kundërshtonte gjyqësisht për pavlefshmëri këto veprime juridike apo jo?

Mënyra sipas së cilës rezulton që të jetë formuluar neni 67 i Kodit Civil do e bënte situatën e sipërcituar mjaft të diskutueshme referuar faktit se kryerja e këtyre veprimeve juridike është lejuar shprehimisht nga ana e të përfaqësuarit.

Referuar doktrinës së të drejtës rezulton që të ekzistojnë dy mendime lidhur me vlefshmërinë e veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi në kushtet e konfliktit të interesit, por që kryerja e këtyre veprimeve rezulton që të jetë lejuar shprehimisht nga i përfaqësuari.

Mendimi i parë është që në rastet kur i përfaqësuari e ka lejuar shprehimisht që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, atëherë ky lejim i dhënë i legjitimon veprimet e kryera nga përfaqësuesi dhe se veprimet e kryera nga ky i fundit nuk konsiderohet se janë kryer në dëm të të përfaqësuarit. Si rrjedhojë i përfaqësuari nuk mund t'i kundërshtojë gjyqësisht këto veprime juridike për shkak se ky i fundit edhe pse e ka parashikuar konfliktin e interesit e ka lejuar përfaqësuesin që t'i kryejë këto veprime juridike.

Mendimi i dytë është që veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij pavarësisht se përfaqësuesi është lejuar nga i përfaqësuari për kryerjen e këtyre veprimeve do të konsiderohen si veprime juridike absolutisht të pavlefshme në kuptim kjo të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil nëse do të rezultojë që nga kryerja e këtyre veprimeve janë cënuar interesat e të përfaqësuarit.

Vlerësimi im personal është që mendimi i dytë rezulton të jetë në përputhje me vetë parimet në të cilat bazohet instituti i përfaqësimit, si dhe në përputhje edhe me detyrimin kryesor që ka përfaqësuesi përkundrejt të përfaqësuarit kur e pranon detyrën e caktuar prej këtij të fundit.

Sikurse e kemi përshkruar edhe në pjesët e mësipërme të këtij punimi një ndër parimet bazë apo siç njihen ndryshe si parimet themelore të së drejtës që gjen zbatim në institutin e përfaqësimit është parimi i mirëbesimit.

Vetë marrëdhënia ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit ndërtohet mbi bazën e parimit të mirëbesimit, sipas të cilit i përfaqësuari mbrojtjen dhe mbajtjen e interesave të tij ia beson një personi tjetër fizik apo juridik, i njohur ligjërisht si përfaqësues, i cili ka si detyrim kryesor të tij mbrojtjen e interesave të të përfaqësuarit. Mos respektimi i këtij detyrimi nga ana e përfaqësuesit i bën veprimet e këtij të fundit të cënueshme në kuptim të ligjit.

Cënimi i parimit të sipërcituar nga ana e përfaqësuesit, si dhe mos përmbushja e detyrimit që ky i fundit ka përkundrejt të përfaqësuarit detyrimisht do t'i reflektojë efektet e veta në

veprimet juridike që ka kryer përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Referuar përmbajtjes së nenit 67 të Kodit Civil lejimi i shprehur nga e të përfaqësuarit që përfaqësuesi mund të kryejë veprime juridike me veten e tij dhe persona të tjerë të përfaqësuar prej tij duhet të kuptohet dhe interpretohet në funksion të parimit të mirëbesimit mbi bazën e të cilit ndërtohet marrëdhënia ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit dhe konkretisht mbi bazën e besimit të mirë që ekziston tek i përfaqësuarit se nga ana e përfaqësuesit do të mbrohen më së miri interesat e tij si i përfaqësuar.

Në situatën e shtruar për diskutim vlerësimi im personal është që pavarësisht se nga ana e të përfaqësuarit mund të jetë lejuar shprehimisht që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të përfaqësuar prej tij, nëse nga këto veprime të lejuara nga i përfaqësuarit do të rezultojë që interesat e këtij të fundit janë çenuar, në interpretim të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil këto veprime juridike duhet të konsiderohen si absolutisht të pavlefshme nga ana e gjykatës.

Si përfundim : Në funksion të qartësimit të situatës të paraqitur si shembull pavarësisht opinionit dhe argumenteve të dhëna në funksion të këtij opinioni nga ana ime si realizues i këtij punimi vlerësoj se neni 67 i Kodit Civil ka vend për ndryshim duke shtuar pas fjalisë : *“përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht”* edhe fjalët : *“me kusht që nga kryerja e këtyre veprimeve interesat e të përfaqësuarit nuk duhet të çënohen”*.

Vendosja edhe e fjalëve të sipërcituara do të evitonte çdo paqartësi të mundshme që mund të krijohet në rastet kur i përfaqësuarit e ka lejuar shprehimisht që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Në kuadër të trajtimit të fenomenit të konfliktit të interesit ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit do të paraqesim si shembuj 3 (tre) raste të cilat mund të hasen shpesh në jetën e përditshme dhe si të tilla vlerësoj se e meritojnë tu kushtohet vëmendja e duhur si për efekt studimor, ashtu edhe në funksion të evidentimit të faktit nëse neni 67 i Kodit Civil paraqet apo jo mangësi si dispozitë.

Rasti i parë : Kur përfaqësuesi e kryen veprimin juridik jo me veten e tij por me bashkëshortin apo bashkëshorten e tij. Pra rasti kur si palë në veprimin juridik nga njëra anë rezulton bashkëshorti apo bashkëshortja e përfaqësuesit dhe nga ana tjetër i përfaqësuarit në emër dhe për llogari të të cilit nënshkruan përfaqësuesi bashkëshort apo bashkëshorte, si dhe nga veprimi juridik i kryer në një rast të tillë rezulton që interesat e të përfaqësuarit të jenë çenuar.

Rasti i dytë : Kur përfaqësuesi veprimin juridik nuk e kryen me veten e tij por me persona me të cilët ka lidhje të afërt gjinie apo krushqie, ose me persona me të cilët ka lidhje të ngushta miqësore, si dhe nga veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi në situatat e sipërcituara rezulton që interesat e të përfaqësuarit të jenë çenuar.

Rasti i tretë : Kur persona të të njëjtës familje ose në lidhje gjinie apo krushqie të afërt ndërmjet tyre mund të jenë përfaqësues të personave të ndryshëm dhe duke qenë të tillë mund të kryejnë veprime juridike ndërmjet të përfaqësuarve prej tyre duke nënshkruar për këtë qëllim në veprimet juridike përkatëse në emër dhe për llogari të personave që ato përfaqësojnë. Si pasojë e këtyre veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesit rezulton

që interesat e ndonjërit prej të përfaqësuarve janë cënuar.

Në rastet e referuara më lart me të drejtë do të shtrohej pyetja nëse këta përfaqësues konsiderohet të kenë vepruar apo jo në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nëse në rastet e evidentuara më lart a do ishte e mundur që i përfaqësuari t'i kundërshtonte për pavlefshmëri këto veprime juridike, në referim kjo të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil apo do të duhej që zgjidhjen e këtyre rasteve ta referonte në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të parashikuar nga Kodi Civil.

Referuar përmbajtjes së nenit 67 të Kodit Civil rezulton që kjo dispozitë të ketë parashikuar si raste të konfliktit të interesit vetëm : **a)** kur përfaqësuesi e kryen veprimin juridik me veten e tij dhe **b)** kur përfaqësuesi kryen veprimin juridik me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij

Referuar mënyrës sipas së cilës është formuluar kjo dispozitë është më se e qartë se rastet e përcaktuara në këtë të fundit sipas të cilave përfaqësuesi konsiderohet se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe që gjejnë mbrojtje ligjore nga dispozita e sipërcituar të kenë natyrë shteruese, duke mos lënë në këtë mënyrë vend për interpretim rastesh apo situatash të tjera që mund të mbrohen në referim të saj si dispozitë.

Në të tre rastet e referuara rezulton që nga veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesve të jenë cënuar interesat e të përfaqësuarit. Konkretisht në të tre rastet e referuara rezulton që përfaqësuesi të ketë përdorur pushtetin apo tagrat që i janë dhënë nga ana e të përfaqësuarit në funksion të realizimit të interesave të tij dhe të palës tjetër duke e favorizuar këtë të fundit në veprimet juridike të kryera nga ai si përfaqësues në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit pikërisht për shkak të lidhjes së afërt që ka me personat me të cilët ai ka kryer këto veprime juridike.

Vlerësimi im personal është që të tre rastet e referuara duhet të konsiderohen si raste në të cilat përfaqësuesi ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe si rrjedhojë veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesit edhe në këto raste plotësojnë kushtet për tu kundërshtuar gjyqësisht për pavlefshmëri.

Legjislacioni Italian në dallim nga legjislacioni ynë paraqitet më i qartë dhe më i plotë në drejtim të evidentimit të konfliktit të interesit duke bërë një parashikim më të përgjithshëm se legjislacioni ynë. Kështu në nenin 1394 të Kodit Civil Italian parashikohet shprehimisht se : *“Kontrata e lidhur nga përfaqësuesi mund të anulohet me kërkesën e të përfaqësuarit kur ekzistojnë konflikte interesash mes tyre nëse konflikti i interesave ishte i njohur nga pala e tretë”*¹⁰².

Me anë të këtij parashikimi të përgjithshëm legjislacioni italian rezulton që ta ketë lënë të hapur mundësinë e evidentimit edhe të rasteve të tjera kur përfaqësuesi ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit duke cënuar me veprimet e tij drejtpërdrejt interesat e të përfaqësuarit dhe jo në mënyrë shteruese sikurse legjislacioni ynë.

Në rastet e referuara pavarësisht evidentimit të faktit se përfaqësuesi ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit duke abuzuar për këtë qëllim me tagrat dhe pushtetet që i

¹⁰² Neni 1394 i Kodit Civil Italian

ka caktuar i përfaqësuar me qëllim favorizimin drejtpërdrejt apo indirekt të interesave të veta apo të personave të tjerë referuar mënyrës sipas së cilës është formuluar neni 67 i Kodit Civil i përfaqësuar nuk do të mund t'i mbronte interesat e tij me anë të kundërshtimit për pavlefshmëri të këtyre veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi. Përjashtim mund të bënte vetëm rasti i parë i referuar gjithmonë nëse do të vërtetohet se bashkëshortët janë nën regjimin e bashkësisë ligjore.

Qëndrimi lidhur me rastin e parë :

Përsa i përket rastit të parë sikurse e kemi përshkruar edhe më lart neni 67 i Kodit Civil ka për qëllim të mos lejojë që përfaqësuesi si rrjedhojë e pushtetit apo tagrave të dhëna nga i përfaqësuar të abuzojë me këto tagra apo pushtete duke favorizuar për këtë qëllim interesat e tij apo të të përfaqësuarve prej tij në raport kjo me interesat e të përfaqësuarit.

Në rastet kur bashkëshortët nuk kanë zgjedhur regjimin e pasurive të ndara por regjimin e bashkësisë ligjore rezulton që secili prej bashkëshortëve për efekt të ligjit, pra si rrjedhojë e zbatimit të përfaqësimit ligjor të jetë edhe përfaqësues i bashkëshortit tjetër. Në rrethana të tilla në rastet kur përfaqësuesi e kryen veprimin juridik me bashkëshortin e tij rezulton të jetë evident prezumimi se përfaqësuesi si rrjedhojë e kryerjes së veprimeve juridike me bashkëshortin mund të abuzojë me tagrat apo pushtetet që i ka dhënë i përfaqësuar në funksion kjo të favorizimit të interesave të tij pasurore në raport me interesat pasurore të të përfaqësuarit, për shkak se nga veprimi juridik i kryer rezulton që të jetë edhe ai përfitues.

Pavarësisht se në pamje të parë duket që përfaqësuesi nuk e ka kryer veprimin juridik me veten e tij, pra nga pikëpamja formale si palë në veprimin juridik të kryer nga njëra anë kemi të përfaqësuarin në emër dhe për llogari të të cilit nënshkruan përfaqësuesi ndërsa nga ana tjetër si palë paraqitet bashkëshorti i përfaqësuesit, ky i fundit në veprimin juridik të kryer si rrjedhojë e regjimit të bashkësisë ligjore që ka me përfaqësuesin për efekt të ligjit përfaqëson edhe interesat e këtij të fundit duke u paraqitur në këtë mënyrë në kuptim të ligjit si përfaqësues ligjor i këtij të fundit. Për rrjedhojë rezulton që përfaqësuesi të jetë përfitues i drejtpërdrejtë nga veprimi juridik që kryen bashkëshorti i tij.

Në referim të shkaqeve dhe arsyeve të referuara më lart qëndrimi im personal lidhur me rastin e parë është se në këtë rast janë të pranishme rrethanat e parashikuara në nenin 67 të Kodit Civil.

Në përfundimin e sipërcituar arrihet si rrjedhojë e interpretimit logjik dhe jo mekanik të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil.

Qëndrimi lidhur me rastin e dytë dhe të tretë :

Lidhur me dy rastet e tjera vlerësoj se i përfaqësuar pretendimet e tij për pavlefshmëri të veprimeve juridike të kryera nga përfaqësuesi në kushtet kur neni 67 i Kodit Civil referuar mënyrës se si është formuluar paraqet në mënyrë të cunguar rastet kur përfaqësuesi konsiderohet se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit do të duhej t'i bazonte pretendimet e tij për pavlefshmëri në përcaktimet e nenit 102 të Kodit Civil, dispozitë kjo në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Veprimi juridik i kryer në dëm të*

të përfaqësuarit për shkak marrëveshjeje me keqbesim midis përfaqësuesit dhe personit të tretë, mund të shpallet i pavlefshëm për të përfaqësuarin”.

Në rastet e referuara, si dhe në raste të tjera kur nuk provohet ndonjë lidhje gjinie, krushqie apo miqësie ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë nëse gjatë gjykimit do të vërtetohet se nga veprimi juridik i kryer ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë interesat e të përfaqësuarit janë cënuar atëherë do të prezumohet se cënimi i këtyre interesave ka ardhur si rrjedhojë i një marrëveshjeje me keqbesim ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë. Në raste të tilla vlerësimi im personal është që barra e provës për të provuar para gjykatës që nuk ka pasur marrëveshje me keqbesim duhet të rëndojë mbi përfaqësuesin dhe personin e tretë. Janë këto të fundit që duhet të provojnë para gjykatës mungesën e marrëveshjes ndërmjet tyre. Në rast se do të provohet mungesa e marrëveshjes ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit atëherë mbi përfaqësuesin duhet të rëndojë detyrimi për t'i shpërblyer të përfaqësuarit dëmin që i ka shkaktuar.

Në kuadër të trajtimit të fenomenit të konfliktit të interesit ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit po paraqesim një situatë e cila në kuadër të itensifikimit të marrëdhënieve juridike mund të ndeshet shpesh në jetën e përditshme dhe si e tillë vlerësoj se e meriton t'i kushtohet vëmendja e duhur si për efekt studimor, ashtu edhe në funksion të evidentimit të faktit nëse neni 67 i Kodit Civil paraqet apo jo mangësi si dispozitë.

Situata që paraqitet :

Personi A rezulton të ketë lidhur një kontratë porosie me personin B sipas së cilës ky i fundit merrte përsipër që të kryente veprime juridike në emër të tij, por për llogari të personit A. Në vijim të veprimtarisë së tij personi B rezulton që të lidhë një kontratë porosie me personin C përfaqësues i të cilit ishte vetë personi B.

Në referim të asaj që parashtruar më lart ajo që me të vërtetë do të shtrohej si pyetje është fakti nëse personi B rezulton të ketë vepruar apo jo në kushtet e konfliktit të interesit dhe në rast se po a jemi në rastin konkret para ndonjërit prej rasteve të parashikuara nga neni 67 i Kodit Civil ?

Në rastin e marrë për shqyrtim rezulton që palë në këtë veprim juridik të kemi nga njëra anë personin B i cili e kryen këtë veprim juridik në emrin e tij, por për llogari të personit A dhe nga ana tjetër kemi personin C, i cili përfaqësohet nga përfaqësuesi i tij dhe konkretisht po nga personi B. Pra në një rast të tillë rezulton që personi B të ketë nënshkruar dy herë dhe konkretisht një herë si i porositur dhe një herë si përfaqësues duke u paraqitur në këtë mënyrë në një funksion të dyfishtë për arsye se :

Së pari : paraqitet si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të porositësit A, sepse pavarësisht nga fakti se në veprimin juridik të kryer ai del vetë si palë, një veprim të tillë rezulton që ta ketë kryer për llogari të porositësit A.

Së dyti : paraqitet edhe si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të të përfaqësuarit C duke nënshkruar për këtë qëllim në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

Edhe në rastin e referuar më lart rezulton se interesi i porositësit A të ndodhet në konkurrencë me interesin e të përfaqësuarit C, kjo për faktin se interesat e tyre realizohen

nga i njëjti person që paraqitet në dy pozicione të ndryshme, nga njëra anë si i porositur dhe nga ana tjetër si përfaqësues. Natyrisht që realizimi i interesave të njërit do të sillte si pasojë sakrifikimin e interesave të tjetrit. Një fakt i tillë të shpie në përfundimin se edhe në rastin e referuar ndodhemi para një konflikti interesash. Nëse ky konflikt është i evitueshëm për porositësin sepse nëse ky i fundit konstaton se i porosituri e ka kryer veprimin juridik në kundërshtim me interesat e tij si porositës ka të drejtë që të mos marrë përsipër detyrimet që i rrjedhin nga kontrata e porosisë e lidhur nga i porosituri, ndërsa përsa i përket të përfaqësuarit ky i fundit ka të drejtë të kërkojë që veprimi i kryer nga përfaqësuesi i tij të konstatohet si i pavlefshëm në referim kjo të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil nëse do të konstatohet se nga ky veprim juridik interesat e tij si i përfaqësuar rezulton të jenë cënuar.

Si përfundim konstatohet se personi B të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në referim kjo të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil dhe për rrjedhojë në rast të ndonjë situatë të tillë i përfaqësuari do të mund t'i mbronte interesat e tij përkundrejt përfaqësuesit duke u bazuar në përcaktimet e dispozitës së sipërcituar.

Me të drejtë do të shtrohej si pyetje se para cilit prej rasteve të referuara nga neni 67 i Kodit Civil jemi në rastin konkret, pra do të konsiderohet që përfaqësuesi B veprimin juridik e ka kryer me veten e tij apo me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij ?

Në rastin e referuar sikurse e përshkruam edhe më lart rezulton që si palë në veprimin juridik të kryer nga përfaqësuesi B të paraqiten nga njëra anë ky i fundit që vepron për llogari të porositësit A, si dhe personi C në emër dhe për llogari të të cilit nënshkruan përfaqësuesi i tij B.

Në pamje të parë duket sikur në rastin konkret ndodhemi para rastit të parë të parashikuar nga neni 67 i Kodit Civil sipas të cilit nuk është e lejueshme që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij, por ajo që e bën të diskutueshme situatën është fakti se përfaqësuesi B me anë të veprimit juridik të kryer nuk ka për qëllim realizimin e interesave të tij por realizimin e interesave të porositësit A, karakteristikë kjo e kontratës së porosisë sipas së cilës i porosituri gjithmonë vepron për llogari të porositësit me qëllim realizimin e interesave të këtij të fundit duke u paraqitur për këtë qëllim në pozitën e një ndërmjetësi përkundrejt porositësit dhe personit të tretë me të cilin kontraktin dhe që në rastin konkret rezulton të jetë i përfaqësuar i tij. Në rrethanat e sipërcituara do ishte e vështirë të themi se jemi para rastit të parë të parashikuar nga neni 67 i Kodit Civil sepse sipas këtij rasti përfaqësuesi sakrifikon interesat e të përfaqësuarit në funksion të realizimit të interesave të tij.

Sipas rastit të dytë të referuar si ndalim nga neni 67 i Kodit Civil përfaqësuesi nuk duhet të kryejë veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij duke e lidhur këtë ndalim me rastin konkret rezulton që përsëri situata të paraqitet mjaft e diskutueshme për shkak se sipas rastit të dytë palë në veprimin juridik rezultojnë persona të ndryshëm që përfaqësohen nga i njëjti

person dhe se ekziston mundësia që ky i fundit të sakrifikojë interesat e njërit prej të përfaqësuarve me qëllim realizimin e interesave të të përfaqësuarit tjetër. Në situatën e paraqitur për shqyrtim nga pikëpamja formale nuk rezulton që të jenë të pranishme rrethanat e sipërcituara për shkak se palë nuk rezulton të jenë dy persona të ndryshëm nga përfaqësuesi, por nga pikëpamja faktike situata rezulton që të paraqitet sipas përcaktimeve të ndalimit të parashikuar në rastin e dytë në kushtet kur personi B në funksion të realizimit të interesave të porositësit A të sakrifikojë interesat e të përfaqësuarit C.

Si përfundim lidhur me shembullin e paraqitur për shqyrtim me të drejtë konstatohet se:

Së pari : Në aspektin formal rezulton që të jemi para rastit të parë të parashikuar nga neni 67 i Kodit Civil.

Së dyti : Në aspektin faktik rezulton që të jemi para rastit të dytë të parashikuar nga neni 67 i Kodit Civil.

Vlerësimi im personal lidhur me situatën e referuar është që nëse i përfaqësuari do të konstatojë se përfaqësuesi i tij ka vepruar si porositës duke kryer për këtë qëllim veprime juridike me veten e tij, si rrjedhojë e të cilave mund të konstatohet një cenim i interesave të të përfaqësuarit, ky i fundit mund t'i kundërshtojë për pavlefshmëri këto veprime juridike në referim të rastit të parë të parashikuar nga neni 67 i Kodit Civil dhe jo në referim të rastit të dytë për shkak se nga veprimi juridik i kryer përfaqësuesi nuk ka për qëllim të realizojë vetëm interesat e porositësit por edhe interesat e tij si i porositur në funksion të përfitimit të shpërblimit përkatës nga ana e porositësit në kushtet kur në referim të përcaktimeve të nenit 920 të Kodit Civil porosia prezumohet se është me shpërblim. Rezulton që të jetë pikërisht ndërthurja e interesave ndërmjet porositësit dhe të porositurit ajo që shërben si shkak për të arritur në përfundimin e sipërcituar.

III.III Format e ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesave.

Në pjesën e parë trajtuam konfliktin e interesit ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit në referim kjo të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil. Në këtë pjesë do të trajtojmë disa nga situatat kur konflikti i interesit mund të ndeshet më shpesh në jetën e përditshme.

i) Konflikti i interesave ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

Sikurse kemi cituar edhe në pjesët e tjera të këtij punimi tagrat e përfaqësimit nuk burojnë gjithnjë nga vullneti i të përfaqësuarit por këto tagra mund të rrjedhin edhe nga vetë ligji. Rasti tipik i përfaqësimit ligjor është ai i përfaqësimit të fëmijëve nga prindërit. Ky lloj përfaqësimi përcaktohet shprehimisht në nenin 232 të Kodit të Familjes në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Prindërit përfaqësojnë fëmijën e tyre të mitur që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që sipas ligjit i mituri mund ti kryejë vetë”*.

Në këtë rast është vetë ligji ai që parashikon lindjen e përfaqësimit, caktimin e përfaqësuesit, si dhe kufijtë e të drejtave të tij, si dhe tagrat e përfaqësimit. Natyrisht që detyrimi kryesor i prindërve të cilët veprojnë si përfaqësues ligjorë të fëmijë të tyre është mbrojtja e interesave të këtyre të fundit, por mund të ndodhë që prindërit të mos e realizojnë një detyrim të tillë dhe me veprimet e tyre të çenojnë interesat e fëmijëve duke abuzuar në këtë mënyrë me pushtetin e përfaqësimit që u buron nga ligji. Në situata të caktuara prindërit si përfaqësues ligjor mund të paraqiten në një funksion të dyfishtë dhe konkretisht nga njëra anë si mbrojtës të interesave të tyre dhe nga ana tjetër si mbrojtës të interesave të fëmijëve të tyre në emër dhe për llogari të të cilëve ata veprojnë. Natyrisht që në situata të tilla kemi të bëjmë me një konflikt interesash prindër – fëmijë, konflikt ky i cili mund të shpjerë në abuzim të pushtetit të përfaqësimit që prindërit kanë ndaj fëmijëve. Për të evituar raste të tilla pra me qëllim që prindërve të mos u krijohet mundësia e abuzimit me pushtetin përfaqësues, kur ata ndodhen në konflikt interesash me fëmijët nga ana e ligjvënësit rezulton të jetë parashikuar caktimi nga ana e gjykatës të një kujdestari të posaçëm. Konkretisht në nenin 274 të Kodit të Familjes dispozitë kjo e emërtuar : **“Rastet e kujdestarisë së posaçme”** parashikohet ndër të tjera shprehimisht që: *“Gjykata vendos caktimin e një kujdestari të posaçëm kur :*

a) ka konflikt interesash midis të miturit dhe prindërve ose midis të miturit dhe kujdestarit të tij, si dhe kur midis tyre duhet të kryhet një veprim juridik.

b) ka konflikt interesash midis të miturve, vëllezër dhe motra që kanë të njëjtin kujdestar ose kur duhet të kryhet një veprim juridik midis tyre”.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që të jetë gjykata ajo që do të caktojë kufijtë e përfaqësimit për kujdestarin e posaçëm, pra se çfarë veprimesh do të kryhen prej këtij të fundit, pra se për çfarë veprimesh ai do të përfaqësojë të miturin në raport me prindërit e këtij të fundit. Është mëse e qartë se në rast të kryerjes nga ana e prindërve të veprimeve juridike në emër dhe për llogari të fëmijëve të tyre me veten e tyre ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tyre pa respektuar kushtet e përcaktuara në dispozitën e sipërcituar të Kodit të Familjes, këto veprime juridike do të konsiderohen si absolutisht të pavlefshme dhe nuk do të sjellin asnjë pasojë në kuptim të ligjit. Si referencë ligjore për të kërkuar pavlefshmërinë e këtyre veprimeve do të shërbejnë përcaktimet e nenit 67 të Kodit Civil, si dhe dispozitat e Kodit të Familjes të cilat rregullojnë Kujdestarinë e posaçme (nenet 274 – 278 të Kodit të Familjes).

Edhe në legjislacionin italian mbahet i njëjti qëndrim lidhur me rastet kur ndërmjet prindërve dhe fëmijëve ka konflikt interesash. Në raste të tilla në paragrafin e gjashtë të nenit 320 të Kodit Civil Italian parashikohet se : *“Në rast të konfliktit të interesave pasurore ndërmjet njërit prej prindërve dhe fëmijës përfaqësimi i fëmijës bëhet nga prindi tjetër. Nëse në konfliktin e interesave përfshihen të dy prindërit, gjyqtari që është caktuar si mbrojtës i të drejtave të fëmijës cakton një kujdestar special”¹⁰³.*

Legjislacioni Italian në dallim nga Kodi ynë i Familjes parashikon se në rast se ka konflikt interesash ndërmjet njërit prej prindërve dhe fëmijës atëherë si përfaqësues i

¹⁰³ Neni 320 paraag 6 i Kodit Civil Italian

fëmijës vepron prindi tjetër dhe vetëm kur në konfliktin e interesave janë përfshirë të dy prindërit atëherë caktohet nga ana e gjykatës një kujdestar special me qëllim për të evituar situatat nga të cilat interesat e të miturit mund të cënohen.

ii) Konflikti i interesave ndërmjet kujdestarit dhe fëmijëve të mitur që ndodhen në kujdestari.

Sikurse përshkruam edhe më lart të drejtën e përfaqësimit për të miturit e gëzojnë prindërit e tyre, por në rastet kur këto të fundit gjenden në pamundësi për të ushtruar pushtetin prindëror dhe si rrjedhojë edhe për të ushtruar të drejtën e përfaqësimit atëherë të miturve u caktohet një kujdestar i cili vepron edhe si përfaqësues ligjor i të miturve në marrëdhënie me të tretët. Edhe në rastin e sipërcituar kujdestarët sikurse prindërit duhet t'i kryejnë veprimet në emër dhe për llogari të të miturve që kanë në kujdestari në funksion të mbrojtjes së interesave të të miturve, madje në ligj rezultojnë që të jetë parashikuar edhe si rast ndalimi për tu caktuar kujdestar, kur ai është në konflikt interesi me të miturin¹⁰⁴.

Në raste të caktuara edhe kujdestari mund të ndodhet në një funksion të dyfishtë duke u paraqitur në të njëjtën kohë edhe si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të veta, por edhe si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të të miturit që ka në kujdestari. Me qëllim për të evituar raste të tilla pra që kujdestari të mos mund të abuzojë me pushtetin që ka si përfaqësues i të miturit nga ana e ligjvënësit rezultojnë që të jetë parashikuar shprehimisht se në rast të gjendjes së konfliktit të interesit kujdestari nuk mund të përfaqësojë të miturin por në të tilla raste do të caktohet një kujdestar i posaçëm nga ana e gjykatës, i cili do të përfaqësojë të miturin në kryerjen e veprimeve juridike në të cilat kujdestari ndodhet në konflikt interesi¹⁰⁵.

Ky rregull vlen edhe kur veprimi juridik duhet të kryhet ndërmjet të miturve që kanë të njëjtin kujdestar, si edhe kur të miturit që kanë të njëjtin kujdestar ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit ndërmjet tyre.

iii) Konflikti i interesave ndërmjet kujdestarit dhe personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

Sikurse përcaktohet shprehimisht në Kodin Civil personit kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile¹⁰⁶. Si rrjedhojë ai ka të drejtë që të jetë vetë palë në veprimet e ndryshme juridike që ai mund të kryejë me persona të tretë. Ligji ka parashikuar që në rastet kur një person madhor nuk është në gjendje të kujdeset për punët e tij për shkak sëmundjeje ose zhvillimi të metë mendor atëherë këtij të fundit me vendim gjykate i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar¹⁰⁷. Në raste të tilla me qëllim për tu kujdesur për punët e

¹⁰⁴ Neni 270 gërma "b" e Kodit të Familjes

¹⁰⁵ Neni 274 gërmat "a" dhe "b" të Kodit të Familjes

¹⁰⁶ Neni 6 parag 1 i Kodit Civil

¹⁰⁷ Neni 10 i Kodit Civil

personave që u hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar këtyre të fundit u caktohet një kujdestar, i cili përfaqëson këto persona në marrëdhënie me të tretët. Nëpërmjet veprimeve të kujdestarit që u është caktuar me vendim gjykatë këto persona, këto të fundit fitojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrime juridiko – civile. Detyrimisht që kujdestari në veprimet që kryen në emër dhe për llogari të këtyre personave duhet të tregojë të gjithë kujdesin e duhur me qëllim mbrojtjen më së miri të interesave të këtyre personave duke mos abuzuar me cilësinë e të qenurit përfaqësues ligjor i tyre. Në raste të caktuara edhe kujdestari mund të ndodhet në një funksion të dyfishtë dhe konkretisht duke u paraqitur në të njëjtën kohë edhe si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të veta, por edhe si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të personit që ka në kujdestari. Edhe në marrëdhëniet kujdestar – person të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar ekziston një rregullim ligjor se si duhet të veprohet kur ndërmjet tyre është i pranishëm konflikti i interesit. Edhe në raste të tilla në referim të përcaktimeve të neneve 274 dhe 308 të Kodit të Familjes do të caktohet nga ana e gjykatës një kujdestar i posaçëm. Ky rregull do të vlejë edhe në rastet kur veprimi juridik duhet të kryhet ndërmjet dy personave të cilëve u është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar dhe që u është caktuar i njëjti kujdestar.

iv) Konflikti i interesave ndërmjet bashkëshortëve.

Neni 68 i Kodit të Familjes rezulton që të ketë parashikuar edhe përfaqësimin e bashkëshortëve nga njëri – tjetri. Konkretisht në këtë dispozitë të emërtuar : **“Përfaqësimi i bashkëshortit”** parashikohet shprehimisht se : *“Secili nga bashkëshortët mund t’i japë të drejtën bashkëshortit tjetër për ta përfaqësuar gjatë regjimit pasuror martesor, sipas dispozitave të Kodit Civil. Mandati i përfaqësimit mund të revokohet në çdo kohë”*¹⁰⁸.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që sipas parashikimeve të kësaj dispozite kemi të bëjmë me përfaqësim vullnetar ku secili prej bashkëshortëve nëpërmjet një prokure mund t’i besojë mbrojtjen e interesave të tij pasurore bashkëshortit tjetër gjatë regjimit pasuror martesor. Natyrisht që marrëdhënia e përfaqësimit ndërmjet bashkëshortëve lind si rrjedhojë e besimit që kanë ndaj njëri – tjetrit.

Të drejtën e përfaqësimit të njërit bashkëshort ndaj bashkëshortit tjetër e ndeshim krahas parashikimit ligjor të sipërcituar e ndeshim edhe në dispozita të tjera të Kodit të Familjes. Kështu në paragrafin e dytë të nenit 90 të Kodit të Familjes, në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Secili bashkëshort është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër përpara organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi”*¹⁰⁹.

Në referim të kësaj dispozite rezulton që tagrat si përfaqësues ligjor të bashkëshortit përkundrejt bashkëshortit tjetër të shtrihen vetëm deri në kufijtë e një administrimi të

¹⁰⁸ Neni 68 i Kodit të Familjes.

¹⁰⁹ Neni 90 parag 2 i Kodit të Familjes.

zakonshëm. Zbatimi i kësaj dispozite rezulton që të jetë i kushtëzuar me qënien e bashkëshortëve në regjimin pasuror në bashkësi, ndërsa lidhur me regjimin e pasurive të ndara rezulton që ligjvënësit të ketë bërë një tjetër parashikim ligjor duke përcaktuar në nenin 117 parag 1 të Kodit të Familjes se : *“Në rast se gjatë martesës, njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij, zbatohen rregullat e përfaqësimit”*¹¹⁰.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që në rastin e regjimit të pasurive të ndara në ndryshim nga regjimi pasuror në bashkësi marrëdhënia e përfaqësimit ndërmjet bashkëshortëve të ndërtohet mbi baza vullnetare duke u lëshuar për këtë qëllim nga ndonjëri prej bashkëshortëve prokurë për bashkëshortin tjetër. Këto tagra përfaqësimi rezulton që të kufizohen vetëm deri në kufijtë e administrimit të zakonshëm të pasurisë.

Është e vetëkuptueshme që bashkëshorti të cilit i është dhënë e drejta e përfaqësimit të veprojë në interes të përbashkët të të dy bashkëshortëve duke mos abuzuar në këtë mënyrë me pushtetin e përfaqësimit që rezulton t'i jetë dhënë në mënyrë vullnetare nga bashkëshorti tjetër ose kur ky përfaqësim i rrjedh si rezultat i parashikimeve ligjore. Është e natyrshme që fenomeni i konfliktit të interesave të mund të shfaqet edhe në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe në mënyrë të veçantë në rastet kur ndërmjet tyre ekziston regjimi i pasurive të ndara, kjo për vetë faktin sepse secili prej tyre paraqitet si mbrojtës i interesave të veta në mënyrë të pavarur përkundrejt bashkëshortit tjetër. Për rrjedhojë në raste të tilla abuzimi me pushtetet e përfaqësimit që i janë dhënë nga bashkëshorti tjetër është më e mundshme. Vërtet që tagrat e bashkëshortit përfaqësues kufizohen vetëm në kufijtë e një administrimi të zakonshëm, pra ky bashkëshort nuk e gëzon të drejtën e disponimit mbi pasurinë e bashkëshortit tjetër por ekziston mundësia që ai të mund të abuzojë me tagrat e gëzimit dhe të përdorimit që i janë dhënë në referim të prokurës së lëshuar nga bashkëshorti tjetër.

Në dispozitat e Kodit të Familjes që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve në ndryshim nga dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet prindër – fëmijë dhe kujdestar – të mitur apo kujdestar – person të cilit i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar nuk ekziston ndonjë rregullim i posaçëm se si duhet të veprohet për të parandaluar apo evituar rastet e konfliktit të interesit kur njëri prej bashkëshortëve është edhe përfaqësues i bashkëshortit tjetër. Në rrethana të tilla arrihet në përfundimin se të zbatueshme do të jenë ndalimet e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Civil sipas të cilave bashkëshorti përfaqësues nuk mund të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij. Në rast të konstatimit të ndonjërit prej këtyre rasteve bashkëshorti i përfaqësuar ka të drejtë t'i kundërshtojë për pavlefshmëri veprimet juridike të kryera nga bashkëshorti përfaqësues në rastet e parashikuara nga neni 67 i Kodit Civil nëse do të konstatojë se nga këto veprime janë cënuar interesat e tij si i përfaqësuar në këto veprime juridike.

Abuzimi i pushtetit që bashkëshorti përfaqësues mund të ushtrojë ndaj bashkëshortit tjetër në regjimin e pasurive të ndara mund të shfaqet sidomos në marrëveshjet me keqbesim që ai mund të realizojë me persona të tretë. Natyrisht që mjete më i mirë

¹¹⁰ Neni 117 parag 1 i Kodit të Familjes.

mbrojtës për bashkëshortin e përfaqësuar në rast se ndërmjet tyre nuk ekzistojnë marrëdhëniet e besimit reciprok ose krijohen dyshime që bashkëshorti përfaqësues po abuzon me pushtetin që i rrjedh nga akti i përfaqësimit do të ishte revokimi i prokurës së dhënë në referim kjo të përcaktimeve të nenit 68 paragraf 2 të Kodit të Familjes. Krahas këtij veprimi bashkëshorti i përfaqësuar ka të drejtë të kërkojë edhe pavlefshmërinë e veprimeve juridike që bashkëshorti përfaqësues ka kryer me persona të tretë si rezultat i marrëveshjeve me keqbesim¹¹¹.

v) Konflikti i interesave në shoqëritë tregtare.

Shoqëritë tregtare si persona juridikë e fitojnë personalitetin e tyre juridik që në momentin e regjistrimit të tyre. Meqenëse kanë personalitet juridik ata kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie me persona të tjerë qofshin këta persona fizikë apo juridikë brenda objektit të veprimtarisë së tyre. Karakteristikë e personave juridikë ndër të cilët janë edhe shoqëritë tregtare është se vullnetin e tyre e shfaqin përfaqësuesit e tyre të cilët në disa raste janë vetë ortakët e tyre që mund të jenë njëkohësisht edhe administratorë të tyre si shoqëri, si në rastin e shoqërive komandite dhe atyre kolektive, ndërsa në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe anonime veprimet në emër dhe për llogari të këtyre shoqërive i kryejnë administratorët të cilët mund të jenë edhe persona jashtë bashkësisë së ortakëve. Pas dhënies së kontributeve ortakët zhvishen nga pronësia mbi to dhe tashmë ato konsiderohen si pasuri e shoqërisë dhe jo e ortakëve të saj. Për rrjedhojë interesat pasurore të shoqërisë paraqiten të ndara nga interesat pasurore të ortakëve me përjashtim të shoqërive kolektive dhe komandite vetëm për ortakët e pakufizuar të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë me gjithë pasurinë e tyre.

Meqenëse janë administratorët ata që angazhojnë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, pra janë ato që veprojnë si përfaqësues të tyre mbi ta rëndon detyrimi që të veprojnë në mbrojtje të interesave të shoqërive. Edhe në rastin e shoqërive tregtare mund të kemi konflikt interesash ndërmjet interesave individuale të ortakëve ose administratorëve nga njëra anë dhe interesave të shoqërisë nga ana tjetër ku realizimi i të parave sjell sakrifikimin e të dytave dhe anasjelltas. Ligji për shoqëritë tregtare bën një rregullim specifik të rasteve të konfliktit të interesit, fakt ky i cili të shpie në përfundimin se të zbatueshme në rastet e konstatimit të konfliktit të interesave në shoqëritë tregtare do të jenë dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare dhe jo përcaktimet e nenit 67 të Kodit Civil.

vi) Konflikti i interesave avokat – klient.

Avokati në ushtrimin e profesionit të tij ka si detyrim kryesor mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe interesave të personave që përfaqësohen

¹¹¹ Neni 102 i Kodit Civil.

prej tij. Ai duhet të sigurojë që asnjë konflikt interesash nuk ekziston ndërmjet tij dhe personit që përfaqëson. Këto detyrime duhet të karakterizojnë avokatin gjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Për këtë arsye të gjitha veprimet që avokati kryen në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit prezumohet se i kryen në interes të këtij të fundit. Në raste të caktuara avokati ashtu sikurse edhe çdo përfaqësues tjetër mund të paraqitet në mënyrë të njëkohshme edhe si mbrojtës apo mbajtës i interesave të të përfaqësuarit prej tij por edhe si mbrojtës dhe mbajtës i interesave të tij personale, nga realizimi i të cilave në disa raste mund të arrihet vetëm duke sakrifikuar interesat e të përfaqësuarit prej tij. Në funksion të evitimit të situatave të konfliktit të interesit në nenin 9 parag 1 të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, dispozitë kjo e emërtuar : **“Konflikti i interesit”** parashikohet shprehimisht se : *“Avokati është i detyruar të mos pranojë përfaqësimin ose mbrojtjen e klientit ose të heqë dorë prej tij, nëse ai ka marrë dajeni ose duhet të kishte marrë dajeni për ekzistencën e një shkaku që tregon një konflikt interesi”*¹¹².

Një ndër rastet e cituara nga dispozita e sipërcituar si rast konflikti interesi është edhe rasti : *“kur avokatët që punojnë në të njëjtën studio avokatie përfaqësojnë palën kundërshtare në të njëjtën çështje ose në çështje të tjera të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me themelin e çështjes”*¹¹³.

Arsyeja e parashikimit të një ndalimi të tillë nga ana e ligjit të posaçëm që rregullon veprimtarinë e avokatisë në Republikën e Shqipërisë rezulton të jetë e njëjtë me arsyen e ndalimit nga ana e përfaqësuesit që të kryejë veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij dhe konkretisht me qëllim për të evituar përplasjen e interesave ndërmjet të përfaqësuarve, i cili mund të sjellë si pasojë sakrifikimin e interesave të njërit prej palëve që ato si studio ligjore përfaqësojnë në funksion të favorizimit të interesave të palës tjetër që përfaqësohet po nga e njëjta studio ligjore.

Ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje është fakti se cilat do të ishin pasojat në rast konstatimi të veprimit të avokatit në shkelje të ndalimit të sipërcituar. Pra nëse veprimtaria e zhvilluar do të sillte apo jo si pasojë pavlefshmërinë e veprimeve procedurale të kryera nga avokatët e të njëjtës studio ligjore.

Në fakti ligji i posaçëm me përjashtim të përgjegjësive disiplinore të avokatit nuk rezulton që të ketë parashikuar ndonjë pasojë tjetër, në rrethana të tilla arrihet në përfundimin se veprimet procedurale të kryera nga avokatët në shkelje të nenit 9 pika 2 gërma “c” nuk do të konsiderohen të pavlefshme por të përfaqësuarit mund t’i lindë e drejta të kërkojë shpërblimin e dëmit nëse do të vërtetohet se interesat e këtij të fundit janë cënuar nga veprimtaria e kryer nga avokati në shkelje të parashikimit ligjor të cituar më lart.

¹¹² Neni 9 i Ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

¹¹³ Neni 9 pika 2 gërma “c” të Ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

KREU IV

IV. Dallimet e Institutit të Përfaqësimit nga Kontratat e Porosisë, Komisionit dhe Agjencisë.

Në kreun e parë ne trajtuam përfaqësimin si një institut të veçantë të së drejtës civile për vetë faktin se jo gjithmonë personat mund të jenë të pranishëm fizikisht në kryerjen e veprimeve të ndryshme kjo për shkak të ekzistencës së faktorëve objektivë apo subjektivë të cilët i pengojnë që të jenë të pranishëm në kryerjen e këtyre veprimeve. Në rrethana të tilla lindi e domosdoshme që t'i jepej zgjidhje ligjore situatave të tilla duke parashikuar për këtë qëllim institutin e përfaqësimit, i cili nuk është gjë tjetër veçse një manifestim i autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit ku i përfaqësuari në vend që të marrë pjesë personalisht në kryerjen e veprimeve të ndryshme preferon që kryerjen e këtyre veprimeve tua besojë personave të tjerë duke pranuar në këtë mënyrë që t'i nënshtrohet vullnetit të të tjerëve në kryerjen e këtyre veprimeve.

Pavarësisht faktit se i përfaqësuari është bartës i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kryerja e këtyre veprimeve ai që shfaq vullnetin për kryerjen e veprimeve rezulton që të jetë përfaqësuesi, por që efektet e këtyre veprimeve të shtrihen ndaj të përfaqësuarit duhet që këto veprime të jenë kryer në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

Tashmë përfaqësuesi nuk paraqitej apo shfaqej thjesht si një mesazher apo mbajtës fjalësh që në gjuhën latine njihej me emrin : *“nuntius”* (mbajtës fjalësh) sikurse pranohej fillimisht nga Savigni, por tashmë ai shfaq iniciativë pavarësisht nga fakti se përmbajtja e këtij vullneti përcaktohet nga tagrat që i janë dhënë nga i përfaqësuari.

Sikurse e kemi përshkruar edhe në kreun e parë të këtij punimi përfaqësimi si institut i së drejtës rregullohet në pjesën e përgjithshme të Kodit Civil dhe konkretisht në nenet 64 – 78 të Kodit Civil. Parashikimet tona ligjore lidhur me institutin e përfaqësimit rezulton që të jenë ndikuar nga parashikimet e Kodit Civil Gjerman të vitit 1896, i cili institutin e përfaqësimit e parashikonte në pjesën e përgjithshme.

Përfaqësimi si institut i së drejtës shfaq ngjashmëri dhe me disa kontrata që parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Civil, siç janë Kontrata e Porosisë (nenet 913 – 934 të Kodit Civil), Kontrata e Komisionit (nenet 935 – 944 të Kodit Civil) dhe Kontrata e Agjencisë (nenet 950 – 961 të Kodit Civil).

Instituti i përfaqësimit krahas ngjashmërive që paraqet me kontratat e sipërcituara paraqet edhe disa karakteristika që e dallojnë nga kontratat e sipërcituara.

Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë të detajuar dallimet dhe ngjashmëritë e përfaqësimit si institut i të drejtës civile me kontratat e cituara më lart.

Dallimet dhe ngjashmëritë e institutit të përfaqësimit nga kontrata e porosisë.

i) Dallimet :

a) Në nenin 64 të Kodit Civil jepet edhe përkufizimi i përfaqësimit ku përcaktohet se: *“Me përfaqësimin një person përfaqësuesi kryen brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar). Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet sipas ligjit të kryhet nga vetë personi. Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar”*¹¹⁴.

Në nenin 913 të Kodit Civil jepet edhe përkufizimi i kontratës së porosisë ku përcaktohet se : *“Porosia është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër”*¹¹⁵.

Në dispozitën vijuese dhe konkretisht në nenin 914 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht se : *“Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin”*¹¹⁶.

Ajo që me të vërtetë do të shtrohej si pyetje është fakti nëse përfaqësimi në vetvete është apo jo një kontratë, pra marrëdhënia që lidhet ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit përbën në vetvete një kontratë apo jo¹¹⁷.

Për përfaqësimin ligjor përgjigja do të ishte e thjeshtë **“Jo”**, kjo për faktin se në rastin e përfaqësimit ligjor tagrat e përfaqësuesit përsa i përket volumit të tyre janë të përcaktuara në normat juridike që rregullojnë institutin e përfaqësimit dhe në të tilla raste vetëm përfaqësuesi mund të shfaqë vullnetin e tij ndërsa i përfaqësuarit jo.

Në funksion të asaj që parashtrua më lart si shembull mund të paraqesim parashikimet ligjore të përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 16 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar”*.

I njëjti parashikim ligjor rezulton të jetë përcaktuar edhe në nenin 307 të Kodit të Familjes në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Gjykata në vendimin për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, cakton dhe kujdestarin për personin që i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar”*.

Në rastet e sipërcituara rezulton që kujdestari të fitojë cilësinë e përfaqësuesit ligjor, si dhe rezulton të jetë vetëm në vullnetin e kujdestarit për të pranuar ose jo për të qenë si i tillë. Në këto raste i përfaqësuarit nuk shfaq vullnet lidhur me një përfaqësim të tillë, në rastin e parë për arsye objektive, ndërsa në rastin e dytë për arsye subjektive.

¹¹⁴ Neni 64 i Kodit Civil

¹¹⁵ Neni 913 i Kodit Civil

¹¹⁶ Neni 914 i Kodit Civil

¹¹⁷ Marjana Semini, “E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave” Pjesa e Posaçme fq 125 – 130

Nëse në rastet e përfaqësimit ligjor çështja rezulton të paraqitet e thjeshtë nuk mund të thuhet kjo gjë për rastin e përfaqësimit vullnetar në kushtet kur në këtë të fundit ekziston shfaqja e vullnetit si nga i përfaqësuari ashtu edhe nga përfaqësuesi. Siç dihet në rastin e përfaqësimit vullnetar i përfaqësuari shfaq vullnetin e tij jo vetëm lidhur me personin që caktohet prej tij përfaqësues, por edhe lidhur me tagrat apo pushtetet që i cakton këtij të fundit.

Ajo që e bën të diskutueshme pyetjen e mësipërme është fakti nëse në përfaqësimin vullnetar shfaqja e vullnetit duhet të jetë e njëanshme apo e dyanshme, kjo për faktin se është e vërtetë se përfaqësimi vullnetar varet ekskluzivisht nga dëshira e të përfaqësuarit por paraqitet e nevojshme edhe që përfaqësuesi të shfaqë vullnetin për të qenë i tillë. Një fakt i tillë e bën mjaft të diskutueshme përgjigjen nëse në përfaqësimin vullnetar marrëdhënia që lidhet ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit përbën në vetvete një kontratë apo jo.

Në fakt doktrina e vjetër e së drejtës e konsideronte prokurën si një element të kontratës së porosisë, ndërsa doktrina moderne sidomos pas studimit themelor të Prof. Laband në librin e tij të emërtuar : *“Die Stellvertretung be idem abschluss von Rechtsgeschäften”*⁸ (Përfaqësimi në kryerjen e veprimeve juridike) e dalloi tërësisht prokurën nga porosia. Arsyeja e këtij dallimi konsiston në faktin se nga kontrata e porosisë burojnë të drejta dhe sidomos detyrime jo vetëm për të porositurin por edhe për porositësin, ndërsa prokura ka për efekt vetëm dhënien e pushteteve përfaqësuesit. Pra prokura bazohet ekskluzivisht në vullnetin e njëanshëm të personit që e lëshon prokurën. Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim përmbajtjes së nenit 70 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit”*.

Referuar vetë përmbajtjes së dispozitës së sipërcituar arrihet në përfundimin se prokura është një instrument ligjor në bazë të së cilës përfaqësuesi legjitimohet si i tillë përkundrejt të tretëve. Prokura nuk konsiderohet si pjesë e marrëdhënies së brendshme që krijohet mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit. Kjo marrëdhënie rregullohet nga një kontratë nga e cila lind detyrimi i përfaqësuesit që të veprojë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Burimi i këtij detyrimi mund të jetë një kontratë pune sipas së cilës përfaqësuesi është një punonjës i të përfaqësuarit dhe të vepruarit si përfaqësues lidhet me funksionin e tij. Gjithashtu burim i këtij detyrimi mund të jetë edhe marrëdhënia avokat – klient etj, ndërsa porosia është një kontratë me anë të së cilës një subjekt detyrohet kundrejt një subjekti tjetër që të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të këtij të fundit. Në një rast të tillë kemi një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve.

Në kontratën e Porosisë detyrimit të të porositurit për të kryer një ose disa veprime juridike për llogari të porositësit i korrespondon detyrimi i porositësit që t'i paguajë të porositurit shpërblimin për punën e kryer, kjo është edhe arsyeja për të cilën kontrata e porosisë prezumohet gjithmonë se është me shpërblim, ndërsa në rastin e përfaqësimit përfaqësuesi si rregull nuk merr shpërblim për veprimet juridike që kryen në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, kjo për faktin se veprimet e kryera prej përfaqësuesit mund

të jenë pjesë e punës së tij ose mes përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit ekzistojnë lidhje gjinie, krushqie ose shoqërore që nuk e lejojnë marrjen e shpërblimit.

Në rastin e përfaqësimit të drejtat dhe detyrimet lindin drejtpërdrejt për të përfaqësuarin pra rezultati ose pasojat juridike që vijnë nga veprimet e kryera nga përfaqësuesi i drejtohen drejtpërdrejt të përfaqësuarit ndërsa në kontratën e Porosisë pasojat ose rezultati i veprimeve të kryera nga i porosituri për llogari të porositësit vijnë gjithmonë në një kohë të mëvonshme kjo për vetë faktin se gjithmonë palë në veprimet e ndryshme juridike që i porosituri kryen me personat e tretë është vetë ai dhe jo i porositësi, prandaj pasojat e veprimeve të kryera nuk bien direkt mbi porositësin por kanë një efekt të mëvonshëm dhe kjo për vetë faktin se gjithmonë palë në veprimet e ndryshme juridike që realizohen në referim të kontratës së porosisë palë rezulton i porosituri dhe jo porositësi. Në rastin e kontratës së porosisë është vetë i porosituri që në aspektin juridik fiton të drejta dhe merr përsipër detyrime që rrjedhin nga veprimet juridike të kryera me të tretët edhe në rast se këta kanë pasur dijeni për kontratën e porosisë. E thënë ndryshe porositësi në kontratën e porosisë nuk ka asnjë lidhje me personat e tretë. Pikërisht këtu qëndron edhe dallimi esencial që ekziston mes përfaqësimit si institut i së drejtës dhe kontratës së porosisë sepse ndërsa në rastin e përfaqësimit, përfaqësuesi vepron gjithmonë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, ku palë në të gjitha veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi me personat e tretë është gjithmonë i përfaqësuari, në kontratën e porosisë është i porosituri ai që është palë në veprimet e kryera për llogari të porositësit me personat e tretë dhe pasojat e veprimeve të tij nuk bien direkt mbi porositësin por kanë një efekt të mëvonshëm për vetë faktin se porositësi nuk është palë në këto veprime juridike. Në kontratën e porosisë personi i tretë kontraktues në asnjë rast nuk mund të veprojë kundrejt porositësit duke pretenduar prej tij përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga i porosituri për arsyen e vetme sepse siç u përshkrua edhe më lart porositësi nuk del si palë në kontratën që lidhet mes të porositurit dhe personit të tretë. Sikurse përshkruam edhe më lart kjo vlen edhe në rastin kur personi i tretë ka dijeni se personi me të cilin ai po kontakton po vepron si i porositur. Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim vetë përmbajtjes së nenit 915 të Kodit Civil.

Le të marrim dy shembuj për të ilustruar përfundimin e sipërcituar.

Shembulli i parë : Personi A cakton si përfaqësues të tij personin B të cilit me anë të një prokure të posaçme i jep tagra për t'i shitur një apartament që i përfaqësuari A kishte në pronësi të tij. Në referim të prokurës së dhënë përfaqësuesi B lidh një kontratë shitjeje me personin C. Pas lidhjes së kontratës dhe vendosjes në posedim të sendit të blerë personi C konstaton se sendi kishte të meta të cilat nuk i ishin bërë të ditura nga ana e përfaqësuesit në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes.

Shembulli i dytë : Personi A lidh një kontratë porosie me personin B të cilin e ngarkon për të shitur një sasi të caktuar mallrash për llogari të tij si porositës. Në referim të kontratës së porosisë i porosituri B kontraktkon me personin C për shitjen e këtyre mallrave duke lidhur për këtë qëllim me këtë të fundit edhe kontratën përkatëse të shitjes. Pas dorëzimit të mallrave personi C konstaton se një pjesë e mallrave të blera ishin me të meta, si dhe nuk ishin në cilësinë për të cilën ato kishin rënë dakord në kontratën e lidhur

me personin B.

Në rastin e shembullit të parë personi i tretë C të gjitha pretendimet e tij që do të kishte lidhur me të metat e sendit do ja kundërdrejtonte drejtpërdrejt personit A, i cili edhe rezulton të jetë palë në kontratën e shitjes si dhe titullar i të drejtës së pronësisë së transferuar tek personi i tretë C, ndërsa në rastin e shembullit të dytë personi i tretë C pretendimet e tij lidhur me të metat dhe cilësinë e mallrave të blera mund t'ia kundërdrejtojë vetëm personit B me të cilin rezulton që të ketë lidhur edhe kontratën e shitjes së mallrave që rezulton të jenë në pronësi të personit A. Në rastin e shembullit të dytë personi C në asnjë rast nuk do të mund t'ia kundërdrejtonte pretendimet e tij personit A, pavarësisht faktit se mund të ishte apo të vihet në dijeni më vonë se këto mallra i përkisnin këtij të fundit dhe se personi B kishte vepruar për llogari të personit A, në referim të kontratës së porosisë së lidhur me këtë të fundit. Në çdo rast përgjegjës përkundrejt personit C lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata do të jetë vetëm personi B me të cilin rezulton që të ketë lidhur edhe kontratën përkatëse të shitjes.

Me shembujt e sipërcituar evidentohet edhe një dallim tjetër esencial ndërmjet përfaqësimit dhe kontratës së porosisë. Përfaqësuesi në asnjë rast nuk përgjigjet për mospërmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga i përfaqësuari, ndërsa në kontratën e porosisë i porosituri është gjithmonë përgjegjës për mospërmbushjen e detyrimeve ndaj të tretëve pavarësisht faktit se ka vepruar si i porositur.

Gjithashtu në rastin e përfaqësimit, i përfaqësuari është menjëherë përfitues i të drejtave të rrjedhura nga veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi, ndërsa në kontratën e porosisë, porositësit të drejtat e përfituara si rezultat i veprimeve juridike të kryera nga i porosituri i përfiton në një moment të mëvonshëm. Konkretisht të drejtat nga ana e porositësit do të përfitohen pas transferimit të tyre nga i porosituri, i cili në referim të kontratës së porosisë është i detyruar t'i transferojë të drejtat e fituara nga veprimet e kryera për llogari të porositësit tek ky i fundit. Ky transferim të drejtash mund të bëhet në referim të kontratës së porosisë ose edhe me anë të një kontrate tjetër siç është rasti kur nga i porosituri janë fituar për llogari të porositësit të drejta pronësie mbi pasuri të paluajtshme ose pasuri të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë.

b) Në kuadër të evidentimit të dallimeve ndërmjet institutit të përfaqësimit nga kontrata e porosisë vlerësoj se lind e nevojshme t'i jepet përgjigje edhe pyetjes që do të parashtrohet më poshtë nga ana ime.

A do të ishte e mundur që i porosituri për llogari të porositësit të transferonte të drejtën e pronësisë së këtij të fundit mbi një pasuri të paluajtshme, apo ndonjë të drejtë tjetër reale që rezultojnë të regjistruara në regjistrat publikë në emër të porositësit ?

Sikurse e përshkruam edhe më lart në kontratën e porosisë në dallim nga përfaqësimi palë në veprimin juridik që kryhet për llogari të porositësit me personin e tretë rezulton të jetë i porosituri. Rezulton të jetë pikërisht i porosituri ai që në veprimin juridik që lidhet me personin e tretë të paraqitet si bartës të drejtash dhe detyrimesh juridiko - civile.

Lidhur me pyetjen e parashtruar në doktrinën e së drejtës është hedhur hipoteza që i njeh të porositurit të drejtën indirekte të disponimit të pasurisë së paluajtshme që është në pronësi të porositësit, apo të ndonjë të drejte tjetër reale që gjendet e regjistruar në regjistrat publikë emër të këtij të fundit. Kjo e drejtë konsiderohet se përbën një nga rastet e rralla ku e drejta e disponimit i njihet një personi tjetër që nuk është titular i të drejtës objekt tjetërsimi.

Pavarësisht qëndrimit doktrinar vlerësimi im personal lidhur me pyetjen e shtuar më lart është se një gjë e tillë nuk do të ishte drejtpërdrejt e mundur pra që i porosituri të mund të transferonte të drejtën e pronësisë së porositësit mbi një pasuri të paluajtshme apo të transferonte ndonjë të drejtë tjetër reale që rezulton e regjistruar në emër të porositësit tek të tretët pa u kaluar më parë të drejtat e pronësisë mbi sendet e paluajtshme apo mbi të drejtat reale tek i porosituri. Vetëm pas realizimit të këtij veprimi pra të transferimit të të drejtave të pronësisë që janë objekt tjetërsimi tek i porosituri, ky i fundit mund që për llogari të porositësit të mund t'i tjetërsojë tek të tretët.

Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim nenit 705 të Kodit Civil, në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi”*.

Në referim të dispozitës së sipërcituar si palë shitëse në kontratën e shitjes paraqitet gjithmonë personi që është titullar i sendit apo të drejtës që është objekt i kontratës së shitjes. Në asnjë rast si palë shitëse nuk mund të paraqitet ndonjë person tjetër referuar edhe parimit të njohur të së drejtës civile që nuk mund t'i transferosh një personi tjetër një të drejtë që nuk e ke fituar asnjëherë.

Si përfundim në dallim nga përfaqësimi anë të kontratës së porosisë nuk mundet që i porosituri për llogari të porositësit të transferojë tek të tretët të drejtat e pronësisë së porositësit mbi një pasuri të paluajtshme apo ndonjë të drejtë tjetër reale që është në pronësi të porositësit dhe që gjenden të regjistruara në regjistrat publikë në emër të këtij të fundit pa u kaluar më parë pronësia mbi këto sende apo të drejta tek i porosituri.

c) Dallim tjetër është edhe se ashtu si prokura në rastin e përfaqësimit vullnetar edhe porosia mund të jetë e posaçme ose e përgjithshme. Megjithatë ato dallojnë nga njëra tjetra për faktin se ndërsa prokura ka karakter të përgjithshëm dhe sipas së cilës i përfaqësuarit i ka dhënë përfaqësuesit tagrat për të kryer veprime juridike të shumëllojshme të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, tek porosia në rastin kur ajo është e përgjithshme nuk mund të dalë jashtë caqeve të një administrimi të zakonshëm pune. E thënë ndryshe gama e veprimeve juridike që mund të kryejë përfaqësuesi në rastin e një prokure të përgjithshme është më e gjerë se në rastin e porosisë së përgjithshme. Ndërsa prokura e përgjithshme mund të sjellë si pasojë delegimin e të gjithë të drejtave e detyrimeve të përfaqësuesit, porosia e përgjithshme vepron vetëm mbi atë kategori veprimesh apo shërbimesh që janë cilësuar shprehimisht në kontratë, duke përfshirë të gjitha interesat e një tipi të veçantë si psh administrimi i një pasurie të paluajtshme, administrimin e një sipërmarrjeje ose të të gjitha interesave në lidhje me një zonë të caktuar. Në rastin e porosisë së përgjithshme gjithmonë bëhet fjalë

për akte të administrimit të zakonshëm, ndërsa aktet e administrimit të jashtëzakonshëm mund të kryhen nga personi të cilit i është dhënë porosi e përgjithshme vetëm në qoftë se rezultojnë në mënyrë të shprehur në kontratën e porosisë.

ç) Dallim tjetër është edhe se në rastin e përfaqësimit vullnetar prokura është një veprim juridik i njëanshëm ndërsa porosia është një kontratë, ku palë të së cilës janë porositësi dhe i porosituri që respektivisht fitojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrime përkundrejt njëri – tjetrit. I përfaqësuari në rastin e përfaqësimit vullnetar mund ta shfuqizojë prokurën dhe përfaqësuesi të heqë dorë prej saj në çdo kohë. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme. Ky parim i sanksionuar në nenin 75 të Kodit Civil shpjegohet nga karakteri personal i marrëdhënieve ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, të cilat mbështeten tek besimi që ata kanë te njëri – tjetri, si psh lidhje krushqie, fisnore ose miqësore. Nëse ky besim humbet atëherë prokura do të konsiderohet se e ka humbur fuqinë e saj ligjore.

Shfuqizimi i prokurës nga i përfaqësuari ose heqja dorë prej saj nga përfaqësuesi nuk shoqërohet me ardhjen e ndonjë pasoje. I përfaqësuari nuk detyrohet të dëmshpërblejë përfaqësuesin në rast të shfuqizimit të prokurës dhe nuk është e nevojshme që të ekzistojë ndonjë shkak i drejtë apo ndonjë arsye e përligjur pavarësisht nga fakti se kjo gjë vjen pothuajse gjithmonë nga humbja e besimit ndaj njëri – tjetrit. Gjithashtu i përfaqësuari nuk është i detyruar që t'i bëjë përfaqësuesit një njoftim paraprak brenda një kohe të arsyeshme. Po kështu edhe përfaqësuesi nuk detyrohet që ta dëmshpërblejë të përfaqësuarin në rastin kur ai heq dorë nga prokura dhe nuk është i detyruar ta njoftojë paraprakisht atë. Në dallim nga shfuqizimi i prokurës që mund të bëhet në çdo kohë nga i përfaqësuari dhe që përfaqësuesi mund të heqë dorë në çdo kohë nga përfaqësimi, kontrata e porosisë nuk mund të zgjidhet në çdo kohë dhe pa një shkak të arsyeshëm nga palët pavarësisht se një nga veçoritë e saj është edhe e drejta e revokimit ose e heqjes dorë prej saj, por kjo e drejtë e cila u njihet të dyja palëve mund të ushtrohet vetëm kur bëhet fjalë për një shkak të drejtë ose për një arsye të përligjur. Vetëm në këtë rast palët nuk mbajnë përgjegjësi për shpërblimin e dëmit ndaj njëra – tjetrës. Në të kundërt kur heqja dorë nuk vjen për ndonjë prej shkaqeve të cituara më lart atëherë pala që heq dorë do të përgjigjet ndaj palës tjetër duke i shpërblyer kësaj të fundit dëmin e ardhur si rrjedhojë e revokimit të porosisë. Gjithashtu porositësi nuk mund të tërhiqet nga kontrata dhe nëse tërhiqet, kjo tërheqje nuk ka vlerë nëse porosia është në interes të të porositurit dhe personave të tretë, përveç kur është parashikuar ndryshe në kontratë ose kur bëhet për një shkak të drejtë. Kjo ndodh kur ndërmjet porositësit dhe të porositurit ose mes porositësit dhe personave të tretë ekziston një marrëdhënie e veçantë.

Në rastet kur kontrata e Porosisë është pa afat porositësi është i detyruar të njoftojë paraprakisht të porositurin brenda një kohe të përshtatshme, përveç kur ekziston një shkak i drejtë për revokim në rast të kundërt porositësi është i detyruar të dëmshpërblejë të porositurin për dëmin që i ka shkaktuar zgjidhja e menjëhershme e kontratës. I njëjti rregull vlen dhe për të porositurin në rast se ai dëshiron të heqë dorë nga kontrata e porosisë pa afat. Në çdo rast heqja dorë duhet të bëhet në një mënyrë dhe në një kohë të tillë që porositësi të marrë masa për të vepruar, përveç rastit kur i porosituri gjendet në një vështirësi të madhe.

d) Në kuadër të evidentimit dallimeve ndërmjet Institutit të Përfaqësimit nga Kontrata e Porosisë vlerësoj se lind e nevojshme t'i jepet përgjigje edhe pyetjes që do të parashtrohet më poshtë nga ana ime.

A ekziston konflikti i interesit ndërmjet porositësit dhe të porositurit ?

Gjatë trajtimit të fenomenit të konfliktit të interesit ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit theksuam që përfaqësuesi duhet të veprojë gjithmonë në mbrojtje të interesave të të përfaqësuarit duke mos abuzuar me tagrat që i janë dhënë nga ana e këtij të fundit. Në funksion të evitimit të mundësisë që përfaqësuesi të abuzojë me tagrat e dhëna nga ana e të përfaqësuarit atij si përfaqësues nuk i lejohet të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Edhe në kontratën e porosisë i porosituri vepron gjithmonë në interes të porositësit. Pavarësisht se në marrëdhënie me të tretët si palë në kontratë rezulton të jetë vetë i porosituri, ky i fundit të gjitha veprimet i kryen për llogari të porositësit, si dhe më pas të gjitha të drejtat e fituara si rezultat i marrëdhënieve me të tretët është i detyruar që në referim të kontratës së porosisë t'ia kalojë porositësit.

Në funksion të përcaktimit të ekzistencës apo jo të fenomenit të konfliktit të interesit në marrëdhëniet ndërmjet porositësit dhe të porositurit po paraqesim për ilustrim një situatë e cila mund të ndeshet në jetën e përditshme.

Personi A lidh një kontratë porosie me personin B, e cila kishte për objekt blerjen nga ana e këtij të fundit për llogari të porositësit A të një apartamenti banimi me sipërfaqe jo më pak se 100 m², me vendodhje të përcaktuar nga palët në kontratën e porosisë së lidhur ndërmjet tyre, si dhe të ishte në gjendje të mirë. Porositësi A në funksion të realizimit nga ana e të porositurit B të objektit të kontratës i vendosi në dispozicion këtij të fundit një shumë të caktuar me anë të së cilës i porosituri B do të paguante çmimin për blerjen e apartamentit të përshkruar më lart.

I porosituri B në referim të detyrimeve të marra përsipër në kontratën e porosisë së lidhur me porositësin A nënshkruan një kontratë shitje me personin C, përfaqësues i të cilit ishte vetë ai si i porositur. Me anë të kontratës së shitjes i porosituri B blen për llogari të porositësit A me shumën e vënë në dispozicion nga ky i fundit një apartament banimi me sipërfaqe më të vogël se ajo e përcaktuar në kontratën e porosisë. Apartamenti i blerë kishte një vendodhje të ndryshme nga ajo që ishte përcaktuar nga palët në kontratën e porosisë së lidhur ndërmjet tyre, si dhe nuk ishte në gjendje të mirë.

Pas realizimit të veprimit përkatës i porosituri B njofton porositësin A me qëllim për të përmbushur detyrimin dhe konkretisht për t'i kaluar në pronësi këtij të fundit apartamentin e blerë për llogari të tij. Porositësi A pasi vihet në dijeni të veprimit të kryer nga i porosituri B refuzon të kryejë me këtë të fundit veprimin përkatës të kalimit në pronësi të tij të apartamentit të blerë nga i porosituri B me pretendimin se ky i fundit nuk kishte vepruar sipas udhëzimeve të përcaktuara në kontratën e porosisë së lidhur ndërmjet tyre.

Referuar shembullit të paraqitur rezulton dukshëm që i porosituri B të mos ketë vepruar në përputhje me udhëzimet e dhëna nga porositësi A në kontratën e porosisë së lidhur

ndërmjet tyre. Veprimin juridik rezulton që i porosituri A ta ketë kryer me një person që përfaqësohej prej tij, si dhe këtë veprim juridik nuk rezulton që ta ketë kryer në funksion të mbrojtjes së interesave të porositësit A, por në funksion të interesave të tij si i porositur.

Referuar dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e porosisë në të kundërt nga dispozitat që rregullojnë institutin e përfaqësimit nuk rezulton që të jetë parashikuar ndonjë ndalim ligjor për kryerjen e veprimeve juridike nga i porosituri me persona të tjerë që përfaqësohen prej tij, si dhe nuk rezulton që të jetë parashikuar edhe ndonjë shkak pavlefshmërie të veprimeve juridike të kryera nga i porosituri në rast se nga veprimet e këtij të fundit me të tretët qofshin këta edhe persona të përfaqësuar prej tij interesat e porositësit janë cënuar.

Arsyeja shpjegohet me faktin se sikurse kemi përshkruar edhe më lart palë në veprimet juridike që kryhen në funksion të kontratës së porosisë është i porosituri dhe jo porositësi. Pra në ndryshim nga përfaqësimi si bartës i të drejtave dhe detyrimeve në kontratat e lidhura me të tretët paraqitet i porosituri dhe jo porositësi. Ky i fundit ka të drejtë të mos i pranojë veprimet juridike të kryera nga i porosituri nëse ky i fundit nuk ka vepruar në përputhje me udhëzimet e dhëna nga ai si porositës. Në rastin kur objekt i kontratës së porosisë është blerja nga ana e të porositurit të sendeve të paluajtshme për llogari të porositësit rezulton që ligjvënësi sikurse është cituar edhe më lart në nenin 918 paragraf 2 të Kodit Civil të ketë bërë një parashikim të veçantë dhe konkretisht ka parashikuar lidhjen e një kontrate të veçantë ndërmjet porositësit dhe të porositurit. Në rast se porositësi do të konstatojë se i porosituri nuk i është përmbajtur udhëzimeve të përcaktuara në kontratën e porosisë ka të drejtë të refuzojë kalimin në pronësi të sendeve të paluajtshme të blera nga i porosituri për llogari të tij si porositës. Gjithashtu ai ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës së porosisë së lidhur me të porositurin dhe t'i kërkojë këtij të fundit edhe kthimin e shumës që i është dhënë në dispozicion për realizimin e kontratës së porosisë, si dhe shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar nga veprimet e të porositurit.

Si përfundim në dallim nga instituti i përfaqësimit në të cilin ekziston konflikti i interesit ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, në Kontratën e Porosisë nuk ekziston konflikti i interesit ndërmjet porositësit dhe të porositurit.

ii) Ngjashmëritë :

a) Instituti i Përfaqësimit krahas dallimeve që ka me Kontratën e Porosisë ka dhe të përbashkëta me këtë të fundit. E përbashkëta kryesore qëndron në faktin se nëse të porositurit në kontratën e porosisë i është dhënë e drejta për të vepruar në emër dhe për llogari të porositësit zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin.

Fakti i sipërcituar gjendet i sanksionuar në nenin 914 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të vepruar në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin”*.

b) Ngjashmëri tjetër qëndron në faktin se si përfaqësuesi ashtu edhe i porosituri duhet të kenë zotësi të plotë për të vepruar, në të kundërt asnjëri prej tyre nuk mund të jetë as në pozitën e përfaqësuesit dhe as në pozitën e të porositurit. Arsyeja lidhet me faktin e thjeshtë që zotësia për të vepruar është kusht i domosdoshëm që personi të kuptojë rëndësinë e veprimeve që po kryen, si dhe të marrë përsipër të drejta dhe detyrime juridiko - civile.

Sipas legjislacionit Italian në ndryshim nga legjislacioni ynë nuk paraqitet si kusht i domosdoshëm që përfaqësuesi të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Në një përfundim të tillë arrihet referuar nenit 1389 të Kodit Civil Italian. Në doktrinën italiane të së drejtës në citimin e dallimeve ndërmjet institutit të përfaqësimit dhe kontratës së porosisë krahas faktit që prokura është një akt i njëanshëm dhe porosia një veprim juridik i dyanshëm, një dallim tjetër që ata citojnë është edhe fakti se kushtet e vlefshmërisë së prokurës janë të ndryshme me atë të porosisë. Kështu sipas legjislacionit Italian kontrata e porosisë është e pavlefshme kur i porosituri nuk e ka zotësinë juridike për të vepruar për vetë faktin se ai është palë në kontratë, ndërsa në rastin e përfaqësimit ndodh e kundërta dhe konkretisht sipas legjislacionit Italian nuk është e nevojshme zotësia juridike për të vepruar e përfaqësuesit, mjafton që i përfaqësuarit të ketë zotësi juridike. Këtë ndryshim e shpjegojnë me arsyetimin se përfaqësuesi nuk disponon të drejtat e tij por të drejtat e të tjerëve. Sipas legjislacionit italian kontrata e lidhur nga përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit do të ishte e vlefshme edhe nëse përfaqësuesi do të ishte i mitur ose një person të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

Vlerësimi im personal në një rast të tillë është se qëndrimi që mbahet nga ana e legjislacionit dhe jurisprudencës italiane nuk qëndron duke e gjetur të drejtë në këtë mënyrë parashikimin tonë ligjor të përcaktuar në nenin 64 paragraf 3 të Kodit Civil sipas të cilit nuk mund të veprojnë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar për arsye se pavarësisht se përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit ai shfaq vullnetin e tij, si dhe nga veprimet e tij lindin të drejta dhe detyrime për të përfaqësuarin pavarësisht se përfaqësuesi nuk disponon të drejtat e tij por ato të të përfaqësuarit.

Sikurse e kemi përshkruar edhe më lart gjithmonë veprimet e përfaqësuesit duhet të jenë në interes të të përfaqësuarit referuar faktit se përfaqësuesi paraqitet gjithmonë si mbrojtës dhe mbajtës i të drejtave të të përfaqësuarit. Në rrethanat kur ligji merr në mbrojtje të miturit dhe personat të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar për shkak se nuk janë të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që ata kryejnë madje vetë ligji ka parashikuar se këto të fundit në veprimet juridike në të cilat ato paraqiten si palë përfaqësohen nga prindërit ose nga kujdestari i caktuar nga ana e gjykatës do të ishte tej kufijve të arsyes të mendohej se të miturit dhe personat të cilëve u është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar të mund të ushtronin funksionin e përfaqësuesit duke nënshkruar për këtë qëllim në emër dhe për llogari të një personi tjetër, ku nga këto veprime të kryera nga një i mitur ose një person që i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar atyre u lindin të drejta dhe marrin përsipër detyrime juridiko – civile ndaj të tretëve.

I diskutueshëm mund të paraqitet rasti kur elementët e veprimit juridik që do të kryejë përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit do të jenë të përcaktuar në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuari. Për shembull i përfaqësuari e ka caktuar në prokurë çmimin e shitjes së një sendi. ***Në këtë rast mund të shtrohej si pyetje nëse përfaqësuesi shfaq apo jo vullnet në veprimet që kryen ?***

Edhe në një rast të tillë vlerësimi im është se përfaqësuesi shfaq vullnet pavarësisht se nga ana e të përfaqësuarit mund të jenë përcaktuar shprehimisht veprimet që do të kryejë përfaqësuesi. Le të themi është përcaktuar qartë çmimi me të cilin përfaqësuesi do të shesë një apo disa sende të caktuara. Kjo shfaqje vullneti konsiston në zgjedhjen e personave me të cilët ai si përfaqësues do të hyjë në marrëdhënie kontraktore në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit. Në të tilla raste gjithmonë konkurrenca vullneti i të përfaqësuarit për elementët kontraktorë që janë paracaktuar prej këtij të fundit me vullnetin e përfaqësuesit dhe konkretisht lidhur me të drejtën e këtij të fundit për të zgjedhur personat me të cilët do të kontraktojë. Edhe në një rast të tillë përsëri arrihet në përfundimin se përfaqësuesi duhet të ketë zotësi juridike për të vepruar.

c) Një ngjashmëri tjetër lidhet edhe me mënyrën e përfundimit të përfaqësimit vullnetar dhe shuarjes së porosisë. Kështu në nenin 76 të Kodit Civil parashikohen rastet e shuarjes së prokurës, ndërsa në nenin 927 të Kodit Civil parashikohen rastet e shuarjes së kontratës së porosisë. Prokura nuk sjell më efekte ligjore në rastet kur përfaqësuesi ose i përfaqësuari kanë vdekur ose njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar. Të njëjtat shkaqe vlejné edhe për shuarjen e kontratës së porosisë. Por ndërsa në rastin e mbarimit të prokurës rastet e cituara më lart parashikohen në mënyrë taksative, pra që prokura mbaron automatikisht dhe nuk sjell efekte në raste se vërtetohet njëri nga shkaqet e mësipërme, në kontratën e porosisë ligji iu njeh mundësinë palëve që të parashikojnë në kontratë që porosia të mos mbarojë në rast vdekjeje ose pazotësie për të vepruar të ndonjërit nga palët. Në një përfundim të tillë arrihet nga vetë shprehja e përdorur në dispozitën e sipërcituar : ***“përveç marrëveshjes tjetër”***. Madje vetë ligji ju njeh të drejtën palëve që edhe në rast se ata nuk e kanë parashikuar shprehimisht se kontrata e porosisë të mos shuhet për ndonjë nga shkaqet e cituara në nenin 927 të Kodit Civil përsëri kontrata nuk do të konsiderohet e shuar nëse do të rezultojë ndryshe nga natyra e rrethanave të krijuara, pra nëse do të cenoheshin rëndë interesat e ndonjërit prej palëve si rrjedhojë e shuarjes së porosisë për shkak të vërtetimit të ndonjë prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht në dispozitën e sipërcituar, palës së cilës i cenohen rëndë interesat ka të drejtë të kërkojë vazhdimin e kontratës.

Një ndër rastet e tjera të përshkruara në nenin 76 të Kodit Civil që sjell mbarimin e efekteve të prokurës është edhe kur përfaqësuesi i ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo është dhënë. Pavarësisht se në nenin 927 të Kodit Civil nuk citohet si rast i shuarjes së porosisë kur i porosituri përfundon detyrimet që ka marrë përsipër në kontratë vlerësoj se një rast i tillë vlen edhe për kontratën e porosisë, kjo për faktin se përmbushja e detyrimeve nga ana e të porositurit të përcaktuara këto në kontratën e porosisë sjell si pasojë mbarimin e efekteve të saj dhe rrjedhimisht edhe shuarjen e saj si kontratë.

Një ndër rastet e tjera që sipas parashikimeve të nenit 76 të Kodit Civil sjell si pasojë mbarimin e prokurës është edhe rasti kur ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar. Ndonëse një rast i tillë nuk parashikohet shprehimisht në nenin 927 të Kodit Civil vlerësoj se një rast i tillë vlen edhe për shuarjen e porosisë. Në fakt dispozita e sipërcituar përcakton si rast të shuarjes së porosisë falimentimin e porositësit ose të porositurit. Nëse do t'i referohemi përcaktimeve të nenit 34 të Kodit Civil në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se : *“Personi juridik mbaron sipas mënyrës së caktuar në aktin e krijimit, në statut ose në ligj”*.

Një nga format e mbarimit të personit juridik është edhe falimentimi, ku pas përfundimit të procedurës së falimentimit një nga pasojat është edhe ç’regjistrimi si person juridik të shoqërisë të deklaruar si e falimentuar.

Një formë tjetër e mbarimit të personit juridik është edhe kalimi i afatit ose kohëzgjatjes së përcaktuar nga ortakët në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, nëse ky afat nuk zgjatet, si dhe një formë tjetër është edhe likuidimi i shoqërisë. Në të dyja rastet personi juridik mbaron dhe për këtë shkak edhe ç’regjistrohet. Me të drejtë do të shtrohej si pyetje në rast të mbarimit të personit juridik porositës apo të porositur a do të mund të vijonte kontrata e porosisë ?

Dihet se si rrjedhje e mbarimit të personit juridik, ky i fundit nuk ka më personalitet juridik. Në kushtet e mungesës së personalitetit juridik në referim të përcaktimeve të nenit 29 të Kodit Civil personi juridik e humbet zotësinë për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime juridiko - civile.

Si përfundim vlerësoj se edhe mbarimi i personit juridik do të sjellë si pasojë shuarjen e porosisë.

Një ndër rastet e tjera që sipas parashikimeve të nenit 76 të Kodit Civil sjell si pasojë mbarimin e prokurës është edhe kur është plotësuar afati për të cilën ajo është dhënë. Ndonëse një rast i tillë nuk parashikohet shprehimisht në nenin 927 të Kodit Civil vlerësoj se një rast i tillë vlen edhe për shuarjen e porosisë.

Le të marrim një shembull për të ilustruar situatën e sipërcituar.

Personi A lidh një kontratë porosie me personin B sipas së cilës ky i fundit do të kryente disa veprime juridike për llogari të porositësit A për një periudhë 1 (një) vjeçare.

Si rrjedhje e kalimit të afatit një vjeçar me të drejtë do të konsiderohet se kontrata e lidhur nuk mund të prodhojë më efekte ligjore dhe si rrjedhje porosia do të konsiderohet e shuar.

ç) Një tjetër ngjashmëri është edhe rasti i parashikuar në nenin 68 të Kodit Civil sipas të cilit kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe. Ky parashikim ligjor do të zbatohet edhe në kontratën e porosisë, ndonëse në dispozitat që rregullojnë kontratën e porosisë nuk është parashikuar. Pra nëse porositësi do të caktonte dy ose më shumë të porositur për kryerjen e veprimeve juridike të caktuara atëherë secili prej tyre mund t'i kryente këto veprime vetë pa pjesmarrjen e të porositurit tjetër.

d) Një tjetër ngjashmëri është edhe rasti i parashikuar në nenin 929 të Kodit Civil sipas të cilit : *“Emërimi i një të porosituri të ri për të njëjtën marrëveshje ose kryerja e kësaj nga ana e porositësit sjell heqjen e porosisë dhe ka efekt qysh nga dita kur i janë njoftuar të porositurit”*.

Sikurse e kemi përshkruar edhe më lart shkaku kryesor që sjell lindjen e marrëdhënies ndërmjet porositësit dhe të porositurit është ekzistenca e disa rrethanave objektive ose mungesa e disa cilësive që e bëjnë të pamundur kryerjen e veprimeve juridike nga vetë porositësi, veprime juridike këto në kryerjen e të cilave porositësi shfaq interes. Por mund të ndodhë që në një moment të mëvonshëm nga lidhja e kontratës porositësi mund ta fitojë atë cilësi që është e nevojshme për kryerjen e veprimit juridik dhe si rrjedhojë kontrata e porosisë e lidhur ndërmjet palëve do e humbte rëndësinë e saj dhe heqjen e të porositurit siç është parashikuar edhe në nenin 929 të Kodit Civil. I njëjti arsyetim do të vllente dhe për rastin e përfaqësimit sepse edhe këtu i përfaqësuarit detyrohet nga rrethana të caktuara të cilat i imponojnë këtij të fundit pamundësinë e kryerjes personalisht të disa veprimeve juridike për të cilat ai shfaq interes. Në funksion të kryerjes së këtyre veprimeve me anë të një veprimi juridik të njëanshëm sikurse është prokura cakton një ose më shumë persona si përfaqësues të tij me qëllim realizimin e këtyre veprimeve. Nëse rrethanat të cilat nuk i mundësonin të përfaqësuarit të ishte vetë i pranishëm në kryerjen e veprimit juridik nuk janë më të pranishme dhe i përfaqësuarit mund t'i kryejë vetë veprimet juridike atëherë edhe prokura do e humbte rëndësinë apo qëllimin për të cilin ishte lëshuar dhe si e tillë nuk do të kishte më vlerë, si dhe do të përbënte shkak për revokimin e prokurës nga i përfaqësuarit.

Në rastin e sipërcituar si heqja e porosisë ashtu edhe revokimi i prokurës do t'i sillnin efektet e tyre që nga momenti që do t'i njoftoheshin të porositurit ose përfaqësuesit.

Kur trajtuam kontratën e porosisë dhe përfaqësimin si institut të së drejtës civile theksuam se këto bazohen në parimin e besimit që porositësi apo i përfaqësuarit kanë tek personat që zgjedhin si të porositur dhe si përfaqësues. Në rast se ky besim humbet ligji i njeh mundësinë si porositësit ashtu edhe të përfaqësuarit që të emërojnë një të porositur të ri ose një përfaqësues të ri. Emërimi i një të porosituri të ri ose të një përfaqësuesi të ri sjell të njëjtën pasojë dhe konkretisht tek kontrata e porosisë sjell heqjen e porosisë, ndërsa tek përfaqësimi sjell përfundimin e marrëdhënies së përfaqësimit.

Më lart cituam që një tjetër shkak i heqjes së porosisë ishte edhe emërimi i një të porosituri të ri. Ky shkak vlen edhe për mbarimin e marrëdhënies së përfaqësimit pra si rrjedhojë e caktimit të një përfaqësuesi të ri marrëdhënia me përfaqësuesin e mëparshëm përfundon.

Edhe në një rast të tillë akti i emërimit të të porositurit të ri ashtu edhe akti i emërimit të një përfaqësuesi të ri do të sjellin efektet e tyre që nga momenti që do t'i njoftoheshin të porositurit ose përfaqësuesit.

dh) Një tjetër ngjashmëri është edhe se të gjitha veprimet që i porosituri apo përfaqësuesi kanë kryer para se të njoftohen për heqjen e porosisë apo revokimin e prokurës janë të vlefshme dhe do të sjellin pasojë si ndaj porositësit ashtu edhe ndaj të përfaqësuarit. Gjithashtu veprimet e kryera nga i porosituri ashtu edhe nga përfaqësuesi do të

konsiderohen të vlefshme dhe do të sjellin pasoja edhe ndaj trashëgimtarëve të porositësit dhe trashëgimtarëve të të përfaqësuarit për ato veprime që janë kryer nga i porosituri apo përfaqësuesi gjatë gjallërisë së porositësit apo të përfaqësuarit.

Më lart parashtruar në mënyrë të hollësishme dallimet ndërmjet institutit të përfaqësimit dhe kontratës së porosisë. Megjithatë në jetën e përditshme në shumë raste nuk arrihet të bëhet ky dallim, si dhe në mjaft akte noteriale apo kontrata të lidhura në prani të noterit nga palët kontraktuese konstatohen mangësi të theksuara në përdorimin e termit kontratë porosie duke mos bërë dallimin ndërmjet kësaj të fundit dhe përfaqësimit si institut i së drejtës.

Në funksion të kësaj që parashtruar më lart po paraqesim një shembull nga praktika gjyqësore :

Personat A, B dhe C rezultojnë të ishin përfitues të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit D. Ky i fundit kishte pasur në pronësi të tij disa pasuri të paluajtshme të cilat i ishin sekuestruar nga shteti shqiptar pas vitit 1944. Trashëgimtarët A, B dhe C rezultojnë që me anë të një prokure të përgjithshme kishin caktuar si përfaqësues të tyre personin E, të cilit i kishin dhënë tagra për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe gjyqësore për njohjen dhe kthimin e pronave që trashëgimlënësi i tyre D kishte pasur në pronësi në referim kjo të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish Pronarëve”. Pas caktimit të personit E si përfaqësues ndërmjet këtij të fundit dhe personave A, B dhe C si trashëgimtarë të trashëgimlënësit D rezultojnë që të jetë lidhur një kontratë e emërtuar nga palët si Kontratë Porosie sipas së cilës personat A, B dhe C me cilësinë e porositësit në këtë kontratë binin dakord që t’i jepnin secili prej tyre nga 2 % të pasurisë që do përfitonin nga njohja dhe kthimi i pronave të trashëgimlënësit të tyre D të porositurit të tyre E, i cili sikurse parashtruar edhe më lart ishte përfaqësues i tyre i caktuar me prokurë. Kjo kontratë rezultojnë që të jetë vërtetuar edhe para noterit publik. Përfaqësuesi E në referim të tagrave të dhëna në prokurën e lëshuar nga të përfaqësuarit A, B dhe C rezultojnë që të ketë përfunduar të gjithë procesin e njohjes dhe kthimit të pronave të trashëgimlënësit të këtyre të fundit duke i regjistruar këto pasuri në emër të të përfaqësuarve prej tij edhe në regjistrat publikë. Si rrjedhojë e refuzimit të personave A, B dhe C për të përmbushur detyrimin që rridhte nga kontrata e porosisë së lidhur me përfaqësuesin E, ky i fundit rezultojnë që t’i jetë drejtuar Gjykatës me kërkesë – padi duke kërkuar detyrimin gjyqësor të personave A, B dhe C për të përmbushur detyrimin e përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet tyre. Pas shqyrtimit të konfliktit përkatës rezultojnë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë të kenë vendosur pranimin e pjesës së kërkesës – padisë ndërsa Gjykata e Lartë rezultojnë të ketë vendosur ndryshimin e vendimeve të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë duke vendosur pranimin e plotë të padisë së paraqitur nga personi E¹¹⁸.

Në referim të rrethanave që u parashtruan më lart objekt analize nuk do të jetë zgjidhja e drejtë ose jo e çështjes nga gjykatat, por përcaktimi i cilësisë në të cilën rezultojnë që të ketë vepruar personi E, pra nëse ky i fundit rezultojnë të ketë vepruar në cilësinë e përfaqësuesit apo në cilësinë e të porositurit.

¹¹⁸ Referoju për këtë qëllim vendimit nr. 516, datë 11.03.2003 të Gjykatës së Lartë.

Referuar fakteve të parashtruara më lart rezulton që personat A, B dhe C t'i kenë lëshuar personit E një prokurë në referim të të cilës ai autorizohej për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme në emër dhe për llogari të tyre, lidhur me fitimin nga ana e tyre të të drejtave të pronësisë së trashëgimlënësit të tyre. Në një moment të mëvonshëm rezulton që ndërmjet personave të sipërcituar të jetë lidhur edhe një kontratë e emërtuar nga palët si kontratë porosie sipas së cilës secili prej personave A, B dhe C detyrohej t'i jepte personit E nga 2 % të pjesës së tyre takuese.

Nga faktet e cituara më lart arrihet në përfundimin se ndërmjet personave A, B dhe C nga njëra anë dhe personit E nga ana tjetër të kenë lindur dy marrëdhënie juridike. **Në të parën** : Personi E paraqitet në pozitën e përfaqësuesit, ndërsa **në të dytën** : Personi E paraqitet në pozitën e të porositurit sipas së cilës për të gjitha veprimet që personi E do të kryente për llogari të personave A, B dhe C me qëllim që këto të fundit të rifitonin të drejtën e pronësisë së trashëgimlënësit të tyre D do të përfitonte si shpërblim nga 2 % të pasurisë së përfituar nga secili prej tyre.

Në të dyja këto marrëdhënie personi E rezulton të ketë vepruar si përfaqësues i personave A, B dhe C dhe jo si i porositur i këtyre të fundit për arsye se në të gjitha rastet rezulton që të ketë vepruar në emër dhe për llogari të këtyre të fundit. Marrëdhënia e dytë nuk përbën gjë tjetër vetëm se përcaktimin nga ana e palëve të shpërblimit që personi E do të përfitonte nga puna e kryer prej tij si përfaqësues. Në referim të kuadrit ligjor nuk mund që personi E të vepronte në emër të tij dhe për llogari të personave A, B dhe C për shkak se ai nuk mund të paraqitej si kërkues në procesin e njohjes dhe kthimit të pronave të trashëgimlënësit të personave të sipërcituar. Sikurse kemi përshkruar edhe më lart në nenin 914 të Kodit Civil përcaktohet shprehimisht se : *“Në qoftë se të porositurit i është dhënë kompetenca për të veprua në emër të porositësit, zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin”*.

Si përfundim mund të themi se e vetmja marrëdhënie që ka ekzistuar ndërmjet palëve është ajo e përfaqësimit me shpërblim, sipas së cilës personi E për punën e kryer si përfaqësues do të përfitonte edhe shpërblimin përkatës nga ana e të përfaqësuarve A, B dhe C.

Dallimet dhe ngjashmëritë e Institutit të Përfaqësimit nga Kontrata e Komisionit.

i) Dallimet :

a) Në nenin 935 të Kodit Civil jepet edhe përkufizimi apo kuptimi i kontratës së komisionit duke u përcaktuar shprehimisht se : *“Kontrata e komisionit është një porosi që ka për objekt blerjen dhe shitjen e sendeve për llogari të porositësit dhe në emër të komisionerit”*

Referuar përkufizimit të dhënë për kontratën e komisionit rezulton që kjo e fundit të mos jetë gjë tjetër veç se një lloj porosie që ka si objekt të saj një shërbim të specifikuar të

ofruar nga ana e të porositurit që ka të bëjë më specifikisht me një veprimtari të caktuar dhe konkretisht për blerjen dhe shitjen e sendeve. Me të drejtë mund të themi se kontrata e komisionit nuk është gjë tjetër vetëm se një variant i kontratës së porosisë me specifikimin përkatës që ka për objekt të saj vetëm blerjen dhe shitjen e sendeve për llogari të porositësit, por në emër të komisionerit.

Veçoria kryesore e kësaj kontrate ashtu si dhe ajo e porosisë dhe agjencisë që do të trajtohet më poshtë është se komisioneri gjithmonë veprimet juridike me të tretët i kryen në emër të tij por për llogari të porositësit. Pra nëse komisioneri do të paraqitet në pozitën e blerësit mbi të do të rëndojë edhe detyrimi për pagimin e çmimit dhe nëse do të paraqitet si shitës mbi të do të rëndojë detyrimi për dorëzimin e sendeve në rastin e sendeve të përcaktuara në gjini, si dhe mbi të do të rëndojë edhe detyrimi edhe në lidhje me garancitë përkatëse.

Veçoria e sipërcituar rezulton që të jetë edhe dallimi esencial apo kryesor ndërmjet kontratës së komisionit dhe institutit të përfaqësimit, ku sipas këtij të fundit përfaqësuesi vepron gjithmonë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, duke mos u paraqitur në asnjë rast si palë në veprimet juridike të kryera nga ai si përfaqësues.

b) Dallim tjetër është edhe se kontrata e komisionit është një kontratë me shpërblim. Kjo veçori gjendet e përcaktuar shprehimisht në ligj dhe konkretisht në nenin 936 të Kodit Civil ku parashikohet shprehimisht se porositësi detyrohet t'i paguajë komisionerit shpërblimin që parashikohet në kontratën e komisionit, ndërsa përfaqësimi si rregull është pa shpërblim.

c) Një tjetër dallim i rëndësishëm është se kontrata e komisionit është një veprim juridik i dyanshëm, ndërsa përfaqësimi në rastin e përfaqësimit vullnetar lind në referim të një veprimi juridik të njëanshëm siç është prokura.

ç) Dallim tjetër është se kontrata e komisionit shoqërohet gjithmonë me kryerjen e dy veprimeve juridike dhe konkretisht njëri veprim juridik kryhet ndërmjet porositësit dhe komisionerit, ndërsa veprimi tjetër kryhet ndërmjet këtij të fundit dhe personit të tretë nga i cili komisioneri blen apo shet sendet për llogari të porositësit. Te përfaqësimi sikurse e kemi kemi referuar gjatë trajtimit të tij rezulton që i përfaqësuarit ngarkon përfaqësuesin për të hyrë drejtpërdrejt në kontakt me personin e tretë, si dhe për të kryer veprimet juridike përkatëse në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Pikërisht referuar karakteristikës së sipërcituar në doktrinë ekziston edhe ndarja përkatëse e përfaqësimit në përfaqësim të drejtpërdrejtë dhe përfaqësim të tërthortë.

d) Dallim tjetër është edhe se komisioneri në rastin e kontratës së komisionit kryen vetëm veprime juridike ndërsa tek përfaqësimi, përfaqësuesi mund të kryejë edhe veprime të tjera që nuk hyjnë në kategorinë e veprimeve juridike siç mund të jetë kryerja e një shërbimi të caktuar në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, paraqitja e një kërkesë – padie në gjykatë ...etj.

ii) Ngjashmëritë :

a) Ngjashmëria kryesore mes përfaqësimit dhe kontratës së komisionit është se si përfaqësuesi ashtu edhe komisioneri veprojnë gjithmonë për llogari të të përfaqësuarit apo të porositësit. Edhe në rastet kur përfaqësuesi ose komisioneri i kryejnë veprimet juridike në kushte më të favorshme se ato për të cilat janë caktuar përfitimet gjithmonë shkojnë në favor të porositësit ose të të përfaqësuarit.

Ndërsa në rastin e përfaqësimit fakti i sipërcituar është mëse evident në kushtet kur palë në veprimin juridik rezulton të jetë vetë i përfaqësuari si dhe nuk do ishte e nevojshme që kjo të pasqyrohej në ligj, ndërsa në rastin e kontratës së komisionit fakti i sipërcituar përcaktohet shprehimisht në ligj dhe konkretisht në nenin 939 të Kodit Civil ku parashikohet shprehimisht se : *“Kur komisioneri ka kryer veprimin juridik në kushte më të dobishme nga ato të udhëzimeve që i kishte dhënë porositësi, gjithçka që komisioneri ka fituar në këtë rast kalon në dobi të porositësit”*.

b) Një ngjashmëri tjetër është edhe se sikurse përfaqësuesi ashtu edhe komisioneri nuk përgjigjen për ekzekutimin e detyrimeve nga ana e personave të tretë. Në rastin e përfaqësimit si rregull përfaqësuesi gjithmonë i kryen veprimet juridike në interes të të përfaqësuarit. Një fakt i tillë nënkupton që përfaqësuesi i zgjedh me kujdes personat e tretë me të cilët hyn në marrëdhënie kontraktore në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit duke verifikuar për këtë qëllim edhe aftësitë përmbushëse të tyre. I njëjti arsyetim vlen edhe për komisionerin madje shmangia e komisionerit nga përgjegjësia për ekzekutimin e detyrimeve nga ana e personave të tretë përcaktohet shprehimisht edhe në nenin 938 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Komisioneri nuk përgjigjet për ekzekutimin nga ana e personit të tretë të kontratës së lidhur nga komisioneri me të për llogari të porositësit, përveç kur në kontratën e komisionit parashikohet ndryshe”*.

Gjithmonë rregulli i sipërcituar vlen kur përfaqësuesi apo komisioneri kanë vepruar në mirëbesim. Në rastet kur vërtetohet se përfaqësuesi apo komisioneri kanë vepruar në keqbesim ndaj të përfaqësuarit apo ndaj porositësit gjithmonë do të jenë përgjegjës përkundrejt këtyre të fundit. Sikurse e kemi përshkruar edhe më lart në rastin e përfaqësimit ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi në dëm të të përfaqësuarit për shkak të marrëveshjes me keqbesim ndërmjet përfaqësuesit dhe personit të tretë shpallen të pavlefshme me kërkesë të të përfaqësuarit. Edhe në rastin e kontratës së komisionit ligji e ka parashikuar mundësinë që komisioneri të konsiderohet përgjegjës për mospërmbushjen e detyrimeve nga ana e personave të tretë. Gjithsesi ashtu edhe sikurse te kontrata e porosisë nëse porositësi konstaton se komisioneri nuk i është përmbajtur udhëzimeve të dhëna në kontratën e komisionit nuk është i detyruar t'i pranojë veprimet e kryera nga ana e komisionerit, si dhe të kërkojë zgjidhjen e kontratës me këtë të fundit dhe detyrimin e tij edhe për t'i shpërblyer dëmin e shkaktuar.

c) Një ngjashmëri tjetër është edhe se komisioneri dhe përfaqësuesi duhet të kenë zotësi të plotë për të vepruar. Në rastin e përfaqësimit një kusht i tillë është i parashikuar shprehimisht në ligj, ndërsa në rastin e kontratës së komisionit ky kusht është i

nënkuptuar referuar faktit se vetëm personat që kanë zotësi të plotë për të vepruar mund të kryejnë veprime juridike sipas të cilave ata marrin përsipër të drejta dhe detyrime juridiko – civile. Mungesa e zotësisë për të vepruar përbën shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e veprimit juridik.

ç) Një ngjashmëri tjetër është edhe se si marrëdhënia e përfaqësimit ashtu edhe kontrata e komisionit përfundojnë me vdekjen e përfaqësuesit ose me vdekjen e komisionerit ashtu edhe kur përfaqësuesi ose komisionieri humbasin zotësinë për të vepruar.

d) Një ngjashmëri tjetër është se si marrëdhënia e përfaqësimit ashtu edhe kontrata e komisionit përfundojnë me mbarimin nga ana e përfaqësuesit të veprimeve juridike të përcaktuara në prokurë ose me mbarimin nga ana e komisionerit të veprimeve juridike të përcaktuara në kontratën e komisionit.

Dallimet dhe ngjashmëritë e institutit të përfaqësimit nga kontrata e agjencisë.

i) Dallimet :

a) Në nenin 950 të Kodit Civil rezulton të jetë dhënë edhe përkufizimi i kontratës së agjencisë duke u përcaktuar shprehimisht se : *“Me kontratën e agjencisë njëra palë merr përsipër, në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër”*.¹¹⁹

Në referim të përkufizimit të dhënë për kontratën e agjencisë arrihet në përfundimin se dallimi kryesor i kësaj të fundit me institutin e përfaqësimit është se e para është një kontratë pra një veprim juridik i dyanshëm, ndërsa e dyta është një veprim juridik i njëanshëm.

b) Dallim tjetër është se në kontratën e agjencisë, agjenti sikurse edhe i porosituri dhe komisioneri gjithmonë veprimet juridike i kryen në emër të tij por për llogari të porositësit ndërsa tek përfaqësimi, përfaqësuesi i kryen veprimet në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit¹²⁰.

Ajo çfarë konstatohej më parë ishte se tek dispozitat që rregullonin kontratën e agjencisë para ndryshimeve që i janë bërë këtyre dispozitave me ligjin nr. 121/2013 dhe konkretisht në nenin 961 të Kodit Civil, para se kjo dispozitë të ndryshohej parashikohej shprehimisht se : *“Dispozitat që rregullonin kontratën e agjencisë zbatoheshin edhe kur pala porositëse i jepte agjentit të drejtën e përfaqësimit për lidhjen e kontratave”*¹²¹, në dallim kjo nga kontrata e porosisë dhe ajo e komisionit që në rast se porositësi apo komisioneri vepron në emër dhe për llogari të porositësit zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin.

¹¹⁹ Neni 950 i Kodit Civil.

¹²⁰ Marjana Semini, “E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave” Pjesa e Posaçme fq 135 – 140.

¹²¹ Referoju për këtë qëllim nenit 961 të Kodit Civil para ndryshimeve që ka pësuar kjo dispozitë me ligjin nr. 121/2013.

Vlerësimi im personal është se shfuqizimi i parashikimit të mëparshëm ligjor duhet interpretuar se edhe te kontrata e agjencisë në rastet kur porositi i ka njohur agjentit të drejtën për të lidhur kontratat në emër dhe për llogari të tij ashtu sikurse edhe te kontrata e porosisë dhe komisionit do të zbatohen dispozitat mbi përfaqësimin. Në një përfundim të tillë do të arrihet referuar për këtë qëllim ndryshimit që nga ana e ligjvënësit i është bërë nenit 961 të Kodit Civil i cili më parë parashikonte rregullim të posaçëm. Në kushtet e mungesës së një parashikimi të posaçëm atëherë do të zbatohen parimet e përgjithshme. Parimi se ligji i posaçëm lë pa veprim ligjin e përgjithshëm (*Lex specialis derogat legi generali*) gjen zbatim vetëm në ato raste kur ekziston një parashikim në ligjin apo dispozitat e posaçme që rregullojnë një marrëdhënie të caktuar, në mungesë të tyre zbatohen parashikimet e përgjithshme.

c) Një dallim tjetër është se kontrata e agjencisë është gjithmonë një kontratë me shpërblim, ndërsa përfaqësimi si rregull është pa shpërblim.

ç) Dallim tjetër është se në referim të përkufizimit të dhënë për kontratën e agjencisë, agjenti kryen shërbime vetëm në një zonë të caktuar me të cilën kuptojnë jo vetëm një hapësirë gjeografike, apo një territor kufijtë e të cilit përcaktohen në kontratë por edhe në një fushë të caktuar veprimtarie ekonomike dhe tregtare, ndërsa tek përfaqësimi, përfaqësuesi mund të kryejë një shumëllojshmëri veprimet në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, çfarë nënkupton faktin se përfaqësuesi në ndryshim nga agjenti nuk ka kufizim për të vepruar në një zonë të caktuar.

ii) Ngjashmëritë :

a) Ngjashmëria kryesore ndërmjet institutit të përfaqësimit dhe kontratës së agjencisë është se si përfaqësuesi ashtu edhe agjenti duhet të kenë zotësi të plotë për të vepruar. Në rastin e përfaqësimit një kusht i tillë është i parashikuar shprehimisht në ligj, ndërsa në rastin e kontratës së agjencisë ky kusht është i nënkuptuar referuar faktit se vetëm personat që kanë zotësi të plotë për të vepruar mund të kryejnë veprime juridike sipas të cilave ata marrin përsipër të drejta dhe detyrime juridiko – civile. Mungesa e zotësisë për të vepruar përbën shkak për të kërkuar pavlefshmërinë e veprimit juridik.

b) Ngjashmëri tjetër është se si tek përfaqësimi ashtu edhe te kontrata e agjencisë gjen zbatim parimi i konfliktit të interesit. Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim parashikimeve ligjore që gjenden të sanksionuara si në dispozitat që rregullojnë institutin e përfaqësimit ashtu edhe në dispozitat që rregullojnë kontratën e agjencisë. Konkretisht ashtu si përfaqësuesi i cili nuk mund të kryejë veprime juridike me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij edhe agjenti nuk mund të trajtojë njëkohësisht në të njëjtën zonë apo për të njëjtin grup klientësh dhe për të njëjtën fushë¹²².

c) Një ngjashmëri tjetër është se si përfaqësimi ashtu edhe kontrata e agjencisë përfundojnë me vdekjen e përfaqësuesit ose të agjentit, si dhe kur përfaqësuesi apo agjenti humbasin zotësinë juridike për të vepruar.

¹²² Referoju për këtë qëllim neneve 67 dhe 951 të Kodit Civil

ç) Një ngjashmëri tjetër është se si marrëdhënia e përfaqësimit ashtu edhe kontrata e agjencisë përfundojnë me mbarimin nga ana e përfaqësuesit të veprimeve juridike të përcaktuara në prokurë ose me mbarimin nga ana e agjentit të veprimeve juridike të përcaktuara në kontratën e agjencisë.

d) Një ngjashmëri tjetër është se si përfaqësuesi ashtu edhe agjenti duhet t'i kryejnë punët personalisht.

KREU V

V. Përfaqësimi në Gjyq (Ad Litem), si dhe aspekte të praktikës gjyqësore lidhur me Institutin e Përfaqësimit.

Kuptimi, llojet dhe karakteristikat e përfaqësimit gjyqësor.

Kur trajtuam konceptin e përfaqësimit theksuam se përfaqësuesi nuk kryen vetëm veprime juridike por edhe veprime të tjera të ligjshme. Një ndër këto veprime është edhe përfaqësimi në veprimet para gjykatës. Përfaqësimi gjyqësor është njëri prej llojeve të përfaqësimit, i cili ka gjetur rregullimin e tij në nenet 90-99 të Kodit të Proçedurës Civile.

Në doktrinën e së drejtës rezulton që përfaqësimi gjyqësor të jetë përkufizuar në këtë mënyrë: *"Përfaqësimi gjyqësor është ajo marrëdhënie në bazë të së cilës një person (përfaqësuesi) kryen veprime proceduriale në emër dhe për llogari të një personi tjetër (i përfaqësuarit që është palë në gjykim) duke ushtruar të drejtat dhe detyrat proceduriale të të përfaqësuarit brenda kufijve të të drejtave që i janë dhënë"*¹²³.

E drejta e palëve ndërgjyqëse që të ndjekin çështjen në gjyq me anën e një përfaqësuesi nuk është e kufizuar nga asnjë kusht dhe prandaj gjykata nuk ka të drejtë të mos pranojë emërimin e një përfaqësuesi nga ana e seciles nga palët ndërgjyqëse, në rast se përfaqësuesi është një nga ata persona që kanë të drejtë të jenë përfaqësues.

Përfaqësimi gjyqësor si një nga llojet e përfaqësimit ka këto veçori :

- a) veprimtaria proceduriale e përfaqësuesit nuk zhvillohet në emrin e tij, por në emër të personit që përfaqëson në gjykimin civil ;
- b) përfaqësimi gjyqësor ka karakter individual ;
- c) pasojat juridike të veprimtarisë proceduriale të përfaqësuesit të ushtruara brenda kufijve të të drejtave që i janë dhënë nga i përfaqësuarit i përkasin këtij të fundit.

Karakterit individual i përfaqësimit gjyqësor lidhet me faktin se pavarësisht se pala e përfaqësuar në një gjykim civil mund të përfaqësohet nga disa përfaqësues, secili prej tyre mund ta ushtrojë përfaqësimin në mënyrë të pavarur prej përfaqësuesve të tjerë, përveç kur ligji parashikon ndryshe¹²⁴. Shprehja që përdoret në nenin 99 të Kodit të Proçedurës Civile : *"përveç kur ligji parashikon ndryshe"*, i referohet rasteve kur pavarësisht nga fakti se e drejta e përfaqësimit u është dhënë dy ose më shumë personave, këta nuk kanë të drejtë të veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, por vetëm të gjithë së bashku (përfaqësimi gjyqësor kolektiv), por kërkohet që një kusht i tillë të jetë parashikuar shprehimisht në ligj. Si shembull mund të përmendim rastin e përfaqësimit ligjor të prindërve ndaj fëmijës, i cili sipas parashikimeve të nenit 220 të Kodit të Familjes ushtrohet në mënyrë të përbashkët nga të dy prindërit¹²⁵.

¹²³ Alqiviadh Lamani, E drejta Proçedurës Civile, faqe. 53-57.

¹²⁴ Referoju për këtë qëllim nenit 99 të Kodit të Proçedurës Civile.

¹²⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 220 të Kodit të Familjes.

Lidhur me pasojat juridike si shembull mund të përmendim rastin se nëse padia e paditësit që përfaqësohet në gjyq nga një përfaqësues rrëzohet atëherë ky paditës nuk ka të drejtë të paraqesë para gjykatës të njëjtën kërkesë – padi për shkak se në kuptim të ligjit konsiderohet : **“Gjë e gjykuar”**.

Përfaqësimi gjyqësor ndryshon nga zëvendësimi proçedural sepse ndërsa në përfaqësimin gjyqësor një person vepron në gjykim në emër dhe për llogari të një personi tjetër të quajtur i përfaqësuar si dhe me qëllim për të mbrojtur të drejtat e këtij të fundit prandaj përfaqësuesi gjyqësor nuk mund të jetë palë në gjykim. Përkundrazi në zëvendësimin proçedural një person vepron në gjykim në emër të tij për të mbrojtur të drejtat e një të treti dhe prandaj bëhet palë në gjykim.

Në nenin 90 paragrafi i dytë të Kodit të Proçedurës Civile është parashikuar shprehimisht se: *"Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe"*.

Gjykata Kushtetuese shkeljen e parimit të sipërcituar nga ana e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm e ka konsideruar si shkelje të rëndë kushtetuese duke shfuqizuar si antikushtetuese të gjithë ato vendime gjyqësore në të cilat është shkelur parimi i sipërcituar.

Konkretisht Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 12, datë 09.04.2003 ka vendosur : *"Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 259, datë 06.07.2001 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimit nr. 940, datë 18.09.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë"*.

Në vendimin e sipërcituar Gjykata Kushtetuese ndër të tjera rezulton që të ketë konstatuar se : *"Gjykata e Apelit Korçë ka lejuar që të marrë pjesë aktivisht në seancë gjyqësore pa ndonjë titull kryetaren e Bashkisë Pogradec. Ky veprim përbën shkelje proçeduriale që bie ndesh me parimin e parashikuar në nenin 90 të Kodit të Proçedurës Civile, sipas të cilit : "askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe". Subjektet e interesuara nuk patën pretendime ligjore për të justifikuar pjesmarrjen e kryetares së bashkisë në shqyrtimin e çështjes. Edhe vetë ajo nuk paraqiti ndonjë shkak ligjor për pjesmarrjen e saj në gjykim"*¹²⁶.

Sikurse rezulton edhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese pjesmarrja e një personi që nuk është palë në gjykim kushtëzohet me pasjen nga ana e këtij të fundit të një titulli përfaqësimi të lëshuar nga ndonjë prej subjekteve që janë palë në gjykim, në të kundërt e gjithë veprimtaria proçeduriale e kryer nga ky person pa qenë i pajisur me titull përfaqësimi do të konsiderohet e pavlefshme, si dhe në shkelje të rëndë edhe të parimit të sanksionuar në nenin 90 parag 2 të Kodit të Proçedurës Civile.

Në fakt vetë ligji ju njeh mundësinë palëve që të përfaqësohen në gjyq nga persona të tjerë. Ky lloj përfaqësimi i cili në kuptim të ligjit njihet si përfaqësim gjyqësor mund të jetë dy llojesh :

- a) vullnetar ose kontraktual ;
- b) i domosdoshëm ose ligjor.

¹²⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 09.04.2003

a) Trajtimi i përfaqësimit gjyqësor vullnetar ose kontraktual.

Vullnetar ose kontraktual quhet përfaqësimi që rrjedh nga marrëveshja e një pale ndërgjyqëse (i përfaqësuar) me personin që ushtron përfaqësimin (përfaqësuesi). Ky përfaqësim ndërtohet në bazë të prokurës, që njëra nga palët ndërgjyqëse i jep personit që vepron si përfaqësues i saj¹²⁷.

Forma që duhet të ketë prokura për të realizuar përfaqësimin gjyqësor rezulton që të jetë përcaktuar në nenin 72 të Kodit Civil, dispozitë kjo në të cilën ndër të tjera parashikohet shprehimisht se : *"Edhe prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë"*¹²⁸.

Në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile, dispozitë kjo e emërtuar : ***"Pajisja me prokurë e përfaqësuesit"***, e referon formën që duhet të ketë prokura për realizimin e përfaqësimit gjyqësor te forma e parashikuar në dispozitën e lartpërmendur të Kodit Civil.

Në dispozitën proçeduriale të sipërcituar parashikohet shprehimisht se : *"Prokura mund të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Ajo bëhet me shkrim sipas dispozitave të Kodit Civil, si dhe me gojë përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen"*¹²⁹.

Nga krahasimi i dispozitave të sipërcituara rezulton që neni 96 i Kodit të Proçedurës Civile krahas referimit që bën tek dispozitat e Kodit Civil lidhur me formën që duhet të ketë prokura për të realizuar përfaqësimin gjyqësor përcakton se ajo duhet të bëhet me shkrim pa cituar formën noteriale sikurse përcaktohet shprehimisht në nenin 72 të Kodit Civil. Përfundimisht nga ajo çfarë parashikon Kodi Civil lidhur me formën e prokurës për kryerjen e veprimeve para gjykatave, dispozita proçeduriale e sipërcituar parashikon tej parashikimeve të nenit 72 të Kodit Civil se ajo mund të jepet edhe në formë verbale përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen.

Vlerësimi im personal është që këto dispozita nuk duhet të konsiderohen si kontradiktore me njëra – tjetrën por si dispozita plotësuese të njëra – tjetrës lidhur me formën që duhet të ketë prokura për të realizuar përfaqësimin gjyqësor vullnetar, kjo për faktin se kryerja e veprimeve para gjykatave përfaqëson një gamë më të gjerë veprimesh se thjesht përfaqësimi që bëhet në seancë gjyqësore. Në kryerjen e veprimeve para gjykatave si shembull mund të përmendim edhe paraqitjen e kërkesë – padisë si fazë fillestare për iniciimin e një procesi gjyqësor. Në një rast të tillë kërkesë – padia nëse është hartuar dhe nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të palës paditëse duhet të shoqërohet detyrimisht edhe me prokurën që vërteton vullnetin e paditësit për caktimin e përfaqësuesit, i cili rezulton që të ketë nënshkruar kërkesë – padinë në emër dhe për llogari të paditësit. Në një rast të tillë prokura duhet të ketë formë noteriale. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ankimin që paraqitet në emër dhe për llogari të palës ndërgjyqëse nga ana e përfaqësuesit të kësaj të fundit.

¹²⁷ Stavri Çeço, Ylber Malindi, Safet Hasani, E dr. proced. Civile, f.115.

¹²⁸ Neni 72 i Kodit Civil.

¹²⁹ Neni 96 i Kodit të Proçedurës Civile.

Kodi i Proçedurës Civile në nenin 96 të tij ka parashikuar se : *“Prokura mund të ketë vetëm formë shkresore kur përfaqësimi ushtrohet nga juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë”*¹³⁰.

Edhe në rastin e sipërcituar nuk është e nevojshme që prokura të vishet me formë noteriale, por e mjaftueshme është që ajo të ketë ekstremitetet e nevojshme që vërtetojnë shfaqjen e vullnetit nga ana e drejtuesit të institucionit shtetëror ose drejtuesit të personit juridik publik apo privat, i cili mund të jetë administratori ose drejtori ekzekutiv në rastin e shoqërive tregtare, si dhe duhet të shoqërohet gjithmonë edhe me vulën e institucionit shtetëror ose vulën e personit juridik publik apo privat.

Në rastet kur njëra nga palët ndërgjyqëse është një shoqëri tregtare si shembull mund të përmendim rastin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në të cilën të drejtën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët e ka administratori. Në një rast të tillë lidhur me veprimet para gjykatave nëse këto veprime kryhen nga administratori nuk është e nevojshme që ai të jetë i pajisur me prokurë për shkak se vetë ligji për shoqëritë tregtare i ka njohur të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në raport me të tretët. E mjaftueshme në një rast të tillë është paraqitja e ekstraktit të shoqërisë në të cilin pasqyrohet fakti se ai është administrator i shoqërisë në emër dhe për llogari të së cilës ai po vepron.

Edhe në rastin kur shfaqja e vullnetit para gjykatës për caktimin e një përfaqësuesi bëhet në mënyrë verbale sikurse parashikohet në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile, kjo shfaqje vullneti fiksohet në procesverbalin e seancës gjyqësore duke i dhënë në këtë mënyrë formë shkresore.

Mosrespektimi i formës së kërkuar nga ligji lidhur me prokurën në rastin e përfaqësimit vullnetar e bën këtë përfaqësim të metë dhe si i tillë nuk mund të sjellë pasoja juridike ndaj të përfaqësuarit.

Në rastin e të metave në aktin e përfaqësimit ligji ka parashikuar mundësinë që gjykata u jep palëve për plotësimin e këtyre të metave. Në një përfundim të tillë arrihet referuar vetë përcaktimeve të nenit 176 të Kodit të Proçedurës Civile në të cilin ndër të tjera parashikohet shprehimisht se : *“Gjykata verifikon legjitimitimin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe kur e sheh të nevojshme u cakton palëve një afat”*¹³¹.

Mosplotësimi i të metave lidhur me aktin e përfaqësimit do të sillte si pasojë pavlefshmërinë e të gjitha veprimeve proçeduriale të kryera nga përfaqësuesi gjyqësor në emër dhe për llogari të palës ndërgjyqëse në referim kjo të përcaktimeve të nenit 90 parag 2 të Kodit të Proçedurës Civile për shkak se në kuptim të ligjit akti i përfaqësimit konsiderohet i paqenë dhe si i tillë nuk mund të prodhojë pasoja.

Kodet e Proçedurës Civile të mëparshme dhe konkretisht Kodi i Proçedurës Civile i vitit 1954 në nenin 60 të tij¹³², si dhe Kodi i Proçedurës Civile i vitit 1981 në nenin 110 të

¹³⁰ Neni 96 i Kodit të Proçedurës Civile

¹³¹ Neni 176 i Kodit të Proçedurës Civile

¹³² Referoju nenit 60 të Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1954

tij¹³³ në ndryshim nga Kodi i Proçedurës Civile aktual, si dhe Kodi Civil aktual veç formave të prokurës që parashikohen aktualisht, parashikonin ndër të tjera edhe se prokura me të cilën duhet të pajisej përfaqësuesi gjyqësor mund të përpilohej dhe të vërtetohej :

- a) Nga kryetari ose sekretari i këshillit popullor të fshatit ose të qytetit në ato vende ku nuk kishte zyra noteriale ;
- b) nga administrata e institucionit shëndetësor në të cilin i përfaqësuari ishte shtruar për mjekim ;
- c) nga reparti ushtarak në të cilin ushtaraku i përfaqësuar bënte pjesë ;
- ç) nga administrata e burgut ose e vendit ku ndodhej i arrestuar personi i përfaqësuar që lëshon prokurën.

Si përfundim : Në përfaqësimin vullnetar lidhur me format e prokurës që parashikohen në Kodin Civil aktual dhe në Kodin e Proçedurës Civile aktual vlerësimi im personal është që në nenin 72 të Kodit Civil, si dhe në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të shtohet një paragraf në të cilin të parashikohet se në rastet kur i përfaqësuari është në pamundësi reale për të shfaqur vullnetin e tij para noterit publik, si dhe ndodhet në pamundësi reale për tu paraqitur para gjykatës prokura për të ushtruar përfaqësimin gjyqësor mund të përpilohet dhe të vërtetohet edhe nga :

- a) drejtuesi i institucionit shëndetësor ku i përfaqësuari është shtruar për mjekim ;
- b) komanda e repartit ushtarak ku shërben i përfaqësuari ;
- c) drejtuesi i institucionit ku i përfaqësuari mbahet i arrestuar ose vuan dënimin me heqje të lirisë.

Në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile është parashikuar edhe se prokura me të cilën pajisen përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse mund të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Kuptimi i prokurës së përgjithshme dhe asaj të posaçme është sqaruar në kreun II të këtij punimi.

Emërimi i një përfaqësuesi i bërë në format e parashikuara nga neni 72 i Kodit Civil, si dhe nga neni 96 i KPr.Civile i jep këtij të fundit të drejtën që të kryejë të gjitha veprimet proçeduriale duke përfshirë edhe të drejtën që të kërkojë ekzekutimin e vendimit, si dhe shpenzimet gjyqësore që duhet të paguajë pala gjyqëse me përjashtim të atyre veprimeve proçeduriale që janë të lidhura me disponimin e të drejtës për të cilën zhvillohet gjykimi, përveç rasteve kur ka fituar tagër në mënyrë të shprehur¹³⁴.

Përfaqësuesi në mungesë të tagrave të shprehura në prokurë qoftë kjo e përgjithshme apo e posaçme nuk mund të kryejë këto veprime proçeduriale që sjellin disponime të së drejtës :

- i) të zgjidhë çështjen me pajtim ;
- ii) të shprehet lidhur me pranimin plotësisht apo pjesërisht të padisë së paraqitur për shqyrtim ;
- iii) të heqë dorë tërësisht ose pjesërisht nga gjykimi i padisë (në heqjen dorë tërësisht apo pjesërisht nga gjykimi përfshihet edhe heqja dorë tërësisht apo pjesërisht nga gjykimi i kundërpadisë ose nga prapsimet e paraqitura nga i padituri) ;

¹³³ Referoju neni 110 të Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1981

¹³⁴ Referoju neni 97 të Kodit të Proçedurës Civile

- iv) të heqë dorë tërësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë apo nga e drejta e kundërpadisë në kushtet kur edhe për këtë të fundit zbatohen të njëjtat rregulla sikurse për padinë ;
- v) të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo të paraqesë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit ;
- vi) të marrë të holla ose sende të tjera me vlerë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit;
- vii) të heqë dorë nga ankimi i paraqitur në gjykatën e apelit ose nga rekursi i paraqitur në gjykatën e lartë.

Në praktikën gjyqësore janë ndeshur mjaft raste në të cilat përfaqësuesi gjyqësor ka kryer veprime procedurale që lidheshin me disponimin e së drejtës pa pasur tagra në mënyrë të shprehur nga i përfaqësuari sikurse kërkohet edhe nga neni 97 paragrafi i dytë i Kodit të Proçedurës Civile. Në raste të tilla vendimet e dhëna nga gjykatat e niveleve më të ulëta janë prishur nga gjykatat më të larta duke i kthyer për rigjykim.

Referuar praktikës gjyqësore ka rezultuar që përfaqësuesi gjyqësor të ketë kryer akte që sjellin disponim të së drejtës pa pasur tagra të shprehura në prokurë nga i përfaqësuari për të bërë një gjë të tillë, megjithatë këto veprime me heshtje ose veprime konkludente të jenë miratuar nga ana e të përfaqësuarit. Në të tilla raste nga gjykatat më të larta këto veprime të kryera nga përfaqësuesi janë konsideruar të mirëqena me arsyetimin se i përfaqësuari me veprimet apo sjelljen e tij i ka miratuar aktet e kryera nga përfaqësuesi tej tagrave të dhëna.

Në funksion të asaj që parashtruam më lart po paraqesim 3 (tre) shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë.

Shembulli i parë : Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 976 datë 27.09.2000 rezulton të ketë vendosur : *“Prishjen e vendimit nr. 88, datë 23.02.1999 të Gjykatës së Rrethit Berat dhe vendimit nr. 340, datë 21.09.1999 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Berat me tjetër trup gjykues”*.

Referuar përmbajtjes së vendimit të sipërcituar rezulton që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ndër të tjera të ketë arsyetuar në këtë mënyrë : *“Gjatë gjykimit të çështjes ka rezultuar se paditësi i ka lëshuar babait të tij një prokurë të përgjithme për ta përfaqësuar atë në gjyq. Nga përmbajtja e kësaj prokure nuk rezulton që paditësi t’i ketë dhënë babait të tij si përfaqësues tagra për të kryer akte që sjellin disponim të së drejtës sikurse është edhe zgjidhja e çështjes me pajtim. Në një rast të tillë sipas përcaktimeve të nenit 97 parag 2 i Kodit të Proçedurës Civile përfaqësuesi i paditësit duhet të kishte fituar tagra në mënyrë të shprehur nga ana e paditësit për ta zgjidhur çështjen me pajtim”¹³⁵.*

Shembulli i dytë : Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 1378, datë 24.10.2000 rezulton të ketë vendosur : *“Prishjen e vendimit nr. 497, datë 23.09.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues”*.

¹³⁷ Referoju vendimit nr. 939, datë 27.09.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

Referuar përmbajtjes së vendimit të sipërcituar rezulton që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ndër të tjera të ketë arsyetuar në këtë mënyrë : *“Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur mos shqyrtimin e ankimit për shkak se avokati i palës që ka paraqitur ankimin ka hequr dorë prej tij. Kjo heqje dorë nga ankimi rezulton që të jetë bërë nga përfaqësuesi i palës ankuese pa e pasur këtë tagër në mënyrë të shprehur në prokurën me të cilën ishte pajisur nga i përfaqësuari prej tij. Një veprim i tillë rezulton që të bjerë ndesh me përcaktimet e nenit 97 paragraf 2 i Kodit të Proçedurës Civile në kushtet kur heqja dorë nga ankimi konsiderohet si akt që sjell disponim të së drejtës”*¹³⁶.

Shembulli i tretë : Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 939, datë 27.09.2003 rezulton të ketë vendosur : *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 112, datë 30.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 263, datë 07.03.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë”*.

Referuar përmbajtjes së vendimit të sipërcituar rezulton që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ndër të tjera të ketë arsyetuar në këtë mënyrë : *“Pretendimi i palës paditëse se përfaqësuesja me prokurë nuk ka qenë e pajisur me tagra për të kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes nuk qëndron sepse siç rezulton nga prokurat që ndodhen në dosje ndër të tjera pala paditëse e autorizonte përfaqësuesen e saj që të kryente dhe çdo veprim tjetër që ajo e konsideronte të arsyeshëm dhe se veprimet e saj do të konsideroheshin të mirëqena si të kryera prej saj. Pavarësisht faktit se përfaqësuesja e palës paditëse nuk ka qenë e pajisur shprehimisht me tagrin për të kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes, këtë veprim të saj pala paditëse e ka miratuar me veprimet e mëpasshme për shkak se nuk e ka ankimuar një veprim të tillë, por thjesht në ankimin që ka bërë në Gjykatën e Apelit ka kërkuar që gjykata duhet të shprehej edhe për kundërpadinë e ngritur nga pala e paditur duke e miratuar në këtë mënyrë aktin e disponimit të së drejtës që ka bërë përfaqësuesja e palës paditëse”*¹³⁷.

Në tre shembujt e referuar më lart rezulton që përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse në gjykim të kenë kryer akte që sillnin disponim të së drejtës.

Në rastet e referuara sipas shembullit të parë dhe të dytë rezulton që këto akte që sillnin si pasojë disponim të së drejtës të jenë kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse dhe për rrjedhojë me të drejtë nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë pas konstatimit të një fakti të tillë është vendosur prishja e vendimeve duke i konsideruar si të pavlefshme veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesve tej tagrave të dhëna në prokurë nga ana e të përfaqësuarve prej tyre.

Në rastin e referuar në shembullin e tretë rezulton që nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë pavarësisht se akti i kryer nga ana e përfaqësuesit të palës paditëse që sillte edhe disponim të së drejtës është kryer tej tagrave të dhëna në prokurë nga pala paditëse, kjo e fundit me veprimet e mëpasshme të kryera rezulton që ta ketë miratuar veprimin proçedural të kryer nga përfaqësuesi i saj.

¹³⁶ Referoju vendimit nr. 1378, datë 24.10.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

¹³⁷ Referoju vendimit nr. 939, datë 27.09.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

Referuar përmbajtjes së nenit 97 parag 2 të Kodit të Proçedurës Civile, si dhe rastit të referuar në shembullin e tretë rezulton që të arrihet në përfundimin se përfaqësimi pa tagra të ndeshet edhe tek përfaqësimi gjyqësor. Ashtu sikurse veprimet juridike që kryhen nga përfaqësuesi pa tagra nuk janë të detyrueshme për personin në emër dhe për llogari të të cilit janë kryer edhe veprimet proçeduriale që kryhen nga përfaqësuesi gjyqësor tej tagrave të dhëna në prokurë nga ana e të përfaqësuarit nuk janë të detyrueshme për këtë të fundit, si dhe në kuptim të ligjit proçedural këto veprime konsiderohen të pavlefshme duke sjellë si pasojë edhe prishjen e atyre vendimeve gjyqësore që janë bazuar në ato akte proçeduriale që janë kryer nga përfaqësuesi gjyqësor tej tagrave të dhëna nga i përfaqësuari. Që veprimet proçeduriale të kryera nga përfaqësuesi gjyqësor tej tagrave të dhëna nga i përfaqësuari dhe që sjellin edhe disponim të të drejtës të konsiderohen të pavlefshme nga pikëpamja proçeduriale duhet që këto veprime proçeduriale të kundërshtohen gjyqësisht nga i përfaqësuari në gjykatat më të larta. Nëse i përfaqësuari me sjelljen apo veprimet e tij i ka miratuar aktet që sjellin disponim të së drejtës pavarësisht se nga përfaqësuesi gjyqësor këto akte janë kryer tej tagrave të dhëna në prokurë duke mos i kundërshtuar këto veprime proçeduriale në gjykatat më të larta atëherë do të konsiderohet se i përfaqësuari ka shfaqur vullnetin e tij për miratimin e këtyre akteve që sjellin disponim të së drejtës, pavarësisht se këto akte janë kryer nga përfaqësuesi tej tagrave të dhëna në prokurë.

Miratimi i dhënë nga i përfaqësuari në një rast të tillë i bën të pacënueshme në aspektin proçedural, aktet që kanë sjellë disponim të së drejtës të kryera nga përfaqësuesi tej tagrave të dhëna në prokurë.

Gjatë trajtimit të përfaqësimit pa tagra në kreun III të këtij punimi kemi theksuar se veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi pa tagra mund të miratohen edhe nga trashëgimtarët e të përfaqësuarit. Një rregull i tillë do të jetë i vlefshëm edhe për përfaqësimin gjyqësor dhe konkretisht për ato akte që sjellin disponim të së drejtës të cilat janë kryer nga përfaqësuesi gjyqësor tej tagrave të dhëna në prokurë nga i përfaqësuari. Edhe në një rast të tillë miratimi i akteve të sipërcituara mund të jepet edhe nga trashëgimtarët e të përfaqësuarit. Në dallim nga përfaqësimi pa tagra në fushën e veprimeve juridike, në rastin e përfaqësimit gjyqësor ky miratim nga ana e trashëgimtarëve të të përfaqësuarit mund të jepet pavarësisht se i përfaqësuari nuk i ka miratuar më parë aktet e kryera nga përfaqësuesi duke paraqitur për këtë qëllim ankim ose rekurs ndaj vendimit të gjykatës që është bazuar në aktet që kanë sjellë disponim të së drejtës të kryera nga përfaqësuesi gjyqësor tej tagrave të dhëna. Ky miratim mund të jepet nëpërmjet tërheqjes nga ana e trashëgimtarëve të të përfaqësuarit të ankimit apo rekursit të paraqitur nga ky i fundit.

b) Trajtimi i përfaqësimit gjyqësor ligjor ose të domosdoshëm.

Përfaqësimi ligjor ose i domosdoshëm quhet përfaqësimi që rrjedh nga ligji dhe që parashikohet si i tillë shprehimisht nga ligji. Ky përfaqësim parashikohet nga ligji për arsye nga më të ndryshmet dhe si i tillë shfaqet në trajta të ndryshme.

Më poshtë do të parashtrojmë disa prej rasteve më të zakonshme të parashikuara në ligj të përfaqësimit ligjor ose të domosdoshëm dhe që ndeshen ose do të ndeshen më shpesh në praktikën gjyqësore :

i) Personat që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil (zotësi proçeduriale) për shkak moshe kur njëra nga palët ndërgjyqëse është i mitur ose kur zotësia për të vepruar i është hequr apo kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Përfaqësues ligjor i tyre në këtë rast janë prindërit për të miturit ose kujdestari kur janë vendosur në kujdestari.

Për personat që u është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar si përfaqësues ligjor i tyre në veprimet para gjykates është personi i caktuar si kujdestar i tyre.

Pjesmarrjen në një gjykim civil të personave të sipërcituar vetë ligji proçedurial e ka kushtëzuar me praninë e përfaqësuesve ligjorë të tyre. Konkretisht në nenin 91 paragrafi 2 të Kodit të Proçedurës Civile parashikohet shprehimisht se : *“Personat që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre”*¹³⁸.

Në kuptim të ligjit proçedurial jo vetëm që pjesmarrja e personave që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil pa praninë e përfaqësuesit të tyre ligjor është e ndaluar, por edhe të gjitha aktet proçeduriale që paraqiten në emër dhe për llogari të tyre duhet të nënshkruhen nga përfaqësuesi i tyre ligjor në të kundërt të gjitha aktet proçeduriale të nënshkruara prej tyre do të konsiderohen të pavlefshme dhe si të tilla nuk mund të prodhojnë pasoja në kuptim të ligjit proçedurial.

Le të marrim një shembull nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për të ilustruar situatën e sipërcituar.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 1364, datë 12.12.2000 rezulton të ketë vendosur : *“Prishjen e vendimit nr. 279, datë 14.09.1999 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr. 918, datë 19.05.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes”*.

Referuar përmbajtjes së vendimit gjyqësor të sipërcituar rezulton që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ndër të tjera të ketë arsyetuar në këtë mënyrë : *“Referuar çertifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Shkodër rezulton që paditësja të jetë e datëlindjes 7 korrik 1981 ndërsa padia e redaktuar dhe e nënshkruar prej kësaj të fundit është depozituar në gjykatë më datë 02.12.1998. Në momentin e ngritjes së padisë, paditësja nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç. Mbi sa më sipër përderisa në momentin e ngritjes së padisë, paditësja nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç, nuk i kishte lindur zotësia për të vepruar e për rrjedhojë as e drejta për të ngritur padi sipas parashikimeve të nenit 33 të Kodit të Proçedurës Civile, dispozitë kjo në të cilën parashikohet se nuk mund të ngrihet padi nga një person që i mungon zotësia juridike për të vepruar”*¹³⁹. Për rrjedhojë të

¹³⁸ Referoju nenit 91 parag 2 të Kodit të Proçedurës Civile

¹³⁹ Referoju nenit 33 të Kodit të Proçedurës Civile

drejtat e saj në rastin konkret mund të mbroheshin vetëm nga përfaqësuesi ligjor i saj që mund të ishin prindërit ose kujdestari në rast se ajo ishte vendosur në kujdestari”¹⁴⁰.

Kodet e Proçedurës Civile të mëparshme dhe konkretisht Kodi i Proçedurës Civile i vitit 1954 në nenin 58 paragrafi i tretë¹⁴¹, si dhe Kodi i Proçedurës Civile i vitit 1981 në nenin 108 të tij¹⁴² në ndryshim nga Kodi i Proçedurës Civile aktual u njihnin të drejtën të miturve që kishin mbushur moshën 14 vjeç dhe personave që u ishte kufizuar zotësia për të vepruar që t’i kryenin vetë veprimet proçeduriale pa ndihmën e përfaqësuesit të tyre ligjor në gjykimet që kishin lidhje me kontratën e punës së lidhur prej tyre, me fitimet e rrjedhura nga puna, si dhe me depozitat e bëra prej tyre nëpër arka kursimi.

Vlerësimi im personal në një rast të tillë është se në nenet 33 dhe 91 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të shtohet një paragraf duke u njohur përjashtimisht të drejtën të miturve që kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe personave që u është kufizuar zotësia për të vepruar për të kryer veprime proçeduriale para gjykatës, si dhe për tu përfaqësuar vetë në gjykim pa praninë e përfaqësuesit ligjor vetëm në gjykimet që rrjedhin nga kontrata e punës së lidhur prej tyre, lidhur me gjykimet që kanë të bëjnë me fitimet e siguruar prej tyre nga puna, si dhe lidhur me gjykimet që rrjedhin nga depozitat bankare të të ardhurave të fituara me punën e tyre.

Në kushtet kur në kuptim të nenit 7 të Kodit Civil të miturve që kanë mbushur moshën 14 vjeç përjashtimisht i njihet e drejta për të kryer veprime juridike për disponimin e të ardhurave të fituara me punën e tyre, si dhe për depozitimin e të ardhurave të fituara me punën e tyre për shkak se konsiderohen të aftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre arrihet në përfundimin se këto të fundit të jenë të aftë edhe të përfaqësojnë veten para gjykatës pa praninë e përfaqësuesit ligjor lidhur me gjykimet që kanë për objekt mosmarrëveshjet që lindin nga kontrata e punës e lidhur prej tyre, lidhur me gjykimet që kanë të bëjnë me fitimet e siguruar prej tyre nga puna, si dhe lidhur me gjykimet që rrjedhin nga depozitat e të ardhurave të fituara me punën e tyre.

ii) Rast tjetër përfaqësimi ligjor është edhe caktimi nga ana e gjykatës të një kujdestari për të administruar pasurinë e personit të shpallur si të zhdukur me vendim të gjykatës¹⁴³. Në këtë rast ky përfaqësues ligjor i përkohshëm ushtron të gjitha të drejtat proçeduriale që i takojnë personit të shpallur si të zhdukur në proçeset gjyqësore në të cilat ky i fundit është palë ndërgjyqëse.

iii) Rast tjetër përfaqësimi ligjor është edhe caktimi nga ana e gjykatës të një kujdestari për personin që i hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar¹⁴⁴. Edhe në një rast të tillë kujdestari i caktuar me vendim të gjykatës paraqitet edhe si përfaqësues ligjor në veprimet para gjykaës duke ushtruar të drejtat proçeduriale që i takojnë personit që i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar në proçeset gjyqësore në të cilat ky i fundit është palë ndërgjyqëse.

¹⁴⁰ Referoju vendimit nr. 1364, datë 12.12.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

¹⁴¹ Referoju për këtë qëllim nenin 58 paragrafi i tretë i Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1954

¹⁴² Referoju për këtë qëllim nenin 108 të Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1981

¹⁴³ Referoju për këtë qëllim nenin 16 parag 1 të Kodit Civil

¹⁴⁴ Referoju për këtë qëllim nenin 307 të Kodit të Familjes

iv) Rast tjetër përfaqësimi ligjor është caktimi nga ana e gjykatës i një kujdestari të posaçëm kur mungon përfaqësuesi ligjor, sipas paragrafit të dytë të nenit 91 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ekzistojnë arsye të justifikuara që kërkojnë kryerjen e shpejtë të disa veprimeve procedurale. Pushteti i këtij përfaqësuesi të posaçëm ligjor është i kufizuar dhe konkretisht funksionet e këtij të fundit mbarojnë kur çështja do të vijojë të ndiqet nga ana e përfaqësuesit ligjor që është ngarkuar të përfaqësojë personin që nuk ka zotësi juridike për të vepruar¹⁴⁵.

v) Rast tjetër përfaqësimi ligjor është ai i parashikuar në nenin 344 të Kodit Civil sipas të cilit noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimi, kryesisht ose me kërkesën e çdo të interesuari, emëron një kujdestar të trashëgimit kur nuk dihet a ka trashëgimtarë ose kur trashëgimtarët mungojnë dhe nuk ka lajme për ta ose kur trashëgimtarët ligjorë apo testamentarë kanë hequr dorë nga trashëgimi dhe nuk dihen trashëgimtarët e tyre¹⁴⁶. Në një rast të tillë kujdestari i trashëgimit do të kryejë të gjitha veprimet procedurale të nevojshme në proceset gjyqësore në të cilat trashëgimlënësi ishte palë ndërgjyqëse.

vi) Rast tjetër përfaqësimi ligjor është edhe ai i përfaqësimit të njërit prej bashkëshortëve nga bashkëshorti tjetër para organeve gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi¹⁴⁷.

vii) Rast tjetër përfaqësimi ligjor është edhe kur ndërmjet përfaqësuesit ligjor të të miturit dhe prindit ose kujdestarit të tij ligjor ose kur ndërmjet përfaqësuesit ligjor dhe personit që i është kufizuar ose hequr zotësia për të vepruar ka konflikt interesash. Në një rast të tillë gjykata cakton një përfaqësues ligjor të posaçëm në gjykim për të miturit ose për personin që i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar¹⁴⁸. Në një rast të tillë interesat e të miturit apo personit që i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar do të përfaqësohen nga kujdestari i posaçëm i caktuar nga ana e gjykatës.

Në të gjitha rastet kur përfaqësuesi ligjor nuk njihet nga gjykata ose kundërshtohet nga pala tjetër, ai ka barrën e provës për të provuar para gjykatës cilësinë e tij si përfaqësues ligjor i palës ndërgjyqëse interesat e së cilës ai kërkon të përfaqësojë në procesin gjyqësor civil. Për të vërtetuar qënien si përfaqësues ligjor ai duhet të paraqesë para gjykatës të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon faktin e sipërcituar. Si shembuj mund të përmendim që në rastin kur përfaqësuesi ligjor është prindi, ky i fundit duhet të paraqesë certifikatën e përbërjes familjare, në rastin kur përfaqësues ligjor është kujdestari, ky i fundit duhet të paraqesë vendimin e gjykatës me të cilin është vendosur emërimi i tij si kujdestar i të miturit apo i personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

¹⁴⁵ Referoju nenit 94 të Kodit të Proçedurës Civile

¹⁴⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 344 të Kodit Civil

¹⁴⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 90 të Kodit të Familjes

¹⁴⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 94 parag 2 i Kodit të Proçedurës Civile

Dallimet ndërmjet përfaqësimit vullnetar nga ai ligjor, rrethi i personave që mund të caktohen si përfaqësues, si dhe mbarimi i përfaqësimit gjyqësor.

i) Dallimet ndërmjet përfaqësimit vullnetar nga ai ligjor.

Referuar legjislacionit tonë proçedural civil rezulton që në gjykimin në shkallë të parë dhe të dytë përfaqësimi gjyqësor vullnetar në ndryshim nga ai ligjor është fakultativ, ndërsa në gjykimin në Gjykatën e Lartë ky lloj përfaqësimi ashtu sikurse edhe ai ligjor është i detyrueshëm për palët ndërgjyqëse. Në një përfundim të tillë arrihet referuar përcaktimeve të nenit 96/a parag 1 të Kodit të Proçedurës Civile, dispozitë kjo e emërtuar: **“Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë”** në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Përfaqësimi i palëve në Gjykatën e Lartë bëhet vetëm nga avokat”*¹⁴⁹.

Arsyeja e parashikimit ligjor të mësipërm shpjegohet me faktin se palët ndërgjyqëse referuar llojit të gjykimit që zhvillohet në Gjykatën e Lartë nuk konsiderohet se zotërojnë aftësitë e nevojshme për të realizuar mbrojtjen e interesave të tyre. Lidhur me përfaqësimin ligjor apo të detyrueshëm ky i fundit është i detyrueshëm në të gjitha shkallët e gjykimit për arsye se sikurse e kemi cituar edhe më lart palës që përfaqësohet në referim të ligjit i mungon zotësia proçeduriale për të kryer veprime para gjykatës. Megjithatë edhe vetë përfaqësuesi ligjor në funksion të mbrojtjes sa më mirë të interesave të personit që përfaqëson mund të caktojë një person tjetër me prokurë si përfaqësues të të miturit ose personit që i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar. Natyrisht që edhe për përfaqësuesin ligjor kjo është një e drejtë fakultative për gjykimin në shkallë të parë dhe të dytë, por është e detyrueshme për gjykimin në Gjykatën e Lartë.

ii) Rrethi i personave që mund të caktohen si përfaqësues.

Sipas parashikimeve të nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile si përfaqësues të palëve në gjyq me prokurë mund të jenë :

- a) *avokatët* ;
- b) bashkëshortët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat ;
- c) juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë ;
- ç) personat që lejohen nga gjykata për të qenë përfaqësues në një çështje ;
- d) personat e tjerë që parashikohen me ligj se mund të jenë përfaqësues të palëve¹⁵⁰.

Siç rezulton edhe nga përmbajtja e dispozitës së sipërcituar jo çdo person mund të veprojë si përfaqësues i ndonjërës nga palët në një gjykim civil. Si përfaqësues të palëve në një gjykim civil mund të jenë vetëm një rreth i kufizuar personash, të cilët për shkak të profesionit që ushtrojnë siç janë avokatët, për shkak të të qenurit bashkëshort ose për shkak të lidhjeve gjinore të afërta që kanë me ndonjërën nga palët ndërgjyqëse, për shkak se janë në marrëdhënie pune me ndonjërën nga palët ndërgjyqëse ose për shkak se vetë ligji ju njeh të drejtën për të vepruar si përfaqësues i ndonjërës nga palët ndërgjyqëse e gëzojnë këtë të drejtë. Në rast se gjykata do të konstatojë se si përfaqësues me prokurë i ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse është caktuar një person jashtë rrethit të personave që

¹⁴⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 96/a parag 1 të Kodit të Proçedurës Civile

¹⁵⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile

në bazë të paragrafit të parë të nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile kanë të drejtë të jenë përfaqësues, atëherë ka të drejtë të refuzojë një përfaqësim të tillë. Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që kjo e fundit të ketë parashikuar të drejtën e gjykatës për të lejuar që një person i caktuar jashtë rrethit të subjekteve të cituara më lart të mund të ushtrojë të drejtën e përfaqësimit ndaj ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse. Referuar mënyrës se si është formuluar fjalia arrihet në përfundimin se nga ana e ligjvënësit është lënë në diskrecionin e gjykatës që të vendosë nëse një person i caktuar jashtë rrethit të subjekteve të cituara shprehimisht në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile të mund të lejohet nga kjo e fundit për të qenë përfaqësues i ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse në gjykimin civil që po zhvillohet para saj. Gjithsesi vlerësimi im personal në një rast të tillë do të ishte që gjykata në refuzimin e lejimit të një personi që nuk përfshihet në rrethin e subjekteve për të qenë përfaqësues me prokurë në një çështje civile apo administrative në kuadër të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor duhet që vendimarrjen e saj ta bazojë në kritere objektive duke pasur parasysh për këtë qëllim edhe vullnetin e të përfaqësuarit, lidhjen që mund të ekzistojë ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit, si dhe formimin apo aftësitë profesionale të këtij të fundit. Është detyrë e gjykatës që të marrë të gjithë masat e nevojshme për t'i garantuar secilës prej palëve ndërgjyqëse një proces të rregullt ligjor dhe si rrjedhojë e këtij detyrimi kjo e fundit duhet të jetë e shumë e kujdesshme në refuzimin e lejimit të një personi për të ushtruar të drejtën e përfaqësimit me prokurë të një pale ndërgjyqëse në një gjykim civil apo administrativ, duke mos e bazuar vendimarrjen e saj të ndërmjetme vetëm në kritere formale. Kusht detyrues për gjykatën është që kjo e fundit në asnjë rast nuk duhet të lejojë që të jenë përfaqësues vetëm personat të cilët e kanë shprehimisht të ndaluar të drejtën për të qenë përfaqësues me prokurë të një pale ndërgjyqëse në një gjykim civil apo administrativ. Në të gjitha rastet e tjera gjykata duhet të ketë parasysh dhe t'i referohet kritereve të sipërcituara.

Në paragrafin e dytë të nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile janë parashikuar rastet kur një person nuk mund të veprojë si përfaqësues i ndonjërës nga palët ndërgjyqëse. Sipas parashikimeve të dispozitës proçeduriale të sipërcituar nuk mund të jenë përfaqësues të palëve :

- a) *personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç ;*
- b) *personat që u është hequr zotësia për të vepruar ;*
- c) *avokatët të cilëve u është pezulluar ushtrimi i profesionit për aq kohë sa zgjat kjo masë;*
- ç) *gjyqtarët dhe prokurorët*¹⁵¹.

a) Lidhur me rastin e parë dhe konkretisht për personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç arsyeja e një ndalimi të tillë lidhet me faktin se në kushtet kur këta persona në referim edhe të përcaktimeve të nenit 91 parag 2 i Kodit të Proçedurës Civile nuk lejohet që në një gjykim civil të marrin pjesë pa praninë e përfaqësuesit të tyre për shkak se në kuptim të ligjit nuk konsiderohen të aftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre me të drejtë nuk mund të ushtrojnë të drejtën e përfaqësimit për faktin e thjeshtë sepse në kushtet kur nuk konsiderohen të aftë për të përfaqësuar interesat e tyre në një gjykim civil, nuk do të ishte e arsyeshme të mendohej se ata janë të aftë për të përfaqësuar interesat e personave të tjerë në një gjykim civil.

¹⁵¹ Referoju për këtë qëllim nenit 96 parag 2 të Kodit të Proçedurës Civile

Në kuadër të trajtimit të ndalimit të sipërcituar të përcaktuar në nenin 96 parag 2 gërma “a” të Kodit të Proçedurës Civile ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje dhe që mund të përbëjë situatë që mund të ndeshet në praktikën gjyqësore është :

Nëse nga ana e gjykatës duhet të lejohet për të qenë përfaqësues një person i cili pavarësisht se nuk ka mbushur moshën 18 vjeç ka fituar zotësinë juridike të plotë për të vepruar si rezultat i martesës¹⁵² ?

Pyetjes së sipërcituar vlerësoj se e meriton t’i kushtohet vëmendja e duhur si për efekt studimor, ashtu edhe në funksion të evidentimit të faktit nëse neni 96 parag 2 gërma “a”, si dhe neni 6 parag 2 të Kodit Civil paraqesin apo jo mangësi si dispozita, si dhe nëse përshtaten apo jo me nenin 7 parag 2 të Kodit të Familjes.

Nëse do kufizoheshim vetëm në kuptimin literal të fjalëve të vendosura në fjali duke bërë në këtë mënyrë një interpretim mekanik të dispozitës, përgjigjia do të ishte e thjeshtë : **“Jo”**, referuar për këtë qëllim faktit se vetë ligji e ka kushtëzuar qënien si përfaqësues me arritjen e një moshe të caktuar.

Në vlerësimin tim përgjigjia e sipërcituar duhet të konsiderohet e gabuar për shkak se jo vetëm që është rrjedhojë e një interpretimi të mangët dhe shumë të kufizuar të dispozitës por vjen ndesh edhe me interpretimin logjik dhe sistematik të saj.

Që të mund t’i japim përgjigje të saktë dhe ezauruese pyetjes së parashtruar më lart fillimisht do të duhej të merrnim në analizë qëllimin e ndalimit të vendosur nga ana e ligjvënësit të të drejtës për të qenë përfaqësues të personave që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç. Në kuptim të ligjit ndalimi lidhet me mungesën e zotësisë për të vepruar të personave që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç. Në një përfundim të tillë arrihet referuar për këtë qëllim edhe ndalimit të mëposhtëm në radhë dhe konkretisht atij të parashikuar në nenin 96 parag 2 gërma “b” të Kodit të Proçedurës Civile sipas të cilit nuk lejohet të jenë përfaqësues personat që u është hequr zotësia për të vepruar. Mos pasja e zotësisë për të vepruar, si dhe heqja e zotësisë për të vepruar në kuptim të ligjit konsiderohen të barazvlefshme sepse në kuptim të ligjit i paaftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij është si personi që nuk e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar ashtu edhe personi të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruar.

Në një përfundim të tillë arrihet edhe referuar parashikimeve të nenit 6 parag 1 të Kodit Civil, dispozitë kjo në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Personit kur mbush moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i lind zotësia e plotë që me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile”¹⁵³.*

Në rrethanat kur në referim të parashikimeve të nenit 6 parag 2 të Kodit Civil përjashtimisht nga rregulli i përgjithshëm sipas të cilit personi kur mbush moshën 18 vjeç fiton zotësinë e plotë juridike për të vepruar, këtë zotësi e fiton me anë të martesës edhe gruaja që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç arrihet në përfundimin se kjo e fundit duhet të lejohet nga ana e gjykatës për të qenë përfaqësuese me prokurë e një pale ndërgjyqëse në kushtet kur në referim të përcaktimeve të nenit 91 parag 2 të Kodit të

¹⁵² Referoju për këtë qëllim nenit 6 parag 2 të Kodit Civil

¹⁵³ Referoju për këtë qëllim nenit 6 parag 1 të Kodit Civil

Procedurës Civile kjo e fundit konsiderohet e aftë për të marrë pjesë dhe për të mbrojtur interesat e saj në një gjykim civil.

Nëse situata paraqitet e qartë lidhur me gruan e cila përjashtimisht nga rregulli i përgjithshëm në referim të përcaktimeve të nenit 6 parag 2 të Kodit Civil e fiton zotësinë juridike të plotë për të vepruar si rezultat i martesës pavarësisht se nuk ka mbushur moshën 18 vjeç dhe nuk e humbet këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushë moshën tetëmbëdhjetë vjeç¹⁵⁴ dhe si rrjedhojë ajo përjashtimisht duhet të lejohet nga ana e gjykatës për të qenë përfaqësuese me prokurë e ndonjëres prej palëve ndërgjyqëse në gjykim për shkak se në kuptim të ligjit konsiderohet e aftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të saj, një gjë e tillë për shkak të mungesës së parashikimeve në ligj nuk mund të thuhet për burrin që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç por që është lejuar nga gjykata për të lidhur martesë në kuptim kjo të nenit 7 parag 2 të Kodit të Familjes.

Konkretisht në nenin 7 të Kodit të Familjes, dispozitë kjo e emërtuar : **“Mosha e lidhjes së martesës”** parashikohet shprehimisht se :

“Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa për shkaqe me rëndësi mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe”¹⁵⁵.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që gjykata e vendit ku lidhet martesa për shkaqe me rëndësi mund të lejojë lidhjen e martesës edhe ndërmjet një burri dhe një gruaje që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Por nëse në referim të përcaktimeve të nenit 6 parag 2 të Kodit Civil gruaja e fiton zotësinë e plotë juridike për të vepruar si rezultat i martesës, ligji dhe konkretisht kjo dispozitë hesht lidhur me burrin duke mos parashikuar asgjë nëse ky i fundit e fiton apo jo zotësinë e plotë juridike për të vepruar si rezultat i martesës pavarësisht se nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Nëse interpretimin e kësaj dispozite do ta bazonim referuar parimeve të sanksionuara në Kushtetutë me të drejtë mund të themi se kjo dispozitë vjen ndesh me përcaktimet e nenit 18 sipas të cilit : **“Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”**¹⁵⁶.

Dispozita e sipërcituar rezulton që të paraqesë mangësi edhe në kuadër të ushtrimit të përfaqësimit ligjor ose të detyrueshëm që është ai prindit përkundrejt fëmijës. Në kuptim të përcaktimeve të dispozitës së sipërcituar një burrë që është lejuar të martohet nga gjykata për shkaqe me rëndësi pa mbushur moshën 18 vjeç nuk do të mund të ushtronte përfaqësimin ligjor përkundrejt fëmijës së tij për shkak se nuk kishte mbushur moshën e caktuar me ligj dhe konkretisht atë 18 vjeç për të fituar zotësinë e plotë juridike për të vepruar.

¹⁵⁴ Referoju për këtë qëllim përsëri nenit 6 parag 2 të Kodit Civil

¹⁵⁵ Referoju për këtë qëllim nenit 7 të Kodit të Familjes

¹⁵⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Arsyeja e mangësisë së dispozitës së sipërcituar dhe konkretisht të nenit 6 paragraf 2 të Kodit Civil duhet të lidhet edhe me kontekstin historik dhe konkretisht me kohën kur është miratuar kjo dispozitë dhe kuadrin ligjor që ishte në fuqi në Republikën e Shqipërisë në atë kohë sipas të cilit burri nuk lejohet të martohet nën kufirin e moshës 18 vjeç.

Si përfundim : Vlerësimi im personal është që neni 96 paragraf 2 gërma “a” të Kodit të Procedurës Civile duhet të pësojë ndryshime duke u riformuluar në këtë mënyrë :

“Nuk mund të jenë përfaqësues të palëve :

a) Personat që nuk kanë fituar zotësinë e plotë juridike për të vepruar ;

.....

Gjithashtu në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar legjislacioni shqiptar paraqitet gjithashtu e domosdoshme që neni 6 paragraf 2 i Kodit Civil të pësojë ndryshime duke u riformuluar në këtë mënyrë : ***“Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe burri apo gruaja që nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ato nuk e humbasin këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushin moshën tetëmbëdhjetë vjeç”.***

b) Lidhur me rastin e dytë vlen i njëjti arsyetim sikurse për rastin e parë dhe konkretisht në kushtet kur këta persona në referim edhe të përcaktimeve të nenit 91 paragraf 2 i Kodit të Procedurës Civile nuk lejohet që në një gjykim civil të marrin pjesë pa praninë e përfaqësuesit të tyre, për shkak se në kuptim të ligjit nuk konsiderohen të aftë për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre me të drejtë nuk mund të ushtrojnë të drejtën e përfaqësimit për faktin e thjeshtë sepse në kushtet kur nuk konsiderohen të aftë për të përfaqësuar interesat e tyre në një gjykim civil, nuk do të ishte e arsyeshme të mendohej se ata janë të aftë për të përfaqësuar interesat e personave të tjerë në një gjykim civil për faktin e thjeshtë se ky arsyetim do vinte ndesh me vetë përcaktimet e dispozitës procedurale të sipërcituar.

c) Lidhur me rastin e tretë sikurse e kemi cituar edhe më lart gjatë trajtimit të nenit 96 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë avokatët. Në kushtet kur këtyre të fundit u është pezulluar ushtrimi i profesionit nuk mund të ushtrojnë të drejtën e përfaqësimit për shkak se si rrjedhojë e këtij pezullimi nuk plotësojnë kushtet për tu konsideruar avokatë. Ky ndalim rezulton të jetë i kushtëzuar me kohëzgjatjen e pezullimit të ushtrimit të profesionit si avokat.

ç) Lidhur me rastin e katërt një ndalim i tillë lidhet me funksionin dhe konkretisht të ushtruarit e detyrës së gjyqtarit apo prokurorit rezulton që të jetë e papajtueshme me çdo veprimtari tjetër me përjashtim të mësimdhënies. Një ndalim i tillë duhet interpretuar edhe si një garanci që ligji ka parashikuar për palët ndërgjyqëse në një gjykim civil duke shmangur në këtë mënyrë çdo dyshim që mund të krijohet lidhur me zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor nga ana e gjykatës¹⁵⁷, si rrjedhojë e qënies së gjyqtarit apo prokurorit si përfaqësues i ndonjëres prej palëve ndërgjyqëse, si dhe dyshimit që mund të krijohet se vendimarrja e gjykatës mund të jetë rrjedhojë e ushtrimit të ndikimit për shkak

¹⁵⁷ Referoju për këtë qëllim neni 14 të Kodit të Procedurës Civile

të funksionit të gjyqtarit apo prokurorit që vepron si përfaqësues i ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse në një gjykim civil.

Në referim të përcaktimeve të dispozitës së sipërcituar gjyqtarit ose prokurorit nuk i lejohet të jetë përfaqësues me prokurë i ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse në një gjykim civil edhe kur gjyqtari ose prokurori ka përkundrejt ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse në një gjykim civil cilësinë e bashkëshortit, të paralindurit, të paslindurit, të vëllait apo të motrës.

Në kuadër të trajtimit të ndalimit të sipërcituar të përcaktuar në nenin 96 paragraf 2 gërma “ç” të Kodit të Proçedurës Civile, ajo që me të drejtë do të shtrohej si pyetje dhe që mund të përbëjë situatë që mund të ndeshet në praktikën gjyqësore është:

Nëse gjyqtari ose prokurori duhet të lejohet për të qenë përfaqësues në rastet e ushtrimit të përfaqësimit ligjor ose të detyrueshëm në referim kjo të përcaktimeve të nenit 65 të Kodit Civil, si dhe në referim kjo të përcaktimeve të nenit 220 të Kodit të Familjes ?

Sikurse kemi cituar në kreun II të këtij punimi përfaqësimi ligjor lind si rrjedhojë e fakteve të ndryshme juridike. Lindja e fëmijës përbën një ngjarje që sjell si pasojë lindjen e marrëdhënies së përfaqësimit të fëmijës nga prindërit e tij. Lindja e kësaj marrëdhënie përfaqësimi parashikohet në nenin 220 të Kodit të Familjes, dispozitë kjo në të cilën parashikohet shprehimisht se : *“Përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit në lidhje me fëmijnë e lindur gjatë martesës së tyre ose jashtë martese, nëse është njohur nga të dy prindërit”*¹⁵⁸.

Në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, janë prindërit ato që përfaqësojnë interesat e fëmijës në raport me të tretët duke u paraqitur në këtë mënyrë si përfaqësuesit ligjor të tyre jo vetëm në jetën e përditshme por edhe para autoriteteve të administratës shtetërore, si dhe para autoriteteve gjyqësore në kushtet kur ky përfaqësim u është caktuar me ligj¹⁵⁹.

Lidhur me pyetjen e shtruar për shqyrtim referuar përcaktimeve të nenit 96 të Kodit të Proçedurës, dispozitë kjo e emërtuar : ***“Pajisja me prokurë e përfaqësuesit”*** rezulton që kjo dispozitë t’i referohet rasteve të përfaqësimit vullnetar dhe jo atij ligjor ose siç njihet ndryshe si i detyrueshëm.

Në referim të dispozitës së sipërcituar rezulton që gjyqtarët dhe prokurorët në kuptim të ligjit dhe konkretisht në kuptim të dispozitës së sipërcituar kanë ndalim ligjor për të qenë përfaqësues me prokurë të ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse në një gjykim civil.

Ndalimi ligjor i sipërcituar do t’i shtrijë efektet e veta vetëm në rastet e përfaqësimit vullnetar dhe jo në rastet e përfaqësimit të detyrueshëm për shkak se në të kundërt pra nëse do të pranohej se ndalimi ligjor i përcaktuar në nenin 96 paragraf 2 gërma “ç” të Kodit të Proçedurës Civile do t’i shtrijë efektet e veta edhe në rastet e përfaqësimit ligjor jo vetëm që një parashikim i tillë ligjor do të konsiderohej si diskriminues por do të ishim

¹⁵⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 220 të Kodit të Familjes

¹⁵⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 65 të Kodit Civil

edhe para mungesës së kuadrit ligjor që do të rregullonte një rast të tillë të ushtrimit të përfaqësimit ligjor apo të detyrueshëm nga ana e gjyqtarëve apo prokurorëve.

Gjithashtu në kushtet kur ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve nuk ka ndonjë ndalim ligjor për të qenë palë në një gjykim civil arrihet në përfundimin se nuk mund të ketë ndalim ligjor që këto të fundit të ushtrojnë të drejtën e përfaqësimit ligjor ose të detyrueshëm.

Si përfundim vlerësimi im personal është që gjyqtarët ose prokurorët nuk kanë ndonjë ndalim ligjor për të ushtruar përfaqësimin ligjor ose të detyrueshëm dhe si rrjedhojë këto të fundit duhet të lejohen nga ana e gjykatës për të ushtruar këtë lloj përfaqësimi në rastet kur fëmija i tyre i mitur është palë ndërgjyqëse në një gjykim civil.

Përveç rasteve të cituara më lart të parashikuara shprehimisht në ligj sipas të cilave një personi nuk i lejohet të jetë përfaqësues i palëve me prokurë, ketyre rasteve siç e kemi përshkruar edhe më lart gjatë trajtimit të nenit 96 paragraf 1 të Kodit të Proçedurës Civile do t'i shtohen edhe rastet kur personat që paraqiten si përfaqësues janë jashtë rrethit të subjekteve të përcaktuar në dispozitën e cituar më lart.

iii) Rastet e mbarimit të përfaqësimit gjyqësor.

a) Vdekja ose humbja e zotësisë juridike për të vepruar e palës ndërgjyqëse.

Me vdekjen ose humbjen e zotësisë juridike për të vepruar të ndonjërës nga palët ndërgjyqëse sipas nenit 297 të Kodit të Proçedurës Civile gjykimi pezullohet gjithmonë edhe kur pala ndërgjyqëse që ka vdekur ose ka humbur zotësinë juridike për të vepruar të ketë qenë e përfaqësuar në gjyq nga avokatët ose persona të tjerë, duke vazhduar ky pezullim derisa në gjykim të paraqiten ose të thirren nga pala kundërshtare personat që hyjnë në të drejtat e ndërgjyqësit të vdekur ose deri në paraqitjen ose thirrjen nga pala kundërshtare të përfaqësuesit ligjor të ndërgjyqësit që ka humbur zotësinë për të vepruar si palë. Si rrjedhojë e fakteve të sipërcituara përfaqësimi gjyqësor i pushon efektet e tij. Ky përfaqësim mund t'i rifillojë efektet e tij nëse përfaqësuesi i mëparshëm gjyqësor zgjidhet përsëri nga trashëgimtarët e ndërgjyqësit të vdekur, ose nga përfaqësuesi ligjor i ndërgjyqësit që ka humbur zotësinë për të vepruar si palë.

I njëjti qëndrim mbahej dhe në Kodet e Proçedurës Civile të mëparshme dhe konkretisht në atë të vitit 1954 dhe në atë të vitit 1981¹⁶⁰. Në Kodin e Proçedurës Civile të vitit 1929 dhe konkretisht në nenin 89 të tij në ndryshim nga Kodet e Proçedurës Civile të mëvonshme përfshirë edhe atë aktual parashikohej se përfaqësimi gjyqësor nuk pushonte me vdekjen ose me humbjen e zotësisë për të vepruar të të përfaqësuarit¹⁶¹. Megjithatë në referim të kësaj dispozite trashëgimtarët e të përfaqësuarit në rastin e vdekjes së tij ose përfaqësuesi ligjor që i caktohej palës që kishte humbur zotësinë për të vepruar si palë kishin të drejtë të revokonin kurdoherë përfaqësimin.

¹⁶⁰ Referoju për këtë qëllim Kodeve të Proçedurës Civile të viteve 1954 dhe 1981.

¹⁶¹ Referoju për këtë qëllim nenit 89 të Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1929.

b) Vdekja e përfaqësuesit ose humbja e zotësisë juridike për të vepruar nga përfaqësuesi.

Përfaqësimi gjyqësor mbaron edhe kur gjatë gjykimit të çështjes përfaqësuesi i ndonjërës nga palët ndërgjyqëse vdes ose humbet zotësinë juridike për të vepruar. Por ky fakt nuk sjell pezullimin e gjykimit, i përfaqësuarit duhet të emërojë një përfaqësues tjetër ose të kryejë vetë të gjitha veprimet procedurale para gjykatës. E kundërta ndodh kur përfaqësuesi ligjor i ndonjërës nga palët ndërgjyqëse vdes ose humbet zotësinë për të vepruar. Në këtë rast gjykata vendos pezullimin e gjykimit të çështjes derisa të përfaqësuarit t'i emërohet një përfaqësues i ri ligjor.

c) Mbarimi i personit juridik.

Përfaqësimi gjyqësor pushon edhe kur mbaron personi juridik i përfaqësuar.

ç) Përfundimi i shqyrtimit të çështjes.

Si rregull përfaqësimi gjyqësor mbaron kur përfaqësuesi i ka kryer të gjitha veprimet procedurale, pra kur çështja është gjykuar në të gjitha shkallët e gjykimit.

d) Shfuqizimi dhe heqja dorë nga prokura.

Sipas parimeve të përgjithshme të përfaqësimit i përfaqësuarit ka të drejtë në çdo kohë që të shfuqizojë prokurën që i ka dhënë përfaqësuesit, si dhe ky i fundit ka të drejtë të heqë dorë në çdo kohë nga përfaqësimi. Parimi i sipërcituar rezulton që të jetë parashikuar shprehimisht edhe në nenin 98 të Kodit të Proçedurës Civile¹⁶².

Sipas parashikimeve të dispozitës procedurale të sipërcituar në dallim nga parashikimet e përgjithshme të Kodit Civil lidhur me përfaqësimin shfuqizimi i prokurës ose heqja dorë nga përfaqësimi nuk kanë efekt për palën tjetër, përderisa nuk është bërë zëvendësimi i përfaqësuesit.

Përfaqësimi gjyqësor i shtetit dhe i personave juridikë publikë.

Personat juridikë publikë si rezultat i marrëdhënieve kontraktore që mund të kenë me persona të ndryshëm, qofshin këta fizikë ose persona juridikë privatë mund të kenë mosmarrëveshje të cilat duhet të zgjidhen në rrugë gjyqësore, ku këta persona mund të paraqiten në rolin e paditësit ose të të paditurit. Në rrethana të tilla me të drejtë mund të shtrohej si pyetje se :

Kush do t'i përfaqësojë interesat e shtetit, si dhe personave juridikë publikë para gjykatës ?

Përgjigjen e një pyetje të tillë do e gjejmë në Ligjin nr. 10 018, date 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" të ndryshuar me Ligjin nr. 86/2018. Konkretisht në nenin 2 pika 2 të këtij ligji parashikohet shprehimisht se : *"Avokatura e Shtetit është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike.*

¹⁶² Referoju për këtë qëllim nenin 98 të Kodit të Proçedurës Civile

*Asistenca juridike përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit dhe jepet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit për personat juridikë dhe sipas funksioneve të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji*¹⁶³.

Në nenin 5 të Ligjit nr. 10 018, date 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" të ndryshuar me Ligjin nr. 86/2018, dispozitë kjo e emërtuar : **"Funksionet e Avokaturës së Shtetit"** parashikohet shprehimisht ndër të tjera se :

"1. Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme :

a) ...

b) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës.

c) ...

ç) ...

d) ...

dh) ...

e) ...

ë) ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës.

*1/1 Avokatura e shtetit ofron asistencë juridike, sipas parashikimeve të këtij ligji, për personat juridikë të mëposhtëm : a) institucionet shtetërore ; b) entet publike ; c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave. Personi juridik bashkëpunon me avokatin e shtetit dhe merr pjesë në procesin gjyqësor, në të cilin është palë ndërgjyqëse....Avokati i shtetit në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit juridik, vendos lidhur me qëndrimin dhe mbrojtjen e çështjes, si dhe bën përfaqësimin në gjykim*¹⁶⁴.

Referuar dispozitave të sipërcituara rezulton që në çështjet gjyqësore në të cilat Shteti Shqiptar është palë ndërgjyqëse, si dhe në çështjet në të cilat institucionet shtetërore, entet publike dhe shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave të shoqërisë janë palë ndërgjyqëse, interesat e këtyre subjekteve do të përfaqësohen nga Avokatura e Shtetit. Sikurse përcaktohet edhe shprehimisht në ligj lidhur me subjektet e sipërcituara Avokati i Shtetit ka cilësinë e përfaqësuesit ligjor. Pra në raste të tilla nuk kemi të bëjmë me përfaqësim gjyqësor vullnetar por me përfaqësim gjyqësor ligjor, sepse është vetë ligji që përcakton se Avokati i Shtetit ka cilësinë e përfaqësuesit ligjor referuar

¹⁶³ Referoju për këtë qëllim nenit 2 pika 2 të Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" të ndryshuar me ligjin nr. 86/2018.

¹⁶⁴ Referoju për këtë qëllim nenit 5 pika 1 të Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" të ndryshuar me ligjin nr. 86/2018.

për këtë qëllim dispozitave ligjore të sipërcituara sipas të cilave në rastet e sipërcituara Avokati i Shtetit vendos lidhur me qëndrimin dhe mbrojtjen e çështjes, si dhe bën përfaqësimin në gjykim.

Subjektet e sipërcituara për të cilët me ligj e drejta e përfaqësimit i është ngarkuar Avokaturës së Shtetit nuk kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësues të tyre për të përfaqësuar interesat e tyre në proceset gjyqësore në të cilat janë palë me përjashtim të rastit kur e drejta e përfaqësimit i është deleguar nga Avokatura e Shtetit, institucionit përkatës që është palë ndërgjyqëse në një gjykim civil apo administrativ.

Ajo që vlen për tu theksuar është fakti se Avokatura e Shtetit do të ketë cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjekteve të sipërcituara në proceset gjyqësore që ato kanë me persona të tjerë fizikë apo juridikë privatë. Në rast konflikti ndërmjet vetë organeve qendrore të administratës publike ose ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe organeve të qeverisjes vendore, në të tilla raste Avokatura e Shtetit nuk mund të ushtrojë të drejtën e përfaqësimit ligjor. Një ndalim i tillë parashikohet në nenin 5 pika 2 të Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" të ndryshuar me Ligjin nr. 86/2018¹⁶⁵.

V.IV. Fenomeni i kufizimit të autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit.

Në përfaqësimin vullnetar pushteti i përfaqësuesit rrjedh nga deklarimi i vullnetit të të përfaqësuarit. Sikurse kemi theksuar edhe më lart ky vullnet mund të shfaqet në formë shkresore me anë të lëshimit për këtë qëllim të një dokumenti që në kuptim të ligjit njihet si prokurë, por edhe në formë verbale para gjykatës që gjykon mosmarrëveshjen në të cilën i përfaqësuarit është palë ndërgjyqëse. Dhënia e pushtetit të përfaqësimit që i përfaqësuarit i jep përfaqësuesit në përfaqësimin vullnetar nuk përbën gjë tjetër vetëm se një manifestim të autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit për të zgjedhur lirisht personin të cilit kërkon t'i besojë përfaqësimin e interesave të tij qoftë në kryerjen e veprimeve juridike, qoftë në kryerjen e veprimeve të tjera përfshirë këtu edhe ato gjyqësore. Sikurse kemi parashtruar edhe në pjesët e tjera të këtij punimi i përfaqësuarit për arsye nga më të ndryshmet mund të mos marrë pjesë personalisht në kryerjen e një veprimi juridik, apo në kryerjen e veprimeve të tjera përfshirë këtu edhe ato gjyqësore duke zgjedhur në këtë mënyrë që t'ia besojë një personi tjetër kryerjen e këtyre veprimeve duke pranuar në këtë mënyrë që të detyrohet nga vullneti i të tjerëve. Është pikërisht kjo marrëdhënie besimi që ekziston ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, e cila sjell lindjen e përfaqësimit si rezultat i manifestimit të autonomisë së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit. Por ndërsa tek përfaqësimi ligjor mungon një akt i autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit ku subjekti vihet pavarësisht nga vullneti i tij në varësi të personit që për shkak të ligjit ose për shkak të emërimit si i tillë nga ana e gjykaës konsiderohet si përfaqësuesi i tij ligjor, e kundërta ndodh te përfaqësimi vullnetar, në të cilin manifestimi i autonomisë së vullnetit nga ana e të përfaqësuarit është determinuese për lindjen e tij.

¹⁶⁵ Referoju për këtë qëllim nenin 5 pika 2 të Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" të ndryshuar me ligjin nr. 86/2018.

Në kuadër të trajtimit të parimit të autonomisë së vullnetit në përfaqësimin vullnetar ajo që me të drejtë do të shtrohet si pyetje të cilës vlerësoj se e meriton t'i kushtohet vëmendje si për efekt studimor, ashtu edhe në funksion të evidentimit të ndonjë mangësie në dispozitat që rregullojnë përfaqësimin në gjyq do të ishte:

A ekzistojnë kufizime në dispozitat që rregullojnë përfaqësimin në gjyq të manifestimit të autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit në zgjedhjen e përfaqësuesit të tij në përfaqësimin gjyqësor vullnetar ?

Ashtu sikurse autonomia e vullnetit si një ndër parimet bazë të së drejtës civile i nënshtrohet kufizimeve përkatëse të përcaktuara në ligj, referuar faktit se në asnjë rast nuk mund të thuhet se është e pakufizuar për shkak se shteti me anë të normave dhe rregullave në raste të caktuara vendos kufizime mbi autonominë e vullnetit të një personi fizik apo juridik edhe dispozitat ligjore që aktualisht janë në fuqi dhe që rregullojnë përfaqësimin gjyqësor rezultojnë të kenë vendosur kufizime të caktuara ndaj vullnetit të të përfaqësuarit në zgjedhjen lirisht prej këtij të fundit të përfaqësuesit të tij në një proces gjyqësor në të cilin ai si i përfaqësuar është palë ndërgjyqëse.

Konkretisht dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile që rregullojnë përfaqësimin gjyqësor vullnetar rezultojnë që të kenë vendosur kufizime ndaj vullnetit të të përfaqësuarit duke i kushtëzuar zgjedhjen e përfaqësuesit brenda një rrethi të kufizuar personash, të cilët për shkak të profesionit që ushtrojnë siç janë avokatët, për shkak të të qenurit bashkëshort ose për shkak të lidhjeve gjinore të afërta që kanë me ndonjërin nga palët ndërgjyqëse, për shkak se janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga palët ndërgjyqëse ose për shkak se vetë ligji ju njeh të drejtën për të vepruar si përfaqësues i ndonjërit nga palët ndërgjyqëse e gëzojnë këtë të drejtë. Në rastin e përfaqësimit gjyqësor jo vetëm që përfaqësuesi duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme për të qenë i tillë sikurse është zotësia e plotë juridike për të vepruar por ky i fundit duhet të jetë brenda rrethit të personave që në kuptim të ligjit mund të jenë përfaqësues të palëve me prokurë në një gjykim civil. Mosplotësimi nga ana e përfaqësuesit të kushteve të përcaktuara në ligj përbën shkak që ky i fundit të mos lejohet nga ana e gjykatës për të ushtruar detyrën e tij si përfaqësues.

Këto kufizime rezultojnë që nga ana e ligjvënësit të jenë vendosur për të gjitha shkallët e gjyqimit, madje për pjesmarrjen në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë kushtet për të qenë përfaqësues gjyqësor rezultojnë që të jenë më specifike.

Konkretisht në nenin 96/a të Kodit të Proçedurës Civile, dispozitë kjo e emërtuar : **“Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë”** rezultojnë të jetë parashikuar shprehimisht se : *“Përfaqësimi i palëve në Gjykatën e Lartë bëhet vetëm nga avokat. Një rregull i tillë nuk rezultojnë që të zbatohet vetëm për rastet kur përfaqësimi bëhet nga Avokatura e Shtetit sipas ligjit që rregullon veprimtarinë e kësaj të fundit”¹⁶⁶.*

Edhe qenia avokat rezultojnë që të jetë e pamjaftueshme për të ushtruar përfaqësimin në Gjykatën e Lartë në kushtet kur në referim të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të dala në zbatim të këtij të fundit ushtrimi i përfaqësimit në Gjykatën e Lartë lidhet me vjetërsinë e avokatit në ushtrimin e profesionit.

¹⁶⁶ Referoju për këtë qëllim nenin 96/a të Kodit të Proçedurës Civile

I njëjti kufizim rezulton që të jetë parashikuar edhe për gjykimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Konkretisht në nenin 39 pika 3 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dispozitë kjo e emërtuar: **“Pjesmarrësit në gjykimin kushtetues”** rezulton që të jetë parashikuar shprehimisht se: *“Përfaqësues të pjesmarrësve në gjykimin kushtetues mund të jenë avokatët, të cilët pajisen me prokurë ose caktohen si të tillë me deklaram në seancë plenare”*¹⁶⁷.

Një kufizim i tillë parashikohet edhe nga Kodi Italian i Proçedurës Civile, sipas të cilit të drejtën për të qenë përfaqësues para Gjykatës Italiane të Kasacionit e gëzojnë vetëm personat që plotësojnë disa kushte të caktuara që lidhen me kohëzgjatjen në ushtrimin e profesionit dhe nivelin akademik. Kështu vetëm: **a) personat që kanë pesë vjet që ushtrojnë profesionin e avokatit; b) personat që kanë punuar më parë si gjyqtarë ose prokurorë; c) personat që punojnë si profesorë të së drejtës në universitete**¹⁶⁸, kanë të drejtë të veprojnë si përfaqësues para Gjykatës së Kasacionit. Nga kjo rezulton se e drejta e të përfaqësuarve për të zgjedhur një përfaqësues me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre para Gjykatës së Kasacionit kufizohet vetëm brenda rrethit të personave që plotësojnë kushtet e përmendura më lart.

Në vlerësimin tim kufizimi i të përfaqësuarit në lirinë e zgjedhjes së përfaqësuesit gjyqësor në përfaqësimin vullnetar në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese duhet të konsiderohet i drejtë sepse kryerja e disa veprimeve të caktuara para gjykatës nga ana e përfaqësuesit sjell pasojat të pariparueshme për të përfaqësuarin. Kufizimi i vendosur duke e kushtëzuar vullnetin e të përfaqësuarit vetëm në zgjedhjen e avokatit duhet të interpretohet në funksion të garantimit këtij të fundit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak se, që interesat e të përfaqësuarit të mbrohen në një mënyrë sa më efikase kërkohet që përfaqësuesit të kenë një nivel sa më të lartë profesional. Në raste të caktuara është vetë ligji që merr në mbrojtje interesat e të përfaqësuarit. Vërtet në pamje të parë duket sikur kemi të bëjmë me një kufizim që i bëhet të drejtës së të përfaqësuarit për t'i besuar çdo personi përfaqësimin e interesave të tij mjafton që ai të ketë zotësi të plotë për të vepruar, por ky përfaqësim nuk do të ishte në interes të të përfaqësuarit referuar për këtë qëllim edhe natyrës së gjykimit që zhvillohet si në Gjykatën e Lartë ashtu edhe në atë Kushtetuese. Edhe në një rast të tillë nuk mund të flitet për një kufizim të plotë që i bëhet të drejtës së të përfaqësuarit për të zgjedhur lirisht përfaqësuesin. I përfaqësuari ka të drejtë të emëroje si përfaqësues të tij secilin nga ata persona të cilëve u njihet e drejta për të qenë përfaqësues në gjykimin e çështjeve para Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese. Një argument tjetër do të ishte edhe fakti se si rregull i përgjithshëm as vetë i përfaqësuari nuk do të ishte në gjendje të përfaqësonte interesat e tij para Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese për shkak se i mungon aftësia për të realizuar diçka të tillë.

Ndërsa kufizimi i autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit për të zgjedhur lirisht përfaqësuesin që do e përfaqësojë atë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese duhet të konsiderohet i justifikuar për arsye të përmendura më lart, ky

¹⁶⁷ Referoju për këtë qëllim nenin 39 pika 3 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

¹⁶⁸ Referoju për këtë qëllim Kodit të Proçedurës Civile të Republikës së Italisë

kufizim në raste të caktuara mund të paraqitet si i pajustificuar lidhur me caktimin lirisht të një përfaqësuesi për gjykimin e çështjes në shkallë të parë dhe të dytë. Kështu kur trajtuam përfaqësimin gjyqësor vullnetar konstatuam që si përfaqësues të palëve në gjykimin në shkallë të parë dhe të dytë në referim të nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile mund të jenë një rreth i kufizuar personash. Rrethi i personave që mund të jenë përfaqësues të palëve në gjykim është përcaktuar në mënyrë taksative. Edhe në këtë rast përballë të drejtës së të përfaqësuarit për të zgjedhur lirisht përfaqësuesin e tij në përputhje kjo dhe me nenin 64 të Kodit Civil, nga permbajtja e të cilit del qartë liria e pakufizuar e të përfaqësuarit për të caktuar përfaqësuesin e tij duke e veshur këtë të fundit me të gjitha tagrat që ai dëshiron me kushtin e vetëm që ai të ketë zotësi të plotë për të vepruar, vendoset parashikimi ligjor që referohet në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile, i cili e kufizon këtë liri vullneti të të përfaqësuarit në një proçes gjyqësor civil. Ky kufizim mund të mos paraqitet i drejtë referuar faktit se në kushtet kur norma ligjore e sipërcituar ju njeh të drejtën për të qenë si përfaqësues me prokurë në një gjykim civil bashkëshortëve, të paralindurve, të paslindurve, vëllezërve dhe motrave, për të cilët si rregull i përgjithshëm nuk mund të flitet se kanë njohuri të mirëfillta juridike aq sa të realizojnë një përfaqësim efektiv të të afërmit të tyre që është palë ndërgjyqëse në gjykimin civil, por e drejta e përfaqësimit këtyre të fundit u njihet vetëm për shkak të marrëdhënieve shumë të afërta që kanë me të përfaqësuarin prej tyre. Por marrëdhënie të afërta ose marrëdhënie besimi ndonjëra nga palët ndërgjyqëse në gjykim mund të ketë edhe me persona të tjerë jashtë rrethit të personave të përmendur më lart. Gjithsesi referuar përmbajtjes së nenit 96 të Kodit të Proçedurës Civile ligji proçedural ka parashikuar mundësinë e qënies përfaqësues edhe të personave jashtë rrethit të subjekteve të sipërcituar por me kushtin që këta persona të lejohen nga gjykata për të qenë përfaqësues. Në një rast të tillë sikurse e kemi cituar edhe më lart ligji proçedural civil rezulton që ta ketë lënë në diskrecionin e gjykatës për të pranuar që të jetë përfaqësues me prokurë i një pale ndërgjyqëse në gjykim edhe një person që nuk përfshihet në rrethin e subjekteve që mund të ushtrojnë të drejtën e përfaqësimit me prokurë.

Si përfundim vlerësimi im personal është që rrethi i personave që mund të jenë përfaqësues me prokurë të ndonjërës prej palëve ndërgjyqëse në një gjykim civil në shkallë të parë dhe të dytë do duhet të ishte më i gjerë se ai i përcaktuar në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile, duke i dhënë në këtë mënyrë të përfaqësuarit në një gjykim civil më shumë mundësi zgjedhjeje të përfaqësuesit të tij, duke shmangur në këtë mënyrë edhe pushtetin diskrecial që ligji proçedural civil i ka njohur gjykatës për të lejuar që të jenë përfaqësues me prokurë të palëve ndërgjyqëse në një gjykim edhe persona të tjerë tej rrethit të subjekteve të përcaktuar në dispozitën e sipërcituar. Në funksion të përfundimit të sipërcituar për efekt krahasimor po citoj edhe parashikimet ligjore të Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1981, i cili në nenin 109 paragraf 1 të tij parashikonte shprehimisht se: *"Përfaqësues të personave që marrin pjesë në gjykim mund të jenë këshilltarët ligjorë dhe të gjithë shtetasit që kanë zotësi për të vepruar, me përjashtim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përmbartësve gjyqësorë"*¹⁶⁹.

¹⁶⁹ Referoju për këtë qëllim nenit 109 paragraf 1 të Kodit të Proçedurës Civile të vitit 1981

KREU VI

VI. Konkluzione, Rekomandime dhe Bibliografia

Konkluzione dhe Rekomandime.

Pavarësisht paraqitjes së konkluzioneve dhe rekomandimeve përkatëse në çdo kre të këtij punimi më poshtë do të paraqesim një përmbledhje të këtij punimi shoqëruar edhe me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse për ndryshimet që duhet të pësojnë dispozitat e Kodit Civil aktual që rregullojnë përfaqësimin si institut të veçantë të të drejtës civile.

Në **kreun I** të këtij punimi trajtuam konceptin e përfaqësimit, si dhe zhvillimin historik të këtij koncepti që nga fillimet e tij dhe më pas edhe zhvillimin që ka pësuar ky koncept në sistemin civil Law, pjesë e të cilit është edhe vendi ynë, si dhe trajtuam edhe zhvillimin e institutit të përfaqësimit në të drejtën tone civile të brendshme.

Kështu sipas teorisë së vjetër latine, personi të cilit i ishte drejtuar mandati (figurë e ngjashme me përfaqësuesin e sotëm) nuk mund të merrte asnjë shpërblim apo kompensim për punën e kryer, pasi mandati ishte zakonisht i shoqëruar nga një marrëdhënie varësie dhe veprimet ishin të prezumuara se kryheshin për shkak të kësaj marrëdhënieje.

Deri në hartimin e Kodit Civil Gjerman të vitit 1896 trajtimi i përfaqësimit si institut më vete nuk ishte i konsoliduar, ndonëse pikërisht tradita e mungesës së shpërblimit shërbeu si bazë për trajtimin e tij si një marrëdhënie juridike e njëanshme. Edhe Kodi Civil Francez i vitit 1804 i njohur ndryshe edhe si Kodi i Napoleonit, i cili ishte më i vjetër se Kodi Civil Gjerman e trajtonte mandatin apo përfaqësimin në mënyrë jo shumë të qartë. Konfuzion krijohej gjithashtu edhe në Kodin Civil Italian, atë Spanjoll si dhe atë Zvicëran. Pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil Gjerman praktika franceze e qartësoi dukshëm situatën duke iu përshtatur teorisë gjermane lidhur me institutin e përfaqësimit. Është pikërisht Kodi Civil Gjerman ai që bëri dallimin e qartë ndërmjet përfaqësimit dhe mandatit, duke e konsideruar të dytin kontratë dhe duke e rregulluar për këtë qëllim më vete nga përfaqësimi dhe konkretisht duke e përfshirë në dispozitat e pjesës së posaçme. Pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil Gjerman shumica e vendeve të traditës së të drejtës civile duke përfshirë Italinë, Finlandën, Danimarkën, Norvegjinë, Suedinë, Zvicrën dhe Greqinë adoptuan mënyrën e rregullimit të institutit të përfaqësimit sipas modelit gjerman të së drejtës. Edhe Kodi Civil aktual që është në fuqi rezulton që ta ketë trajtuar institutin e përfaqësimit sipas modelit gjerman të së drejtës.

Në vendin tonë konceptin e përfaqësimit, si dhe trajtimin e tij si institut e hasim për herë të parë në Kodin Civil të vitit 1929, në të cilin trajtimi i këtij të fundit rezulton që të jetë bërë në kuadër të legjislacionit francez dhe atij italian që e rregullonte këtë institut në atë periudhë. Sipas parashikimeve të këtij kodi njihej vetëm përfaqësimi i drejtpërdrejtë. Në një përfundim të tillë arrihet referuar përkufizimit të përfaqësimit të dhënë në nenin 1105 të këtij Kodi në të cilin parashikohej shprehimisht se : *“Veprimet e kryeme prej*

*përfaqësuesit në emrin e të përfaqësuesit, brenda kufijve të pushteteve të tij, kanë efekt drejtpërsëdrejti në favor të përfaqësuesit dhe kundra tij*¹⁷⁰.

Sipas përcaktimeve të Kodit Civil të vitit 1929 kushtet që kërkoheshin për vlefshmërinë e përfaqësimit ishin :

a) duhet që të ekzistonte një pushtet përfaqësimi domethënë një raport juridik i cili të autorizonte përfaqësuesin që me veprimin e tij të prodhonte efekte juridike për të përfaqësuarin. Pushteti me përfaqësue e kishte burimin ose në vullnetin e të përfaqësuarit ose në një shkak tjetër (pushteti ligjor i përfaqësuesit).

b) duhet që përfaqësuesi të vepronte në emrin e të përfaqësuarit¹⁷¹.

Në dallim nga Kodi Civil aktual sipas të cilit është parashikuar shprehimisht që përfaqësuesi duhet të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar, sipas parashikimeve të Kodit Civil të vitit 1929 dhe konkretisht nenit 1106 të tij nuk ishte e nevojshme që përfaqësuesi të kishte zotësi të plotë juridike për të vepruar¹⁷². Të njëjtin parashikim ligjor sikurse edhe Kodi Civil i vitit 1929 gjejmë edhe në Kodin Civil Italian dhe konkretisht në nenin 1389 të tij, sipas të cilit nuk konsiderohet e domosdoshme që përfaqësuesi të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

Doktrina e asaj kohe lidhur me parashikimin ligjor sipas të cilit nuk ishte e nevojshme që përfaqësuesi të kishte zotësi të plotë për të vepruar jepte këtë arsytim : *“Kufizimi i të drejtës për të qenë palë në një veprim juridik që i bëhet të miturve ose personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar bëhet me qëllim mbrojtjen e interesave të të miturve ose të personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar me qëllim që të tjerët të mos abuzojnë me pozitën juridike të tyre, për shkak se ata nuk konsiderohen të aftë që nëpërmjet veprimeve juridike që ata kryejnë të fitojnë të drejta dhe të marrin përsipër detyrime juridiko – civile. Prandaj ky kufizim nuk duhet të ekzistojë kur këta persona veprojnë si përfaqësues dhe për këtë shkak nuk mund të cënohen efektet e veprimeve të tyre, sepse efektet e këtyre veprimeve nuk shtrihen ndaj tyre por ndaj personave të përfaqësuar prej tyre*¹⁷³. Në të njëjtin arsytim rezulton që të bazohet edhe doktrina italiane e së drejtës civile”¹⁷⁴.

Lidhur me këtë parashikim ligjor pas paraqitjes edhe të qëndrimit doktrinar të asaj periudhe, si dhe të qëndrimit që mbahet edhe nga doktrina italiane e së drejtës paraqitëm edhe opinionin përkatës duke e bazuar këtë të fundit edhe në qëndrimin që mbahet nga doktrina aktuale e të drejtës civile shqiptare në funksion kjo të arritjes në përfundimin se zotësia e plotë për të vepruar e përfaqësuesit paraqitej e domosdoshme në kushtet kur

¹⁷⁰ Referoju për këtë qëllim nenit 1105 të Kodit Civil të vitit 1929.

¹⁷¹ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

¹⁷² Referoju për këtë qëllim nenit 1106 të Kodit Civil të vitit 1929.

¹⁷³ Referoju për këtë qëllim librit “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si Komentari i Kodit Civil të vitit 1929, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998, fq 225 – 275.

¹⁷⁴ Alberto Trabucchi, Istituzioni di Diritto Civile, botim i vitit 1986.

përfaqësuesi në rastin e kryerjes së veprimeve juridike nuk paraqitet thjesht në pozitën e një transmetuesi vullneti të të përfaqësuarit, por në shumë raste ai si përfaqësues shfaq vullnetin e tij nga i cili lindin të drejta dhe detyrime juridiko – civile për të përfaqësuarin.

Përfundimin e sipërcituar e ilustruam edhe me një shembull në të cilin evidentohet plotësisht shfaqja e vullnetit nga ana e përfaqësuesit në kryerjen e veprimit juridik në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Në Kodin Civil të vitit 1929 krahas përfaqësimit vullnetar ku pushtetet e përfaqësuesit buronin nga vullneti i të përfaqësuarit njihej edhe përfaqësimi ligjor i quajtur ndryshe dhe si pushteti ligjor.

Përgjithësisht trajtimi që i bëhej institutit të përfaqësimit në Kodin Civil të vitit 1929 me përjashtime të vogla rezultoi që të jetë i njëjtë edhe me trajtimin që i bëhet institutit të përfaqësimit në kodin civil aktual.

Edhe Ligji për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 i cili e trajtonte përfaqësimin si institut të veçantë të të drejtës civile në nenet 61 – 75 të tij kishte parashikime ligjore pothuajse të njëjta me parashikimet ligjore aktuale që janë në fuqi lidhur me institutin e përfaqësimit.

Në Kodin Civil të vitit 1981 në ndryshim nga Ligji për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955, konstatohet një regres lidhur me trajtimin e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile për shkak se shumë dispozita të mëparshme ligjore që rregullonin institutin e përfaqësimit në këtë kod mungonin. Konkretisht në Kodin Civil të vitit 1981 përfaqësimi si institut i veçantë i të drejtës civile trajtohej në vetëm pesë dispozita dhe konkretisht në nenet 54 – 58 të tij. Gjithsesi qëndrimi doktrinar vijoi të mbetej i njëjtë, duke i bërë për këtë qëllim institutit të përfaqësimit nga pikëpamja doktrinale një trajtim të njëjtë sikurse në Ligjin për Pjesën e Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955.

Në Kodin Civil të vitit 1994 përfaqësimi si institut i veçantë i të drejtës civile ka gjetur trajtimin e tij në nenet 64 – 78 të këtij Kodi. Në kuadër të trajtimit të konceptit të përfaqësimit sipas Kodit Civil aktual evidentuam karakteristikat thelbësore të përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile në referim të të cilave më pas definuam edhe një përkufizim të plotë lidhur me përfaqësimin duke e përkufizuar përfundimisht këtë të fundit në ndryshim nga parashikimet e nenit 64 paragraf 1 të Kodit Civil në këtë mënyrë : *“Përfaqësimi është një marrëdhënie juridiko civile në të cilën një person fizik ose juridik (përfaqësuesi) duke vepruar brenda kufijve të të drejtave apo tagreve që i janë dhënë nga ligji, prokura ose gjykata kryen veprime juridike dhe veprime të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër të quajtur i përfaqësuarit, veprime këto të cilat krijojnë pasojë drejtpërdrejt për këtë të fundit”.*

Në funksion të përkufizimit të dhënë vlerësoj se neni 64 paragraf 1 i Kodit Civil duhet të ndryshohet duke u riformuluar paragrafi i parë sipas përcaktimit të mësipërm.

Gjithashtu në këtë kre trajtuam edhe ndalimin e parashikuar në nenin 64 paragraf 2 të Kodit Civil se përfaqësimi nuk lejohet në ato raste kur veprimi juridik duhet të kryhet nga vetë

personi duke përcaktuar se për një kategori të tjera veprimesh përgjithësisht të karakterit personal, përfaqësimi si institut i të drejtës nuk mund të zbatohet për shkak kjo të vetë natyrës së këtyre veprimeve të cilat kërkojnë detyrimisht praninë personalisht të personit që shfaq vullnetin. Si shembuj sipas të drejtës sonë të brendshme referuam rastin e testamentit si veprim juridik i njëanshëm që kryhet personalisht nga ana e testatorit ashtu edhe rastin e lidhjes së martesës që sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Familjes që rregullojnë lidhjen e martesës rezulton që kjo e fundit lidhet para autoriteteve kompetente vetëm në prani të personave që shfaqin vullnet për të lidhur martesë ndërmjet tyre.

Gjithashtu në kuadër të interpretimit të parashikimit ligjor të referuar në nenin 64 parag 2 të Kodit Civil përcaktuam se kjo dispozitë duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar referuar faktit se me anë të përfaqësimit nuk mund të kryhen jo vetëm ato veprime për të cilat ligji ka përcaktuar si detyrim praninë e vetë personit, por edhe të gjitha ato veprime të tjera të cilat për vetë natyrën e tyre janë të lidhura ngushtë me praninë e vetë personit, si dhe pa praninë e këtij të fundit ato nuk mund të kryhen. Në funksion të këtij përfundimi referuam si shembull kryerjen e një pune të caktuar e cila lidhet pazgjidhshmërisht me cilësitë personale të personit pa të cilat ajo nuk mund të kryhet. Gjithashtu si shembull paraqitëm edhe rastin e një futbollisti i cili pjesmarrjen në një ndeshje të caktuar nuk mund ta realizojë me anë të një përfaqësuesi.

Në kreun II të këtij punimi trajtuam llojet e përfaqësimit, si dhe trajtimin e institutit të përfaqësimit në raport me institute të tjera të së drejtës sikurse është gjerimi i punëve të tjetrit të parashikuar nga nenet 648 – 652 të Kodit Civil, si dhe kontrata në dobi të personit të tretë e parashikuar nga neni 694 i Kodit Civil.

Lidhur me llojet e përfaqësimit përcaktuam se kur pushteti i përfaqësimit buron nga ligji kemi përfaqësim ligjor, ndërsa në rastin e dytë kur pushteti i përfaqësimit buron nga vullneti i të përfaqësuarit kemi përfaqësim vullnetar.

Në referim të përcaktimit të mësipërm të sanksionuar edhe në ligj arrihet në përfundimin se përfaqësimi si institut i veçantë i të drejtës civile të shfaqet në dy forma apo në dy trajta të ndryshme të cilat përbëjnë edhe llojet e përfaqësimit dhe konkretisht ai shfaqet si:

- i)** përfaqësim ligjor ose i detyrueshëm ;
- ii)** përfaqësim vullnetar.

Përsa i përket përfaqësimit ligjor ose të detyrueshëm përcaktuam se në të gjitha rastet kur pushteti i përfaqësimit buron nga ligji kemi të bëjmë me përfaqësim ligjor. Edhe në ato raste kur këto tagre caktohen nga gjykata sikurse referohet në nenin 64 të Kodit Civil përsëri kjo e fundit në caktimin e tagreve të përfaqësuesit i referohet dispozitave ligjore që parashikojnë caktimin e përfaqësuesit.

Në rastin e përfaqësimit ligjor i njohur ndryshe edhe si përfaqësim i detyrueshëm është ligji ai që përcakton lindjen e marrëdhënies së përfaqësimit, caktimin e përfaqësuesit, si dhe kufijtë e të drejtave të këtij të fundit të njohura ndryshe si tagre përfaqësimi. Ky lloj përfaqësimi ka karakter të detyrueshëm si për të përfaqësuarin ashtu edhe për përfaqësuesin.

Në vijim të trajtimit të përfaqësimit ligjor referuam disa shembuj të lindjes apo krijimit të marrëdhënies së përfaqësimit ligjor, duke u përpjekur të evidentojmë disa prej situatave më të zakonshme që ndodhin në jetën e përditshme, si rrjedhojë e fakteve të ndryshme juridike.

Përsa i përket përfaqësimit vullnetar përcaktuam se në të gjitha rastet kur pushteti i përfaqësimit buron nga vullneti i të përfaqësuarit kemi të bëjmë me përfaqësim vullnetar. Ky vullnet i të përfaqësuarit përgjithësisht shfaqet duke u pasqyruar në një akt apo dokument që në kuptim të parashikimeve ligjore quhet : **“Prokurë”**.

Gjithashtu në kuadër të trajtimit të përfaqësimit vullnetar përcaktuam se ky i fundit krahas formës shkresore si një nga format e shfaqjes së vullnetit mund të shfaqet edhe në format e tjera të parashikuara nga ligji për kryerjen e një veprimi juridik dhe që përcaktohen në nenin 80 të Kodit Civil sikurse janë në mënyrë verbale, me heshtje dhe me veprime konkludente. Në një përfundim të tillë arrihej referuar për këtë qëllim vetë përcaktimeve të nenit 65 parag 2 të Kodit Civil në të cilin parashikohet shprehimisht se : *“Tagret e përfaqësimit mund të nxirren edhe nga rrethanat, në të cilat kryhen veprimet juridike përkatëse”*¹⁷⁵.

Përcaktimi ligjor i sipërcituar nuk nënkupton gjë tjetër vetëm se shfaqja e vullnetit nga ana e të përfaqësuarit për caktimin e përfaqësuesit në përfaqësimin vullnetar, si dhe përcaktimi i tagreve të këtij të fundit mund të bëhet edhe në forma të tjera krahas asaj shkresore.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit vullnetar përcaktuam edhe se karakteristikë e këtij të fundit ishte edhe fakti se ai mund të shfaqej si përfaqësim individual ose si përfaqësim kolektiv. Një karakteristikë e tillë nxirrej referuar për këtë qëllim përmbajtjes së nenit 68 të Kodit Civil.

Në vijim të trajtimit të përfaqësimit vullnetar vëmendje të veçantë i kushtuam prokurës si forma më e zakonshme e shfaqjes së vullnetit nga i përfaqësuari në caktimin e përfaqësuesit meqenëse format e tjera të shfaqjes së vullnetit nuk para hasen shpesh në jetën e përditshme.

Pas përcaktimit të konceptit të prokurës definuam edhe përkufizimin përkatës lidhur me këtë të fundit duke përcaktuar se prokura nuk përbën gjë tjetër vetëm se një veprim juridik të njëanshëm, si dhe përbën faktin juridik mbi bazën e të cilit lind marrëdhënia juridiko – civile e përfaqësimit ndërmjet të përfaqësuarit i cili shfaq vullnetin e vet për caktimin e një ose disa personave të tjerë, të cilët do të veprojnë në emër dhe për llogari të tij si i përfaqësuar dhe personit apo personave që caktohen si përfaqësues.

Në trajtimin e formës së prokurës duke iu referuar për këtë qëllim edhe parashikimeve ligjore dhe konkretisht nenit 72 të Kodit Civil në të cilin parashikohet edhe forma që duhet të ketë kjo e fundit si përfundim përcaktuam se prokura është një veprim juridik formal, madje vetë dispozita e sipërcituar ka përcaktuar shprehimisht se prokura krahas formës shkresore duhet të jetë e shoqëruar edhe me formë noteriale në ato raste kur ligji parashikon se veprimi juridik që do të kryejë përfaqësuesi në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit bëhet me akt noterial.

¹⁷⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 71 parag 2 të Kodit Civil.

Në funksion të përcaktimit të sipërcituar referuam si shembull kontratën e shitjes së një sendi të paluajtshme ose të drejtave reale mbi të, të cilat në referim të përcaktimeve të nenit 83 të Kodit Civil duhet të bëhet me akt noterial. Në një rast të tillë edhe prokura që i përfaqësuari i jep përfaqësuesit për të kryer veprime juridike të natyrës së sipërcituar duhet që detyrimisht të ketë formë noteriale në të kundërt konsiderohet e pavlefshme në referim të përcaktimeve të nenit 72 të Kodit Civil¹⁷⁶.

Lidhur me llojet e prokurave duke iu referuar për këtë qëllim edhe parashikimeve ligjore të nenit 71 të Kodit Civil përcaktuam se prokura mund të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Duke iu referuar përkufizimit të dhënë në ligj dhe konkretisht në dispozitën e sipërcituar lidhur me prokurën e përgjithshme përcaktuam se në kuptim të ligjit prokura konsiderohet e përgjithshme : *“kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagra për të kryer veprime juridike të shumëllojshme, të cilat kanë të bëjnë me një tërësi të drejtash të të përfaqësuarit, përveç atyre që i përfaqësuari i ka përjashtuar shprehimisht”*¹⁷⁷, ndërsa prokura konsiderohet e posaçme në kuptim të ligjit : *“kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët”*¹⁷⁸.

Si prokura e përgjithshme ashtu edhe ajo e posaçme mund të përmbanin kufizime për veprimtarinë e përfaqësuesit. Si shembull referuam rastin kur i përfaqësuari i ka dhënë prokurë përfaqësuesit për t’i administruar tërë pasurinë e tij ose një pasuri të tij por jo tjetërsimin e këtyre pasurive për të cilat është caktuar t’i administrojë.

Vëmendje të rëndësishme në këtë kre i kushtuam nenit 76 të Kodit Civil, dispozitë kjo në të cilën parashikohen rastet e mbarimit të prokurës. Krahas trajtimit të rasteve të mbarimit të prokurës të përcaktuara shprehimisht në dispozitën e sipërcituar konstatojmë se kjo e fundit paraqiste mangësi lidhur me evidentimin e disa rasteve të tjera të cilat në mendimin tim sillnin si pasojë mbarimin e prokurës. Konkretisht në punim u parashtruan këto pyetje :

- a) Nëse duhet të konsiderohej si rast i mbarimit të prokurës edhe rasti kur i përfaqësuari është shpallur si i zhdukur me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- b) Nëse duhet të konsiderohej si rast i mbarimit të prokurës edhe rasti kur të përfaqësuarit ose përfaqësuesit i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- c) Nëse duhet të konsiderohej si rast i mbarimit të prokurës rasti kur është vërtetuar kushti zgjidhës i përcaktuar në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuari në referim kjo të përcaktimeve të nenit 85 të Kodit Civil.

Në funksion të pyetjes së parë paraqitëm edhe një shembull që i referohet një situatë që mund të jetë e pranishme në jetën e përditshme.

Lidhur me dy pyetjet e para arritëm në konkluzionin se si shpallja si i zhdukur i të përfaqësuarit ashtu edhe kufizimi i zotësisë juridike për të vepruar të këtij të fundit me vendime gjyqësore të formës së prerë sillte si pasojë mbarimin e prokurës së lëshuar nga ana e të përfaqësuarit para se të shpallej si i zhdukur, si dhe para se t’i kufizohej zotësia për të vepruar. Në arritjen në konkluzionin e sipërcituar ju referuam dispozitave ligjore që

¹⁷⁶ Referoju për këtë qëllim nenit 72 të Kodit Civil

¹⁷⁷ Referoju për këtë qëllim nenit 71 parag 1 të Kodit Civil.

¹⁷⁸ Referoju për këtë qëllim nenit 71 parag 2 të Kodit Civil.

rregullojnë situatat e sipërcituara në referim të të cilave vetë ligji ka parashikuar caktimin e një përfaqësuesi ligjor për administrimin e pasurisë së personit të shpallur si të zhdukur, si dhe për personin të cilit i kufizohet zotësia për të vepruar. Si rrjedhojë e këtyre fakteve prokura e lëshuar si nga i përfaqësuarit që shpallet si i zhdukur me vendim gjykatë të formës së prerë ashtu edhe prokura e lëshuar nga personi të cilit i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk mund të vijnë të sjellë më efekte për arsye se si rregull pushtetet e përfaqësimit të fituara në një kohë të mëvonshme lënë pa veprim pushtetet e përfaqësimit të fituara në një kohë të mëparshme pavarësisht shkakut që ka sjellë si pasojë lindjen e pushtetit të përfaqësimit. Pra pavarësisht faktit se tagrat e përfaqësimit janë rrjedhojë e vullnetit të të përfaqësuarit apo rrjedhojë e parashikimeve ligjore duhet pranuar se të njëjtat tagra të fituara nga përfaqësuesi i mëvonshëm sjellin si pasojë revokimin e të njëjtave tagreve të fituara nga përfaqësuesi i mëparshëm me përjashtim të rastit kur i përfaqësuarit e ka përcaktuar shprehimisht se tagrat e fituara nga përfaqësuesi i mëparshëm do të vijojnë të jenë në fuqi.

Lidhur me përfaqësuesin të cilit i ishte kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë situata paraqitet më e thjeshtë referuar faktit se në kuptim të ligjit kusht i domosdoshëm për ushtrimin e përfaqësimit është që përfaqësuesi duhet të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar. Në kushtet kur ky kusht si rrjedhojë e kufizimit të zotësisë juridike të përfaqësuesit mungon ky i fundit nuk mund të vijojë të jetë përfaqësues me prokurë për shkak se nuk plotëson kushtin e kërkuar nga ligji për të pasur zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Lidhur me pyetjen e tretë dhamë mendimin dhe argumentat përkatëse të cilat të shpjen në përfundimin se edhe në rastin kur është vërtetuar kushti zgjidhës në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuarit duhet të konsiderohet që prokura ka mbaruar për shkak kjo të vërtetimit të kushtit zgjidhës të përcaktuar në prokurën e lëshuar nga i përfaqësuarit.

Si përfundim pavarësisht mendimeve të dhëna nga ana ime si realizues i këtij punimi lidhur me pyetjet dhe situatat e parashtruara më lart në kushtet e ekistencës së një vakumi ligjor për rastet e referuara më lart kam paraqitur edhe rekomandimin përkatës sipas të cilit paraqitet e nevojshme që neni 76 i Kodit Civil duhet të pësojë ndryshime duke u parashikuar si raste të mbarimit të prokurës veç atyre rasteve të përcaktuara shprehimisht në dispozitën e sipërcituar edhe këto raste të tjera :

- a) me shpalljen si të zhdukur të të përfaqësuarit ;
- b) me kufizimin e zotësisë juridike për të vepruar të të përfaqësuarit ose të përfaqësuesit ;
- c) me vërtetimin e kushtit zgjidhës për rastet kur kohëzgjatja e prokurës lidhet me vërtetimin e një ngjarjeje të caktuar.

Vëmendje të rëndësishme në këtë kre i kushtuam edhe çështjes së delegimit të pushteteve të përfaqësimit nga përfaqësuesi, i njohur ndryshe edhe si nënprokura.

Në dhënien e përkufizimit lidhur me delegimin e pushteteve të përfaqësimit ju referuam autorit rus D.M.Genkin sipas të cilit *akti me të cilin përfaqësuesi cakton një person tjetër për kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, për të cilat ai ka qenë i autorizuar në bazë të prokurës të lëshuar nga ky i fundit më parë quhet*

*nënprokurë*¹⁷⁹.

Pas referimit të konceptit dhe përkufizimit përkatës lidhur me delegimin e pushteteve të përfaqësimit përcaktuam se një rast i tillë në kuptim të ligjit nuk mund të konsiderohet si humbje e pushtetit të përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit për shkak se ky i fundit vijon të jetë mbajtës i prokurës së lëshuar nga i përfaqësuari, por për shkaqe nga më të ndryshmet nuk mund t'i kryejë personalisht veprimet juridike apo veprimet e tjera të ligjshme të përcaktuara në prokurë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Në kuadër të trajtimit të delegimit të pushteteve të përfaqësimit morëm në analizë dhe dhamë edhe mendimin përkatës nëse në referim të dispozitave aktuale të Kodit Civil që rregullojnë institutin e përfaqësimit a duhet të konsiderohet e lejueshme delegimi nga ana e përfaqësuesit të pushteteve të përfaqësimit.

Lidhur me pyetjen e sipërcituar referuam se dispozita e mëparshme e Kodit Civil dhe konkretisht neni 69 i tij, para se kjo dispozitë të shfuqizohej me Ligjin nr. 8781, datë 03.05.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” për raste të veçanta të referuara shprehimisht në këtë dispozitë e kishte parashikuar mundësinë që përfaqësuesi në referim të tagreve të dhëna në prokurë nga i përfaqësuari të caktonte një person tjetër për kryerjen e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Si rrjedhojë e shfuqizimit të nenit 69 të Kodit Civil referuar faktit se një ndër karakteristikat thelbësore të përfaqësimit, si institut i veçantë i të drejtës civile është kryerja e veprimeve juridike apo veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit personalisht nga vetë përfaqësuesi rezulton që në legjislacionin tonë civil dhe konkretisht në dispozitat që rregullojnë përfaqësimin si institut të veçantë të të drejtës civile të krijohet konfuzion lidhur me faktin nëse përfaqësuesi në rast pamundësie reale të ushtrimit të pushteteve të përfaqësimit qoftë kjo edhe për shkak mungese njohurish në një fushë të caktuar do të mund të caktonte një person tjetër si zëvendës për kryerjen e veprimeve përkatëse në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit.

Në kushtet e mungesës së parashikimit ligjor situata do të paraqitej mjaft e diskutueshme edhe në rastet kur i përfaqësuari ja ka njohur shprehimisht përfaqësuesit të drejtën për të caktuar një person tjetër si përfaqësues në rast pamundësie të kryerjes së këtyre veprimeve nga ana e këtij të fundit.

Theksuam se shfuqizimi që legjislatori i ka bërë dispozitës që në raste të caktuara e lejonte përfaqësuesin për të caktuar një person tjetër si zëvendës mund të interpretohej edhe si ndalim që ligjvënësi ka dashur t'i bëjë një situatë të tillë në kushtet kur më parë e drejta e përfaqësuesit për të caktuar zëvendës ishte parashikuar shprehimisht në ligj. Ky lloj ndalimi do të kishte efekte negative jo vetëm ndaj veprimtarisë së përfaqësuesit por edhe ndaj vetë interesave të të përfaqësuarit në kushtet kur në raste të caktuara përfaqësuesi mund të mos jetë në gjendje të ushtrojë pushtetin e përfaqësimit në mënyrën më të mirë të mundshme. Si shembull referuam rastin kur prindërit si përfaqësues ligjor të fëmijës së tyre si rrjedhojë e mungesës së njohurive në fushën e së drejtës nuk do të mund të

¹⁷⁹ Referoju për këtë qëllim librit të emërtuar : “E drejta Civile sovjetike”, autor D.M.Genkin, fq.298

realizonin një përfaqësim efektiv të interesave të fëmijës së tij në raport me të tretët në ndonjë proces gjyqësor në të cilën fëmija si i përfaqësuar prej tyre ka cilësinë e ndërgjyqësit.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe në rastet e përfaqësimit vullnetar ku përfaqësuesi i caktuar me prokurë nga i përfaqësuari nuk do të mund t'i mbronte në mënyrën më efektive të mundshme interesat e të përfaqësuarit prej tij.

Si përfundim parashtrova si rekomandim se në kushtet kur shfuqizimi i nenit 69 të Kodit Civil ka krijuar vakum ligjor lidhur me të drejtën e përfaqësuesit që në raste të caktuara të mund të caktojë një zëvendës për kryerjen e veprimeve juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit paraqitet e domosdoshme që kjo dispozitë të rivendoset në Kodin Civil, në funksion kjo të evitimit të qëndrimeve të ndryshme që mund të ndeshen në praktikë lidhur me të drejtën e përfaqësuesit për të caktuar një zëvendës.

Vëmendje të rëndësishme në këtë kre sikurse e kemi referuar edhe më lart i kemi kushtuar trajtimit të institutit të përfaqësimit në raport me institute të tjera të së drejtës sikurse është gjerimi i punëve të tjetrit të parashikuar nga nenet 648 – 652 të Kodit Civil, si dhe kontrata në dobi të personit të tretë e parashikuar nga neni 694 i Kodit Civil.

Gjatë trajtimit të institutit të gjerimit të punëve të tjetrit në raport me institutin e përfaqësimit pavarësisht dallimeve thelbësore që ekzistojnë ndërmjet këtyre instituteve, dallime të cilat i kemi evidentuar në mënyrë të hollësishme konstatuam se referuar përcaktimeve të nenit 650 të Kodit Civil arrihet në përfundimin se kur gjeruesi kryen akte juridike në emër dhe për llogari të personit të interesuar, gjeruesi paraqitet në pozitën e përfaqësuesit pa tagra, si dhe veprimet e këtij të fundit mund të mos miratohen nga i interesuari kur ato janë kryer në dëm të interesave të këtij të fundit.

Gjatë trajtimit të kontratës në dobi të personit të tretë në raport me institutin e përfaqësimit përcaktuam se në kontratën në dobi të personit të tretë ky i fundit në asnjë rast nuk paraqitet si palë në kontratën që lidhet për llogari dhe në dobi të tij, ndërsa tek veprimet juridike të kryera nga përfaqësuesi gjithmonë palë në këto veprime juridike paraqitet i përfaqësuari dhe në asnjë rast përfaqësuesi, sepse në të kundërt do të ishim para kontratës së porosisë. Kontrata në dobi të personit të tretë lidhet pa pasur nevojë që të merret prokurë nga personi i tretë në dobi të të cilit ato si kontrata lidhen, si dhe kjo lloj kontrate sjell vetëm të drejta për personin e tretë në dobi të të cilit ajo është lidhur në dallim kjo nga përfaqësimi sipas të cilit përfaqësuesi ngarkohet nga ana e të përfaqësuarit për të kryer veprime juridike dhe veprime të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të këtij të fundit, mbi të cilin rëndojnë si të drejtat ashtu edhe detyrimet që lindin si rrjedhojë e veprimeve të kryera nga përfaqësuesi brenda tagreve të dhëna nga i përfaqësuari ose që i janë dhënë në referim të ligjit.

Në kreun III të këtij punimi trajtuam në mënyrë të hollësishme përfaqësimin pa tagra dhe pasojat që sjell ky i fundit në raport me të tretët. Gjithashtu trajtim të hollësishëm i kushtuam edhe fenomenit të konfliktit të interesit ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit, si dhe pasojat e këtij konflikti në raport me të përfaqësuarin.

Sikurse e kemi përcaktuar edhe më lart në këtë punim i kushtuam një kre të veçantë përfaqësimit pa tagra duke e trajtuar këtë të fundit për efekt krahasimor si në kuadër të të drejtës civile gjermane dhe asaj italiane, ashtu edhe në kuadër të parimeve europiane të të drejtës kontraktore (PECL), si dhe në kuadër të parimeve të të drejtës ndërkombëtare tregtare meqenëse ky lloj përfaqësimi rezulton të ketë një shtrirje të gjerë dhe në mënyrë të veçantë edhe në fushën tregtare.

Lidhur me përfaqësimin pa tagra përcaktuam se në ndryshim nga rasti i zakonshëm që përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit në referim të prokurës së lëshuar nga ky i fundit në jetën e përditshme mund të ndodhë që kryerja e veprimeve juridike dhe e veprimeve të tjera të ligjshme në emër dhe për llogari të një personi tjetër të mos paraprihet nga dhënia e tagrave për të bërë një gjë të tillë nga ana e të përfaqësuarit, ose kur përfaqësuesi i kapërcen apo vepron tej tagrave (pushteteve) të dhëna nga ana e të përfaqësuarit në prokurën e lëshuar prej këtij të fundit.

Të vepruarit e përfaqësuesit në situatat e mësipërme rezulton që nga ana e teorisë të së drejtës civile të jetë përkufizuar si përfaqësim pa tagra në kushtet kur askujt nuk i lejohej të ndërhyjë me anë të veprimeve juridike të tij në sferën juridike të një personi tjetër pa e pasur pushtetin apo tagrat për të bërë një gjë të tillë.

Sipas parimeve të të drejtës europiane kontraktore ky rregull shërben për të mbrojtur autonominë e vullnetit të të përfaqësuarit pasi e parandalon për të qënë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve kundër vullnetit të tij.

Pas dhënies së kuptimit të përfaqësimit pa tagra dhe përkufizimit të këtij të fundit si sipas të drejtës sonë të brendshme ashtu edhe sipas legjislacionit civil gjerman, si edhe sipas parimeve europiane të të drejtës kontraktore duke iu referuar për këtë qëllim edhe doktrinave përkatëse morëm në analizë edhe faktin nëse në kuadër të të drejtës sonë të brendshme përbënte apo jo rast të përfaqësimit pa tagra, rasti kur një person vepron si përfaqësues pas mbarimit të prokurës ose pas ndryshimeve të bëra në prokurë.

Lidhur me faktin e sipërcituar konstatojmë se në të drejtën tonë të brendshme të vepruarit e një personi në cilësinë e përfaqësuesit pas mbarimit të prokurës ose pas ndryshimeve të bëra në prokurë në dallim nga doktrina gjermane e së drejtës, si dhe në dallim edhe nga qëndrimi i mbajtur nga autorë të ndryshëm të të drejtës që kanë marrë në analizë dhe kanë interpretuar parimet europiane të të drejtës kontraktore nuk konsiderohet si rast përfaqësimi pa tagra, si dhe veprimet e kryera nga ky përfaqësues në një rast të tillë në referim të përcaktimeve të nenit 77 të Kodit Civil janë të detyrueshme për të përfaqësuarin ose për trashëgimtarët e këtij të fundit duke e kushtëzuar këtë detyrim vetëm me faktin që personat e tretë me të cilët janë kryer këto veprime juridike nuk duhet të kenë pasur dijeni për ndryshimet ose për mbarimin e prokurës.

Lidhur me faktin e sipërcituar paraqitëm opinionin përkatës shoqëruar edhe me argumentet përkatëse sipas të cilëve arritëm në përfundimin se në të kundërt nga sa parashtrohet në nenin 77 të Kodit Civil të vepruarit e një personi si përfaqësues pas mbarimit të prokurës ose pas ndryshimeve të bëra në prokurë të cilat nuk i lejojnë kryerjen e veprimeve të caktuara juridike duhet të konsiderohet si rast përfaqësimi pa tagra, si dhe që veprimet juridike të kryera në një rast të tillë nuk duhet të jenë të detyrueshme për të përfaqësuarin apo trashëgimtarët e këtij të fundit.

Si përfundim rekomandojmë se neni 78 i Kodit Civil në të cilin jepet edhe kuptimi i

përfaqësimit pa tagra duhe të riformulohet duke u përfshirë si rast i përfaqësimit pa tagra dhe rasti kur një person vepron si përfaqësues pas mbarimit të prokurës ose pas ndryshimeve të bëra në prokurë të cilat nuk i lejojnë kryerjen e veprimeve të caktuara juridike, si dhe që neni 77 i Kodit Civil duhet të shfuqizohet si dispozitë kjo që bie ndesh si me parimin e autonomisë së vullnetit të përcaktuar në nenin 79 të Kodit Civil ku dhe jepet përkufizimi i veprimit juridik ashtu edhe me parimet europiane të të drejtës kontraktore lidhur me mbrojtjen e autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit në kushtet kur e detyron këtë të fundit dhe trashëgimtarët e tij për të qenë mbajtës të të drejtave dhe detyrimeve kundër vullnetit të të përfaqësuarit.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit pa tagra u arrit edhe në përfundimin se në ato raste kur akti i përfaqësimit paraqet të meta të cilat nuk lidhen me shfaqjen e vullnetit të të përfaqësuarit, nuk duhet të konsiderohen si raste të përfaqësimit pa tagra dhe për rrjedhojë në të tilla raste nuk mund të gjejnë zbatim përcaktimet e nenit 78 të Kodit Civil, por në të tilla raste autoritetet gjyqësore në referim edhe të përcaktimeve të nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile duhet t'i lenë kohën e nevojshme përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit që të rregullojnë të metat që paraqet akti i përfaqësimit, ndër të cilat mund të jetë edhe mungesa e vulës apostile në aktin e përfaqësimit.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit pa tagra u arrit edhe në përfundimin se do jemi para rastit të përfaqësimit pa tagra edhe në ato raste kur prokura mund të paraqitet e rregullt nga pikëpamja formale por që në përmbajtjen e saj nuk përfaqëson vullnetin e të përfaqësuarit si rrjedhojë e faktit se nënshkrimi i të përfaqësuarit mund të jetë i falsifikuar, ose kur nënshkrimi është marrë si rezultat i dhunës së ushtruar ndaj të përfaqësuarit, ose si rrjedhojë e përdorimit të mashtrimit nga ana e përfaqësuesit apo edhe kur prokura e lëshuar nga i përfaqësuarit është rrjedhojë e një lajthimi.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit pa tagra u arrit edhe **në përfundimin dhe u rekomandua që** neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u përcaktuar në mënyrë të qartësishme nga ana e ligjvënësit se personit të tretë duhet t'i njihet e drejta për tu tërhequr nga kontrata me kushtin që kjo e drejtë të ushtrohet para dhënies së miratimit nga ana e të përfaqësuarit për veprimet juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Përfundimin dhe rekomandimin e sipërcituar e shoqëruam me arsyetimin se ky parashikim i ri ligjor duhet të konsiderohet si një barazpeshim i mbrojtjes së interesave ndërmjet të përfaqësuarit dhe personave të tretë në mënyrë të veçantë të atyre që janë në një mirëbesim referuar faktit se përpjekjet e këtyre të fundit për të përfituar dëmin e shkaktuar nga përfaqësuesi pa tagra për shkaqe të ndryshme përfshirë këtu edhe insolvabilitetin e personit që ka vepruar si përfaqësues pa tagra mund të rezultojnë të pasukseshme, si dhe të dëmshme edhe për veprimarinë e tyre tregtare si persona të tretë në kushtet kur vonimi në kohë i përfitimit të dëmit të pretenduar mund të ketë ndikim negativ në veprimtarinë e tyre tregtare. Gjithashtu ky parashikim ligjor duhet të konsiderohet edhe si një mundësi që i jepet personave të tretë të cilët ishin në dijeni të mungesës së tagrave nga ana e përfaqësuesit ose se ky i fundit po vepron në kapërcim të tagrave të dhëna për tu tërhequr nga këto veprime juridike të cilat do të rezultojnë të dëmshme për veprimtarinë e tyre si persona të tretë.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit pa tagra u arrit **në përfundimin dhe u rekomandua që** neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u përcaktuar në mënyrë të

qartësishme nga ana e ligjvënësit afati kohor brenda të cilit i përfaqësuarit duhet të japë miratimin e tij lidhur me veprimet e kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra, ose që personit të tretë që është në mirëbesim t'i njihet shprehimisht e drejta për t'i caktuar të përfaqësuarit një afat brenda të cilit ai duhet të vendosë për miratimin ose jo të veprimeve juridike të kryera nga ana e përfaqësuesit pa tagra.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit pa tagra u arrit ***në përfundimin dhe u rekomandua*** që neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u shtuar një paragraf në të cilin të përcaktohet shprehimisht se : ***“Miratimi nuk çënon të drejtat e palëve të tjera”***, në përputhje kjo edhe me parimet europiane të të drejtës kontraktore.

Arsyeja e vendosjes së paragrafit të sipërcituar paraqitet e detyrueshme referuar faktit se gjatë periudhës nga kryerja e veprimit juridik nga përfaqësuesi pa tagra deri në momentin e miratimit të këtij veprimi nga ana e të përfaqësuarit, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim mund të ketë pësuar dëme si rrjedhojë e veprimeve të përfaqësuesit pa tagra. Gjithashtu theksuam se parashikim i ri ligjor duhet të vendoset edhe në funksion të barazpeshimit të interesave ndërmjet të përfaqësuarit dhe personit të tretë që rezulton të ketë qenë në mirëbesim në kuadër kjo edhe të përshtatjes së legjislacionit tonë me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit pa tagra u arrit në ***përfundimin dhe u rekomandua që*** neni 78 i Kodit Civil duhet të riformulohet duke u shtuar një paragraf në të cilin të përcaktohen disa raste përjashtimore të kufizimit të përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra përkundrejt personit të tretë që ka qenë në mirëbesim.

Shkaku i një ndryshimi të tillë ligjor paraqitet i nevojshëm në kuadër edhe të përshtatjes së legjislacionit tonë me atë të vendeve të Bashkimit Europian në të cilat parashikohet rasti i kufizimit të përgjegjësisë së përfaqësuesit pa tagra përkundrejt personit të tretë kur ai arrin të provojë para gjykatës se në kohën kur është kryer veprimi juridik nuk ka pasur dijeni dhe nga tërësia e kushteve dhe rrethanave nuk mund të kishte dijeni për mungesën e tagrave, madje sipas legjislacionit hollandez ky përbën shkak përjashtimi nga përgjegjësia të përfaqësuesit pa tagra.

Në këtë kre vëmendje të veçantë i kushtuam edhe trajtimit të konfliktit të interesit në marrëdhëniet ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit, e parashikuar kjo në nenin 67 të Kodit Civil.

Në kuadër të trajtimit të konfliktit të interesit si dhe dispozitës përkatëse ligjore që e rregullon atë u arrit në përfundimin se pavarësisht se nga ana e të përfaqësuarit mund të jetë lejuar shprehimisht që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij ose me persona të përfaqësuar prej tij nëse nga këto veprime të lejuara nga i përfaqësuarit do të rezultojë që interesat e këtij të fundit janë çenuar, në interpretim të përcaktimeve të nenit 67 të Kodit Civil këto veprime juridike duhet të konsiderohen si të pavlefshme nga ana e gjykatës.

Pavarësisht përfundimit të sipërcituar u rekomandua që në funksion të evitimit të qëndrimeve të ndryshme që mund të mbahen lidhur me rastin e sipërcituar paraqitet e nevojshme që neni 67 i Kodit Civil të ndryshohet duke shtuar pas fjalisë : ***“përveç kur i përfaqësuarit e ka lejuar këtë shprehimisht”*** edhe fjalët : ***“me kusht që nga kryerja e këtyre veprimeve interesat e të përfaqësuarit nuk duhet të çënohen”***.

Vendosja edhe e fjalëve të sipërcituara do të evitonte çdo paqartësi të mundshme që mund të krijohej në rastet kur i përfaqësuari e ka lejuar shprehimisht që përfaqësuesi të kryejë veprime juridike me veten e tij dhe me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij.

Në kreun IV të këtij punimi trajtuam në mënyrë të hollësishme dallimet ndërmjet institutit të përfaqësimit nga kontata e porosisë, nga kontrata e komisionit dhe nga kontrata e agjencisë.

Në kuadër të dallimeve ndërmjet institutit të përfaqësimit nga kontrata e porosisë arritëm në përfundimin se në dallim nga përfaqësimi me anë të kontratës së porosisë nuk mundet që i porosituri për llogari të porositësit të transferojë tek të tretët të drejtat e pronësisë së porositësit mbi një pasuri të paluajtshme apo ndonjë të drejtë tjetër reale që është në pronësi të porositësit dhe që gjenden të regjistruara në regjistrat publikë në emër të këtij të fundit pa u kaluar më parë pronësia mbi këto sende apo të drejta tek i porosituri.

Në kuadër të dallimeve ndërmjet institutit të përfaqësimit nga kontrata e porosisë arritëm edhe në përfundimin se në dallim nga instituti i përfaqësimit në të cilin ekziston konflikti i interesit ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit në kontratën e porosisë nuk ekziston konflikti i interesit ndërmjet porositësit dhe të porositurit.

Në kuadër të dallimeve ndërmjet institutit të përfaqësimit nga kontrata e komisionit dhe nga kontrata e agjencisë arrihet në përfundimin se dallimet apo ngjashmëritë janë pak a shumë të natyrës së njëjtë me ato të kontratës së porosisë me disa ndryshime të vogla.

Në kreun V të këtij punimi sikurse e kemi cituar edhe më lart trajtuam përfaqësimin gjyqësor si një nga llojet më të rëndësishme të përfaqësimit duke evidentuar në këtë mënyrë edhe mangësitë përkatëse që ekzistojnë në Kodin e Proçedurës Civile lidhur me këtë lloj përfaqësimi. Në kuadër të përfaqësimit gjyqësor trajtuam edhe fenomenin e kufizimit të autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit që ndeshet dhe rezulton të jetë i pranishëm në këtë lloj përfaqësimi dhe konkretisht lidhur me barrierat apo kufizimet e vendosura nga ligji proçedural civil lidhur me të drejtën e të përfaqësuarit për të zgjedhur lirisht përfaqësuesin e tij në një proçes gjyqësor civil, në të cilin ai si i përfaqësuar ka cilësinë e palës ndërgjyqëse.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit gjyqësor vullnetar u arrit në përfundimin dhe u rekomandua që në përfaqësimin vullnetar lidhur me format e prokurës që parashikohen në Kodin Civil aktual dhe në Kodin e Proçedurës Civile aktual dhe konkretisht në nenin 72 të Kodit Civil, si dhe nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të shtohet një paragraf në të cilin të parashikohet se në rastet kur i përfaqësuari është në pamundësi reale për të shfaqur vullnetin e tij para noterit publik, si dhe ndodhet në pamundësi reale për tu paraqitur para gjykatës prokura për të ushtruar përfaqësimin gjyqësor mund të përpilohet dhe të vërtetohet edhe nga :

- a) drejtuesi i institucionit shëndetësor ku i përfaqësuari është shtruar për mjekim ;
- b) komanda e repartit ushtarak ku shërben i përfaqësuari ;
- c) drejtuesi i institucionit ku i përfaqësuari mbahet i arrestuar ose vuan dënimin me heqje të lirisë.

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit gjyqësor u arrit në përfundimin dhe u rekomandua që neni 96 parag 2 gërma “a” të Kodit të Proçedurës Civile duhet të pësojë ndryshime duke u riformuluar në këtë mënyrë :

“Nuk mund të jenë përfaqësues të palëve :

a) Personat që nuk kanë fituar zotësinë e plotë juridike për të vepruar ;

.....

Gjithashtu në kuadër të ndryshimeve ligjore që ka pësuar legjislacioni shqiptar paraqitet gjithashtu e domosdoshme që neni 6 parag 2 i Kodit Civil të pësojë ndryshime duke u riformuluar në këtë mënyrë : *“Zotësinë e plotë për të vepruar e fiton me anë të martesës edhe burri apo gruaja që nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Ato nuk e humbasin këtë zotësi edhe kur martesa është deklaruar e pavlefshme ose është zgjidhur para se të mbushin moshën tetëmbëdhjetë vjeç”.*

Në kuadër të trajtimit të përfaqësimit gjyqësor u arrit në përfundimin edhe konkretisht në kuadër të trajtimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 96 të Kodit të Proçedurës Civile lidhur me të drejtën për të qenë përfaqësues të gjyqtarëve dhe prokurorëve u arrit në përfundimin se këto të fundit nuk kanë ndonjë ndalim ligjor për të ushtruar përfaqësimin ligjor ose të detyrueshëm dhe si rrjedhojë këto të fundit duhet të lejohen nga ana e gjykatës për të ushtruar këtë lloj përfaqësimi në rastet kur fëmija i tyre i mitur është palë ndërgjyqëse në një gjykim civil.

Vëmendje të rëndësishme në këtë kre i kushtuam edhe trajtimit të përfaqësimit gjyqësor të shtetit si dhe të personave juridikë publikë duke përcaktuar se lidhur me këto subjekte në referim të kuadrit ligjor të drejtën e përfaqësimit e ka Avokatura e Shtetit.

Vëmendje të rëndësishme në këtë kre i kushtuam edhe fenomenit të kufizimit të autonomisë së vullnetit të të përfaqësuarit ku dhe përcaktuam se ashtu sikurse autonomia e vullnetit si një ndër parimet bazë të së drejtës civile i nënshtrohet kufizimeve përkatëse të përcaktuara në ligj, referuar faktit se në asnjë rast nuk mund të thuhet se është e pakufizuar për shkak se shteti me anë të normave dhe rregullave në raste të caktuara vendos kufizime mbi autonominë e vullnetit të një personi fizik apo juridik edhe dispozitat ligjore që aktualisht janë në fuqi dhe që rregullojnë përfaqësimin gjyqësor rezulton të kenë vendosur kufizime të caktuara ndaj vullnetit të të përfaqësuarit në zgjedhjen lirisht prej këtij të fundit të përfaqësuesit të tij në një proces gjyqësor në të cilin ai si i përfaqësuar është palë ndërgjyqëse.

Lidhur me kufizimet e sipërcituara shprehëm edhe qëndrimin përkatës duke arritur në përfundimin se në raste të caktuara ky kufizim paraqitet i panevojshëm.

Bibliografia

Në realizimin e këtij punimi i jam referuar trajtimeve që i janë bërë institutit të përfaqësimit nga profesorë dhe studiues njohur të të drejtës civile anembanë kontinentit europian dhe në gjithë vendet e tjera që ndjekin traditën e të drejtës civile, si dhe trajtimit që i kanë bërë institutit të përfaqësimit edhe profesorë të njohur të së drejtës civile në vendin tonë. Gjithashtu në realizimin e këtij punimi i jam referuar edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese.

Konkretisht në funksion të realizimit të këtij punimi shkencor kam studiuar dhe përdorur si material referimi këto burime literature :

1. “E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme”, botim i vitit 2012, me autor Prof.Dr. Ardian Nuni.
2. *Instituzioni di Diritto Civile* me autor Alberto Trabucchi, botim i vitit 1986.
3. “Obligimet dhe Kontratat përgjithësisht” botim i vitit 1932, i njohur ndryshe si *Komentari i Kodit Civil të vitit 1929*, botim i shtëpisë botuese “LUARASI”, i vitit 1998.
4. “E drejta Civile e RPSH – së”, me autor Andrea Nathanailin.
5. *Revista Drejtësia Popullore* nr.1/1969.
6. *E drejta civile e RPSSH – së* me autor Andrea Nathanaili dhe Nazmi Biçoku.
7. “*Traité de Droit Civil*” me autor Jacque Chestin, botim i vitit 1980.
8. *E drejta Civile sovjetike*” me autor D.M.Genkin.
9. *Diritto Privato (E drejta Private)*, me autor Francesco Galgano.
10. *Larenz and Wolf, Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Rechts. (Komentari i Kodit Civil Gjerman)*.
11. *Schramm, Münchener Kommentar zum BGB, Kommentar i Kodit Civil Gjerman*.
12. K.-H. Schramm, in F. J. Säcker (ed.) *Münchener Kommentar zum Bürgerlichen Gesetzbuch*.
13. K. Larenz and M. Wolf, *Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Rechts*, 9th edn (München: Beck-Verlag, 2007).
14. Lando and Beale, *Principles of European Contract Law, Parts I and II*.
15. *International Institute for the Unification of Private Law, 2004*. Teksti i plotë shoqëruar me komentarin www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles. [www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2004/intergralversionprinciples2004 – e.pdf](http://www.unidroit.org/english/principles/contracts/principles2004/intergralversionprinciples2004-e.pdf). UNIDROIT Agency Convention D.Busch, *Indirect Representation in European Contract Law (The Hague : Kluwer Law International 2005)*.
16. Përfaqësimi pa tagra, botuar nga Danny Busch dhe Laura J. Macgregor (*THE UNAUTHORISED AGENT, Perspectives from European and Comparative Law*).
17. *Schramm, Münchener Kommentar zum BGB, (Komentari i Kodit Civil Gjerman)*.
18. *The Contribution of Mixed Legal Systems to European Private Law (Antwerp: Intersentia, 2001)*.
19. *Les contrats pour le compte d’autrui: essai critique sur les contrats conclus par un intermédiaire en droit français (Toulouse: F. Boisseau, 1950)*.
20. ‘L’apparence, source autonome d’obligations, ou application du principe général de l’exécution de bonne foi’, *JT* 1989, faqe 543.
21. ‘Aspects de la représentation en matière contractuelle’, in *Les Obligations Contractuelles (Brussels: Jeune Barreau Edn, 2000)* Foriers, faqe 79.
22. *Les intermédiaires commerciaux (Brussels, Editions du Jeune Barreau de Bruxelles, 1990)*.
23. *New Netherlands Civil Code: Patrimonial Law (Property, Obligations and Special Contracts) (The Hague/London/New York: Kluwer Law International, 1999) (CD-ROM edition)*.
24. *Koppert-Van Beek, M. S., Handelen namens een op te richten vennootschap (Deventer: Kluwer, 2003)*.
25. *Geschiedenis van het nieuwe Burgerlijk Wetboek, Boek 3, Vermogensrecht in het algemeen (Deventer: Kluwer, 1990)*.

26. Van Schaick, A. C., *Volmacht* (Monografieën Nieuw BW. B-serie; 5) (Deventer: Kluwer, 1999).
27. Van der Grinten, W. C. L., *Lastgeving* (Monografieën Nieuw BW: B-serie; 81) (Deventer: Kluwer, 1999).
28. ‘Het leerstuk van de opgewekte schijn van volmacht en de EngelsAmerikaansrechtelijke leer van de “apparent authority”’, in *Honderd jaar rechtsleven. De Nederlandse Juristen-Vereniging 1870–1970*, (Zwolle: Tjeenk Willink, 1970), pp. 1–24; reprinted in Van Dunné, J M, Nieuwenhuis, J H, Vranken, J B M (eds), *Verspreid werk van Prof. Mr. H. C. F. Schoordijk*, (Deventer: Kluwer 1991), faqe 197–221.
29. Zwitser, R., ‘De aansprakelijkheid van de onbevoegde vertegenwoordiger naar Burgerlijk recht en Handelsrecht’ (1999), faqe 199–208.
30. Conant, M., ‘The Objective Theory of Agency: Apparent Authority and the Estoppel of Apparent Ownership’ (1968) 47 *Neb L Rev* 678–704.
31. Müller-Freienfels, W., ‘Law of Agency’ (1957) 6 *Am J Comp L* 165–188.
32. Morse, G., *Charlesworth’s Company Law*, 17th edn (London: Sweet & Maxwell, 2005).
33. Pappas, T. G., ‘Rescission by Third Party Prior to Principal’s Ratification of Agent’s Unauthorized Action’ (1948) 2 *Vand L Rev* 100–108.
34. Powell, R., *The Law of Agency*, 2nd edn (London: Pitman & Sons Ltd, 1961).
35. *Commentaries on the Law of Scotland and on the Principles of Mercantile Jurisprudence*, 7th edn, by J. McLaren (Edinburgh: T. & T. Clark, 1870; reprinted 1990).
36. Dunedin, Viscount, Wark, J. L. and Black, A. C. (eds.), *Encyclopaedia of the Laws of Scotland*, 1st edn (Edinburgh: W. Green & Sons Ltd, 1913) vol. I.
37. Feltham, P, and Hochberg, D. and Leech, T., in S. Bower, *The Law Relating to Estoppel by Representation*, 4th edn (London, Butterworths, 2004).
38. Fridman, G. H. L., *The Law of Agency*, 7th edn (London: Butterworths, 1996).
39. ‘Good Faith’, in H. MacQueen and R. Zimmermann (eds.), *European Contract Law: Scots and South African Perspectives* (Edinburgh: Edinburgh University Press, 2006), faqe 43–73.
40. Reynolds, F. M. B. and Davenport B. J., *Bowstead on Agency*, 14th edn (London: Sweet & Maxwell, 1976).
41. Stoljar, S. J., *The Law of Agency* (London: Sweet & Maxwell, 1961).
42. Jooste, R., ‘The Law of Agency’ (1975) *Annual Survey of South African Law* 95.
43. Pothier, R. J., (trans. B. G. Rogers and B. X. de Wet), *Treatise on the Contract of Mandate* (Johannesburg: Lex Patria, 1979).
44. *Bowstead and Reynolds on Agency*, 18th edn (London: Sweet & Maxwell, 2006).
45. Wanda, B. P. (original text by J. C. de Wet), ‘Agency and Representation’, in W. A. Joubert et al. (eds.), *The Law of South Africa*, 2nd edn, 34 vols. (Durban: LexisNexis Butterworths, 2003), vol. 1, faqe 167–223.
46. *Principles of European Contract Law. Parts I and II*, (The Hague/ London/Boston: Kluwer Law International, 2000).
47. Lando, O., Clive, E., Prüm, A. and Zimmermann, R. (eds.), *Principles of European Contract Law. Part III* (The Hague: Kluwer Law International, 2003).
48. Bonell, M. J., ‘Agency’, in A. Hartkamp, M. Hesselink, E. Hondius et al. (eds.), *Towards a European Civil Code*, 3rd edn (Nijmegen/The Hague: Ars Aequi Libri/Kluwer

Law International, 2004).

49. Busch, D., *Indirect Representation in European Contract Law* (The Hague: Kluwer Law International, 2005).

50. Reynolds, F. M. B., 'Authority of agents' (2005) ICC International Court of Arbitration Bulletin, Special Supplement, UNIDROIT Principles: New Developments and Applications, page 9–16.

51. H. van Kooten, et al. (eds.), *The Principles of European Contract Law and Dutch Law. A Commentary* (The Hague/London/New York/Nijmegen: Ars Aequi Libri/Kluwer Law International, 2002).

52. Bester, D. H., 'The Scope of an Agent's Power of Representation' (1972) 89 SALJ 49–70.

53. Brown, I. 'The Agent's Apparent Authority: Paradigm or Paradox?' (1995) JBL 360–372.

54. Bork, R., *Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Gesetzbuchs*, 2nd edn (Tübingen: Mohr Siebeck-Verlag, 2006).

55. Canaris, C.-W., *Die Vertrauenshaftung im deutschen Privatrecht* (München: BeckVerlag, 1971).

56. Laband, P., 'Die Stellvertretung bei dem Abschluß von Rechtsgeschäften nach dem allgemeinen Deutschen Handelsgesetzbuch' (1866) 10 ZHR, 183.

57. Flume, W., *Allgemeiner Teil des Bürgerlichen Rechts – Das Rechtsgeschäft*, vol. II (Berlin: Springer Verlag, 1965).

58. 'Volmacht en sterkmaking bij oprichting van vennootschappen', in A. BenoitMoury, O. Caprasse, N. Thirion and B. Tilleman (eds.), *De oprichting van vennootschappen en de opstartfase van de ondernemingen* (Brussels: Die Keure, 2003), p. 332.

59. De Quenaudon, R., 'Le mandat', *Jurisc Dalloz*, fascicule 20.

60. Didier, P. and Lequette, Y. *De la représentation en droit privé* (Paris: LGDJ, 2000) Esmein, P., JCP 1963, II, 13104.

61. Flattet, G., *Les contrats pour le compte d'autrui: essai critique sur les contrats conclus par un intermédiaire en droit français* (Toulouse: F. Boisseau, 1950).

62. Le Tourneau, Ph., 'Mandat' (2000) *Répertoire de droit civil* 26–52.

63. Storck, M., *Essai sur le mécanisme de la représentation dans les actes juridiques*, LGDJ, *Bibl. dr. Privé*, t. 172, 1982.

64. Chen, C.W., *Apparence et représentation en droit positif français* (Paris: LGDJ, 2000).

65. Izorche, M. L., 'A propos du contrat sans représentation' (1999) *D Chron* 369–74 Le Gall, J., *French Company Law* (London: Oyez Publishing, 1974).

66. Cauffman, C., 'The Principles of European Contract Law', TPR 2001.

67. Van Ommeslaghe, P., 'L'apparence comme source autonome d'obligation et le droit belge' (1983) *Rev Dr Int Comp* 154.

68. Capitant, H. (ed.), *Les Grands Arrêts de la Jurisprudence Civile*, 10th edn (Paris: Dalloz, 1997).

69. Dumont, M.-P., *L'opération de commission* (Paris: Litec, 2000).

70. E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave, Pjesa e Posaçme, me autore Marjana Semini.

71. Istituzioni Di Diritto Privato (Institucionet e të Drejtës Private) me autor Mario Bessone, botim i G.Giappichelli, Torino 2003.

72. E drejta Procedurës Civile, me autor Alqiviadh Lamanin, botim i vitit 1961.

- 73.** E Drejta e Procedurës Civile, me autorë Stavri Çeço, Ylbere Malindi, Safet Hasani, botim i shtëpisë botuese të librit universitar, viti 1989.
- 74.** Vendim nr. 913, datë 08.11.1968 i Gjykatës së Rrethit Shkodër.
- 75.** Vendim nr. 154, datë 13.12.1968 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- 76.** Vendim nr. 1, datë 06.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- 77.** Vendimi nr. 516, datë 11.03.2003 të Gjykatës së Lartë.
- 78.** Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 09.04.2003.
- 79.** Vendimi nr. 976, datë 27.09.2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- 80.** Vendim nr. 1378, datë 24.10.2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- 81.** Vendim nr. 939, datë 27.09.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- 82.** Vendim nr. 1364, datë 12.12.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Abstrakt (shqip – anglisht)

Abstrakt

Studimi i realizuar ka për objekt të tij trajtimin e përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile duke sqaruar për këtë qëllim si konceptin e përfaqësimit dhe zhvillimin historik të këtij të fundit, ashtu edhe llojet e përfaqësimit, si dhe trajtimin e tij në raport me institute të tjera të ngjashme të së drejtës. Në kontekstin e tezës së doktoraturës janë marrë në analizë problematika të shumta që ndeshen në jetën e përditshme në marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit, ndërmjet përfaqësuesit dhe personave të tretë me të cilët ai ka kryer veprimet juridike në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, si dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe personave të tretë. Në këtë punim një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përfaqësimit pa tagra duke e trajtuar këtë të fundit për efekt krahasimor si në kuadër të të drejtës civile gjermane dhe asaj italiane, ashtu edhe në kuadër të parimeve europiane të të drejtës kontraktore (PECL), si edhe në kuadër të parimeve të të drejtës ndërkombëtare tregtare. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe trajtimit të konfliktit të interesit në marrëdhëniet ndërmjet të përfaqësuarit dhe përfaqësuesit. Pjesë e këtij punimi është edhe përfaqësimi gjyqësor, si një nga llojet më të rëndësishme të përfaqësimit.

Lidhur me problematikat e konstatuara në kuadër të trajtimit të përfaqësimit si institut i veçantë i të drejtës civile janë dhënë edhe konkluzionet përkatëse shoqëruar kjo edhe me rekomandimet për ndryshimet që duhet ti bëhen dispozitave përkatëse që rregullojnë këtë institut të së drejtës.

Fjalët kyçe : Përfaqësim, i përfaqësuar, përfaqësues, përfaqësim ligjor, përfaqësim vullnetar, prokurë, përfaqësim pa tagra, person i tretë, konflikt interesi, gjerim i punëve të tjetrit, gjerues, kontratë në dobi të personit të tretë, kontratë porosie, kontratë komisioni, kontratë agjencie, përfaqësim gjyqësor.

Abstract

The object of the study is the presentation of the *Representation* as a special institute of civil law, explaining for this purpose the concept of representation and its historical development, the types of representation, as well as its treatment in relation to other similar law institutes. The context of the doctoral thesis analyzes many problems encountered in everyday life to the relations between the representative and the represented party, between the representative and third parties with whom he has performed legal actions in the name and on behalf of the represented party, as well as between the latter and third parties. This paper work emphasizes the importance of the representation without entitlement, treating it for comparative reasons, within the framework of German and Italian civil law, within the framework of European principles of contract law (PECL), as well as within the principles of international commercial law. Special attention is paid to the conflict of interest in relationship between the representative and represented party. Judicial representation is also part of this paper, as one of the most important types of representation. Regarding the problems identified, the relevant conclusions were given, accompanied by recommendations for changes to be made to the relevant provisions governing this institution of law.

Keywords: Representation, represented party, representative, legal representation, voluntary representation, power of attorney, representation without rights (entitlement), third party, conflict of interest, completing of another's work, the person completing other's work, contract for the benefit of a third person, order contract, commission contract, agency contract, judicial representation.